

BIBLIOTEKA
SHËTETIT

85H-32

A 14

ALI ABDIHOXHA



MIRAZH

TREGIME
DHE NOVELA

8JH-32

A 14

ALI
ABDIH OXHA

MIRAZH

tregime
dhe novela



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

N J Ë P U N Ë T O R

1

— Mirëmëngjes! — tha shkrimtari.

— Mirëmëngjes! — tha inxhinieri i sektorit.

Inxhinieri i sektorit të montimit të Uzinës së Çelikut ishte djalë i ri, inxhinier i ri, por megjithatë flokët i kish-te të rralluar, kurse nga pamja vinte pak i hajthëm. Prej disa ditësh shkrimtari vërtitej në zyrën e tij dhe si pada-shur dhe si rastësisht shikonte çfarë bënte e me se me-rrej ai. Shkurt: ai ishte shkrimtar i ri dhe përgatitej të shkruante një tregim për një inxhinier të ri. Por ndodhi që tregimi i parë nuk u shkrua për inxhinierin e ri. Ndosh-ta ai tregim do të shkruhej më vonë, shkrimtari i ri i ruan edhe sot e kësaj dite ato materiale. Ai ruan edhe materia-le të tjera, sepse në Metalurgjik ai kishte parë shumë gjëra nga më të ndryshmet. Para se të vinte këtu, gruaja i thosh-te: shko në Kombinat. Të afërmit i thoshin: shko në Ko-mbinat. Edhe shokët e Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Elbasanit i thoshin të shkonte në Kom-binat. Të gjithë i thoshin ose e porosisnin nga pozita e njerëzve që pandehin se kanë medoemos të drejtë. E me-që të gjithë donin që ai të shkonte në Kombinat, një ditë të mirë mori bilokun e shënimeve, lapsin, i hipi urbanit

dhe shkoi. Duke e bërë zakon t'i kalonte atje orët e lira, shkrintari i ri pa shumë gjëra, por nga ato që e çuditën më shumë qenë kolektivi shumëmiqësh i punëtorëve, ai ambient i ri dhe i panjohur, qenë ato biseda me tema të ndryshme nga ato të rrethit të tij, ajo dëlirësi në sjellje dhe ai shpengim për të mbrojtur ata që kishin të drejtë, apo për të kritikuar cilindo qoftë që përpiquej të përfitonte në kurriz të të tjerëve. Atje ai kishte zbuluar ose po zbulonte një botë tjetër nga ajo që kishte njohur më parë dhe këtë po e zbulonte aty ku figura e Metalurgjikut rritej e zbukurohej para syve të tij me shpejtësi të pabesueshme, jo vetëm, por, duke u rritur, ajo bëhej dita-ditës e fuqishme, imponuese me ato konture e konstruksione prej çeliku, që shtriheshin në gjerësi e ngriheshin në lartësi. Kudo çelik. Asnjë tullë, ose fare pak: në ndonjë mur, apo objekt, që do të përdorej për depo apo garderobë, në ndonjë oxhak dhe asgjëkundi tjetër.

Si zakonisht, shkrintari i ri u fut edhe atë mëngjes në zyrën e inxhinierit të sektorit, pa asnjë parandjenjë, pa asnjë gjë të veçantë.

— Mirëmëngjes! — tha ai prapë.

Ky «mirëmëngjes» i dytë s'kishte të bënte me inxhinierin. Ai i qe adresuar furnizuesit të sektorit.

— Mirëmëngjes! — tha furnizuesi i sektorit, Artan Marku, me mbiemër mirditor, megjithëse Artani s'ishte mirditor, ndoshta vetëm stërgjyshërit mund të kishin qenë nga Mirdita. Ai ishte krutan.

Ky Artan nuk ishte i ri, siç ishte inxhinieri i sektorit, as burrë në moshë, siç ishte, bie fjala, planoviku. Ai vërtitej rreth të tridhjetave, po edhe më tepër, mund të ishte moshatar me normistin e sektorit, që ishte një tip i gjallë e që ta jepte përgjigjen aty për aty, kurse Artani ishte e kundërta e tij ose gati e kundërta. Artani ishte tip i urtë, të linte përshtypjen e një njeriu të qullur, përjetë i lodhur ose përjetë i pakënaqur me vetveten, ose me fatin e vet, ose me një dhimbje të pakuptueshme, ta zëmë, në njërën nga brinjët dhe sytë i kishte gjithmonë si të dremitur. Por të gjitha këto përshtypje, nëse mund t'i quajmë negative nga

forma apo nga paraqitja dhe e gjithë kjo pamje e përfjetur e Artanit, binin në kundërshtim me punën e tij si furnitor, që e detyronte të ishte tërë ditën në lëvizje, tërë ditën në operativitet. Të paktën për ato kohë që shkrimtari i ri vërtitej aty rrotull, Artan Marku rrallë shikohej në zyrë, rrallë shikohej mbi tabelat e formularët e tij, vetëm atë mëngjes...

Atë mëngjes, i kërrusur para tryezës mbi regjistrat e furnizimit, ai uli e ngriti kokën disa herë. Më në fund, zuri të shënonte diçka përmes vizave paralele të tabelave të mëdha që kishte hapur përpara. Befas, Artani vendosi lapsin kopjativ në xhepin e vogël të xhaketës, lëshoi qepallat mbi sy dhe një copë herë s'bëri asnjë lëvizje, si të qe duke dremitur. Edhe frymëmarrjen e kishte prej njeriu të dremitur, ose prej njeriu që e kishte zënë gjumi.

— Sot nuk mund ta ngremë vinç-urën! — tha një punëtor, pa futur mirë këmbën e dytë në zyrë.

— Në aksin B? — pyeti inxhinieri.

— Po.

— E pse?

— U sëmur brigadieri! — tha punëtori. — Tha prapë: — Pa të nuk e bëjmë dot, jemi të gjithë të rinj në këtë zana!

Inxhinieri u mendua një çast. Shikoi shkrimtarin e ri, si t'i thoshte: «E shikon?... Një e papritur!»

Tha:

— Brigadieri u sëmur, por vinç-ura duhet ngritur sot!

Tha prapë inxhinieri:

— E padiskutueshme!

Dhe pyeti:

— Si t'ia bëjmë?

Punëtori shikoi nga furnizuesi.

— Artani, ndoshta...

— Artani po fle, — tha pa të keq shkrimtari dhe pa kuptuar thelbin e bisedës.

— Artani ka punuar tërë natën! — tha inxhinieri. — Erdhi kontigjent i ri furnizimi dhe punoi tërë natën mbi tabelat e librat e tij. Ja, aty e gdhui!

Ndoshta pa një ëndërr, ndoshta dëgjoji emrin e vet, se Artan Marku, megjithëse pamjen e kishte gjithmonë si të dremitur, gjumin e kishte të lehtë, tundi kokën, lëvizti buzët, ngriti qepallat përgjysmë (ai dremiste me mjekrën mbi gjoks e jo me kokën mbi tryezë) dhe tha:

— Ah!

Tha prapë:

— Me mua e keni? — dhe bëri përpjekje të dështuar për të vënë buzën në gaz. Buzëqeshja nuk pajtohej me natyrën e tij, ajo dukej si një pullë e ngjitur gabimisht në atë fytyrë të qetë e të dremitur përjetë.

— Si është puna? — pyeti Artani, duke shikuar nga punëtori.

— Vinç-ura!

— Çfarë vinç-ura?

— U sëmur brigadieri, — tha punëtori.

Artan Marku gogësiu me dorën para gojës (shkrimtari i ri kishte vënë re se ai nuk gogësinde kurrë pa vënë dorën para gojës) dhe sytë e tij filluan të sqaroheshin, të bëheshin gri, të errët. Tashti edhe vështrimi i Artanit s'kishte të bënte më me dremitjet e me gogësimat. Ai u ngrit pa folur, u fsheh prapa një dollapi të gjatë prej hekuri a prej llamarine dhe pas pak doli prej andej me çizme e me një xhakëtë të vjetër lëkure një pëllëmbë mbi gjunjë (ishte dimër) dhe:

— Shkojmë! — tha.

Te pragu qëndroi me vështrimin nga inxhinieri.

— Dokumentacioni është në rregull, — tha.

— Kujdes, mos të të merret mendja nga pagjumësia!
— tha inxhinieri.

Artani buzëqeshi. Me atë buzëqeshje ai sikur deshi të thoshte: «Jo, s'më gjen gjë!»

— Megjithatë, kujdes!

«Jo» tha prapë buzëqeshja e Artan Markut.

Pas disa minutash, Artani, punëtori tjetër dhe shkrimtari i ri u gjendën nën çatinë e Uzinës së Çelikut, që tashmë e kishte marrë pak a shumë fizionominë e saj e që nga përmasat e volumet, nga lartësitë, gjerësitë e largësitë e

kolonave e të akseve ngjante me një sallë të madhe apo madhështore, me një sallë plot ambiente të ndryshme, që nesër ose pasnesër (në të ardhshmen, në një të ardhshme të afërt) në këto salla, në këto kate e ambiente të ndryshme, të hapura e të ajrosura do të shkrihej çeliku i parë shqiptar. Këtu arritën dhe këtu i pritën montatorët, këtu e priste edhe vinç-ura gati njëqindtonëshe, që do të ngrihej në aksin B të uzinës. Kjo vinç-urë duhej të ngrihej atë ditë dhe, për ta ngritur, ishte në gatishmëri brigada bashkë me një vinç-kullë.

Tashti vëmendjen e shkrimtarit të ri zuri ta tërhiqte puna përgatitore e brigadës së montimit, puna e vinçerit me lëvizjet e rënda e të matura të vinçit-kullë, e sidomos aktiviteti i Artan Markut, të cilin ai e kishte njohur vetëm si furnizues dhe nuk i kishte shkuar asnjëherë në mendje se ky Artan, me trupin vërtet pak të madh, por si të zbërthyer, që nuk shquhej as për fjalën e zjarrtë, as për gjallërinë e gjymtyrëve, mund të bënte edhe punë të tjera, sidomos një punë të tillë. Por, pas disa minutash ai nuk e njohu më furnitorin. Tashti që kavot e vinçit-kullë e kishin rrethuar vinç-urën, siç rrethon një piton gjahun e vet, tashti Artan Marku hidhej mbi krahët e skeletet e vinç-urës si një shpend i shkathët dhe i fuqishëm, ndërsa vinç-ura që do të ngrihej lart shtrihej akoma përtokë si një fosil vigan i kafshëve prehistorike të periudhave që zënë fill milionëra vjet më parë. Pastaj fosili zuri të ngrihej lart, zuri të ishte më pak fosil, zuri t'u ngjante më shumë vinç-urave që ishin ngritur më parë, me të vetmin ndryshim se nuk ishte akoma i plotë dhe se ai ishte ngarkuar me shumë baltë e me shumë pluhur sepse, duke qëndruar shumë kohë në tokë, mbi kurrizin e tij kishin kaluar furtuna e ciklone, llaçera e betone të ndërtuesve, hekurishte e copëra metalesh të montatorëve.

U dëgjua bilbili i Artan Markut, si bilbili i një arbitri suprem.

Dora horizontal: fiksoje aty.

Vinç-ura mbeti pezull një metër mbi tokë.

U dëgjua prapë bilbili i Artanit.

Disa punëtorë të brigadës hipën mbi fragmentet e para të vinç-urës, që sapo ishte ngritur nga toka. Tashti ata shembëllenin me shkencëtarë, apo me bashkëpunëtorë shkencorë, ose me studentë, ose me punëtorë të një muzeu natyror, të cilët, para se të ngrënë e të montojnë skeletin e përbindshit prehistorik mbi konstruksionet metalike, e pastrojnë atë nga baltovinat e nga pluhuri shekullor. Ata e pastronin me ç'të mundnin, por shumica me fshesa dhe shkrimtari i ri dukej tepër i çuditur, tek shikonte fshesat në duart e montatorëve. Bile atij as që i kishte shkuar në mendje se edhe pastrimi me fshesa mund të merrte pjesë në proceset e montimit.

Kishte filluar ngritja e vinç-urës, ngritja e gjysmës së saj, njërit krah të vinç-urës, që peshonte disa dhjetëra tonë. Kishin filluar kështu edhe akordet e bilbilat të Artan Markut, tingulli i vazhdueshëm i të cilit donte të thoshte: vazhdo ngjitjen! Një goditje e fortë dhe e prerë e tij: stop! Plus shenjat konvencionale të duarve e të gishtave, që kanë edhe ato rregullat e tyre gramatikore, sintaksore e pantomimatike. Gishti i madh përpjetë: ngjitu drejt. I lëvizur në mënyrë të vazhdueshme: ngjitu drejt dhe shpejt. Gishti i madh poshtë: ule. I lëvizur disa herë drejt tokës: ule akoma. Kështu, krahu i vinç-urës, ky masiv çeliku, apo masiv fosilesh, lëvizte, ngrihej, ulej, nga mënyra si vibronin bilbilat, nga mënyra si lëvizte gishti i njëjës dorë ose gishtat e mëdhenj të të dyja duarve, ose nga mënyra si lëviznin vetëm duart.

Pastaj do të ngrihej edhe krahu tjetër, më i rëndë se i pari. Dhe herën e tretë do të ngrihej kareli, që manovron ganxhat dhe në fund kabina e komandimit të vinçierit. Pasi të ishin ngritur të gjitha këto pjesë deri në trarët apo në shinat nën tavanin e uzinës, që s'janë asnjëherë më pak se njëzet metra lart, atëherë do të fillonte ajo që quhej punë e imtë, do të bëhej montimi i tyre në një të tërë. Para se vinç-ura të hyjë në librat e dorëzimit, bile para se rrotat e saj të vendosen mbi shinat, brigada e montatorëve bashkë me Artan Markun, me vinçierin e vinçin-kullë, do të djersiten akoma, bilbilat do të bien qindra herë, puna

apo procesi i punës do të zbrapsen, do të fillojnë nga e para, do të ngatërrohen kabllot, do të lidhen me litar e do të mbahen të tendosura nga montatorët, që e kanë rrethuar vinç-urën nga të gjitha anët.

Pikërisht kur vinç-ura ishte rrethuar plotësisht, pikërisht në këtë çast shkrimtari i ri i ndërpreu shënimet, u lëshua drejt kabllit të tendosur e të ngatërruar dhe e tërhoqi si gjithë të tjerët, vrapoi e u kthye nja dy herë në barakë për të marrë një levë apo... ngjiti e zbriti shkallët e ngushta dhe prapë tërhoqi kabllin bashkë me ata që u ndodhën më afër, e bashkë me ata u lodh e u djersit gjithë paraditën, gati gjithë ditën, derisa vinç-ura u vendos mbi trarët e shinave diku atje nën tavanin e uzinës.

Gjë e bukur, kështu mendoi shkrimtari dhe këtu mendoi ai t'i jepte fund tregimit në imagjinatën e tij, që do të ishte tregimi i parë që shkruante për Metalurgjikun, i pari edhe për atë vetë. Ndërkaq Artan Marku, punëtorët, vinçieri, bashkë me ta inxhinieri i ri, që gjatë ngritjes së vinç-urës kishte ardhur e shkuar disa herë — të gjithë këta ishin ulur tashti mbi disa hekurishte dhe po pinin cigare. Edhe një çudi tjetër për shkrimtarin e ri: megjithëse ai, fatkeqësisht e pinte duhanin, kjo ishte cigarja e parë që ndizte nga mëngjesi. Por jo vetëm ai. Kjo ishte cigarja e parë për të gjithë, edhe për Artan Markun, që i ishin zverdhur gishtat nga nikotina. Asnjë s'ishte kujtuar ta ndizte. Edhe po të qe kujtuar, do ta kishte pasur të vështirë të gjente kohë për të pirë. Me orë të tëra kishin zotëruar fishkëllimat e bilbilave, të prera e të zgjatura, sipas kuptimit e kërkesave, ose shenjat konvencionale të duarve e sidomos të gishtave, ose më saktë, të drejtimit që merrnin gishtat.

Por tashti kishin marrë fund të gjitha. Dielli i shkurtit kuqëlonte. Edhe thëllimi ishte bërë më i fortë. Ata pinin duhan me jaka të ngritura, sepse vetëm tashti ata e ndienin të ftohtët e mbrëmjes së shkurtit.

Para se të ktheheshin në qytet, atyre do t'u duhej të punonin edhe pak nën dritën e projektorëve apo të llamba-ve të mëdha, për ta fiksuar vinç-urën në shina, sepse mund

të ndodhte që të frynin erëra të forta dhe skeleti i fosilizuuar i përbindshit prehistorik të zemërohej, të shkiste, të kërcente e të binte në tokë, duke dëmtuar veten e duke bërë dëme të tjera. Kështu, derisa t'u dorëzohej brigadave elektrike, të cilat nga ana e tyre do t'i qepeshin, siç i qepen ushtarët në sulm një së përpjete, për t'i bërë lidhjet e fundit, ato mijëra lidhje dhe, një mëngjes të mirë, gjithë ai përbindësh do t'i nënshtrohej një leve apo një çelësi nga më të vegjlit që mund të jenë fabrikuar ndonjëherë. Bile për këtë do të mjaftonte vetëm një buton.

Kështu brigada piu cigaren e dytë dhe u largua nga Uzina e Çelikut kur ishte errësuar dhe kur nata ishte bërë më e ftohtë.

Artan Marku dhe shkrimtari i ri u kthyen në zyrë. Inxhinieri i sektorit punonte akoma.

Artan Marku pyeti për ndonjë të re, mblodhi formularët apo librat e furnizimit, i mbylli në dosje, dosjen në sirtar, u fut pas dollapit të madh prej hekuri a prej llamarine dhe doli prej andej i veshur «civil», ashtu siç e kishte parë në mëngjes shkrimtari i ri, kur Artani shënonte diçka me qepallat gjysmë të rrëzuara, ose kur dremiste me mjekrën të mbështetur në gjoks. Ai kishte kaluar një natë pa gjumë, tashti kishte kaluar edhe një ditë të lodhshme. Po sytë nuk i mbylleshin si në mëngjes. Ndoshta do t'i mbylleshin më vonë. Hëpërhë pathosi i punës, që e kishte emocionuar dhe eksituar gjithë ditën, nuk i kishte kaluar akoma, mendonte shkrimtari i ri.

Ecën në heshtje, shkrimtari dhe furnitori, që s'ishte më vetëm furnitor për sytë e shkrimtarit. Shkurtuan rrugën përmes komplekseve të Metalurgjikut, konturet e të cilit, në errësirën e natës e nën ndriçimin e llambave, merrnin një madhësi të veçantë, përzier me një farë enigme po aq të veçantë e të pangjashme me enigmat e zakonshme. Ndodhte kështu, sepse kjo enigmë nuk buronte nga gërmadhat, ku zakonisht këndojnë bufi e qyqja, as nga pyjet e vetmuara e të pashkelura, ajo ishte një tjetër enigmë; ajo buronte nga zhurmat e punëtorëve të turnit të dytë, nga goditjet e çekanëve të tyre, që përçinonin, që saldonin,

që lidhnin kapriata, që shtronin çati e rrihnin llamarina, që ngulnin shtylla e konstrukte të rënda, që shtronin shina e hapnin kesone. Një enigmë që s'ishte enigmë, enigmë metali, enigmë çeliku, kishte filluar përsëri të mendonte shkrimtari i ri, e kështu derisa arritën në stacionin e autobusit, derisa hipën në autobus dhe shkuan në qytet, e prej aty në restorant. Ky do të jetë rreshti i fundit i tregimit tim, tha me vete shkrimtari. Tashti kohën e kishte të lirë. Mund të hante bukë e mund të bënte çfarë të donte.

2

Tha Artan Marku:

— Unë kam bërë punë të ndryshme. Para se të fute-sha në shkollë, mbaj mend që kullosja një qingj dhe një dhi malteze. Qingjin babai e theri në vjeshtë, kur martuam motrën dhe unë qava për qingjin.

Tha:

— Pastaj u ndava edhe nga dhia. Kishte ardhur koha për t'u futur në shkollë. Por vitet që kalova me dhinë malteze mezhdave dhe arave në periferi të qytetit, më kanë lënë kujtimet e punës sime të parë si bari!

— Pasi mbarova shtatëvjeçaren, — tha ai, — atëherë nuk kishte tetëvjeçare, babanë tim e këshilluan të më çonte në Liceun Artistik të Tiranës, sepse kisha zë të fortë. Më bënë provat në qytetin tonë të vogël, nuk mbaj mend si e çfarë këndova, por një ditë babai më tha:

— Fitove!

— Çfarë fitova, i thashë unë.

— Do të shkosh në Tiranë, tha ai, të mësosh për të kënduar!

— Babai im, — tha Artani, — e kishte qejf muzikën dhe ato ditë ishte shumë i gëzuar që i biri do të bëhej kën-

gëtar. Por unë këngëtar nuk u bëra. Kisha zë, por s'kisha vesh, kështu më thanë në Lice. Kjo ishte e vërtetë. Unë e dija që s'kisha vesh për muzikë.

Ata kishin zënë një tryezë në qoshe të restorantit dhe varavinga e njerëzve që hynin e dilnin vazhdimisht, ose që flisnin e qeshnin, s'para i pengonte. Kamerieri u solli listën e gjellëve. Pastaj racionet e bukës. Pastaj mori porosinë dhe u solli supë me barishte. Ata filluan të hanin me oreks. S'kishin ngrënë tërë ditën, kishin uri. Ai, Artani, furnizuesi i sektorit apo brigadieri i brigadës montatore (për atë ditë) porositi përsëri një racion bukë.

Pyeti:

— Po ti, s'do më bukë?

— Jo, — u përmbajt shkrimtari i ri dhe aty për aty u pendua. Tha: — Të shoh më vonë!

— Unë sot kam uri! — tha Artani.

Kamerieri solli racionin e dytë të bukës për Artanin. Tashti sytë e tij ishin më të qartë se në mëngjes. Ishin fare gri. Gri të errët. Dhe sikur u kishte ikur gjumi. Është akoma i eksituar nga tensioni i punës që bëri sot, mendoi shkrimtari.

Tha Artani:

— U ktheva nga Liceu e nga Tirana dhe, pasi u vërtita ca ditë nëpër shtëpi, vendosa që shkollën e mesme ta mbaroja natën.

— Atëherë? — e pyeti shkrimtari i ri, që po dyshonte se tregimi i tij nuk kishte marrë fund me largimin nga Metalurgjiku një orë më parë.

— U futa në kooperativën e qytetit dhe punova tokën bashkë me babanë. Babai im ishte bujk i mirë dhe unë fillova dalngadalë të bëhesha bujk i mirë si babai. Harrova të të thosha se, që ditën e parë që u futa në bujqësi, mbi të gjithë u gëzua gjyshja ime!

— Pse?

— Ajo kishte një opinion të ngulitur fort në kokë, që secili duhej të mësonte e të dinte një zanat në jetë. Ose të bënte tryeza, karrige, të piqte bukë, ose të zinte gjerba, të ngrinte mure, të qepte, të endte, ose të bëhej bujk.

të prodhonte grurë e misër. Secili duhet të mësojë një zanat, thoshte ajo dhe thoshte se këtë këshillë e kishte dëgjuar nga gjyshi i vet, domethënë nga katragjyshi im, — vuri buzën në gaz Artani.

Tha:

— Punova tre vjet me babanë në bujqësi, në kooperativën e qytetit. Një ditë më thanë se isha emëruar instruktor në komitetin e rinisë së rrethit. Kështu u largova nga bujqësia, por gjyshja ime i vari buzët e nuk i qeshi fytyra për pesë vjet që unë punova në rini. Rrethi ynë është i vogël, por punët ishin të mëdha e të ndërlikuara, sepse unë punova me ririnë në ato vite kur Partia e thelloi më tej luftën kundër zakoneve të vjetra dhe mbeturinave të ideologjive të huaja në ndërgjegjen e njerëzve. Ti e di, Kruja është vend malor dhe në malësi kishte shumë nga këto.

— Po gjyshja nuk m'u nda. Ajo më thoshte vazhdimisht se mjaft kisha qëndruar në rini, se tashti, më thoshte ajo, kishte ardhur koha të mësoja një zanat dhe më numëronte tryezat, djepat, dollapët, këpucët, lopatat, kazmat, e çfarë nuk më thoshte, po vetëm në zyrë nuk duhej të punoja më, sepse, thoshte ajo, burri që kapërcen të njëzetepesat dhe nuk ka fituar një zanat, ai burrë nuk vlen asnjë grosh. Kështu thoshte gjyshja ime. Dhe ishte e zemëruar me mua. Zanat, më thoshte, sapo të më shikonte majën e hundës. A di të bësh mulli kafeje, më pyeste ajo. Jo, i thosha unë. Po të paktën, a di të mprehësh një mulli kafeje, më pyeste ajo. Jo, i thosha unë. Turp, thoshte ajo.

— Kështu janë disa njerëz. Ata kanë dëshirë të thonë mendimin e tyre dhe kanë dëshirë të bëhet ashtu si duan ata. Njërit i pëlqen zyra, tjetrit bujqësia, tjetrit çekiçi e sharra, dhe secili përpiqet t'u mbushë mendjen të tjerëve për atë që i pëlqen atij. Kështu edhe me gjyshen time. Ishte opinioni i saj që unë të mësoja një zanat. O zanat, o s'ka. Edhe qetësinë time e prishi, edhe të vetën.

Kamerieri solli të dytat: rosto derri. Solli përsëri bukë për Artanin. Ishte gjysma e tretë e panines. Kurse shkrimtari i ri porositi gjysmën e dytë.

Tha Artani:

— Rostoja e derrit do pak verë. Kamerier! — thirri ai.

Kamerieri e kishte zakon të mos fliste, por të kërruste kokën: «Të dëgjova», donte të thoshte ajo kërrusje koke.

— Dy gota verë! — tha Artani.

Kamerieri kërrusi kokën dhe mori kthesën. Nuk pranonte të prapakthehej, por medoemos i pëlqente ta mban-te kokën pak shtrembër e të bënte një rreth njëqindtetëdhjetëgradësh. Solli dy gotat me verë dhe iku duke bërë po atë rreth.

— Tashti nuk ishte vetëm gjyshja që më thoshte të mësoja një zanat. Edhe tezza më thoshte, kur do të mësoja një zanat. Nëna, gjithashtu, edhe motra. Gati të gjithë. Një ditë edhe vëllai pesëvjeçar më tha kur do të mësoja një zanat. Unë çuditesha. Si është e mundur që të gjithë u bënë me gjyshen? Jo vetëm njerëzit e shtëpisë, por edhe fa-refisi, edhe fqinjët e të njohurit. Gjyshja ime është e çuditshme. Atë që ka në kokë, përpiqet t'ua fusë të tjerëve në tru e në gjak, si një sëmundje ngjitëse, si një epidemi. Është e fortë për opinion gjyshja ime. E ndikuar nga ajo, bota rreth meje nuk më lejonte të jetoja pa një zanat. Isha i ri, thoshin ata, ishte shumë shpejt për t'u marrë me punë zyre. Kështu thoshin dhe ishin bërë të gjithë si gjyshja.

Tha:

— Shkurt, më hyri edhe mua në qejf të mësoja një zanat. Mendimi i gjyshes kishte triumfuar, më ishte ngjitur edhe mua si rrodhe, ashtu siç u ishte ngjitur të gjithëve. Zanat. Një ditë shkova në komitetin e partisë, ngrita duart lart dhe thashë: zanat. U shpjegova mendimin e gjyshes, të të afërmve, timin dhe thashë: zanat! Shokët e komitetit të partisë qeshën dhe e pranuan lutjen time. Kuptohet, që gjatë kësaj kohe unë kisha hyrë në Parti, kuptohet, që kisha mbaruar të mesmen pa shkëputje nga puna, isha martuar. Njëri nga shokët tha se kishin nevojë për një komunist në oficinën e SMT-së.

— Shkova në oficinën e SMT-së dhe muajt e parë sharrova ose përkula hekura. Pastaj fillova nga riparimi i traktorëve. Fillova kështu të hidhja hapin e parë në punët mekanike. Të mos e zgjas, pas një viti kishim nevojë për mekanikë në Laç. Më transferuan atje. Prej andej, një vit më vonë dola vullnetar dhe erdha këtu, në Kombinatin Metalurgjik. Ishte viti 1970.

— Atëherë në fushën e Bradasheshit, përveç Petëzimit të imtë, ngritur disa vjet më parë, s'kishte asgjë. Kisha ardhur këtu si mekanik, por në fillim punonim ku të kishte front pune, herë si muratorë, herë hapnim kanale, herë themele, herë mbartnim gurë. Bile, meqë kisha bërë tre vjet punë e zanat bujku, ndihmova edhe kooperativistët e Bradasheshit në korrjen e shirjen e grurit në ato parcela ku ne duhej të hapnim themele. Ashtu ishte në fillim. Atëherë kantieri kishte vetëm një brigadë mikse dhe unë isha një nga pjesëtarët e parë të kësaj brigade. Brigada e parë. Më vonë u bë një e dytë. U krijuan brigada të tjera, sektorë, ndërmarrje, drejtorira, drejtoria e përgjithshme, komiteti i partisë së rajonit e tjerë e tjerë, derisa u krijua ky kantier i madh që ti shikon sot, nga më të mëdhenjtë në Shqipëri.

Artan Marku e shikoi shkrimtarin e ri, sikur ai të ishte pas një mjegulle të dendur, apo si të ishte një kilometër larg. Shkrimtari vuri re se diku në thellësitë e syve gri të Artanit po ngriheshin disa hije të lodhura, ose diçka e ngjashme me to, që e turbullonin atë gri të fortë e që hidhnin mbi ata sy një vel gjumi ose shumë vela dremi-tjesh. Pagjumësia, tha me vete shkrimtari dhe kujtoi mëngjesin kur Artan Marku flinte ose dremiste në karrige me mjekrën në gjoks.

Tha:

— Tre vjet më parë në Kombinatin kishte vetëm një brigadier dhe vetëm një brigadë që mund të ngrinte e të montonte peshat të rënda. Po fronti dhe ritmi i punimeve kërkonin shumë brigada.

— Artan, më tha një ditë drejtori, sikur ti me brigadën tënde, që deri më sot ke luajtur rol të dorës së dytë,

të provosh të ngresh një vinç-urë, pa ndihmën e brigadës të Skënderit, si thua?

— Jo, thashë unë, kam frikë se më vritet ndonjë nga shokët. Mund të bëj edhe dëme të tjera.

— Skënderi tha se brigada e Artanit mund ta bëjë një gjë të tillë.

— Ashtu tha Skënderi? — Shikoi shkrimtarin: — Skënderi është mjeshtri im!

— Po, tha drejtori.

— Jo, thashë unë dhe ika.

Artani piu gërqen e fundit të verës.

— Ishte një natë e bukur gushti, nga ato net kur njeriu e ndien veten të lumtur dhe s'ka qejf të mbyllet në shtëpi a në konvikt. Atëherë u thashë shokëve të brigadës:

— A kthehemi në Kombinat?

— Pse?

— Të ngremë vinç-urën. Nesër në mëngjes një surprizë...

Tha:

— Ngrohtësia e natës së gushtit na bënte jo vetëm të lumtur, por edhe sikur na jepte guxim, na bënte të mëdhenj. I ke parasysh ato netët e verës, që të freskojnë nga vapa e që në atë freski e ngrohtësi bashkë, njeriut sepse i shtohet besimi në vetvete? Të paktën mua kështu më duket. Të paktën me mua kështu ndodhi.

— U kthyem në Kombinat me mendimin se edhe po nuk e bëmë, nuk humbasim asgjë, qoftë nga orari, qoftë... Po në mëngjes njëri krah i vinç-urës ishte ngritur, më vonë ngritëm krahun tjetër, ngritëm karelin e ganxhave dhe në mbrëmje kabinën e komandimit. Kështu filloi. Vinç-urat që kemi ngritur në Kombinat janë më të mëdhatë në Shqipëri.

Ai kapri gotën e verës, por u kujtua që e kishte pirë. E la prapë në tryezë.

— Sikur u lodhëm, ë? — pyeti Artani.

— Ë? — pyeti prapë Artani.

— Po, — tha shkrimtari i ri.

— Kamerier! — thirri Artani.

Kamerieri, megjithëse u ndodh aty afër, bëri rrotullimin e tij të famshëm njëqindetëdhjetëgradësh.

Ky njeri, mendoi me vete shkrimtari, pasi kishin dalë nga restoranti, punon mirë edhe si furnizues, edhe në krye të brigadës montatore për ngritjen e peshave të rënda. Por jo, Artan Marku jo vetëm punonte mirë, por ai ishte edhe një tregimtar i zoti, u kujtua shkrimtari, ai fliste bukur e thjesht dhe shkrimtari s'do ta kishte vështirë ta shkruante tregimin e tij të parë, i cili tashmë nuk do të merrte fund me mbarimin e punës në Metalurgjik. Tashti ai kishte vendosur t'i shtonte tregimit edhe bisadat që bëjnë në restorant. Bile kishte një parandjenjë se edhe bisadat e restorantit mund të mos ishin fundi i tregimit.

Ndërsa ecnin përkrah njëri-tjetrit, shkrimtari pyeti:

— Ta pëlqeu gjyshja këtë zanat?

— Cilin zanat?

— Zanatin e montatorit!

Ecën disa hapa në heshtje.

— Jo, — tha Artani.

— Pse?

— Të thashë, — tha Artani, — zanat ajo quan kur di të bësh gjëra të nevojshme e të dobishme për përdorim të përditshëm, nga tryezat deri te hapja e themeleve, deri te mbjellja e qepëve, e orizit, e grurit, e misrit e çdo gjë tjetër që e njeh dhe e merr me mend.

Tha shkrimtari:

— Pse nuk e merr një ditë në Kombinat të shohë me sy punën që bën ti?

— Erdhi, — tha Artani. — Mezi u shkul nga shtëpia e nga qyteti.

— Dhe?

— Më ndezi belaja. Erdhi një javë më parë. Do ti, më gjeti në zyrë, siç më gjete ti sot në mëngjes, të kërrusur mbi tabelat.

— Prapë në zyrë më qenke mbledhur zotrote, më tha.

— Jo, i thashë, jam montator. Ajo më shikoi me sy të turbullt. Jam punëtor, i shpjegova prapë. Ajo më shikoi po me ata sy të turbullt. Bashkë me shokët ngre pesha të rënda në tavanet e uzinave!



— Në tavanet, tha, se vetëm këtë fjalë kishte kuptuar dhe vetëm kjo fjalë e kishte ngrohur disi. Por deshi të dinte prapë me këmbëngulje, ç'bëja unë në zyrë.

— Më kanë sjellë shokët e drejtorisë përkohësisht si furnizues, i thashë unë.

— Ç'është kjo, si ajo puna në rini?

— Jo, u gjej dhe u shpërndaj material punëtorëve që të punojnë.

Artan Marku shikoi nga shkrintari.

Tha:

— E kisha vështirë t'i shpjegoja fazën, në të cilën ndodheshin punimet në Uzinën e Çelikut, se tashti që jemi në pikun më të madh të punimeve, çështja e furnizimit ka dalë në plan të parë, është një nga pikat më nevralgjike të kantierit, por si t'ia shpjegoja gjyshes të gjitha këto? Ej, thashë me vete, po fillon përsëri gjyshja të më vihet prapa, dhe ti e kupton, po t'u qep ajo, tërë botën e ngre më këmbë. Por jo, duket më pa në zor, nuk e zgjati e më tha:

— Pa hajde njëherë të shohim, ç'janë këto punë që bëmë ti nëpër tavanet e fabrikave?

Tha Artan Marku:

— U hodhi një sy objekteve të Kombinatit, kudo hekur, diçka pëshpëriti për hekurin, përpëliti qepallat dhe vuri dorën në ballë.

— Ç'ke, gjyshe, i thashë unë.

— Më dhemb koka, më tha ajo.

— E çova te Uzina e Çelikut, — tha Artani, — që është si një labirint apo si një pyll fantastik kolonash, kapriatash, aksesh, trarësh konvertitorësh, furrash, platformash, vinç-urash, ganxhash, karelesh, kabinash, shinash në tokë e në tavan, kate mbi kate dhe të gjitha këto, të gjitha pa përjashtim ose gati pa përjashtim, të gjitha prej çeliku.

Artan Marku ngriti jakën e palltos prej lëkure. Efekti i verës që piu kishte kaluar dhe tashti në rrugën e gjerë ndiente të ftohtë.

Tha:

— Vura re se i bëri shumë përshtypje Uzina e Çelikut, sidomos vinç-ura, sidomos ganxhat e kavot e tyre të më-

dha, për të cilat ajo tha se u ngjanin çengelave të mishit që varnim në shtëpi, kur babai therte ndonjë qingj. Ti e pe, në Uzinën e Çelikut këto ganxha e kavo varen kudo, ato varen me gjatësi të ndryshme, me madhësi të ndryshme e nga lartësi të ndryshme, në sheshe, në platforma e kudo. Të gjitha të mëdha. Kur them se i bënë përshtypje ganxhat e kavot sidomos, e çdo gjë tjetër që i panë sytë, dua të them se Uzina në tërësinë e saj i kishte futur gjyshes një si farë frike. Asaj i dukej sikur kishte rënë në një botë tjetër, ku gjithçka ishte e panjohur për të. Më shtrëngo- goi krahun, ma shtrëngoi fort, dhe tha:

— Prandaj i thonë metalurgji e zezë kësaj!

— Eh, gjyshet tona, — tha Artani. — Unë e dua shumë gjyshen time! Por unë bëra një gabim trashanik. E pyeta pikërisht për vinç-urat e për ganxhat e tyre, në i pëlqenin apo jo dhe i thashë se disa nga ato i kishte ngritur brigada ku punoja unë. Ajo më shikoi me sy të trembur, hoqi dorën nga balli, ku e mbante shpesh, që kur tha se kishte dhimbje dhe e vuri mbi kokë, si ta mbronte nga diçka. Klithi pak dhe tha se i merrej mendja, se duhej të ikte sa më shpejt. Unë e mora për krahu dhe nuk e lëshova derisa hipëm në autobus.

— Ama zanat paske mësuar, më tha gjyshja kur e kishte marrë pak veten në autobus!

— Tashti ajo shikonte disi e qetësuar njerëzit që ecnin, karrocet, delet që kullosnin livadheve e çdo gjë tjetër të dashur për të, intime, të afërt, të njohur qysh në fëmijëri e qysh në rininë e saj!

— Të bukur zanat, çengela, apo si i quajte ti, ganxha, ku mund të varen njëqind buaj!

— Po ç'quan zanat, ti, gjyshe, e pyeta unë me tërë mend.

— Të kam thënë, mullirin e kafesë, tha ajo me tërë mend, po edhe me inat.

Tha Artani:

— Padashur qesha. Gjyshja e kishte zor të kuptonte se në zanatin e nipit të saj, si ngritës i vinç-urave, ajo kishte luajtur një rol të madh dikur.

— Edhe më qesh, më kërcënoi gjyshja!

— Po kur ajo m'i tha këto fjalë, në të vërtetë unë isha i ngrysur, isha edhe i lodhur, por isha i ngrysur, sepse doja ta bindja gjyshen, doja ta mbërtheja me fjalë, megjithëse e dija se ajo për herë të parë shikonte një kantier të madh, qoftë edhe të vogël.

— Po mirë, moj gjyshe, i thashë unë, ta lëmë zanatin mënjanë, po ti s'më the një fjalë për punën që kemi bërë ne?

— Edhe gjyshja u ngrys si unë dhe u mendua gjatë, — tha Artan Marku.

— Çfarë, ma priti ajo me inat, do të më bësh politikë tashti?

— Jo, pse, Gjyshe, i thashë unë.

— Ç'më di ti, mua, plakë të prapambetur?

— Jo, gjyshe!

— Afro veshin, më urdhëroi ajo, se t'i kam nja dy fjalë të mos na i dëgjojnë bota!

— Unë afrova veshin dhe ajo afroi buzët te veshi im, — tha Artan Marku, — por i afroi kot, se për të folur, foli me zë të lartë:

— S'ka gjë, do të mësosh më vonë të bësh, ta zëmë, edhe mullinj kafeje. Babai im mësoi t'i mprichte mullinj të e kafesë kur ishte dyzet vjeç!

Tha Artani:

— Befas në autobus plasi një e qeshur e përgjithshme. Duket, punëtorët, që ktheheshin si ne në qytet, dëgjuan e dëgjuan pastaj... Kurse gjyshja ime nuk i ngriti sytë të shikonte njeri. Ajo kishte rënë në mendime të thella. Por e keqja ishte se bashkë me të tjerët qesha edhe unë.

— Edhe ti, më kërcënoi gjyshja!

Artan Marku dhe shkrimtari i ri u ishin afruar konvikteve. Ishte natë shkurti, ishte natë dimri. Nuk ishte natë e ngrohtë vere, natë gushti, por ishte shkurt dhe bënte ftohtë. Dhe s'para kishte njerëz nëpër rrugë. Diku dëgjohej zhurma e një frigoriferi në një dyqan mishi. Dëgjohej edhe fishkëllima e erës në majat e pishave të bu-

levardit rrëzë kalasë së vjetër të Elbasanit. Në qiell yjet
ia hidhnin pantomimës së tyre të përgjumur.

Tha Artan Marku:

– Natën e mirë!

– Natën e mirë! – tha shkrimtari i ri.

– Së shpejti do të më japin apartament dhe, kur të
më vijë gruaja bashkë me të dy fëmijët, do të të ftoj një
të diel!

– Falemnderit! Natën e mirë!

– Natën!

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

PHYSICS DEPARTMENT

1

K Ë S H I L L A T

Kur erdhi në vete në spital (kjo ndodhi dy orë më vonë) Ardian Dobini pa se ishte gjallë dhe, përveç që kishte një dhimbje të përgjithshme në trup, nuk mundi të kuptonte menjëherë ç'kishte ndodhur me të. Pak nga pak vuri re se njërin sy ia kishin fashuar, i kishin fashuar të dy bërrylat, brinjët, më në fund kuptoi se bashkë me syrin i kishin fashuar edhe kokën. Me të parë e me të prekur këto fasho e garza, menjëherë mendoi se duhej të kishte dhimbje dhe në çastin tjetër ndjeu vërtet, si me porosi, dhimbje të forta pikërisht në pjesët e fashuara. Tashiti ai kishte ardhur plotësisht në vete. Rrotull tij vërtiteshin nja tre mjekë, dy infermiere, brigadieri, Pal Moni dhe ai punëtori tjetër me vështrim të ndezur e me flokë të kuq, që e quanin Astrit Caka. Më përtej në korridor ai pa edhe fytyra të tjera të njohura të brigadës, që rrinin në heshtje dhe shikonin brenda në dhomë, shikonin nga ai. Nga fytyrat e atyre që e rrethonin e nga fytyrat e atyre që e shikonin nga korridori, ai kuptoi se gjendja e tij nuk ishte aq e rëndë, se njerëzit ishin të qetë ose ishin qetësuar dhe se ai kishte shpëtuar përfundimisht. Nuk foli, as kërkoi gjë, as pyeti dhe, megjithëse ishte

akoma i tronditur, i mallëngjyer apo i emocionuar, gjatë minutës së parë që kishte ardhur në vete, ai kishte bërë ca prova të vogla në duar, në këmbë e në bel dhe ishte bindur se duart, këmbët dhe shtyllën kurrizore, këto gjymtyrë e pjesë, që mund ta pësonin nga ai rrëzim, i kishte pothuajse në rregull. Dhe ishte qetësuar disi. Veçse nuk dinte si e qysh kishte ndodhur. Pal Moni, si të kishte kuptuar dëshirën e tij, i tha se ai kishte luftuar si burrat, nuk e kishte humbur gjakftohtësinë, ishte mbajtur nga një tra në tjetrin, në çdo rast kishte mundur t'ia priste vru-llin trupit, derisa kishte rënë në katrorin tjetër të llamarinës, që i kishte shërbyer dikur si shesh çlodhjeje një brigade elektrike pranë pultit të komandimit dhe aty kishte ngecur, aty duhej të kishte vrarë kokën dhe kishte humbur ndjenjat. Pastaj Pal Moni i tha se e kishin zbritur në tokë me ndihmën e vinçit e të ganxhave.

Pak më vonë pyetjes së mjekëve, si kishte ndodhur që ishte rrëzuar, Pal Moni i ishte përgjigjur se nuk e dinte, se gjëra të tilla ishte vështirë të merreshin me mend, ndoshta Ardiani do ta thoshte vetë, por Pali mendonte se ajo turbullirë, që i kishte marrë mendjen, e kishte buri-min te shkallët, pikërisht te shkallët, vetëm te shkallët. (Me të thënë këto fjalë, Pal Moni e kishte fiksuar vështrimin e vet te sytë e Ardianit, por e kishte fiksuar në mënyrë të çuditshme). Ai, Pal Moni ishte i mendimit se Ardian Dobini, ndonëse montator e mekanik, nuk ishte mësuar t'u ngjitej shkallëve aq të pjerrëta, aq të ngushta, por edhe fare thikë, siç ishin ato të kuotës 30, që rrallë ndodhnin nëpër objekte. (Vështrimi i Palit ishte fiksuar ose ishte zhytur sërish në sytë e Ardianit, por kësaj radhe ai kishte qenë më kuptimplotë, ose gati kuptimplotë, ai sikur donte t'i thoshte se nuk kishin qenë shkallët arsyeja e vërtetë e rrëzimit, se këtë ai nuk do ta besonte kurrën e kurrës, dhe askush nuk do ta besonte, po të dinte aq sa dinte Pali.) Pastaj Pali u tregoi mjekëve hollësisht e ngjitetes nëpër shkallë, se si ishte ndodhur pranë tij, se si në një moment të caktuar Ardiani kishte dashur të përshëndeste shokët poshtë, se si Pali i kishte dhënë një të shtyrë pikërisht në shkallaren

e fundit, sepse i qe dukur sikur Ardiani ishte vonuar pa arsye. Fjalët e fundit ai i kishte shoqëruar me vështrimin e çuditshëm, të fiksuar për herë të tretë në sytë e Ardianit, ose më saktë, në syrin e vetëm të Ardianit, sepse tjetrin e kishte të fashuar.

Pastaj Ardian Dobinin e vizituan me radhë sekretari i organizatës-bazë, komunistët e tjerë nga dy e nga tre; erdhën nga sektori e nga drejtoria; erdhën edhe nga komiteti i partisë; rierdhën shokët e brigadës, midis të cilëve xha Toli e Loni, Mrica e Nadirja e shumë të tjerë. I fundit fare erdhi për ta parë edhe Dalan Leka, që i kishte lënë përshtypje të mirë në mbledhjen e organizatës së partisë, në radhë të parë për mendimet që kishte shprehur për të, pastaj edhe për zërin e matur, për gjestet e matura, për fytyrën në ngjyrën e bronzit e, sidomos, për flokët e thijnur, si t'u kishte hedhur miell përsipër, të cilët, duke gjykuar nga sytë, duhej të kishin qenë ngjyrë kafe.

Familjarët, gruaja, prindërit etj., nuk erdhën as atë ditë, as të nesërmen, as ditët e tjera. Ardiani u qe lutur shokëve dhe administratës së spitalit të mos bënin asnjë lajmërim në Lezhë, sepse atij do t'i vinte turp që të afërmit, shokët e oficinës dhe të ndërmarrjes, miqtë, të njohurit e farefisi ta merrnin vesh ç'i kishte ndodhur, pa hedhur mirë këmbën në Kombinatin Metalurgjik.

Të gjithë këta që i vinin për vizitë, meqë pandehnin se Ardianit i kishte ndodhur një incident në ngjitje, krejt i rastit, e uronin të shërohej shpejt e të kthehej sa më parë, se objekti 500 i uzinës N ishte në valën e punës dhe kuota 30 së shpejti do të bëhej sektori më urgjent e më i rëndësishëm në të gjithë objektin e në të gjithë uzinën.

Vetëm brigadieri, Pal Moni, që kishte qenë dëshmitari më i afërt e që kishte parë me sytë e vet mënyrën si ishte rrëzuar (pastaj Pali u bazua edhe në disa nga çastet e ngjitjes nëpër shkallë, që pak më vonë, pas rrëzimit, ai e kishte kuptuar menjëherë përmbajtjen e kuptimin e tyre) vetëm ai ishte i bindur se rrëzimi i Ardianit s'kishte të bënte me ndonjë aksident të rastit.

Të nesërmen Pal Moni erdhi vetëm në spital, e shikoi përsëri me sytë blu të pastër, si një copë qiell (para atij shikimi Ardiani uli kokën, uli edhe sytë) dhe tha:

— Shpëtove mirë, por në të ardhshmen duhet të kesh kujdes. Së shpejti do të kemi edhe aty poshtë punime të vështira. S'është gjithmonë me të thënë, por edhe me të dhënë. Më shikon mua ti? Edhe unë, kur isha më i ri, gati dhjetë vjet më parë, gjeta në shtëpi një mandolinë të vjetër e të pluhurosur të babait. Nëna më kishte thënë se asaj kohe babai merrte pjesë në korin apo në orkestrën e punëtorëve të qytetit. Edhe unë desha ta mësoja mandolinën. Në fillim ëndërroja t'i bija vetëm në dhomën time e t'i bija për vete, pastaj midis shokëve. Por nuk i rashë as për vete as për shokët, s'qe e mundur, nuk e mësova që nuk e mësova. Çfarë nuk bëra që t'ia arrija qëllimit, e lustrova, kujtova se fajin ma kishin telat, i ndërrova disa herë, por megjithatë mandolinën nuk e mësova.

Pal Moni në fillim qeshi ngadalë, pastaj fort (duhet të themi se Pali e kishte të qeshurën të fortë) pas tij qeshi edhe Ardian Dobini, por Ardiani qeshte ngadalë, sepse, kur fliste shumë e kur qeshte shumë, koka e fashuar e shqetësonte, po edhe dhimbje i jepte.

Tha Pal Moni:

— Ëndrra më mbeti vetëm ëndërr!

2

O B J E K T I V I

Mbledhja e organizatës-bazë kishte mbaruar ose ishte gati në të mbaruar. Rendi i ditës kishte qenë ngritja ideopolitike, arsimore dhe profesionale e punëtorëve të obje-

ktit 500 në uzinën N. Kishin folur për ata që shkonin mirë, për ata që kishin braktisur kurset e kualifikimit apo shkollën e mesme industriale pa shkëputje nga puna, ose për ata që, në zallahinë e madhe të uzinës, ku punonin jo më pak se tri mijë punëtorë (pa llogaritur ato mijëra forca vullnetare që vinin e shkonin) u kishin bërë bisht kurseve e shkollës e nuk ishin regjistruar fare. Kishin thënë se këto qëndrime ndaj ngritjes ideologjike dhe kualifikimit profesional ishin çështje koncepti: mjaft kaq sa di, nuk më duhet më tepër. Por disa kishin ngulur këmbë se kjo nuk ishte çështje koncepti. Atëherë të tjerët u kishin shpjeguar prapë se këto qëndrime kishin të bënin me mendime të vjetra, që e kishin bazën në punën artizanale, u kishin thënë se niveli i ri i teknikës së ndërtim-montimit kërkonte ngritje e nivel të ri, u kishin thënë se ky ishte realiteti dhe askush s'mund t'i shmangej atij etj. etj.

Së fundi, kur mbledhja gati kishte mbaruar dhe njëzetit ishin gati në të ngritur, sekretari i organizatës-bazë të partisë tha se ai shoku i ri, që shikonin të ulur në stolin e fundit, ishte Ardian Dobini, kandidat partie nga rrethi i Lezhës, që kishte ardhur ose e kishin dërguar aty për të bërë stazhin e Partisë. Sipas rregullave, shokët kërkuan që Ardiani t'u fliste për biografinë e vet. Ardiani jo se deshi me qëllim t'u fliste shkurt, por si djalë njëzet e pesë vjeç, biografia e tij ishte vërtet e shkurtër: nxënës në ekonomi e punëtor që në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare, bir punëtori, nëna punëtore, e shoqja punëtore (me një djalë motak) vazhdonte shkollën industriale pa shkëputje nga puna dhe... dhe ndonjë hollësi tjetër, pastaj heshti, pastaj u ul. Pastaj u bisedua se në ç'brigadë duhej të punonte. U bënë propozime nga më të ndryshmet, por shumë nga këto propozime të ndryshme u afruan me njëri-tjetrin, u bashkuan, dhe, pothuaj, shumica ishin të mendimit që Ardian Dobini duhej të punonte në brigadën mekanike të Pal Monit, në objektin 500, sepse ajo brigadë kishte mbetur për një kohë të gjatë pa komunist dhe sepse në atë brigadë ndihej nevoja për një komunist, që të përçonte vijën e frymën e organizatës-bazë në brigadë.

Pyeti Ardiani:

— Pse?

I thanë se brigadieri, Pal Moni kishte disa të meta. I thanë se tek ai ishin shfaqur ngadalë këto të meta, por kjo s'kishte rëndësi, rëndësi kishte fakti që ishin shfaqur!

— Për shembull? — pyeti Ardiani.

Për shembull, i thanë se Pal Moni mbante pranë tre ose katër vetë, sigurisht, më të mirët e më të zotët. Me ta përpiquej të zgjidhte çdo gjë, të bënte çdo gjë të vështirë. Atyre u besonte proceset më të ndërlikuara. Atyre u jepte volum pune më shumë, si rrjedhim edhe lekë më shumë. Vetëkuptohet që s'para përpiquej për kualifikimin e të tjerëve. Si rregull, shoqet i caktonte të lyenin me bojë makinerinë, pajisjet apo detalet që do të montoheshin lart. Edhe unim e kishte pak të zhvilluar. I pëlqente t'i lëvdoheshin puna dhe nuk pranonte kritikë, as llogari nuk jepte para brigadës, ose, edhe kur jepte, e kalonte lehtë, fare lehtë. Shpirtin e repartit e kishte të zhvilluar e, meqë kishte sedër të sëmurë, kur shikonte se brigada fqinjë po ia kalonte, ai rendte pas globalit, duke lënë për më vonë ato procese pune që nuk i ngrinin planin. Në përgjithësi planin e realizonte, por jo grafikun, sepse tashti, për shembull, kishte braktisur punimet e imta në aksin B, që i duhej dorëzuar pa vonesë shfrytëzimit dhe ishte hedhur në aksin A për vendosjen e montimit e disa pajisjeve të rënda. U tha se vërtet disa nga të metat e fundit, ndonëse të rëndësishme, mund të rregulloheshin e të kapërceheshin me urdhër, por u tha, gjithashtu, se një gjë e tillë, meqë ishte kronike te Pal Moni, bëhej shkak për kokëçarje e shqetësime të tjera. Duhej bindja, duheshin thyer konceptet e shtrembra. Duheshin vendosur koncepte të reja, socialiste.

Ardiani u ngrit e tha:

— Me leje?

— Fol!

— Në përgjithësi këto të meta, më duket, se nuk janë të reja e të panjohura për brigadat e montimit, por unë desha të dija, a nuk ka asgjë të mirë ky Pal Moni?

Atëherë filloi përshkrimi dhe zbulimi i anës tjetër të medaljes, pra, kishte filluar seria e punëve dhe e shfaqjeve pozitive të Pal Monit. Bile u tha se disa nga cilësitë e Palit duhej të ktheheshin në normë për shumë brigada të tjera dhe po të punohej, e tërë brigada mund të merrej si shembull i mirë në të gjithë kantierin. I thanë se Pali ishte shumë punëtor. Kishte brigadierë që e kthenin veten në mbikëqyrës. Ai jo. Ai drejtonte dhe në të njëjtën kohë punonte vetë si gjithë të tjerët; ishte tepër i kualifikuar; ishte i guximshëm; i dhimbsej pasuria socialiste; kërkonte disiplinë; kishte iniciativë, p.sh. ai kishte dhënë i pari kuptimin, por edhe shembullin personal se furnizimin nuk e zgjidhte dot një furnitor, as dhjetë, po nuk patën ndihmën e çdo brigade e të çdo punëtori. Bile, kur mungonte automjeti, ishte vetë ai, Pali, që ngarkohej me tuba, me llamarinë apo me kablo. Ai nuk mund të pranonte që brigada të mbetej pa punë nga mungesa e furnizimit në kohë. Sa për rëndësinë e furnizimit ritmik e në kohë, ata thanë se atë e kuptonte çdo punëtor, mjafton të kishte punuar dy ditë në një kantier.

— Pali ka dhe shumë cilësi të tjera të mira, që do t'i shikosh vetë në punë e sipër! — tha sekretari. Tha prapë: — Ky është afërsisht Pal Moni me të mirat e me të metat e tij! — Tha prapë: — Po ti, ç'thua?

— Unë ç'them? — mbeti Ardian Dobini.

Ra heshtje.

— Unë them se qenka njeri i ngatërruar! — tha Ardiani. — Edhe bardhë, edhe zi!

— S'është vetëm Pali bardhë e zi, por, sigurisht, Pali ka individualitetin dhe origjinalitetin e vet dhe aty qëndron vështirësia për të punuar me të, — tha sekretari. — Ç'thua, pra?

— S'ka ç'thotë ai, të themi ne që e njohim Palin, — tha një tjetër. — Unë them të mos e çojmë Ardianin në brigadën e Palit!

Kështu, që nga ky çast, në organizatë u zbulua qëndrimi i kundërt me propozimin që ishte bërë, të cilin e mbështetën disa komunistë, duke thënë se, po të ishte e

domosdoshme të çonin patjetër një komunist në brigadën e Palit, ky s'duhej të ishte Ardiani, por një tjetër më me eksperiencë. Pa përmendur shumë arsye të tjera, të paktën, thanë ata, Pali kërkonte punë, ai donte fuqi, fizik, në kuptimin më të ngushtë të fjalës. Ardiani s'kishte fizik. Ai ishte i hajthëm. Për herë të parë në historinë e Metalurgikut brigada e Palit po punonte për ngritjen dhe montimin e pajisjeve të rënda në lartësi tridhjetë e gjashtëdhjetë metra...

(Ardian Dobini pati një të dridhur të brendshme. Po edhe një gëzim, apo diçka të ngjashme me të. Gjashtëdhjetë metra lartësi, këtij i them montim unë, mendoi. Pastaj vëmendjen e tij e tërhoqën diskutimet e shokëve.)

Disa thanë se Ardiani hëpërhë mund të merrej me pjesën tjetër të brigadës që punonte poshtë, ose me ndonjë punë tjetër, fundja, le ta zgjidhte ai vetë me Palin se ku do të punonte. Por thanë, gjithashtu, se për t'iu imponuar Palit, për të fituar besimin e tij e të të tjerëve, komunisti duhej të punonte në frontin më të vështirë. E, megjithatë, shprehën prapë dyshimin se mund të mos ishte Ardiani ai që duhej çuar në brigadën e Palit, por një tjetër.

Tha sekretari:

— Tjetër s'kemi. Ju e dini, në organizatën tonë jemi gjithsej dymbëdhjetë komunistë e kandidatë. Komunistë që mund të punojnë në brigadë mekanike kemi vetëm pesë. Secili ka zënë vendin e vet, hëpërhë më të rëndësishëm e më të domosdoshëm sesa korrigjimi i disa të meta-ve në brigadën e Palit. Por nga ana tjetër, po nuk çuam tashti Ardianin, ajo brigadë mund të mbetet edhe për disa kohë pa komunist, kurse unë jam i mendimit se edhe me Pal Monin e me ndonjë tjetër ka ardhur radha që të merremi më seriozisht. Kurse Ardianit t'ia vëmë si një nga objektivat e kandidatit që duhet të përmbushë gjatë kohës së stazhit.

Pas këtyre fjalëve zotëroi një heshtje ngurrimi. Pastaj u thanë përsëri mendime nga më të ndryshmet.

Kur çështja kishte ngecur në një udhëkryq, sekretari pyeti:

— Ti, shoku Dalan, si brigadier që je vetë e si mekaniku më i vjetër midis nesh, ç'thua për Ardianin?

Dalan Leka, burrë afër të pesëdhjetave, me thinjat si t'i kishin hedhur një grusht miell në kokë, u ngrit në këmbë e megjithatë nuk foli menjëherë: u duk sikur ishin pikërisht thinjat ato që e pengonin, ato që e detyronin të mendohej gjatë. Shikoi duart e veta, shikoi Ardianin, shikoi shokët e sekretarin. Pak më vonë u duk qartë se ajo që do të thoshte ai, nuk i pëlqente, por para se ta thoshte, vuri buzën në gaz, me një buzëqeshje që të kujtonte pyllin në vjeshtë, gjethet e të cilit, para se të bien, zverdhen e skuqen në ngjyrën e bronzit (për të mos thënë në ngjyrën e hekurit të ndryshkur) që ishte ngjyra e fytyrës dhe e darve të Dalan Lekës. Ai tha:

— Më mirë të çojmë një tjetër! — Por, duke vënë re diçka të veçantë në sytë e thellë e të zinj të Ardianit, të vetmit tek ai që, me vështrimin e tyre të pastër e gjithmonë të përqëndruar, shprehnin një farë force, shtoi: — Jo për gjë, vetëm nga ana e eksperiencës, them unë. — Por vështrimi i Ardianit, në kundërshtim me të gjithë pamjen e tij, që ishte e hajthme e që dukej si e çoroditur, nuk ishte tërhequr. Dalani shtoi: — Këtu jemi. Më vonë shohim e bëjmë. Hëpërhë unë them... jo!

Dalan Leka kishte heshtur, kishte mbaruar, por nuk ishte ulur. Shikoi nga Ardian Dobini, u ndesh me vështrimin e tij të menduar e të përqëndruar dhe befasi briti:

— E dini ç'them unë?... Ta çojmë!... Ja ç'them unë!

Nëpër barakë kaloi aty-këtu ndonjë e qeshur, por ato s'qenë të qeshura për të qeshur. Ato sikur plotësuan diçka.

Tha sekretari:

— Edhe unë ashtu them, do ta bëjë Ardiani, s'është kaq tragjike!

— Po të luftojë, e bën! — tha një tjetër.

— Për t'ia dalë me sukses këtij objektivi, e këshillojmë të mos luftojë vetëm, por të mbështetet tek vetë punëtorët e asaj brigade, bile dhe në ndonjërin nga ata që Pal Moni mban pranë vetes.

Pyeti sekretari:

— Si thua, Ardian?

Ardian Dobini s'tha dot asgjë. Shikoi shokët dhe nuk i përmbloodhi mendimet. Një mendje i thoshte «jo», një tjetër «po». (Sytë gjithmonë «po»).

Kur erdhi radha e votimeve, fitoi teza e shprehur thjesht nga Dalan Leka, por sidomos nga sekretari, se nuk ishte aq tragjike, në qoftë se do të çonin Ardian Dobinin në brigadën e Pal Monit.

Me kaq mbledhja mbaroi.

Dera e barakës u hap dhe një fllad i freskët, aq sa mund të jetë ai i freskët në pjesën e fundit të pranverës e në pjesën e parë të verës, u fut brenda dhe trazoi ajrin e ndenjtur. Ardian Dobini ndjeu lëvizjen e këtij ajri, ndjeu ajrin e ngrohtë të dilte jashtë dhe ajrin e freskët t'i mbështillte trupin e fytyrën e djersitur dhe kjo freski i kujtoi atij se kishte diçka që duhej ta thoshte pa tjetër. Kështu, kur mbledhja qe deklaruar e mbyllur, kur dera e barakës qe hapur, kur bile shumica qenë ngritur në këmbë, ai tha:

— Dakord! — dhe largoi nga balli krelën e zezë të flokëve.

3

Ë N D R R A T

Po në ditët e para në spital Ardian Dobini u shkroi letër prindërve e së shogës. Në atë letër — që ishte e para pas largimit të tij nga Lezha — ai u shkruante se ishte fare mirë, se konviktet e punëtorëve të Metalurgjisë ishin shumë të rehatshme, u thoshte se kishte zënë shokë, u thoshte se punonte shumë dhe ishte shumë i këna-

qur. Në fund të letrës Ardiani i porosiste të mos merrnin mundimin e të vinin deri në Kombinat për ta takuar se ai (përsëriste) do të shkonte vetë tek ata një të diel... Këto porosi ai i jepte si padashur, si pa rëndësi, si rastësisht, kurse në të vërtetë...

Letrën e postoi me anën e një shoku dhe pas letrës, që kishte qenë një transferim e një variacion për jetën e tij në spital, padashur mendimet e ndjenjat iu përqëndruan te ngjarja që i ndodhi në Kombinat. Sado nuanca të reja që i jepte ai gjendjes në të cilën ndodhej, ajo gjithmonë ishte e barabartë ose e ngjashme me atë të një alpinisti të ri, që arrin në rrëzë të malit e prej aty shikon majat me borë, ku ai duhet të ngjitet.

Ndoshta ishte po kjo gjendje dhe ishin po këto arsye që ai, Ardian Dobini, e kishte bërë zakon të shikonte shpesh panoramën përballë dritares së dhomës. Zakonisht, mëngjeseve malet ishin të mbuluara me një mjegull të lehtë ngjyrë manushaqe. Pak më vonë kjo mjegull shndërrohej në një vel të tejdukshëm e pak më vonë akoma, mjegulla zhdukej dhe ajri bëhej fare transparent. Atëherë Ardiani i shikonte mirë shkrepat, honet, pyjet e gjelbëruara, përsëri shkrepat e majat, të gjitha të largëta e meqë ishin të largëta, të gjitha të bukura e të pafajshme. Vetëm pas disa ditëve ai do të kuptonte arsyen e vërtetë, pse ajo panoramë malore e tërhiqte dhe pse i linte mbresa të reja vazhdimisht: ajo kishte të bënte me lartësitë, dhe si e tillë, ajo ishte vetëm e bukur dhe romantike, siç mund të jetë e bukur e romantike çdo gjë që s'është arritur akoma.

Një natë Ardian Dobini pa në ëndërr sikur ndiqte një zog të bukur dhe hë ta zinte këtu, hë ta zinte atje, nuk e zuri kurrë por, duke mos e zënë, ai provoi një ndjenjë të ëmbël për vetë faktin që vraponte prapa tij dhe për faktin që herë-herë arrinte t'i prekte vetëm puplat. Duke vrapuar e duke qenë sa më afër zogut, ndjenja e ëmbël filloi t'i kthehej në dëshirë, por edhe në shpresë, që e përveçlonte vazhdimisht, sepse tashmë atij i dukej se jo vetëm ishte më afër zogut, por gati-gati e kishte në duar. Kur ai zgjati dorën ta kapte përfundimisht, zogu fluturoi pak

më lart. Përsëri më lart. Atëherë Ardian Dobini u ngjit nëpër një palë shkallë të ngushta e të pjerrëta, vende-vende fare të thikta dhe aty nga mesi i tyre iu mor mendja, iu përzie në stomak... Kur u zgjua, ai pësoi atë dëshpërim që pësojnë zakonisht njerëzit pas një ëndrre që u ka kujtuar diçka të hidhur. Ai nguli vështrimin tek Ylli i Mëngjesit që dridhej përtej dritares dhe, për ta zënë gjumi, zuri të numëronte si në fëmijëri, një...dy...tre... deri në dhjetë, deri në njëqind. Dhe prapë një... dy... tre...

Kështu kishte numëruar edhe disa vjet më parë, kur i ati, për të kontrolluar tubacionet ajrore të një rezervuari, që e rridhnin ujin poshtë, kishte qenë i detyruar të varej pezull në krahun e një vinçi, duke pasur poshtë një humnerë gati treqindmetërshe. Në mbrëmje, i djersitur, i lodhur, i mpirë, kishte zbritur në breg, ishte ulur në tokë, kishte dredhur një cigare (duhanin e pinte të dredhur) dhe kishte thënë:

— Do ta gjej se s'bën!

Ardiani, duke shpresuar se i ati do ta gjente shumë shpejt të çarën e tubave, kishte numëruar një... dy... tre... dhjetë... ja, te njëzeta do të gjendej e çara. Por i ati nuk e kishte gjetur as në numrin njëqind, as në një mijë. Atëherë Ardiani kishte numëruar gjithë ditën nga njëshi deri te mija. Qe kthyer disa herë, dhjetëra herë, ndoshta qindra herë, nga njëshi, deri...

Atë mbrëmje, mbrëmjen e dytë, i ati kishte thënë:

— Do ta gjej se s'bën!

E çara që gjetur ditën e tretë.

Pastaj kishte filluar procesi i vështirë i ngjites së tubave. Dy ditë më vonë uji u lëshua dhe në fillim tubat kishin qarë (shprehje e të atit) pastaj kishin pikuar, pastaj kishin rrjedhur si më parë dhe, si më parë, uji i rezervuarit shkante kot.

Atë mbrëmje i ati dridhte cigaren dhe thoshte:

— As që duhet të vijnë të tjerë. Do ta ngjis vetë se s'bën!

Dhe e kishte ngjitur të nesërmen. Ardianit i kujtohej se ajo kishte qenë një punë e vështirë. Ato ditë kishin

shkruar edhe gazetate, kurse kryesia e njërës nga kooperativat e bashkuara, lokate e së cilës vaditeshin nga ujërat e atyre tubave, kishte shpejtuar ta shpallte të atin anëtar nderi të kooperativës.

Kështu, herë me kujtime, herë me ëndrra, ditët e netët zvarriteshin, duke i sjellë vazhdimisht Ardianit dëshira e mendime të reja.

Kur gjendja e tij u keqësua, kur temperatura iu ngrit, kur dhimbjet iu shtuan, në dhomë hynte e dilte gjithnjë më shpesh një infermiere, që Ardianit i ngjante me zonjat e vjetra të romaneve. Vetëm se ajo s'ishte e ftohtë e mospërfillëse si ato zonja, ishte e dashur dhe e kujdesshme, por edhe pak qesharake me atë skufje të bardhë, që s'ishte veçse një gjë e vogël në kokën e saj. Ishte pikërisht kjo infermiere, që me lëvizjet rrotull tij e rrotull krevatit të tij i kujtonte Ardian Dobinit kujdesjet e motrës së madhe (tashmë e martuar) sa herë që ai sëmurej në fëmijëri. Ai nuk e dinte se ç'pamje i merrte fytyra, kur zgjohej nga ëndrra e zogut të bukur, kur evokonte punën këmbëngulëse të të atit mbi tubat e rezervuarit, kur shikonte panoramën malore përballë dritares, apo fundja, kur ai, akoma i vogël, vraponte zbatthur për të arritur i pari në malin mbi Lezhë, kështjellën e Skënderbeut e ku i pëlqente të hipte në pikën e saj më të lartë... Vallë, ç'pamje i merrte fytyra në këto çaste?!... Sigurisht, infermierja nuk kuptonte gjë, ai nuk e kishte zakon të fliste me vete, por megjithatë ajo diçka kuptonte ose duhej të kuptonte, sepse nuk ishte e rastit kur ajo, bie fjala, e pyeste pse ishte ngrysur befasisht (mos kishte ndonjë dhimbje?) pse buzëqeshte (mos i kishte kaluar dhimbja?) pse lëkundej, pse kishte hapur krahët etj. etj. Këtyre pyetjeve ai rrallë u ishte përgjigjur me ndonjë shaka si kjo:

- U ngjita në kuotën 30!
- Ç'është kuota 30? - pyeste infermierja.
- Ajo... ku unë u rrëzoval
- Po kur u ngjite atje?
- Tashti!

Këto pyetje e përgjigje zakonisht mbaronin me buzëqeshje, por të njëanshme: Ardiani nuk buzëqeshte, ai fliste me seriozitet dhe infermierja e merrte për humor të dyfishtë qëndrimin e tij serioz. Kishte edhe raste kur infermierja shikonte ndonjë ekuivok në këtë qëndrim të Ardianit, kishte raste edhe që dyshonte. Dhe, kur dyshonte, atëherë ajo merrte pamjen e zonjave të vjetra të romaneve...

...Një ditë Ardiani iu lut mjekut ta nxirrte nga spitali, sepse atij i bëhej sikur ishte shëruar, por... pas kësaj lutjeje, mjeku kishte vazhduar vizitën, si të mos kishte ndodhur asgjë, si të mos kishte dëgjuar asgjë. Përkundrazi, ai kishte thënë:

— Do të të japim një raport që të mos punosh në lartësi. Nuk mundesh. Të punosh poshtë, aty je i sigurtë.

Mjeku, duke parë se Ardianit nuk i kishin pëlqyer këto fjalë, e pyeti:

— Jo?

— Jo!

— Pse?

— Nuk e di. Më pëlqen të punoj si gjithë të tjerët. Kur të punojnë të gjithë poshtë, edhe unë poshtë. Kur të tjerët sipër, edhe unë bashkë me ta.

Tha Mjeku:

— Mendohu! — dhe iku.

Ardiani nuk kishte çfarë të mendonte, por, meqë ishte i lodhur, u kthye në krahun tjetër dhe befas e ndjeu veten të trishtuar. Ç'ishte ai vetëmohim i kotë, kur sytë e tij, kur e gjithë qenia e tij s'ishin krijuar për të punuar në lartësi? Atë çast ai ndjeu barrën e jetës të mbushur me rreziqe të asaj pune që ishte jashtë mundësive të tij, ndjeu barrën e tmerrshme të luftës së kotë kundër fuqive që ishin jashtë natyrës së organizmit të tij. Ndjeu t'i iknin gëzimet, shpresat, ndjeu zbrazëtirë në shpirt e në mendje dhe përballë të gjitha këtyre ai provoi joshjen dhe tundimin e jetës pa rreziqe. Pa fytyrën e Palit dhe pas asaj atë të infermieres e të mjekut, që sikur vazhdonin t'i lute-

shin, dhe të gjitha këto fytyra i vinin rrotull me vezulli-me. Por kjo... nuk zgjati shumë. Në dhomë kishte vetmi dhe heshtje. Përtej dritares fekste refleksi i një drite të largët. Ishte drita që varej mbi portën e madhe të spitalit, prej nga hynin e dilnin makinat e furnizimit dhe auto-ambulancat e urgjencës. U kujtua se aty s'kishte pasur asnjë Pal e asnjë infermiere e asnjë mjek, asnjë bisedë me ta, asnjë propozim për të hequr dorë nga lartësitë, asgjë s'kishte pasur, përveç një ëndrre me shumë kate, që ai nuk do të dëshironte ta shikonte kurrë më. Fshiu djersët e ballit me mëngët e pizhameve, u kthye në krahun tjetër dhe fjeti.

Në mëngjes u përpoq të rikujtonte ëndrrën, por ajo nuk i bëri më efektin e natës, kështu që i pëlqeu të mendonte se bashkë me atë ëndërr kishin marrë fund çdo trishtim, çdo zbrapsje e çdo gjë tjetër.

Po edhe në netët e mëpastajme, silueta e objektit 500 të uzinës N, nuk iu nda asnjëherë. Ajo futej aty nga dritarja, ecte përmes dhomës dhe i ngulej buzë krevatit. Ardiani përpiqej të mos e shikonte atë siluetë, po përpjekjet e tij s'kishin asnjë vlerë. Ajo njësoj qëndronte përballë tij dhe për diçka i fliste, megjithëse ai nuk e kuptonte, sepse ajo fliste me gjuhën e siluetave, me gjuhën e lartësive të objektit 500, dhe, më keq akoma, ajo fliste me të qeshur, që kthehej në tallje e që s'ishin vetëm zërat e njohur të pjesëtarëve të shtëpisë që e tallnin, por ishin edhe të shokëve, të të njohurve të tjerë dhe të shumë të tjerëve të panjohur. Një botë e tërë merrej me të, një botë e tërë... Po, kur zgjohej, i mbytur në djersë, ai vinte re se ishte fare vetëm dhe askush s'merrej me të, askush nuk e shikonte, askush nuk e qeshte e nuk e tallte.

Disa ditë më vonë Ardian Dobinit i kishte zbritur temperatura, ai kishte dalë nga ajo gjendje e ngjashme me një somnambul. Tashti mendimet e tij ishin bërë më të qarta, ai ishte përmirësuar, kishte filluar të ecte, ëndrrat qenë zhdukur ose po zhdukeshin dhe ai qe kthyer në radhën e njerëzve të zakonshëm. Tashti ai zuri të bënte ca stërvitje sa të befasishme, aq të rastit, aq edhe të çuditshme. Në

mesditë, kur infermierja me skufjen e bardhë s'para dukej aty, ai shkonte në fund të oborrit, ku ishin mbeturinat e një poligoni të një reparti ushtarak, para se aty të ndërtohej spitali dhe vraponte mbi trarët, që s'ishin veçse dy-tre metra nga toka. Por, meqë Ardiani ishte shquar gjatë kohës së shërbimit ushtarak (ai kishte ecur menjëherë lirisht mbi trarët) e kuptoi se këto stërvitje s'kishin asnjë vlerë. Kështu, hoqi dorë shpejt nga ato dhe këtë vendim e mori edhe për të mos u rënë në sy personelit të spitalit e të sëmurëve, të cilët, po ta shikonin... Por, me të hequr dorë nga «stërvitjet» në poligonin e braktisur, ai i zëvendësoi ato me disa «stërvitje» të tjera, të cilat i quajti stërvitje me «vetveten» e që s'ishin veçse imagjinare, ku ai, duke ndenjur shtrirë në krevat, duke shikuar tavanin, si të shikonte kuotën 30 të objektit, e përfytyronte veten sikur ngjitej atje sipër, sikur...

Bile një herë, në një nga këto inkursione imagjinare, Ardian Dobini pati një vizion, një si halucinacion, sikur gjoja Pal Moni i ishte afruar në një pushim të shkurtër, i kishte vënë dorën në sup, i kishte buzëqeshur si shokushokut, e kishte shikuar me ata sytë e tij blu, si një copë qiell i pastër dhe, së fundi, i kishte zgjatur një cigare nga paketa e famshme dhe e pandryshueshme «Partizani».

Cigarja. Cigarja e parë. Kjo cigare ishte bërë shkak t'i kujtonte sërish Ardian Dobinit detyrën që i kishin vënë shokët në organizatën-bazë të partisë, lidhur me brigadën e Pal Monit e me Pal Monin vetë, lidhur dhe me objektivin e tij si kandidat partie.

Por hëpërhë ai ishte në spital dhe kokën (jo vetëm kokën) e kishte akoma të lidhur e të fashuar. Përveç «stërvitjeve» imagjinare, ku e përfytyronte veten sikur ndodhej jo vetëm në kuotën 30, po edhe në kuotën 60, përveç përfytyrimit të cigares nga paketa e Pal Monit, ai s'ishte në gjendje për asgjë tjetër, për asgjë më tepër.

C I G A R J A

Nuk mjaftoi që Ardian Dobini gati s'kishte fjetur tërë natën, duke menduar e stërmenduar detyrën dhe objektivin që shokët i kishin vënë një ditë më parë, si dhe të gjitha ato që kishin thënë për punën e për brigadier Palin, por edhe tashti, që ecte drejt objektit 500, mendimet herë e shtynin përpara, herë e pengonin. Iu kujtua një histori që i kishte ndodhur një kandidati në oficinën ku ai kishte punuar vetë. Pa ditur si të vepronte, kandidati kishte kërkuar nga organizata-bazë të caktonin një tjetër në vend të tij. Shkurt: ai e kishte humbur autoritetin, s'ishte në gjendje t'u afrohej të tjerëve, as të shoqërohej me ta, as t'u imponohej atyre. Shkaqet ai s'kishte qenë në gjendje t'ua shpjegonte, por dinte që nuk po luante rolin pararojë në brigadë. Vetëm kaq dinte, vetëm kaq mund të thoshte. Organizata e shikoi këtë çështje nga të gjitha anët. Bile u interesua mos vallë ishte ndonjë shkak tjetër, si bie fjala mos bëheshin dallavere në atë brigadë? Mos ishin familjarizuar me brigadierin? Mos largoheshin nga puna dhe paguheshin për ditët që kishin munguar? Mos kishin edhe të meta të tjera, si raportimi për punë të pabërë, apo drejtpërdrejt ndonjë armik klase... dhe për të gjitha këto, atyre u duhej ta nënshtonin kandidatin për antar partie që kishin në brigadë? Po kur s'doli asgjë nga këto, kur doli që edhe kandidati vetë ishte i rregullt, organizata nuk e zëvendësoi me tjetër. Atëherë ai e humbi farenë, filloi t'i kërcënonte, ose t'u kujtonte orë e çast brigadierit e punëtorëve se ishte kandidat partie, se ishte... I kujtohej gjithashtu Ardianit se kandidati tjetër, që zëvendësoi pas disa kohësh të parin, kishte fituar respektin e gjithë brigadës, pa i rënë gjoksit e pa thënë se ishte...

Këto mendonte atë mëngjes qershori Ardian Dobini,

ndërsa shikonte nga larg objektin 500, ku ai do të punonte. Duke parë konturet e këlij objekti, duke u nisur nga ajo pak teori e praktikë që kishte, ai mendoi se ndërtimi duhej të kishte hapur front pune për montimin të paktën dy vjet më parë. Të paktën dy vjet më parë inxhinieri-topograf apo grupi topograf kishte kontrolluar akset e kuotat (distancat e lartësitë) pastaj birigada e Palit si dhe shumë brigada të tjera kishin montuar kolonat dhe pas veri fikimit për vertikaltetin e tyre, ishin montuar trarë e kapriata, ishin bërë saldimet përkatëse dhe tashti punohej vende-vende për mbulimin e çatisë me llamarinë të valëzuar, kurse në akse apo anekse të tjera, ku montoheshin makineri apo pajisje të ndryshme, çatia ishte akoma e zbuluar, për të mos penguar vinçat... Duke menduar apo duke përfytyruar këto procese pune që ishin kryer, ai kishte arritur më në fund pranë një barake të gjelbër, ku i kishin thënë se ndodhej brigada e Pal Monit.

Ky i fundit qëndroi gati dy minuta në heshtje dhe Ardiani, duke e shikuar në fytyrë, u përpoq të kuptonte çfarë mendonte ai dhe çfarë përgatitej t'i thoshte.

— E po, tashti e gjete të vish?! — e pyeti Pal Moni.

Kjo pyetje e kjo pritje e zunë në befasi Ardian Dobinin. Tjetër gjë kishte përfytyruar e shpresuar ai!

— Pse? — e pyeti Ardiani.

Tha brigadieri:

— E shikon këtë karafil këtu? — Brigadieri kishte zgjatur dorën drejt një punëtori. — Më ka bërë dje një saldime në pajisjet e rënda, që s'mban as pesë atmosferë e jo... — Këtu Pali kishte heshtur, i kishte buzëqeshur të porsaardhurit (ndoshta ai e bëri këtë, duke menduar se e kishte tepruar me atë pritje të çuditshme) dhe kishte shtuar: — Fajet, i kam vetë, se vetë ia kam krehur bishtin!

Pal Moni ishte brigadier i ri, jo sa Ardiani, njëzet e pesë vjeç, po as më shumë se tridhjetë. Sytë blu të thellë (që ishin errësuar sapo foli për punën skarco të saldatorit) sidomos trupi i gjatë, sidomos bluxhinset e rripat e pajisjet e sigurimit teknik në bel e në supe, pa harruar sytë, si të kishte futur në ta dy copa qielli blu, këto e të tjera si

këto, të jepnin përshtypjen se kishe të bëje jo me një montator, jo me një brigadier, por me një instruktor, që pret aeroplanin për të stërvitur nga lartësi të ndryshme e në kushte atmosferike të ndryshme skuadrën parashutiste, veshur si ai e rreshtuar prapa tij gati për... ngjitje.

Nga sa kishte dëgjuar për Pal Monin, për karakterin, për aftësitë e vullnetin e tij, por edhe për të gjitha ato të meta që i kishin folur, Ardian Dobini kishte pritur të ndodhej para një brigadieri të një tjetër brezi, të një tjetër moshe, ku rrudhat do të kishin bërë punën e tyre, ku thinjat... por në të vërtetë ai mbeti paksa i çuditur që Pal Moni i përkiste brezit të tij.

Ai prapë i kishte buzëqeshur të porsaardhurit, i kishte rrahur shpatullat (Ardiani pati kohë dhe rast të kup-tonte forcën e krahut të Palit) pastaj kishte thënë:

— Ardian Dobini, mos gaboj!

Ardiani vuri re se Pali e shqiptoi emrin e tij me ngrohtësi, me intimitet, ai e shqiptoi si për të njëmijtën herë, si të ishin të njohur të vjetër, si të ishin shokë fëmijërie. Nga ajo gjendje pak a shumë e papërcaktuar e çasteve të para me një të panjohur kurrë, aq më tepër që diçka të mirë e diçka të keqe e kishte dëgjuar për karakterin e këtij njeriu, e aq më tepër akoma që do ta kishte brigadier e do të punonin bashkë të paktën tre vjet (ndoshta edhe më shumë) Ardian Dobini i mjaftuan vetëm ai zë i ngrohtë, ajo goditje e dorës së tij në shpatulla, ajo buzëqeshje më e ngrohtë se zëri, që ai të shkrihej e të mblidhte veten. Këtë çast të takimit të tyre, të pritjes së çuditshme, por edhe të afrimit të çuditshëm, veçanërisht me anë të shqiptimit të ngrohtë të emrit të tij, Ardian Dobini do ta komentonte më vonë, se pikërisht atë çast ai e kishte ndier veten krejtësisht të çmontuar.

— Po, unë jam Ardian Dobini, — tha ai pas një hesh-tjeje të shkurtër.

— Pse s'thua, ti qenke çelik! — tha Pali dhe e goditi me grusht në gjoks.

Pastaj Pali e njohu Ardianin me punëtorët që u ndodhën më afër, e njohu me punimet e brigadës në përgji-

thësi, i tha se brigada punonte në dy fronte kryesore. Një pjesë e saj montonte pajisje të rënda në gjashtëdhjetë metra lartësi, pjesa tjetër në tridhjetë metra, gjë që Ardiani kishte dëgjuar të flitej në organizatë. Pastaj Ardiani i tha nja dy fjalë për vete, Pali u gëzua kur mori vesh se i por-saardhuri, megjithëse i ri (po edhe i hajthëm nga trupi) ishte mekanik i kategorisë së gjashtë dhe maturant në shkollën industriale pa shkëputje nga puna. Meqë as në kuotën 60 as në kuotën 30, s'kishte front pune, Pali i tha Ardianit të punonte përkohësisht poshtë, ku punonin edhe katër të tjerë, për ngritjen e pajisjeve me vinç, apo për saldimin e ndonjë detaji, apo... fundja, për të ndihmuar dy shoqet që pastronin pajisjet nga balta dhe i lyenin me bojë para se të ngriheshin nga vinçi në kuotën 30 e 60.

Pastaj brigada, e ndarë më dysh, sulmoi dy palë shkallë. Njëra, me Palin në krye, ngjiti shkallët ku montoheshin ca pajisje që ngjanin me tubacione shumë të shkurtra e shumë të gjera (Ardiani nuk i kuptonte akoma funksionet e tyre) tjetra ngjiti shkallët, ku montoheshin pajisje të tjera, po aq të rënda e po aq të panjohura për të: kjo ishte kuota 60. Shkallët, dihet, ishin prej hekuri, ishin të ngushta e me shumë zigzage, me sheshe për çlodhje, por sidomos ishin shumë të pjerrëta, vende-vende ato ngjiteshin pingul, të thikta, siç janë zakonisht shkallët e oxhaqeve të fabrikave. Pikërisht këto dy shkallë sulmoi brigada, jo si montatorë, por si pilotë apo si parashutistë, që kërkojnë një kuotë të çfarëdoshme për të bërë provat e para me parashutë. Ngjiteshin duke biseduar me zë të lartë, duke qeshur, duke thumbuar njëri-tjetrin, gati duke vrapuar si në garë e kështu me të qeshura e me klithma gëzimi, trupat e tyre vinin gjithnjë duke u zvogëluar, por zërat jo, ata tingëllonin njësoj, bile Ardianit i dukej e kundërta: sa më lart, aq më fort e më pastër tingëllonin ata zëra. Kurse rrezet e pjerrëta të mëngjesit i kishin zgjatur hijet e tyre, i kishin çuar larg dhe u kishin dhënë formën e disa qenieve fantastike, që ngjiteshin në një hapësirë po aq fantastike.

— Ngjiten e lozin, çunat! — tha ai që ishte më i thye-

ri në moshë, mbi të pesëdhjetat e afër të gjashtëdhjetave, që ishte i vetmi pjesëtar i brigadës në një moshë të tillë. Megjithëse mekanik i përsosur, punën e kishte poshtë, për arsye se mosha kishte bërë të sajën dhe shpesh xha Toli s'kishte qenë i sigurt atje sipër mbi trarët e kalimit.

— Bëjnë edhe shakara! — tha prapë xha Toli. — Ja, i shikon?

Sigurisht, Ardian Dobini atje i kishte sytë, tek ata që ngjiteshin me klithma e me thumba. Shikonte nga ata dhe diçka ndiente, diçka mendonte, por ato që ai ndiente e mendonte nuk ishin akoma të qarta, nuk ishin akoma të kristalizuara, nuk ishin bërë fakt, mund të ishin vetëm idera, bile edhe më pak se idera, mund të ishin thjesht hamendje, por sidoqoftë diçka ishin, përderisa ai ndiente dhe mendonte diçka për ata që ngjiteshin.

Edhe pjesëtari i tretë i brigadës, që kishte mbetur në tokë, që ishte i ri si Ardiani, mekanik e montator si Ardiani, edhe ai diçka ndiente e mendonte... Mbase mosha dhe profesioni i përbashkët bënë që Ardiani të kuptonte se ndjenjat dhe mendimet e tyre ishin të përafërta, me të vetmin ndryshim se, ndërsa brigada ngjitej gjithnjë më lart, fytyra e shokut bëhej pak qesharake, sepse ai e kishte zakon ta ulte kokën aq, sa mjekra e hollë dhe e gjatë t'i mbështetej mbi gjoks dhe, në të njëjtën kohë, ishte i detyruar t'i zbardhte sytë aq, sa bebëzat, gati të fshehura nën qepallat, të mund të shikonin atje lart. Merrte kësh-tu një pozë qesharake, por edhe të trembur, si të një zo-gu gati për të fluturuar, por jo për lart.

— Lonit i merren mendtë! — tha pa të keq xha Toli.

— Ah, ashtu! — u çudit Ardiani, megjithëse i bëhej sikur e kishte pritur prej kohësh një gjë të tillë.

Loni shikoi Ardianin dhe vuri buzën në gaz. Por ajo ishte një buzëqeshje që shprehte shumë gjëra, të paktën pikëllim, turp e shqetësim e luftë të brendshme po se po, por buzëqeshje jo.

Dy shoqet kishin filluar nga puna. Ato lyejnë me bojë pajisje e tuba të gjerë. të ngritur mbi kambaleca.

— Kjo shejtane e vogël, Nadirja që shikon këtu, kur

e ka dashur puna, është ngjitur si fishnjar në kulmin e çatisë, mbi gjashtëdhjetë metra! — tha xha Toli.

Nadirja mbeti me furçë as në tub e as në kutinë e bojës, shikoi nga xha Toli, shikoi nga Ardiani e nga Loni dhe u skuq deri në rrëzë të flokëve.

— Sa para bën, — foli si me shaka e me zë të dridhur Nadirja, — brigadieri ynë nuk i përfill shoqet! — Tek buzëqeshte, sytë e saj të vegjël gati u mbyllën färe.

— Mrica nuk e ka provuar, — tha xha Toli, — por thotë se mund të ngjitet ku të jetë nevoja!

— Ngjitem, po, — tha ajo me zë të vendosur, pa e ndërprerë lyerjen, pa shikuar asnjëherë nga ata që ngjiteshin, as nga ata që flisnin aty poshtë, dhe Ardiani, nuk dihet si e qysh ndodhi, e besoi plotësisht se ajo mund të ngjitej në qdo lartësi, bile menjëherë.

Pyeti ai:

— Saldon?

— Pa asnjë defekt! — u përgjigj në vend të saj xha Toli. — Saldatore më e mirë se unë. Do ta shikosh vetë!

Atje lart ngjitja kishte mbaruar. Disa vërtiteshin si pika e si hije në kuotën 60, të tjerë në kuotën 30, dhe sakaq, përveç zhurmave të përgjithshme, që vinin nga të gjitha anët e objektit, po të doni, nga të gjitha anët e Metalurgjikut, filluan të zbritnin nga lart-poshtë edhe zhurmat e brigadës montatore të Pal Monit, disa nga pjesëtarët e së cilës kërcenin nga një tra në tjetrin, disa vraponin si pa të keq, disa, të lidhur me rripat e sigurimit, vareshin pezull në ajër dhe saldonin të mbrojtur nga maskat, të tjerë kishin hipur mbi pajisjet e rënda që dukeshin si tuba dhe rrihnin fort me çekan.

Tha xha Toli:

— I shikon ata që rrahin me çekan?

— Po, — tha Ardiani.

— Prej tri ditësh nuk arrijnë të saldojnë bërrylin e një pajisjeje.

Ardiani shikonte lart.

— Nuk puqen mirë buzët e bërrylave. Ditën e parë u

përpoqën ta saldonin nga jashtë, por e çara ishte e gjerë dhe nuk qe e mundur të mbyllej.

— Me fasho, jo? — pyeti Ardiani.

— Po. Dje dhe sot janë futur brenda në pajisje. Ti e merr me mend ç'do të thotë të qëndrosh i kërrusur brenda, të saldosh, të fashosh, të rrahësh buzët nga brenda e nga jashtë.

— Nuk më ka qëlluar të montoj pajisje kaq të mëdha, — tha Ardiani, i mbuluar befas në djersë. As në lartësi të tilla s'më ka ndodhur të punoj, — tha ai prapë.

Tjetri, Loni dëgjonte dhe vazhdonte të shikonte me pozën e tij qesharake: mjekra e gjatë i ngulej apo i mbështetej në gjoks, e bardha e syve i shikonte qiellin. Kur dëgjoi të flitej për lartësinë, nuk e ndryshoi pozën, por qepallat i rrahu disa herë.

Dy shoqet nuk shikonin më lart, as nuk dëgjonin bisedat e këtyre (të paktën kështu dukej) por punonin, dmth lyenin.

Këto qenë vetëm përshtypjet e para, ndjenjat e para, mendimet e të panjohurat e para, se pastaj atje lart vazhdoi puna, aty poshtë xha Toli me dy djemtë (me Ardianin e Lonin) filluan gjithashtu punën. Ishin ganxhat e vinçit që u kujtuan atyre se bisedat kishin marrë fund dhe se shokët atje lart prisnin materialet. Punuan kështu deri në drekë. Pastaj zbriti për pushimin e drekës e për të ngrënë drekë e gjithë brigada.

Por nga përshtypjet e ditës së parë, Ardianit do t'i mbetet për shumë kohë më vonë, si një mbresë e kujtim i përhershëm, fakti i pabesueshëm, që nga lartësi të tilla 30-60 metra, në një konstruksion të zhveshur prej çeliku, siç ishte objekti 500, njerëzit i qenë dukur nga poshtë të vegjël, fare të vegjël, gati sa një pikë. Ai kishte dëshirë të dinte, po nga lart (nga ato lartësi) si do të dukeshin ata që ishin poshtë, ata të pestë, p.sh. xha Toli, Loni, ai vetë e dy shoqet. Kishte dëshirë t'i pyeste, por lexuesi e merr me mend se ai e mbajti gjuhën e nuk i pyeti, sepse ashtu duhej, sepse nuk duhej t'i pyeste.

Shpalosi pakon ose gazetën ku kishte mbështjellë ushqimet dhe filloi të hante si gjithë të tjerët.

Pastaj pinë duhan.

Si gjatë kohës kur hëngrën, edhe tashti që pinin duhan, brigada ishte ndarë në mënyrë të vetvetishme në dy grupe apo në dy pjesë. Njërin grup e përbënin montatorët e lartësive, dmth ata që aktualisht punonin për montimin e pajisjeve të rënda në kuotat 30 e 60. Këta ishin rreth njëzet vetë dhe, vetë kuptohet, përbënin grupin kryesor. Të tjerët, që ishin pesë, Ardiani, xha Toli, Loni, Nadirja e Mrica qenë mbledhur pak si mënjanë dhe bisedonin me zë të ulët, sepse këta ishin, ose të paktën quheshin grupi më pak i rëndësishëm, kurse ata të lartësive edhe këtu shquheshin: me zë të lartë. Dy grupet ishin afër, ngjitur me njëri-tjetrin. Brigadieri, me qëllim ose pa qëllim, kjo nuk dihet, ishte ulur, si të thuash, në mes të dy grupeve, por bisedat i kishte me ata të kuotave 30 e 60, se me ata punonte, me ata hëngri e me ata po e pinte cigaren e parë. (Për të pirë një cigare erdhën edhe dy vinçierët, fatet e të cilëve ishin lidhur pazgjidhshmërisht, sepse edhe vinçat e tyre, për herë të parë në historinë e kantiereve, me propozimin e punëtorëve të kësaj brigade, ishin montuar njëri mbi tjetrin. Edhe ata u ulën me grupin kryesor, por krejt padashur, në mënyrë të pandërgjegjshme, fare të rastit, fare të vetvetishme. Të paktën kështu iu duk Ardian Dobinit.)

Erdhi koha e cigares së dytë. Përsëri ata të grupit të të njëzetëve, dmth të grupit të lartësive (që përfshinte në vetvete edhe kuptimin e grupit të mjeshtëreve) bënë shkëmbimet e rastit, i zgjatën paketën njëri-tjetrit, lanë borxhet, ndezën shkrepëset, përsëri krahët e duart e tyre, gjatë kohës së shkrepëseve të ndezura, formuan «T» e dopio «T», formuan «L» (ele) rreze e kryqe, të cilat patën jetë derisa cigaret nxorën tymin e parë apo fjollat e para.

Ardian Dobini, i vetmi që pinte në grupin e dytë, me pamje të menduar, me pamje që tregonte se merrej vetëm me vetveten, nxori paketën (e vet) futi një cigare në gojë cigaren e dytë e ndezi me shkrepësen (e vet) dhe e thi-

thi thellë, si të kishte gjashtë muaj pa pirë duhan. Në të vërtetë ai e pinte rrallë duhanin, të paktën e pinte më rrallë dhe cigaren e dytë menjëherë pas së parës e kishte të tepërt, por i kishte ndodhur edhe herë të tjera: në ambiente e në shoqëri të re, apo në një darkë e mbrëmje të ndërmarrjes Ardiani e shkelte pak, e tepronte, e thyente rregullin, pinte më shpesh. Kjo i ndodhi edhe atë ditë, me të shuar cigaren e parë, ndezi të dytën. Pasi e thithi thellë tymin e pasi e nxori fjollë nga hundët, pasi vërtiti nëpër gishta fijen e shuar të shkrepëses, gjithmonë si i përhumbur e me mendjen gjetkë, i dha një të vërtitur shkrepëses me gishtin tregues dhe ajo, shkrepësja fluturoi mbi kokën e grupit të madh...

Njëri nga punëtorët e ndoqi shkrepësen me sy, siç ndjekim një grenzë, që shkëlqen në rrezet e diellit e, kur shkrepësja kaloi përtej dhe ra larg, punëtori nxori një fishkëllimë habitore (po që ishte e këndshme dhe melodioze).

— Raketë e bëre atë fije shkrepëse ti, Ardian?! — tha ose pyeti ai.

Punëtorët qeshën, ndërsa brigadier Pali ktheu kokën, i hodhi Ardianit një vështrim, gjallëria e të cilit sikur dyfishohej nga ngjyra blu e syve të pastër, po edhe nga freskia që buronte nga tiparet e tij, se edhe Pali i ri ishte, tridhjetë e as tridhjetë e po me atë gjallëri, hodhi dorën e rëndë mbi supin e hajthëm të Ardianit dhe tha:

— Mirë do të jesh te ne, shumë mirë! — Shikoi nga të tjerët. — Ardiani bën stazhin e Partisë.

Fi-i-iu, lëshoi përsëri fishkëllimën habitore po ai që kishte fishkëllyer pak më parë (për fijen e shkrepëses).

Tha Pali (pa e hequr dorën nga supi i Ardianit):

— Lëri fishkëllimat, Tafë, se puna është serioze. Më thirrën në drejtori. Më qortuan, më thanë se e kam përsëritur disa herë, më thanë se e kam bërë vijë, më thanë se e kam bërë stil, kështu më thanë, të lësh pas dore punët e vogla, punimet e imta dhe në kundërshtim me planin e sektorit, me grafikun e përgjithshëm të ndërtimeve e të

montimeve, të pëlqen ta hedhësh brigadën në fronte pune që të japin plan e të ardhura.

Që kur kishte thënë frazën e parë të kësaj periudhe të gjatë (jemi të detyruar ta quajmë periudhë të gjatë, sepse është vënë re që, sa më të mëdha të jenë kantieret, aq më të shkurtra janë frazat, aq më pak bisedojnë njerëzit, sidomos në pushimin e vogël të mesditës) fytyra e Palit, po edhe fytyrat e punëtorëve të tjerë qenë bërë menjëherë të rënda, qenë bërë serioze e të menduara.

Ardiani mbushi mushkëritë me frymë dhe u bë gati të shtonte si me shaka e seriozitet, se jo vetëm punimet e imta, por edhe shumë gjëra të tjera nuk i përfillte kjo brigadë. Pas kësaj «shakaje», mund të thoshte edhe ndonjë gjë tjetër po aq të rëndësishme, bile më të rëndësishme, një nga ato që kishte dëgjuar mbrëmë në mbledhjen e organizatës, por në çastin e fundit u pendua. Ardiani kishte vënë re seriozitetin apo heshtjen solemne që kishte pasuar «periudhën e gjatë» të Pal Monit dhe ishte përmbajtur. Ai ndiente akoma peshën e rëndë të dorës së Palit, por Ardiani e kuptonte fare mirë se ajo dorë i kishte mbetur kot dhe rastësisht mbi sup, sepse, mund të thuash, Pali e kishte harruar me kohë praninë e tij. Bisedën ai e kishte me të tjerët. Me të tjerët ndante ose shkëmbente edhe mendimin, edhe seriozitetin, edhe shqetësimin, edhe cigaret.

— Po ti, çfarë u the? — e pyeti ai që ishte ulur pranë Palit e që Ardiani kishte vënë re se në mëngjes ishin ngjitur bashkë e kishin punuar bashkë tërë paraditen.

Tha Pali:

— Çoni një brigadë tjetër, u thashë! — dhe hoqi dorën nga supi i Ardianit. — Je i kënaqur, Astrit Caka, me këtë përgjigje?

— Cilën? — nguli këmbë ai që quhej Astrit Caka dhe në sy iu ndez një dritë e kuqe, që Ardiani e komentoj apo e shpjegoi se atë dritë, ndoshta, sytë e Astritit e merrnin nga flokët, që i kishte gjithashtu të kuq. — Cilën brigadë?

Tha Pali:

— Brigadën e Bujarit, u thashë!

— Pse të Bujarit? — pyeti një tjetër që ishte ulur pra-

në Astritit e që në letërnjoftimet e dikurshme për tipa si ai shkruhej: «Pa shenja e karakteristika të veçanta».

— Ti, Arben, e di, Bujari përpiqet shpesh ta hajë qyl. Të shtojë të ardhurat për brigadën ia ka qejfi, por po t'i thuash se kemi këtë apo atë pengesë, e lëshon veten menjëherë, bile këtë sëmundje ua ka ngjitur edhe disa pjesëtarëve të tjerë të brigadës. Janë djem të fortë, por bien në apati, në vend që, për shembull, t'i vënë krahët punës. Ja pse u thashë të dërgonin brigadën e Bujarit. Gjithmonë nuk do të gjenden punë qyl, punë të lehta e të gatshme për Bujarin. Pa të shkojë njëherë e të merret me punimet e imta që paskemi lënë ne në aksin B!

— Më duket, Pal, se kjo çështje duhet menduar pak, — tha syndezuri apo vështrimkuqi e flokëkuqi, Astrit Caka. — Jo të gjitha punimet e imta mund të lihen për në fund. Ti e di, ka nga ato që...

Tha Pali:

— E mendojmë, por jo tashti, tashti s'kemi kohë! — Sytë blu të Palit sikur ishin errësuar.

— Kanë filluar të pëshpërisin! — tha prapë ai punëtori, që ishte pa shenja e pa karakteristika të veçanta e që quhej Arben.

— Çfarë, për shembull?

— Sikur gjoja Pal Moni përpiqet vazhdimisht ta vejë brigadën e tij në pozita të privileguara!

— Për shembull?

— Thonë se Pali e rregullon që brigada e tij të punojë dhjetë orë, kurse një brigadë tjetër...

— Cila?

— Ajo e Tahirit, bie fjala, javën që kaloi ishte fare pa punë ose pastronte terrenin!

— Këto janë të meta të tjetërkujt! — tha Tafa nëpër dhëmbë dhe lëshoi fishkëllimën e tij të këndshme e melodioze. — Dimë edhe ne ca gjëra. — Tha prapë: — Këto që thua ti, për ne janë të meta objektive!

— Objektive, subjektive, një fjalë goje të thuash, — tha syndezuri dhe flokëkuqi, Astrit Caka.

— Duhet biseduar për këto gjëra! — mori guxim

Ardian Dobini. Tha prapë: — Duhet biseduar shtruar! — dhe largoi nga balli krelën e zezë.

Pal Moni e shikoi Ardianin vetëm për një çast, bile e shikoi pak si i habitur për ndërhyrjen e tij, pastaj hoqi vështrimin dhe tha:

— E ç'të bisedojmë? — Sakaq vështrimi i tij kishte kaluar te të tjerët.

Paş këtyre fjalëve zotëroi një heshtje e gjatë. Fytyrat e punëtorëve sikur përlësheshin me diçka të padukshme e të bezdisshme dhe të mbushej mendja se serioziteti (ai seriozitetet solemn) ishte fiksuar në ato fytyra një herë e përgjithmonë. Pastaj ata nxorën përsëri paketat. Mënyra si i nxorën, tregoi se cigarja që do të pinin duhej të ishte e fundit para fillimit të punës. Pal Moni u dha nga një «Partizani» tre shokëve që kishte pranë, Astritit, syndezur e flokëkuq, Tafës, që sikur fishkëlleu para se ta vinte në buzë dhe Arbenit, pa shenja e karakteristika të veçanta. Përsëri duart e punëtorëve formuan rreze «L» «T» e dopio «T», kryqe e diametra (këtë të fundit e formonin kur duart e tyre zgjateshin shumë, përtej kokës së dikujt, tek i fundit që mbyllte rrethin e atyre që punonin në kuotat 60 e 30.

Pas pak edhe Ardian Dobini nxori paketën (megjithëse nuk i pihej) e ndezi cigaren pa e vënë mirë në gojë dhe e hodhi shkrepësen po në atë mënyrën e parë, por, për të mos tërhequr vëmendjen e të tjerëve, kësaj radhe nuk e hodhi përmbi e përtej kokës së punëtorëve të grupit të madh e të rëndësishëm, po në anën tjetër, në anën e kundërt, mbi kokën e grupit të vogël e të parëndësishëm, ku ishin Mrica e Nadirja, Loni e xha Toli, plus edhe ai vetë.

Pesë minuta më vonë brigada u ngrit për të filluar punën. Tashti s'kishte ndonjë gjë të re për Ardian Dobinin. Punëtorët shtrënguan rripat e sigurimit, u bënë si pilotë apo si parashutistë dhe morën përpjetë shkallëve të pjerrëta e të ngushta, të ndarë në dy grupe: një pjesë sulmoi drejt kuotës 60, pjesa tjetër drejt kuotës 30, ku flitej se hëpërhë bëhej puna më e ndërlikuar. Ajo që u duk e re, ose më mirë, e papritur për Ardianin, qe përsëri ngjitja e tyre të-

rë gjallëri, tërë klithma gëzimi, tërë shakara e thumba. Në fakt këtu s'kishte asgjë të re, ashtu sikurse s'kishte asgjë të papritur: të gjitha këto s'ishin veçse përsëritje e ngjites së mëngjesit, por, pas asaj bisede që bënë pak më parë e që kishte të bënte me punën e me ndërjegjen, pas gjithë atij serioziteti, solemniteti e mendimi të shqetësuar që u kishte rënë mbi fytyrë, Ardiani nuk e kishte pritur që ata të ktheheshin aq shpejt në natyrën e tyre të gëzuar që, ndonëse përputhej me moshën, nuk përputhej me momentin. Diku në një farë lartësie ai syndezuri e flokëkuqi, që quhej Astrit Caka, befasi kërceu nga një tra në tjetrin, si ta kishin gudulisur në brinjë. Fill pas këtij kërcimi, u dëgjua ajo fishkëllimë e këndshme e melodioze e atij që quhej Tafë e që kësaj radhe shprehte thjesht habi dhe përgëzim, po edhe nxitje. Astriti përsëri kërceu si i gudulisur në brinjë. Edhe këto kërcime e fishkëllima të befasishme të Astritit e të Tafës, me sa dukej, bënë pjesë në repertorin e shakave, sepse shokët qeshën me ta dhe kush e kush u përpoq edhe t'i imitonte.

— Rini! — foli me vete xha Toli dhe ndezi motosaldatriçen për të ushqyer me korent rininë atje sipër.

Loni kishte marrë me kohë pozën e tij të preferuar: maja e hollë e mjekrës i që mbështetur mbi gjoks. Kur në kuotën 30 Astrit Caka, Tafa, Arbeni dhe të tjerët zunë të hidheshin pupthi mbi trarët e çelikut, ai shikoi lart me të bardhën e syve dhe përplasi qepallat disa herë.

Mrica dhe Nadirja filluan nga puna. Dihet, ato lyejnë pajisje ose më saktë fragmente të pajisjeve të rënda.

Ardian Dobini thithte akoma cigaren, por dukej sikur thithte mendimet e veta e të të tjerëve. Vështrimin, si zakonisht, e kishte tëpër të përqëndruar dhe, si zakonisht, të pastër. Dhe kur, pastaj, ai e hodhi bishtin e cigares, bashkë me të u duk sikur hodhi edhe mendimet. Largoi nga balli krelën e zezë e të ashpër, veshi dorezat prej shajaku dhe po në ato çaste dëgjoi xha Tolin, që i thoshte Lonit diçka për lartësitë 30 e 60.

— Xha Tol!

— Fol, Loni!

— Unë jo! — foli si me vete Loni, që vazhdonte të shponte gjoksin me mjekrën e hollë.

— Mos thuaj jo, — tha Toli. — Edhe ti mund të përpiqesh. Ç'është marramendja, që thua ti? Hiç asgjë! Një lloj frike që mund të mposhtet, por kadalëkadalë!

Brigada punoi derisa dielli përëndoi dhe ajri i qershorit u bë i freskët.

5

VIZITA

Pasditja e qershorit ishte ngjyer me shkëlqimin e rrezeve të zbutura të diellit, që varej mbi majat e ullinjve gjatë tërë zinxhirit të kodrave në veri të qytetit. Nga kjo dritë, muret e bardha të dhomës së spitalit kishin marrë një nuancë rozë, dhe ishte pikërisht kjo nuancë, ishte edhe qetësia që ndehej në ajër, ishte edhe heshtja që kishte pllakosur korridoret e spitalit, ishin këto e shumë shkaqe të tjera që kishin ngjallur në shpirtin e Ardian Dobinit një ndjenjë të përzier paqeje edhe trishtimi për gjendjen në të cilën ndodhej. Tërë ai peisazh malor, që kishte shkëlqyer me të gjitha ngjyrat, dalngadalë kishte avulluar para syve të tij, derisa qe bërë njësh me errësirën, derisa në qiell yjet kishin përhapur dritën e tyre.

Diku prapa spitalit dëgjohej zhurma e një autokombajne. Kishte filluar korrja e grurit. Më larg jehonte motori i një traktori që kthente tokat e porsakorrura. Ardiani, që i kishte dëgjuar tërë ditën këto zhurma, ishte familjarizuar aq shumë, sikur ato të ishin përtej caqeve të asaj qe-

tësie që kishte pushtuar pjesën tjetër të botës e që ishte pjesa më e madhe e saj. Në këtë pjesë ndodhej edhe spitali.

Befas u dëgjua një trokitje e lehtë në derë. Pas trokitjes e pas hapjes së kanatit, në prag u projektua trupi mesatar i një njeriu, i cili ndriçohej që prapa nga drita e korridorit.

— Në errësirë?! — foli ai pa lëvizur nga pragu.

— Çelësi në të majtë! — tha Ardiani.

Kur u hap drita, Ardian Dobini njohu menjëherë këndin e thinjur të Dalan Lekës. Ky i fundit nguli sytë kafe të çelët mbi Ardianin dhe vuri buzën në gaz, me atë buzëqeshjen e tij të ngjashme me reflekset që krijojnë rrezet e diellit mbi majat e dushqeve në vjeshtë, kur gjethet e tyre, para se të thahen, para se të bien në tokë, kanë filluar të skuqen e të marrin ngjyrën e bronzit, që ishte aq e afërt me ngjyrën e fytyrës e të duarve të Dalan Lekës.

Ardiani, që kishte dëgjuar shumë gjëra për Dalanin gjatë dhjetë ditëve që punoi në Kombin, e pritë me qejf këtë vizitë. Si komunist e brigadier i vjetër, Dalan Leka bashkë me brigadën e tij të oficinës kishin mundur të pakësonin nga viti në vit listën e importit të disa pjesëve ndërrimi për makinat. Ai kishte qenë edhe nxitës i idesë së disa punëtorëve e pastaj zbatuesi i saj në montimin e dy vinçave njëri mbi tjetrin për transportimin e pajisjeve të rënda në kuotën 60 e mbi këtë kuotë.

Për të mbyllur derën, Dalani u rrotullua i tëri, e mbylli atë ngadalë, sikur ajo të ishte prej xhami fare të hollë, pastaj, po ashtu ngadalë, u kthye dhe eci drejt krevatit të Ardianit. Kishte veshur një kostum të ri, në ngjyrën e fytyrës e në ngjyrën e imagjinuar të flokëve, aq sa Ardiani, në atë çast të shkurtër që i kishte mbetur për të menduar, e quajti Dalanin «njeriu prej bronzi». Në dorë mbante një pako të mbështjellë me kujdes dhe po me atë kujdes të tepruar, që kishte hapur e mbyllur derën, e vendosi pakon mbi komodinë.

Pas përshëndetjeve të para, që nuk u shquan për asgjë të veçantë, Dalani u ul në buzë të krevatit, e shikoi Ardianin.

nin me shkujdesje, siç mund të shikojmë një të njohur që e takojmë disa herë në ditë dhe tha:

— Ajo... gruaja ime kishte bërë sot një lakror Elbasani!

— Ç'është ky lakror Elbasani?

— Me kos, — tha Dalani. — Kosi është specialitet i Elbasanit!

Ai shpëstolli pakon.

— Ke dëgjuar për tavën me kos?

— Edhe kam ngrënë, — tha Ardiani.

— Të ka pëlqyer?

— Po!

— Elbasani!

Ardiani buzëqeshi.

— I thashë asaj... gruas sime, më jep një copë për atë djalën që e kemi në spital e që e kemi stazhier për në Parti. Ajo më tha, qyqja mre burrë, se e kam nga Elbasani gruan, të më kishe thënë më parë, t'i bëja një lakror si me porosi. S'ka gjë, i thashë unë, nuk mbaj mend të kem ngrënë ndonjëherë lakror të keq nga duart e tua!

U kthye nga Ardiani.

Tha:

— Hajde të hamë një çikë bashkë, se edhe mua më hahet lakrori në shoqëri me të tjerët!

Ardianit i erdhi zor të thoshte jo, i erdhi zor t'i thoshte se ai sapo e kishte ngrënë darkën. Për një çast Dalani i kujtoi të atin (thinjat) por nga sjellja dhe kujdesi Ardianit ia pati qejfi ta quante si vëllanë e tij më të madh, të cilin s'e kishte pasur kurrë (po t'i kujtohet lexuesit, Ardiani kishte vetëm një motër të martuar).

Hëngrën. Llafe-llafe, copë e nga një copë, e mbaruan lakrorin të gjithë.

Tha Dalani:

— E kishim fjalën për Elbasanin. Ai është mbushur plot me të ardhur. Më thotë mendja se vetëm çereku janë vendës. Dhe më shumë se çereku. Por jo gjysma. Gjysma jo! Gjysma e përpjetë janë të ardhur. E di ti, që njerëzit vijnë këtu dhe u bëhet mirë? Ka ca gjëra të vetat Elbasa-

ni. Ka... ka... portokalla, ullinj... fqinjët sidomos. Ah, fqinjët e Elbasanit!

Heshtën.

— Dhe mua që më shikon këtu, nuk jam Elbasanas!

— Jo!? — pyeti dhe u çudit Ardiani.

— Jo!

— Gjuha!

— M'u bënë tridhjetë vjet që punoj këtu... Po, e kishim fjalën te fqinjët. E beson ti se nuk ka ditë pushimi apo ditë feste që ta pi vetëm kafën e mëngjesit? Herë dal unë në oborr dhe thërres, Shaqir, Hamide; janë fqinjët e krahut të djathtë. Ose Luan, Arta; janë fqinjët e krahut të majtë. Erdhëm, thonë ata dhe e pimë bashkë kafën, herë me ata të krahut të majtë, herë me ata të krahut të djathtë. Por ndodh edhe ndryshe. Ndodh që vijnë befas. E di si vijnë? Me xhezven që nxjerr avull. Kërcet muhabeti që ç'ke me të. Ti më thua gjuha! E kam përzier gjuhën. Unë vetë jam nga Gjirokastra. Kam ardhur në Elbasan në një ditë të shënuar, në dhjetor të vitit 1945. Një xhaxhai im mekanik më thirri të punoja në një oficinë me të, në oficinën ku jam sot. Por atëherë ajo ishte fare e vogël, se edhe makinat ishin fare të pakta. Arritëm në Elbasan në orën gjashtë të mbrëmjes. Frynte erë... ajo që elbasanasit e quajnë erë Kraste. Ishte errësirë dhe dritat e elektrikut të rralla. Me të zbritur nga makina, dëgjova një zë të njomë që më pyeti:

— Prej nga vjen ti, shok?

— Nga Gjirokastra, i them unë pionierit, që s'duhej të ishte më shumë se trembëdhjetë vjeç.

— A votove në Gjirokastër?

— Ah, thashë unë, që kisha harruar fare se isha nisur pa aguar nga Gjirokastra e më kishin pajisur me një certifikatë për të votuar në Elbasan. Dhjetë ditë më parë kisha mbushur tetëmbëdhjetë vjeç.

— Jo, i thashë unë pionierit.

— Eja me mua, më tha ai dhe shkuam atje ku duhej të votoja. Nuk e harroj atë ditë, ato ishin votimet e para të Pushtetit tonë Popullor. Votonim për Asamblenë Ku-

shtetuese, që pas një muaji do të shpallte Republikën më Njëmbëdhjetë Janar. Rrugës, pasi kisha votuar, më qëndruan e më pyetën disa të tjerë. Kur trokita te xhaxhai, ai më hapi derën e më pyeti: Votove për Asamblenë? Të gjithë me atë punë merreshin atë ditë. Pleq e të rinj, pionierë, xhaxhai dhe xhaxhesha.

Dalan Leka qeshi, me atë të qeshurën e tij të matur e të mbytur e pas tij qeshi edhe Ardian Dobini (sigurisht më mbytur: fashot e kokës!)

— U martova dhe u bëra elbasanas. Kushedi, pas tre vjetësh edhe ti mund të mos kthehesh fare në Lezhë, edhe ti mund të bëhesh elbasanas!

Pyeti Ardiani:

— Pse?

— Këtu, dmth në Kombinat e kanë zakon nganjëherë që, dora-dorës, duke dorëzuar veprat, montatorët e ndërtesit t'i kthejnë në punëtorë shfrytëzimi! Ë?...

Ardian Dobini në sy e shikoi, po për t'i folur nuk i foli. Nuk dinte çfarë t'i thoshte. E kishte gjetur të papërgatitur kjo pyetje. Ai rrezikohej të kthehej me turp në Lezhë, kurse Dalani...

— Të marrësh këtu edhe gruan. Kam dëgjuar që e ke punëtore në fabrikën e vajit.

— Po!

— Të marrësh edhe djalin, po edhe prindërit po të erdhën, kur të dalin në pension dhe, hopa, Ardian Dobini hodhi rrënjë në Elbasan!

Një minutë më vonë, kur Dalan Leka u bind se e kishte zënë ca ngushtë Ardianin, ose kur u bind se ai hëpër-hë kishte tjetër hall, befas e pyeti:

— E ke parë Shkumbinin?

— Jo!

— Jo?

— Jo!

— Duhet ta shikosh!

— Pse?

— Unë kur erdha këtu, tridhjetë vjet më parë, shkova

menjëherë dhe e pashë. Është lumë i bukur, me brigje plot gjelbërim e me ujë të pastër.

Ardiani e shikoi si t'i thoshte: «S'e kam hallin te Shkumbini!»

Tha Dalani:

— Po s'ka gjë. Edhe po nuk shkove, së shpejti do të kesh rast ta shikosh Shkumbinin!

Ardiani e pyeti vetëm me anën e vështrimit të tij të përqëndruar.

Tha Dalani:

— Kur të mbaroni montimin në kuotën 30, atëherë dy brigadat tona do të punojnë bashkë në kuotën 60. Nga ajo lartësi Shkumbini duket na-a-a, nga Krasta deri në Cërrik e në Papër.

Ardiani shikonte sytë kafe të çelët të Dalanit, që fliste për kuotat 30 e 60 dhe pyeste veten a ishte e mundur që Dalani të mos e dinte hallin e tij, të mos e dinte se ai nuk ishte penguar aksidentalisht, se ai nuk kishte mundur t'i rezistonte kuotës 30 e jo më kuotës 60? A ishte e mundur të mos kishte biseduar Pal Moni me shokët e Partisë, ose qoftë edhe vetëm me Dalanin? Po sado që e shikonte me vërejtje, ai as tashti as më vonë nuk mundi kurrë të kuptonte të vërtetën nga sytë e nga fytyra e Dalanit, që i fliste për kuotat si për një gjë të zakonshme e që i thoshte se një ditë mund të bëhej edhe ai elbasanas.

Pastaj ata heshtën një copë herë. Ardiani diçka ndiente në shpirt dhe ishte gati të buzëqeshte orë e çast. Por nuk buzëqeshte, sigurisht. E mbante përbrenda, shikonte Dalanin dhe buzëqeshte me vete. Ngrohtësia e tjetrit e kishte lehtësuar disi.

Pastaj ata biseduan gjëra të shkëputura, si bie fjala:

— E di pse e kam këtë ngjyrë në fytyrë?

— Jo, nuk e di, — u përgjigj me qejf Ardiani.

— Nga hekur-nikeli i Pishkashit dhe i Gurit të Kuq!

Ardiani qeshi.

Pyeti Dalani:

— Ke udhëtuar andej?

— Jo!

— Edhe bimësia buzë rrugës, edhe rrugët vetë po atë ngjyrë kishin marrë para se të bëhej treni. Pa le për shoferët, që s'bëhej fjalë, po edhe ne të ofiçinave. Ja, shikomë mua dhe bindu!

Në një nga pauzat e bisedave të tyre, Ardiani e pyeti:

— Si është puna me pjesët e ndërrimit që importohehin nga jashtë?

Ardiani e pyeti kot dhe u pendua që e pyeti. Ai kishte dëgjuar se Dalan Leka mund të fliste për portokallat e për ullinjtë, për Shkumbinin e për fqinjët, mund të tregonte edhe ndonjë histori që i kishte ndodhur (dhjetori i vitit 1945) por për punën e tij si mekanik e për ofiçinën e brigadën e vet s'para ia kishte qejfi të fliste.

— Ka qenë e vështirë! — e kaloi ai tërthor dhe shkurt pyetjen e Ardianit.

Atëherë ai e pyeti për vete (më vonë ai do të çuditej për këtë pyetje që i kishte bërë):

— Si thua ti, shoku Dalan, ku të punoj unë kur të dal nga spitali?

— Nuk të kuptoj! — u çudit ose bëri sikur u çudit Dalan Leka.

— Në brigadën e Pal Monit?

— Po ku?

— Lart apo poshtë?

— Si thua ti?

— Ti si thua? — nguli këmbë Ardiani.

— Lart! — them unë.

— Edhe unë ashtu dua, po...

— Çfarë po, — nguli këmbë Dalan Leka.

Pas pak:

— Dua të të tregoj të vërtetën, — tha Ardiani.

— Tregoma!

— Jam keq!

— Pse? — pyeti Dalani me të butë.

— Unë nuk u pengova!

— E pastaj, ç'do të thuash me këtë?

— U rrëzova!

- E pastaj?
- Më merren mendtë, më vjen për të vjellë!
- Kujtova se çfarë do të më thoshe!

— Po nuk mora lartësitë, po nuk u bëra i barabartë me të tjerët, s'më mbetet tjetër veçse të hap kanale. Po në goftë se një teknik i kategorisë së gjashtë detyrohet të hapë kanale, atëherë ç'kuptim ka që ta bëjë stazhin në Metalurgjik? Më mirë të kthehem në Lezhë.

Heshtën. Dalan Leka palosi shaminë, me të cilën kishte sjellë pjatën e lakrorit dhe e futi në xhep.

Tha Ardiani:

— Si do ta kryej unë detyrën dhe objektivin e organizatës së Partisë, po nuk kapërceva këtë pengesë që më doli përpara, po nuk qeshë në gjendje të punoj përkrah të tjerëve?

Heshtën prapë. Po edhe në këtë heshtje Dalan Leka u mor me diçka, thua se nuk e kishte dëgjuar fare çfarë i thoshte tjetri. Kësaj radhe ai mbështolli pjatën me një copë gazetë.

— S'jam i përshtatshëm për të punuar në lartësi! — e ngriti pak zërin Ardian Dobini.

Dalan Leka qeshi me të qeshurën e tij të mbytur, siç mund të qeshim për një gjë fare pa rëndësi (si për tekat e një fëmije) ndërsa sytë e fytyra e tij vazhdonin të shprehnin: kujtova se çfarë do të më thoshe!

— Kush të tha që s'je i përshtatshëm për të punuar në lartësi?

— Pal Moni!

— Vetëm Pali?

— Dhe ndonjë tjetër!

— Kot, fare kot. Nuk ekziston një sëmundje e tillë. Të gjithë njësoj jemi, por disa mësohen më vonë, kadalë-kadalë, siç thonë në Elbasan! — Dhe shtoi: — Brigada e Palit u kthye në aksin B, bëri punimet e imta dhe së shpejti kthehet në aksin A. — Heshti. I hodhi Ardianit një vështrim evokues e kuptimplotë dhe tha si padashur: — Fron-

ti i punës, fundja, rregullohet me urdhër, po të tjerat presin që...

Kësaj radhe heshtja që pak më e gjatë. Pastaj Dalani tha diçka që Ardian Dobini nuk e kuptoi, në e kishte në vazhdim të bisedës për Palin, apo për vetë Ardianin e për lartësitë, apo ashtu kot. Ja çfarë tha:

— Vullneti!

Pastaj ata folën për shumë gjëra të tjera, por që s'kishin të bënin fare as me vullnetin, as me lartësinë, që ishin shqetësimi kryesor i Ardianit ato ditë. Dalani, p.sh. i foli për metalurgjikun, për vullnetarët që vinin dhe shkonin, për ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme të organizatës së partisë që kishin bërë një ditë më parë. Aty nga fundi i bisedës, para se të ndaheshin, para se Dalani të largohej po me atë hap të matur e po me atë buzëqeshje të matur, i kishte thënë ose e kishte porositur:

— Kur të kthehesh në Kombin, eja të më takosh!

Kur mbeti vetëm, Ardian Dobini e shoi përsëri dritën. Në errësirë ai hodhi sytë nga korniza e dritares. Nata, si më parë, ishte e qetë. Yjet pikonin dritën e tyre mine-rare dhe herë-herë këputeshin e linin një vazhdë të kuq nga prapa.

Dita kishte shkëlqim, mendonte Ardiani, dita kishte edhe zhurmë, nata kishte qetësi, kishte errësirë dhe që të dyja bashkë ishin të bukura... Dhe Dalan Leka, me largimin e tij, kishte lënë nga prapa diçka nga bukuria e ditës, diçka nga bukuria e natës... Kështu mendonte ai dhe pada-shur iu kujtua se atë mëngjes...

N G J I T J A

... Atë mëngjes, kur ai u pajis si të tjerët, me rripat e sigurimit, me çekan e çelësa në torbë dhe, pasi u përshëndet me të gjithë ata, me të cilët kishte punuar një javë aty poshtë, me xha Tolin, me Lonin, që e shikonte me mjekrën në gjoks, me Mricën serioze e Nadiren, që i buzëqeshte me sytë e vegjël gati të mbyllur, ai zuri t'u ngjitej shkallëve të ngushta e të pjerrëta i parafundit. I fundit ngjitej vetë brigadieri, Pal Moni. Ky ishte një zakon i vjetër i tij, i vjetër dhe i pandryshueshëm: gjithmonë i fundit.

Sakaq në tërë pjerrësinë e shkallëve kishin filluar të qeshurat, klithmat e gëzimit, shakarar, thumbat e garat. Kishin filluar edhe kërcimet, si të gudulisur përjetë në brinjë. Në mes të kësaj zallahie mëngjesore, po edhe i frymëzuar nga kjo zallahie, Ardian Dobini, pasi ishte ngjitur afër njëzet metra, hodhi sytë poshtë në tokë. Ai deshi të përshëndeste edhe një herë xha Tolin, Lonin, dy shoqet dhe bile deshi t'i përshëndeste në mënyrë të veçantë, që t'u jepte të kuptonin Mricës e Nadires, se nuk do të ishte e largët dita që edhe ato do t'u ngjiteshin atyre shkallëve, kurse Lonit ai donte t'i hiqte frikën, donte t'i tregonte se nuk ishte gjë fare lartësia, ja, le të shikonte Loni si mbahej ai me një dorë (bile atje ku shkallët ishin fare pingul) dhe me dorën tjetër ai mund të përshëndeste lirisht, njësoj si në tokë. Por, për fatin e tij të keq, Ardian Dobini u ndodh, si të thuash në një çast fatal: ashtu do të mendonte ai pak më vonë për atë çast. Ai e quajti fatal, sepse, çuditërisht, kur hodhi sytë poshtë, toka iu duk shumë larg, e fundosur diku në disa thellësi mitologjike, ndërsa xha Toli e Loni (që po ndiznin motosaldatriçen) Mrica e Nadirja (që po lye-nin me bojë vaji) iu dukën si pika të zeza apo si ato goglat

e selvisë, që ishte pranë shtëpisë së gjyshes, një orë përtej Lezhës. Atij nuk i kujtohet (dhe nuk do t'i kujtohet as më vonë) si e lëshoi poshtë njëren dorë (por që nuk përshëndeti kurrë me atë dorë) si arriti të mbahej vetëm me dorën tjetër, bile nuk i kujtohet në i kishte sytë të hapur apo të mbyllur. Vetëm mban mend që e tërë toka poshtë e malet përreth, të gjitha rombet, katërkëndëshet, katrorët e kubet e dhjetëra figura të tjera poliedrike, që projektoheshin në sfondin e kaltër të qiellit përmes atyre trarëve e eleve, përmes atyre kapriatave e kolonave, dhe së fundi të gjitha konturet e uzinës N, që ishte një pyll i pafund prej çeliku, e gjithë bota, e gjithë qenia e tij u vërtitën me aq shpejtësi, sa ai më kot lëvizte dorën e lirë për ta mbërthyer pas shkallëve, sepse edhe shkallët vetë ishin hedhur në një valle të çmendur rrotullore.

— Ç'bën kështu?! — i briti Pal Moni që ngjitej pas tij. Ai i vuri dorën në kurriz dhe e ngrii bustin e varur të Ardianit deri në pozicionin normal, dmth në pozicionin vertikal, paralel me shkallët. — Të jetë hera e fundit kjo shaka! — Pali e shkundi me inat. — Të jetë hera e fundit që mbahesh me një dorë, dëgjon ç'të them?! — e shikoi ai me dyshim.

Ardian Dobini u mbërthye me të dyja duart, mbështeti ballin te hekurat e ftohtë të shkallëve dhe, kur e ndjeu se ai vetë, e pas tij, bota dhe shkallët ishin fiksuar në vendin e tyre, për pak deshi t'i tregonte Palit se kjo ishte hera e parë që ai ngjitej në lartësi, se ai vërtet ishte mekanik prej disa vjetësh, por tërë kohën kishte punuar poshtë, në një oficinë, në fillim pranë ndërmarrjes, pastaj pranë një kantieri të vogël dhe nuk i kishte ndodhur të ngjitej në lartësi të tilla, veçse në manin e gjyshes, në majën e të cilit qe ndier fare i sigurtë. Por mani i gjyshes s'ishte veçse dhjetë metra i lartë. Kurse këtu ishte ndryshe dhe ai s'e kishte marrë kurrë me mend se do të ishte kaq ndryshe. Ai kishte dëgjuar nga Loni (dhe jo vetëm nga Loni) të fliste për lartësitë e konstruksioneve prej çeliku apo të shkallëve të zhveshura, ku tërë ajo zbrazëti, që shtrihej midis teje dhe tokës, të dukej sikur do të të thithte nga çasti në

çast, por ai edhe këtë s'e kishte marrë dot me mend, bile as e kishte besuar. Po tashti, a t'i thoshte Palit se kjo ishte hera e parë që ai ngjitej kaq lart? A t'i tregonte të vërtetën, apo?... Nuk e hapi gojën, nuk tha asgjë, megjithëse që prapa zverkut e kishte ndier me kohë dyshimin e tjetrit, të paktën, nga notat alarmuese të zërit të brigadierit. Po ku ta dish, ky dyshim mund të kishte kaluar, mendoi ai, ashtu sikurse kishte kaluar edhe marramendja e tij, ose të paktën tashti ai ndihej i fiksuar dhe i mbërthyer fort pas shkallëve. Sidoqoftë, as deshi ta thoshte dhe as e tha të vërtetën edhe për faktin e thjeshtë se i erdhi turp.

— Hajde, ngjitu, se kemi punë për të bërë! — i foli prapë me inat Pal Moni.

Ardian Dobini ngjiti shkallaret që i kishin mbetur, por pikërisht te shkallarja e fundit sikur stopoi papritur. Pak më vonë ai e kuptoi se kishte rënë nën pushtetin e një mendimi të ri, mendim që ishte ose mund të ishte baraz me frikën, bile edhe më tepër, dhe prapë, krejt papritur, ai sikur u bë i ndërgjegjshëm se diçka do t'i ndodhte patjetër. Kur të shkëputej nga shkallët, Ardianit do t'i duhej të qëndronte drejt në këmbë mbi traun e kalimit e më vonë mbi dhjetëra trarë të tillë, që më i trashi mund të ishte dyzet centimetra...

Ashtu ndodhi, ose ashtu iu bë, sikur shkallaren e fundit nuk e ngjiti vetë, po me ndihmën e Palit, i cili, pasi e kishte mbërthyer mirë nga rripi i sigurimit, e kishte vendosur mbi një fletë llamarine, që shërbente si shesh çlodhjeje për montatorët e kuotës 30.

— Prit këtu, — tha Pali, — sa të të caktoj me ç'punë do të merresh! — Kaq kishte thënë Pali dhe kishte ecur mbi një tra vinç-ure, apo mbi një tra kalimi, që Ardianit nuk i kujtohet mirë. Por rëndësi kishte fakti që Pali kishte ecur shpejt dhe pa u lëkundur asnjë qime, si të ishte duke ecur në bulevardin e gjerë rrëzë kalasë së Elbasanit.

— Mirë, — tha Ardiani, duke u përpjekur të tregohej i shkujdesur e gjakftohtë, bile duke guxuar të hidhte edhe vështrimin poshtë. Askush s'mund të gjykojë se në një konstruksion të zhveshur çeliku, tridhjetë metra janë lar-

tësi e madhe apo e vogël, pa u ndodhur vetë në atë lartësi, por të paktën Ardianit iu duk sikur ndodhej në majën e një shtize dhe nga ajo majë ai s'mundi të shquante asgjë atje poshtë, përveç një lëmshi të mjegullt, pa formë e pa asgjë. Mbylli sytë dhe aty për aty u pendua që ia kishte lejuar vetes një gjë të tillë. U betua se atë ditë nuk do të shikonte më asnjëherë poshtë. Ndenji i mbledhur galiç mbi fletën e llamarinës, vendosur në një kryq trarësh, por mendja i punonte vazhdimisht, ajo nuk donte të rrinte galiç. Po sikur ta thërrisnin të shikonte atje... ose atje... Çfarë do të bënte ai?... Shikoi rrotull dhe lart (jo poshtë, se poshtë ishte betuar të mos shikonte) dhe vuri re se shokët kishin filluar nga puna. Nja tre nga ata, pikërisht tre shokët e ngushtë të Palit, Astriti, Tafa dhe Arbeni, pasi kishin hipur edhe pesë metra të tjera, qenë lidhur, qenë varur pezull dhe tashti rrinin kaluar mbi ca pajisje të rënda dhe i qëllonin me çekan. Edhe nga brendësia e tyre dëgjoheshin goditje çekani: ishin ata që, siç i kishte thënë xha Toli, përpiqeshin ta fashonin bërrylin nga brenda. Një tjetër kishte ulur maskën dhe ngjyra portokalle e elektrodës dukej tepër e thellë aty midis qiellit të kaltër dhe skeletit të zhveshur të objektit 500, që ishte në qendër të konstruksionit të uzinës N. Disa tërhiqnin me litar ca «T» e dopio «T» ca «U» e «L» me të cilat, mendoi Ardiani, mbërtheheshin ato pajisje që ngjanin me tuba e që e kishin diametrin një metër e gjysmë.

Po sikur ta thërrisnin? Po sikur të dëgjonte zërin e Palit: «Ardian, eja këtu!» Çfarë duhej të bënte ai? Do të pranonte se nuk ishte në gjendje të ecte? Po, ashtu do t'i them, foli me vete, por, para se t'i them ashtu, para se të dorëzohem, duhet të bëj një provë. Patjetër që duhet të bëj një provë. Dhe u ngrit. Po nuk qëndroi gjatë në këmbë, bile as që arriti të drejtohej i tëri, bile nuk arriti as të vinte këmbën mbi traun, prej nga kishte kaluar pak më parë Pal Moni. Kjo ndodhi sepse (të paktën kështu iu duk Ardianit) llamarina mbi të cilën qëndronte ai, nuk na qenkësh mbërthyer mirë, ose nuk paskësh qenë fare e mbërthyer. Ajo (llamarina) u var në një anë(!) dhe ai lëshoi një klithmë. Ai

u vërtit rrotull vetes dhe klithi prapë. Kur klithi, pati përshlypjen sikur dëgjoi një zhurmë të çuditshme, që mund të... kishte qenë zëri i tij apo një tingëllim i brendshëm dhe i shurdhër i çeliqueve që e rrethonin. Por edhe kjo klithmë nuk zgjati shumë. Ajo ishte shuar apo kishte vdekur po aq befasisht, siç kishte lindur. Bashkë me klithmën e tij, ose një çast më parë, Ardiani kishte dëgjuar njërin nga shokët të thoshte, se ajo ishte një ditë e bukur, por edhe kjo frazë që prerë në mes. Kur shokët kthyen kokën nga ai, atëherë Ardianit i mjaftoi vetëm vështrimi i tyre, që të kuptonte sa shumë ishte trembur, sa shumë ishte tronditur dhe frikësuar dhe tashti ai kishte kaluar në panik, në atë panik që pasqyrohet te njeriu vetëm në çastet e një rreziku për vdekje. Kur të tjerët hodhën një hap përpara, ai nuk ndodhej më mbi sheshin e çlodhjes. Trupi i tij kishte rrëshqitur dhe ai mezi kishte mundur të kapej pas një trau disa metra më poshtë. Por në çastin tjetër duart s'e kishin mbajtur. Asgjë s'mund të bënte më, përveç t'i uronte vetes që, kur të binte në tokë, të shpëtonte për mrekulli (se nuk do të ishte as i pari as i fundit që shpëtonte nga aksidente të tilla) pastaj, po të mos ishte e mundur kjo, dmth po të mos ishte e mundur të shpëtonte, atëherë ai i uroi vetes... çfarë t'i uronte?... Nuk i pëlqente në asnjë mënyrë Ardianit të... Së fundi atij i kaluan nëpër mend gruaja, prindërit, djali motak dhe aty për aty ai u çudit, që kishte gjetur kohë të mendonte për këto gjëra pikërisht në çastin që ishte duke rënë. Bile, me të gjithë forcën e duarve, ai që kapur përsëri pas cepit të një trau dhe pas një lëkundjeje të vogël, ndjeu të binte sërish poshtë të shikonte një tjetër shesh çlodhjeje, drejt të cilit shkante. Pastaj dëgjoi një zhurmë. Iu duk sikur ra, sikur u rrokullis, sikur... dhe ngeci diku, siç mund të bjerë, të rrokulliset e të ngecë një disk i thyer dhe... asgjë tjetër. Kaq. Çast tjetër nuk kishte pasur më. Të paktën ai s'mbante mend se çfarë i kishte ndodhur më pastaj. Veçse kur kishte ardhur në vetë në spital...

P L A K U

Nga fundi i javës së dytë në dhomën e Ardian Dobinit shtruan një plak, tek i cili të binte në sy menjëherë trupi i tij i gjatë dhe i drejtë, që fshihte energji dhe qëndresë të rrallë. Këtë përshtypje përftoi Ardiani që kur plakun e sollën për krahu dhe e shtrinë në krevatin përballë tij. I tillë iu duk edhe i biri i plakut: i gjatë, i fortë, ndoshta dyzet vjet më i ri se i ati. Por pavarësisht nga përshtypjet e para, që s'qenë veçse të mira, pak më vonë Ardian Dobini e ndjeu veten të mërzitur. E kishte mërzitur vështrimi i plakut, me ata sy të kërcyer që të shikonte sikur ti të ishe një nxënës i keq dhe ai të ishte kujdestari yt. Më vonë e kishin mërzitur edhe disa shqetësime e përkujdesje të shtjerrura të disa vizitorëve për shëndetin e plakut, ose më saktë, për gjurin e plakut, që jo vetëm mund të kishte zënë ujë, por që mund të hante edhe thikën. Nuk dihet si e qysh, dalngadalë Ardiani e zuri ters me këtë plak, si të ishin parë me sy të keq, si i thonë. Ardianin e mërziste edhe një zakon tjetër që kishte plakut: të kërciste buzët, që i kishte të holla si lapkër dhe pastaj të përtypej, si të kapërdinte menjëherë një kokërr vezë të zier. Përshtypjen e fundit ndoshta ia jepnin Ardianit sytë e plakut pak të kërcyer jashtë, si t'i kishte ngecur veza në fytyrë. Dhe kishte një zakon që, kur midis tyre vazhdonte një heshtje e gjatë (ndoshta Ardiani jetonte në flatrat e ëndrrave të veta!) plakut pyeste befas dhe pyeste kot:

— Pastaj, mre çun? — kjo pyetje u bë ditën e parë.

Ditën e dytë biseduan gjithashtu pak. Ajo kaloi pa asnjë ngjarje, me përjashtim të një karkaleci (që s'dihet nga erdhi) që ra mbi krevatin e plakut, u ngrit mbi këmbët e gjata dhe, duke u hedhur pupthi, u ngul në cepin e ja-

stëkut. Plaku e zuri karkalecin nga fletët, e shikoi me kureshtje (në përgjithësi vështrimi i tij ishte jo vetëm prej kujdestari, por edhe prej kureshtari të pandreqshëm e të pakorrigjueshëm) pastaj e hodhi në drejtim të dritares së hapur. Karkaleci, që dukej si ta kishin lyer atë ditë me ngjyrën e freskët të gjelbërimit të atij qershori, u hodh dy-tri herë në parvazën e dritares dhe u zhduk jashtë.

Tha plaku:

— Karkaleci është armik i bujqësisë dhe i blegtorisë!

Tha pas pak:

— Aty ku bie me tufa, na-a-a i bën të lashtat dhe bimesinë!

Tha pas pak:

— Nuk e vrava!

Tha prapë:

— Në spital nuk mund të vriten qenie të gjalla!

Kjo ndodhi në orët e para të mëngjesit. Pjesa tjetër e ditës kaloi pa ndonjë ngjarje të shënuar. Veç aty afër mbrëmjes nga dritarja e hapur u fut në dhomë një bletë, që fluturonte ngadalë e që me uturimën e saj të përkëdhel-te veshët me ëmbëlsi nanuritëse. Me të parë bletën tek i vërtitej mbi kokë, plaku pësoi ndryshime ngazëlluese, dmth u bë në qejf, tiparet iu zbutën, si të reflektonin uturimën e bletës, ndërsa pamja e tij thatime u bë si e një prindi të ri, kur shikon fëmijën që hedh hapat e parë duke u mbajtur mureve.

Pas disa rrotullimeve të plota, bleta qëndroi mbi komodinën në mes të dy krevateve dhe lëshoi thumbin mbi disa thërrime apo kokrriza sheqeri të lagura. Pastaj ajo u ngrit, bëri sërish disa rrotullime nëpër hapësirën e dhomës dhe kësaj radhe çuditërisht deshi të binte me këmbëngulje mbi duart e Ardianit, por ai e përzuri dhe atëherë ajo ra mbi kurrizin e njërës dorë të plakut, që e kishte të rreshkur, të tharë e plot damarë blu të errët. Plaku nuk bëri asnjë lëvizje, as frymë nuk mori, derisa bleta u ngrit nga dora e tij e rreshkur, u ul përsëri mbi komodinë dhe, kur i kishte thithur të gjitha mbeturinat molekulare të sheqerit apo kur ishte velitur me to, u ngrit e fluturoi si plumb nga dritarja e hapur.

Tha plaku:

— Vetëm në vjeshtë, kur mbush hojet me mjaltë, vetëm atëherë ajo bëhet grindavece dhe nervoze. Por jo tash, tash ajo është e butë e shumë punëtore.

Me këto fjalë morën fund bisedat e tyre (nëse mund t'i quajmë të tilla) të ditës së dytë dhe po në fund të ditës së dytë Ardiani filloi t'i rrëzonte përshtypjet antipatike ndaj plakut, që kishin të bënë me ditën e parë e sidomos me çastet e para të njohjes së tyre, megjithëse plaku, para se të kthehej në anën tjetër për të marrë një sy gjumë, siç thoshte ai, demonstroi atë zakonin e tij të çuditshëm: përplasi buzët dhe pastaj u përtyp si të kishte kapërdirë me-njëherë vezën e zier.

Ditën e tretë:

- Nga të kemi?
- Nga Lezha!
- Bukur. Unë jam vendas.

Heshtën.

Pyeti plaku:

- Si të quajnë?
- Ardian...
- Çfarë Ar...diani?
- Ardian Dobini.
- E gëzofsh emrin! Me jetë të gjatë!

Heshtën.

Tha plaku:

- Mua më quajnë Tahir Tahiri.

Ditën e katërt:

- Me çfarë pune merresh?
- Punëtor!
- Në Kombinat?
- Po!
- Ekstra.

Heshtën.

Tha plaku:

- Unë jam pensionist!

Ditën e pestë:

- Kur dola në pension këtu e dhjetë vjet më parë, atë-

herë unë isha shtatëdhjetë e dy vjeç, të gjithë më këshilluan të hiqja dorë nga puna, të gëzoja pleqërinë, pensionin, të mirat e qeverisë e të Partisë. Dhe unë sikur u binda, sikur i dëgjova, u sorollata nja dy muaj nëpër shtëpi. Më kishte thënë një mik se luanin plak, kur ka ndodhur ta lirojnë nga kafazi, nuk ka jetuar në pyll më tepër se dy muaj. Kurse unë, po më mbylle në kafaz, nuk rroj më shumë se dy muaj. Një mëngjes u ngrita në orarin e punës, mbështolla, si zakonisht, ca bukë, autobusit lart dhe, o burra, te bletët e mia, me të cilat kam jetuar më shumë se gjashtëdhjetë vjet. Tashti jam si mbikëqyrës, si këshilltar vullnetar. Njëzet vjeç isha kur vura zgjuan e parë apo kosheren, si i thonë disa. Por, që ta kam fjalën, pasi u bëra këshilltar e mbikëqyrës vullnetar, do ti, më eci ters muajt e parë, u sëmura dy herë me radhë. Prapë m'u hodhën në grykë, hiq dorë, xha Tahir, babë Tahir, gjysh Tahir, por unë s'hoqa dorë nga bletët dhe që nga ajo ditë e kam ndër trupin si fil, veç një javë më parë kjo këmba, ky gjuri më gozhdoi në shtëpi.

Kaq foli atë ditë xha Tahiri, shikoi batanijen aty ku duhej të ishte gjuri dhe heshti...

Ditën e gjashtë:

— Pastaj, mre çun? — dhe befas nguli mbi Ardianin vështrimin e tij, që shikonte e rrëmonte jo vetëm nëpër sipërfaqen e fytyrës, por sikur gërryente përbrenda, derisa një herë Ardiani kaloi padashur pëllëmbën nëpër faqe, si për të parë edhe sa mishra i kishin mbetur. — Bleta është një in-sekt që jeton në rregull të madh, bën një jetë shumë të organizuar, si i thonë tashti, shumë të disiplinuar. Vetëm se unë jam i pakënaqur. Do t'i bëj një letër Tiranës. E di pse?

— Pse?

— Bleta futet në sektorin e blegtorisë, po për lopën, për delen, për dhinë e për shpendët, për pulat e për gje-lat është bërë zakon të flitet mot e zaman, për bletët jo, për bletët flitet shumë pak dhe pothua nuk shkruhet fare nëpër gazetat e Tiranës. Kurse bletët na japin mjaltin, që jo vetëm pëlqehet shumë nga popullata, po përdoret edhe

si ilaç heqimi, apo doktori, si i thoni tashti. Apo s'është një e ardhur pa shpenzime, apo s'kursehet sheqeri, apo...

Po, kur Ardiani s'po e dëgjonte më, befas plak u tha:

— Pastaj, mre çun, nuk më the si të ndodhi që u rrëzove:

— U rrëzova! — Shtoi: — M'u mor mendja! — Shtoi:

— U pengova! — dhe Ardiani i tregoi më shumë sesa duhej, i tregoi edhe gjëra të panevojshme, edhe gjëra të tjera që mund t'i kishin ndodhur para se të vinte në Metalurgjik. Duke dëgjuar Ardianin, xha Tahiri nuk e ndërpreu asnjëherë, nuk e pyeti asnjëherë. Kjo ndodhte, sepse ai plak, sado kureshtar që ishte, nuk e kishte zakon të pyeste kur tjetri tregonte diçka nga jeta e tij, apo kur tjetri i qante ndonjë hall. (Këtë zakon të plakut ai do ta kuptonte e do ta fiksonte disa ditë më vonë të jetës së tyre të përbashkët në spital.) Ndoshta ishte edhe kjo (heshtja dhe pasiviteti i plakut kur të tjerët tregonin) që Ardiani ta ndiente veten lirshëm e të mos ia thoshte plakut arsyet e vërteta të rrëzimit të vet. Ai përsëriti shkurt:

— U pengova!

— Nga ç'lartësi?

— Tridhjetë metra!

Sytë e kërcyer të plakut kërcyen akoma, si t'i kishte ngecur veza në grykë.

— Nuk rashë deri në tokë. Shokët më thanë se diku ngeca e diku u mbajta!

Plaku tha:

— S'ka gjë, kusure të zanatit. Edhe unë e kam pësuar nga bletët. Më janë hedhur gati të gjitha, — tregoi ai me dorë se si ishte fryrë në fytyrë e kudo. — Bleta është një ushtri e vërtetë. Ajo jeton gjithnjë si në festë, festë e ka punën, nuk njeh shevalë, s'ka shevalë për bletën...

Që nga ajo ditë filluan bisedat e rrefimet pa mbarim për jetën e bletëve, për meshkujt parazitare, për mbretëreshën, për... dhe Ardiani ishte i detyruar që gjysmën e kohës ta ndante për ëndrrat e veta, gjysmën tjetër për bletët, sidomos për bletët femra, që ishin punëtore të palodhura...

— Bleta, — vazhdonte ai me vështrimin të fiksuar përjetë në sytë e Ardian Dobinit, — bën jetë kolektive, si i thonë tashli, të përbashkët, si i thoshin në rininë time! — dhe vështrimi i plakut shkëputej nga sytë e Ardianit, shëtiste nëpër fytyrën e tij, por, aty ku ngulej pastaj, e shponte thellë dhe s'dinte të shkëputej. — Vetëm ka një të metë...

— Ç'të metë? — e pyeste Ardiani sa për ta ndërprerë, me shpresë se plaku do ta shkulte vështrimin nga fytyra e tij.

— Që ka mbretëreshë! — thoshte plaku pa e lëvizur një qime vështrimin nga sytë, apo nga balli, apo nga mjekra e Ardianit, po sidomos nga sytë. — Mbretëreshë. Por mbretërive u ka kaluar koha, janë bërë, si të thuash, për muzeum, apo jo?

Në këtë pikë të bisedës Ardiani kishte guxuar një herë të bënte një shaka:

— Ndoshta atë emër ia kemi vënë ne!

— Ç'emër?

— Mbretëreshë!

— Ah!... Ç'je ti!

Ardiani kishte bërë shakanë e dytë:

— Ku ta dish, po ta marrin vesh bletët që ne e quajmë mbretëreshë të parën e tyre, do të na zemëroheshin...

— Dhe?...

Tha Ardiani në vazhdim të shakasë:

— Do të protestonin!

— Ah!... Ç'je ti!

Tha plaku:

— Po si ta quanin?

— Drejtoreshë, kryetare, përgjegjëse, e të tjera e të...

— Ah!... — tha plaku dhe mbeti një copë herë pa folur.

Ishte e qartë: nuk i kishin pëlqyer ato tituj. Shkurt: i pëlqente mbretëreshë!

Tha pas pak:

— Se mos na bën ndonjë proçkë e propozon që mbretëreshat t'i quajmë kryetare!

— Jo, — tha Ardiani, duke kafshuar gjuhën për të mbajtur të qeshurën.

— Hë, mirë, — tha i çliruar plaku. Tha prapë: — Bletët femra... —

Kështu zgjatej biseda paraditeve e pasditeve, derisa vinin disa nga ata vizitorët, që ishin më të mërzitshëm se rrëfimet e përsëritjet e plakut për bletët, që shtireshin sikur gjoja vuanin njësoj ose më shumë se vetë plaku që ishte i sëmurë. Kur plaku u fliste për dhimbjen e gjurit, ata ngërdheshnin fytyrën, sikur e ndienin atë dhimbje pikërisht në gjurin e tyre dhe donin të dinin me skrupulozitet:

— Këtu, ë, ja këtu, a-a-a!

Tjetri:

— Shiko, shiko, pak më lart. Domethënë të dhemb kur e vë në tokë, a-a-a!

Tjetri:

— Domethënë, ta jep dhimbja në tepe të kokës, a-a-a!

Me t'u larguar vizitorët, Ardiani shikonte tavanin dhe priste që plaku të fillonte:

— Pastaj, mre çun?

— Kujt i thonë shevalë, xha Tahir? — pyeste Ardiani për të ndërruar bisedë, se e dinte që për tema të tjera xha Tahiri nuk zgjatej si me bletët.

— Ditët e zakonshme, — thoshte xha Tahiri. — As festat, as ditët me ngjarje, si bie fjala, kongreset e Partisë, as ditët e shënuara, siç është ajo e flamurit e të tjera. Shevalë janë ditët e zakonshme dhe këtu ta kisha fjalën për bletët...

«Prapë!» thoshte me vete Ardiani, «Prapë ua gjeti anën bletëve!»

— Bletët femra s'njohin shevalë, ato punojnë me gëzim gjithnjë si në festë!... — dhe tërkuza vazhdonte e vazhdonte...

PËRFYTYRIMI I PARË

— Sikur të mblidheshim, ta zëmë sot pas orarit të punës, e të bisedonim bashkërisht për disa çështje...

Askush nuk foli. Foli vetëm Pal Moni.

— Pse me kaq ngut, Ardian? Ç'është kjo dëshirë që, me të dalë nga spitali, kërkon të futesh menjëherë në çështjet tona?

Ardiani heshti, por Pali vazhdoi:

— Doktorët të kanë dhënë dy javë leje. Shko njëherë në shtëpi, çlodhu, pastaj...

— I çlodhur jam!

— Po ç'problem do të rrahim në atë mbledhje, që thua ti?

— Një nga ato problemet që kanë mbetur nëpër këmbë, nga ato që u biseduan këtu një ditë e që brigadës i është hequr vërejtja edhe nga sipër, por që ka mendime edhe nga poshtë!

Pal Moni e shikoi në heshtje Ardianin, e shikoi gjatë e me ngulm, por megjithatë kësaj radhe sytë e tij blu sikur nuk u errësuan. Kur u duk se po e tepronte me heshtjen e me vështrimet e veta, tha:

— Po, të mblidhemi!

— Të mblidhemi, po, — tha edhe Astrit Caka dhe sytë e tij, nën refleksin e flokëve të kuq, gati u ndezën flakë.

Pas kërkesës së Ardianit, pas përgjigjes së Palit e pas ndërhyrjes së Astritit, në rrethin e brigadës u krijua një tension i përgjithshëm, që e kishte epiqendrën te Pali e tek Ardiani. Për këtë tension dëshmoi edhe fishkëllima e njohur melodioze e Tafës, si dhe ajo gjendje e papërcaktuar e Arbenit, që e kemi quajtur pa shenja e karakteristika të veçanta por që kësaj radhe, befas, nxori disa tinguj të

mbytur grykorë, që megjithatë nuk krijonin diçka të re e që mund të mos ishin asgjë, apo mund të ishin diçka më tepër se heshtja, por të paktën jo armiqësore. Kurse shumica tjetër e punëtorëve heshtte me një heshtje të rëndë e serioze, që i tregonte Ardian Dobinit, se kërkesa e tij nuk ishte e kotë.

Pastaj ai ndezi një cigare, shikoi Palin me një nga ato vështrimet e tij të përqëndruara, që flisnin më shumë se çdo fjalë dhe, ndërsa të tjerët prisnin që ai ta hidhte si zakonisht fijen e shkrepëses mbi kokat e tyre, pikërisht kësaj radhe ai e lëshoi ngadalë pranë këmbëve të veta.

Për Pal Monin (si dhe për të tjerët) s'kishte si të mos ishte e qartë kërkesa e Ardianit për të biseduar rreth disa çështjeve, prandaj tha:

— E di, e di!... — dhe pjesën tjetër të fjalisë e të mendimit sikur e plotësoi me vështrimin e syve blu. Ardianit i duk sikur ata sy thanë më tej: e di, e di, për ty s'kishte rëndësi të ngjiteshe lart vetëm për sedër, ti e kishe hallin gjetskë, ti kërkon të hapësh ca rrugë të reja... E di, e di, e njoh këmbënguljen tënde, derisa të bëhet ashtu si thua ti!... Befas sytë e Palit u errësuan dhe Ardianit iu bë sikur dëgjoi: — Por do të ndeshemi!

Kurse krela e ashpër dhe e zezë e Ardianit, sytë e zinj e vështrimi i përqëndruar i tyre, u dukën sikur shprehën vetëm një «po» dhe pas kësaj «po-je» ai shtoi me zë:

— Në mbledhjen e parë mendoj të aprovojmë një plan pune, një si program për të gjithë brigadën.

— Për shembull? — pyeti Pal Moni me zë të papërcaktuar ose me zë asnjans.

— Një ditë mund të mbledhim brigadën, — tha Ardian Dobini, — dhe në këtë mbledhje brigadieri të raportojë e të japë llogari për gjashtëmuorin e parë të këtij viti. Shokët të flasim për të mirat e të metat e punëve në brigadë dhe të merren zotime e të vendoset një regjim pune për gjashtëmuorin e dytë.

Ardiani heshti. Ai kishte heshtur si me qëllim, si për t'u dhënë kohë të tjerëve të mendoheshin dhe, në qoftë se do të kishin kundërshtime, ta kundërshtonin,

Askush nuk foli.

Tha Ardiani:

— Pastaj dora-dorës mund të bisedojmë edhe për probleme të tjera!

Kaq tha ai dhe ngriti kokën, duke përfshirë me sy të gjithë brigadën. Mënyra si e ngriti kokën dhe mënyra si i shikoi tregonte se ai i kishte dhënë fund fjalës së tij.

— Po-o-o, s'është keq! — tha Astrit Caka. — Dikur i bënim të gjitha këto, mirë a keq, por i bënim. Këta dy vjet sikur na rrëmbeu puna, apo nuk di ç'të them!...

Të gjithë kishin heshtur. Bashkë me ta kishte heshtur edhe Pal Moni, sytë blu të të cilit tashti dukeshin tepër të zbutur në krahësim me fytyrën e tij të ngurtësuar, sikur brenda atyre tipareve të zhvillohej një luftë e ashpër, që ishte një luftë e vjetër dhe një luftë e re.

Pastaj Ardian Dobini hodhi vështrimin lart dhe pa qiellin që shtrihej me një kaltërsi transparente. Ishte një nga ditët e bukura të asaj vere. Disku i diellit shkëlqente e lëvizte ngadalë nëpër pyllin e çelikut të objektit 500. Ky pyll e kishte prerë qiellin dhe vetë diskun në copëza të vogla, në rombe, trapeza e katërkëndëshe e në qindra copëza e figura të tjera, që ndoshta gjeometria e teknikumit të ndërtimit, ku Ardiani mësonte pa shkëputje nga puna, nuk i njihnte akoma.

Këtë diell të copëtuar shikonte Ardiani dhe e gjithë genia e tij dukej sikur ishte aty për ta bashkuar atë, diellin, në një të tërë, se ashtu ai do të ishte më i bukur, më i ngrohtë e më i shkëlqyeshëm...

... U hap dera e dhomës dhe më parë u dëgjua zëri i infermieres, që e thërriste Ardianin në infermieri për t'i ndërruar plagën, pastaj u duk skufja e saj e bardhë, që s'ishte... Këtu morën fund përfytyrimet e Ardianit, që lidheshin me të ardhshmen, me dëshirën, me qëllimin dhe objektivin e tij, që lidheshin me ato skena që s'kishin ndodhur akoma, por që ai përfytyronte e mendonte se duhej të ndodhnin dikur...

P E R S Ē R I

Një ditë bëri një furtunë e papritur me shi e me erë, që erdhi jo vetëm nga grykat e maleve, jo vetëm nga lindja, jo vetëm nga Krasta, por edhe nga ana e detit, edhe nga anët e tjera, se në muajin qershor ndodh që Elbasanin ta hanë të gjitha erërat njësoj. Ajo ishte një erë e ngrohtë, që uturinte nëpër telat e telefonit, nëpër shtyllat e filxhanët e elektrikut, që përkulte majat e plepave përpara oborrin të spitalit, që aty lëshonte rrebesh e breshër bashkë — dhe atëherë ullukët, llamarinat, çatitë e xhamat kërcisnin, si të binin nga qielli gurë e zhur e jo shi e breshër. Por befas shiu e breshri pushonin, erërat, apo më mirë të themi, erërat kryesore, ajo e lindjes dhe e perëndimit tërhiqeshin, njëra në thellësi të Gadishullit Ballkanik, tjetra drejt hapësirave të Adriatikut e të Jonit dhe, kur ndodhte kjo, kur ndodhte të pushonin erërat, atëherë gjithçka qetësohej si me magji, retë griseshin, copa të kaltra arnonin qiellin, zogjtë këndonin të çakërdisur, këndonin me ngut, me shqetësim e gëzim bashkë, si ta ndienin e si ta dinin se rrezet e diellit, po edhe çdo gjë tjetër e çdo qetësi të ishin të përkohshme. Vërtet, retë trazoheshin përsëri, përsëri erë dhe, pa u tërhequr mirë rrezja e fundit e diellit, përsëri breshëri e shiu rrihnin çatinë e xhamat e spitalit.

Kur... befas trokiti dera. Tashmë Ardiani e njihte atë trokitje. Kanati u hap ngadalë (aq ngadalë, thuase nga njëri çast në tjetrin ai do të mbyllej sërish) dhe tek e çara e ngushtë u duk më parë një dorë në ngjyrën e bronzit, në gishtat e së cilës varej një si pako e vogël. Pastaj u dukën flokët e thinjur (grushti i miellit) pastaj fytyra, gjithashtu prej bronzi, jo e re, por e shëndetshme, pastaj i tërë trupi e me një bohçe më dorën tjetër, ku ishin mbledhur një palë kominoshe.

Gjëja e parë që ndjeu Ardiani ishte se ai u gëzua për ardhjen e Dalan Lekës. Së dyti, i bëri përshtypje qetësia e përjetshme e asaj fytyre dhe, së treti, kontrasti që krijohej midis asaj fytyre të qetë dhe furtunës që uturinte jashtë.

Për një çast Dalan Leka sikur shtangu. Ardiani s'ishte vetëm. Së fundi, ai e çliroi trupin, zbërtheu xhakëtën dopiopet, që duhej ta kishte qepur shumë vjet më parë, se i rrinte pak e ngushtë, shikoi këndeve të dhomës, mbështeti çadrën në njërin nga ato dhe eci i pavendosur akoma, cilin të përshëndeste më parë; po kur qe afruar, u duk sikur pëshpëriti nëpër dhëmbë: xha Tahiri i bletëve! Pastaj i buzëqeshi plakut (dhe i shtrëngoi dorën) i buzëqeshi Ardianit (dhe i shtrëngoi dorën). Buzëqeshjen e tretë ua adresoi të dyve njëherësh, por nga ana e jashtme ajo ishte asnjënjë, ishte një buzëqeshje që e kishte pikësynimin diku midis të dyve, dhe më shpesh shigjetat e saj godisnin komodinën që ndante dy krevatet. Mbi atë komodinë ai vendosi pakon që mbante në dorë, ndërsa bohçen e futi si me marifet prapa saj dhe tha:

— Kam dëgjuar se u bëre më mirë, xha Tahir!

Plaku rrotulloi sytë e kërcyer në drejtim të të porrsaardhurit dhe, pasi përplasi buzët e holla, pasi «kapërdiu» edhe vezën e famshme, tha:

— Posi, më mirë jam!

— Kurse ti së shpejti do të hedhësh valle majë hekura të objektit 500! — i tha ai Ardianit dhe, pasi ngurroi një hop se ku të ulej, vendosi dhe u ul në krevatin e Ardianit, por fjalën ia hodhi xha Tahirit:

— Qenkeni bashkë!

— Po, — tha plaku dhe heshti, pa qenë nevoja të shtonte diçka më tepër.

Befas, Dalan Leka qeshi me atë të qeshurën e tij të mbytur, që gati nuk mund të quhej e qeshur, por një gurgullimë tingujsh të largët.

— Qenka bashkuar mjalti me çelikut!

Ardiani dhe plaku qeshën gjithashtu. Edhe ata kishin qeshur mbytur, si për të imituar Dalan Lekën.

— Sikur... në gju... xha Tahir!

— Po, — tha plaku dhe, si më parë, s'qe nevoja të shtonte asgjë më tepër.

— Të kaluan dhimbjet?

— Po, — tha plaku dhe, si më parë...

Befas u ndezën dy shkrepëtima njëra pas tjetrës dhe rrebeshi rrahu xhamat. Pastaj një bubullimë kaloi tejper-tej nëpër qiell, si perëndi e luftës dhe e furtunës.

Tha Dalani:

— Bletët, xha Tahir!

Me të dëgjuar këto fjalë, plaku mori hov, ktheu kokën nga Dalani dhe aty për aty u duk sikur u bë dhjetë vjet më i ri.

Tha Dalani:

— Furtuna mund t'i ketë zënë jashtë!

— Jo, — tha plaku tërë gjallëri.

— Pse? — pyeti me gjithë mend Dalan Leka.

Prej kohësh askush s'kishte dashur apo s'kishte guxuar t'i bënte pyetje të këtilla xha Tahirit. Askush s'kishte dashur ta dëgjonte kur fliste për bletët e veta. Por ja që ishte gjendur një njeri ta pyeste e për më tepër, ta pyeste me tërë mend. Deshi të sigurohej:

— Pse, the?

— Po, pse?

Plaku mbylli qepallat si diafragma e aparatit fotografik. Ashtu, mbyll e hap, ai dukej sikur fotografonte të porsaardhurin. Dalani, që e ndjeu se po e fotografonin, u kthye i tëri nga ai, i gatshëm për ta dëgjuar.

Tha plaku, i ngritur në bërryla:

— Bleta e kupton e para furtunën. Ajo e kupton nga bimësia, me të cilën ka lidhje të ngushta. Kur prishet moti, disa bimë i mbyllin lulet përpara fillimit të shiut. Gjethet e mimozës së turpshme, që ne i themi lule mos më prek, përkulen shumë kohë përpara se të ketë filluar furtuna. Edhe lulet e akacies e tregojnë prishjen e motit me erën e fortë që lëshojnë. Të marrim pastaj lulemëllagën apo lulepataten, që vyshken e mbyllen pa u zënë mirë dielli...

Te dera u duk infermierja me skufje të bardhë. Ajo eci drejt krevalit të xha Tahirit, me një ampulë në dorë e me gjilpërën në dorën tjetër. Plaku e kishte ndërprerë rrëfimin, me sa dukej, për instinkt, kishte prekur propagnicën me dorë, kishte fotografuar me diafragmën e qepallave disa herë infermierën dhe, kur kjo e fundit u ndodh pranë krevatit të tij, ai kishte marrë pozicionin e përshatshëm...

Biseda për bletët nuk u lidh më. Kur u largua infermierja, Dalani dhe Ardiani ishin afruar kokë më kokë e diçka pëshpërisnin midis tyre. Ajo që pëshpërisnin ata, kishte të bënte me një bisedë të shtruar, të gjatë e shumë të domosdoshme.

Plaku, si u bind që ishte rrethuar nga vetmia, shikoi tavanin me sy të dremitur dhe as që kishte ndër mend të merrte pjesë në bisedë, veç një herë, në vazhdim të pëshpëritjeve të Dalanit me Ardianin tha befas:

— Duhej të takoje një njeri të vrazhdë si ai, që ti thua se e quajnë Pal Moni. Edhe baçi im i vrazhdë ka qenë, por unë s'pashë asgjë të keqe nga vrazhdësia e tij, veçse të mira. Ai ma ka mësuar zanatin e bletëve.

Pastaj ai ra prapë në atë si dremitje, me sytë hapur në tavan, kurse ata të dy, pasi e shikuan plakun, si për të miratuar ndërhyrjen e tij, po edhe heshtjen e tij, vazhduan të pëshpërisnin çuçu-çu, çuçu-çu...

Sa herë që dielli i qershorit rrëshqiste midis reve, dhoma ndriçohej, dhe e kundërta, ajo errësohej kur retë uleshin, kur era frynte dhe shiu e breshri rrihnin xhamat, e jo vetëm xhamat.

Pas disa ndriçimeve dhe errësimeve të këtilla, Dalan Leka u ngrit për të ikur por, në çastin kur po u zgjaste dorën, iu kujtua pakoja që kishte vënë mbi komodinën në mes të dy krevateve.

Tha, duke shikuar herë njërin, herë tjetrin:

— Ajo... gruaja ime kishte bërë sot një kek. Unë i thashë të hiqte një pjesë...

PËRFYTYRIMI I DYTË

Pasi ta kishte bashkuar apo afruar Pal Monin me të gjithë brigadën (pasi të ishin bërë të gjithë të barabartë për sytë e brigadierit) Ardian Dobini kishte ndër mend të godiste tendencën tjetër të sëmurë të Pal Monit, që kishte të bënte me shpirtin e repartit, që rendte pas globalit, që realizonte planin, por jo grafikun.

Një herë tjetër do të vinte përpara kritikës së brigadës shpirtin individualist dhe mikroborgjez, si mbeturinë e së kaluarës, që kishte të bënte me tendencën e Pal Monit e të shokëve të tij të ngushtë, për t'u hedhur medeo-mos në ato fronte pune që siguronin më shumë të ardhura, qoftë edhe në kurriz të brigadave të tjera.

Një herë tjetër Ardian Dobini do të ngrinte përpara shokëve punën e Mricës e të Nadires. Do të thyhej kështu koncepti frenues ndaj gruas, po do të prekej edhe problemi i kualifikimit. Nadirja e Mrica të ngjiteshin lart dhe dy të tjerë, sipas radhës, të zbrisnin poshtë. Të gjithë duhej të kualifikoheshin. Revolucioni tekniko-shkencor...

...Ishte përsëri infermierja ajo që e shkëputi Ardianin nga këto përfytyrime.

— Pse të qeshet me vete? — pyeti befas ajo.

— Më qeshet me skufjen tënde të re! — tha ai pas një heshtjeje të gjatë.

— Pse-e-e?! — u çudit ajo, gati për të qeshur edhe vetë. Po nuk qeshi, sepse në të njëjtën kohë infermierja kishte vënë re se fytyra e Ardian Dobinit ishte mprehur së tepërmi, pamja e tij ishte bërë tepër polemike, ajo të kujtonte fushat e betejave dhe betejat vetë.

— Me mua e ke? — pyeti e pasigurt infermierja.

— Jo! — tha Ardiani dhe kësaj radhe qeshi me të vërtetë.

Tha plaku nga krevati pranë:

— Skufja... skufja, moj gocë! — dhe ngriti gishtin tregues në drejtim të skufjes. — Edhe unë mezi e mbaj veten për të qeshur, pa le çuni!...

Kjo ishte hera e parë që Ardian Dobini dhe infermierja shikonin xha Tahirin të qeshte e të zbulonte dhëmbët, që i kishte të vegjël, por të gjithë të vetët!.

Tha prapë:

— Si një kapuç për ta mbushur me mjaltë!

Plaku kishte thënë edhe diçka tjetër, pastaj kishte zënë me gojë edhe bletët, por kishte qënë i detyruar të heshte shpejt sepse, me të filluar të thoshte diçka për bletët, gazi kishte ngrirë në buzët e Ardianit dhe të infermieres...

11

M E T A M O R F O Z A

Por një mëngjes plaku e ndërpreu fare rrëfimin për bletët. As pyeti më (Pastaj, mre çun?) veç e shikonte Ardianin jo me vështrimet e tij thjesht prej kureshtari e prej kujdestari konvikti, por me ca vështrime të tjera, të ndryshuara, që kishin marrë nuanca të reja e që të kujtonin vështrimet zhbiruese e të ngulitura të një maniaku, po edhe merimangën ta kujtonin, kur ajo përgjon mizën tek i afrohet pezhishkës.

Megjithatë, sigurisht, jeta vazhdonte në dhomën me dy krevatë të spitalit, ajo bënte të sajën. Vizitorët e të dyja palëve hynin e dilnin, fashot zvogëloheshin në gjymtyrët e në kokën e Ardianit, gjilpërat shtoheshin në pranicën e tharë të plakut dhe të dy bashkë përpiqeshin të

bindnin mjekët se e ndienin veten më mirë, sidomos plaku thoshte se tashti mund të ecte, dhimbje kishte, por mund të ecte, thoshte gjithashtu se rrugën për të shkuar te bletët e veta ai e bënte me autobus.

Pastaj vizitorët e mjekët largoheshin, vinin orët e qetësisë, përshtypjet shuheshin, të gjitha kalonin dhe atëherë mbetej vetëm vështrimi i ndryshuar i plakut, që Ardianin e hutonte gjithnjë më shpesh, gjithnjë më shumë. Për shëmbull, ky hutim arriti deri aty sa, nga fundi i javës së tretë, kur Ardiani shikoi një njollë mbi xhaketën e pizhameve në kokën e krevatit, ai shkoi të merrte peshqirin për ta fshirë, por befas njolla kishte kaluar në mur. Atëherë Ardiani mezi u kujtua se dielli nuk qëndronte në një vend.

Por plaku, megjithëse dëshmitar i këtij hutimi, as foli, as e vuri buzën në gaz dhe kjo heshtje ia përforcoi bindjen Ardianit se plaku kishte ndryshuar shumë...

12

PËRFYTYRIMI I TRETË...

Ardiani:

— Si thoni, a mblidhemi për të parë anët e mira të brigadës sonë e të brigadier Pal Monit?... Fjala është për të përhapur eksperiencën pozitive...

Kaq. Më gjatë Ardian Dobini nuk mundi të përfytyronte. Kësaj radhe e kishte penguar ai vështrim aq i ndryshuar i plakut...

R R Ē F I M I

Infermierja: — Xha Tahir, doktori është i lodhur!
Plaku e pyeti vetëm me anën e syve të kërcyer.

Infermierja: — Ai bëri një operacion urgjent pas mesit të natës!

Plaku shikoi skufjen e bardhë, që s'ishte veçse një gjë e vogël në kokën e saj, por e shikoi në mënyrë të atillë, sikur të ishte skufja ajo që e pengonte.

Tha plaku:

— Edhe puna ime s'pret!

Infermierja: — Xha Tahir, ai duhet të çlodhet!

Trupi i drejtë, i thatë dhe i gjatë i xha Tahirit, që fshihte energji dhe qëndresë të rrallë, u tund si një plep para erës.

Një zog fluturoi fr-fr mbi skufjen e infermieres dhe doli menjëherë nga dritarja e hapur.

— Nesër! — tha ajo. — Nesër, xha Tahir!

— Pse nesër? — u dëgjua një zë tjetër.

Tahiri u kthye dhe shikoi mjekun, që ishte një kokë më i shkurtër se ai.

— Sot, — tha mjeku apo kirurgu. — Tashti, — shtoi ai. — Shikoi nga infermierja: — Një xha Tahir ka qyteti ynë!

Infermierja heshti.

— Kush s'e njeh?! — shtoi mjeku dhe e zuri për krahu xha Tahirin.

— Ja si qëndron puna, — tha Tahiri.

— Në zyrë, të ulësh, xha Tahir!

— Ai çuni që kam në dhomë...

Tha mjeku:

— Jo këtu, xha Tahir, jo këtu!

Mjeku hapi derën e zyrës, hodhi njërin hap, por u zbraps i penduar.

— Urdhëro, xha Tahir, urdhëro, futu ti i pari!

Plaku i hodhi një nga ato vështrimet e tij të kërcyera, mbërtheu pizhamet, mbërtheu edhe xhaketën dhe prapë e shikoi mjekun, që lëvizte e rrotullohej para tij, si të ishte një kokërr bletë e shqetësuar.

Tek u ndesh me atë vështrim, mjeku e kuptoi se xha Tahiri nuk do të futej kurrë i pari në dhomë, prandaj, pa mbaruar mirë fjalën «urdhëro», në të vërtetë ai qe futur vetë.

— Erdha për punën e atij çunit!

— Prit, xha Tahir, se na paska hyrë dielli në dhomë. Të mbyllim edhe perdet, pastaj...

Mjeku mbylli perdet.

Tha plakui:

— E quajnë Ar-dian Dobini!

— Ulu, xha Tahir! — i tregoi karrigen mjeku dhe prapë u ul vetë i pari, sepse kishte pasur rast e kohë t'i njihte huqet e plakut.

Mjeku nxori nga sirtari një letër të pashkruar, nxori stilografin nga xhepi i brendshëm i xhaketës, e vuri diagonalisht mbi letër, fërkoj duart e ngjallura (këtë e bëri sepse atë çast pikërisht te duart e tij ishte ngulur vështrimi i plakut) hoqi një qime nga mënga e grykëses së bardhë dhe heshti një çast, por në çastin tjetër u duk sikur tha: pa hë, xha Tahir, ne të dy do të bisedojmë tashti. Sikur tha prapë, qetësisht, me durim e nëpër dhëmbë: nuk do të mërzitemi, jo-o. Pastaj ngriti kokën, shikoi plakun dhe kësaj radhe fjala e vetme, e qartë, që doli nga buzët e tij, qe kjo:

— Dëgjoj!

(Sikur të kishte qenë tjetër njeri, e jo xha Tahiri, që s'njihte në këtë botë veçse bletët, do të kishte kuptuar menjëherë se mjeku, që sapo kishte dalë nga operacioni, ishte akoma i emocionuar!)

— Dëgjoj! — përsëriti ai.

Plaku spastroi gurmazin me një kollë të lehtë dhe tha:

— Ai, Ar-dian Dobini, që i thonë... — dhe heshti. Diçka kujtoi. — Nga mënyra e guximi i ngjan bletës, por nuk është si bletë. — Heshti dhe u duk qartë se i kishte humbur fjalët që deshi të thoshte. Pastaj tha: — Bleta thumbin e ka të hidhur, por mjaltin të ëmbël, kurse ky çuni...

— A, ai punëtori me fasho në kokë! — i erdhi në ndihmë mjeku.

— Dua të bisedoj me ty, shoku doktor, për një çështje që ka të bëjë edhe me çunin, — dhe rrotulloi dorën rreth kokës për të krijuar figurën e fashos, — edhe me rregullin e brendshëm të spitalit. Se... ma pret mendja, një spital vërtet nuk prodhon mjaltë, të sëmuret vërtet nuk janë bletë, por megjithëkëtë ai duhet të ngjasojë me një zgjua bletë, me një koshere, si i thonë disa, se...

— Po, — tha ose e ndërpreu mjeku, pak i trembur se mos plaku po fillonte nga bletaria.

Ndoshta ngaqë e kishin ndërprerë, ndoshta pse mund të ishte bërë pak nervoz, plaku përplasi fort buzët e holla, i përplasi prapë dhe pastaj u përtyp. Tha:

— Disa net më parë u zgjova nga një zhurmë në krevatin fqinj. Ai Ar-dian Dobini, i kanë të vështirë emrat këta çunat e rinj, ai me çallmë në kokë, me fasho, si i thonë tashti, u ngrit, sho-ku doktor, dhe shikoi nga unë. Si nëpër gjumë isha unë, ashtu me qepallat pak të hapura. Ai veshi kominoshet, që ia solli një shok para ca ditëve e që i mbante pas komodinës, eci në majë të këmbëve, mbështeti duart pas mureve, llamba e portës hidhte, sipas zakonit, një dritë fare të zbehtë në dhomën tonë, hapi derën e doli në korridor. Mua, ashtu kot, nuk më mori gjumi. Prit e prit. Prit e prit që të kthehej ai, çuni me çallmë në kokë, ai që e thërresin Ar-dian Dobini. Por ai s'u kthye. U bëra merak, si i thonë fjalës. Ndeza dritën dhe cak, i hapa kapakun sergjeseffit tim, ora njëmbëdhjetë, efenem. Demek, thashë me vete, do të jetë larguar aty nga ora dhjetë. U ngrita, u rashë korridoreve, banjave e fermerive, e ku s'futa kokën, por çunin nuk e pashë gjëkund. Tha-

shë me vete... asgjë s'thashë me vete. U shtriva dhe prita, Gjumë s'kisha që s'kisha. Nuk e di sa prita. Kur ki-i-iu u hap dera ngadalë. Unë sytë na-a-a në errësirë. Ai eci prapë në majë të këmbëve, përsëri duart pas mureve, midis dy krevateve, hoqi kominoshet, i palosi, i vuri pas kominoshës dhe plluq në dyshek. Kur e zuri gjumi, unë hapja llambën e kokës, cak sergjeseffit tim, ora një pas mesit të natës. Çuni shkoka larg, thashë me vete. Të nesërmen unë hiç. Ai hiç. Hiç, po diçka i thashë. I thashë, sikur natën e kaluar kisha parë një ëndërr, sikur të gjithë të sëmuret kishin ikur nga spitali, vetëm unë jo. Vetëm unë kisha mbetur! Çuni vuri buzën në gaz, se është i ëmbël ai, që e thërresin Ar-dian Dobini. Të më falësh, e kam ca vështirë me këta emra të rinj. Pas tri netësh, sho-ku doktor, u përsërit një më një nata e parë. Iku po ashtu, u kthye po ashtu. Të nesërmen hiç. Vetëm i thashë prapë sikur kisha parë po atë ëndërr. Ai gjithë ditën më shikoi me dyshim. Herën e tretë, që thua zotrote, ai jashtë dhomës, unë fiu në këmbë, veshja xhaketen, tutat, se plak hesapi, mërdhuh. Kësaj radhe i isha qepur mirë, se edhe gjurin e kam më mirë. Ai një hap, unë një hap. Në korridor... në oborr. E kishte rregulluar çuni me rojtarin. Doli në rrugën e madhe. Atëherë, mua që më shikon këtu, e beson që më kënduan dyzet kumuria mbi kokë? Ishte një gjë kjo, thashë me vete. U ktheva në dhomë dhe mbeta me sytë në tavan. Gjumë hiç fare. Velasiqelam, çuni u kthye me orët e vogla. Unë bëra sikur fjeta e nuk ia hapa muhabetin gjatë natës. Ai psherëtiu ca herë dhe e zuri gjumi. Në mëngjes, kur hapëm sytë, i thashë këtu e këtu... i thashë se ishte larguar nga spitali tri herë. Ai u mendua e u mendua, pastaj më qau hallin. Më tha se nuk ishte penguar, por ishte rrëzuar. Se i qenë marrë mendtë, se i kishte ardhur për të vjellë. Edhe ato tri herë që u zhduk nga spitali, atje kishte qenë, tek ato shkallët e ngushta e të pjerrëta. Kishte qenë bashkë me atë mikun që i ka ardhur për vizitë nja dy a tri herë, me atë që i sollë kominoshet e na sollë kek të dyve. Çuni më tha se e kishte pisk punën, prapë i qenë marrë mendtë, e prapë i qe

përzier. Velasiqelam, që ta kam fjalën, më tha se nuk do të heqë dorë, o do të ngjitet si gjithë të tjerët, o bjer e vdis... i thashë, more çun, pse nuk kërkon ndihmën e sho-këve të brigadës sate? Ai më tha se do ta kërkonte atë ndihmë, sapo të dilte nga spitali, por deshi të përfitonte kohën, deshi të stërvitej, deshi ta provonte përsëri veten, pastaj... Kështu më tha. Që ta kam fjalën, më tha se nuk e kishte hallin vetëm te lartësia, por te disa detyra që i kishin vënë shokët, se ai që e thërresin Ar-dian qenka kandidat Partie. Ja, kështu, sho-ku doktor! — Kaq tha plaku dhe heshti me vështrimin futur brenda vetes. Pastaj, si të zgjohej nga një dremetje, shtoi: — Ah, harrova të të them, nuk dihet si ndodhi, por mbrëmë çuni u kthye pa kasketë në kokë. Them, që do t'i ketë ngecur atyre hekurishteve...

Pastaj plaku, që po jepte shenja lodhjeje, u ngatërrua pak, befas e hodhi fjalën te Kombinati, ku kishte qenë një herë, tha se i kishin bërë përshtypje kuberat e ndriçuara të një uzine, që ishin pesë herë më të mëdha se kuberat e xhamive të Stambollit, të cilat ai i kishte parë në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare. (Sigurisht, ai kishte dashur të fliste për çatinë e furnaltës, që me sferat e saj të kujton atllazet viganë!)

Tha plaku:

— Çuni ka një hall të madh!

Tha prapë:

— Mbrëmë nuk fjeta fare. Sikur më ka rënë njeri me dru në kokë. I shikon sytë e mi të skuqur?

Mjeku, që s'para kishte qejf ta shikonte në sy (në sytë e kërcyer) e shikoi në mjekër, e shikoi në ballë, por asnjëherë në sy.

— I shoh, — tha ai.

— Rrija shtrirë, pa bërë asnjë lëvizje, mbaja veshët ngritur dhe sytë mbyllur, që është shumë e vështirë për mua. Edhe çuni, që e thërresin Ar-dian, nuk flinte. Kaq e kuptoja unë. As lëvizte. Asnjë qime nuk i lëvizte. Rrinte prapët, qepallaqepur dhe përgjonte si merrja frymë unë. Tashti plakut kishin filluar t'i pengoheshin fjalët në

gojë. Buza e poshtme i qe varur si lakër e regjur dhe dukej shumë i lodhur.

Tha:

— Në qoftë se këtu ka diçka që s'është në rregull, ta marrim vesh me kohë. Edhe bleta që është bletë...

Mjeku i kishte bërë një shenjë me dorë, që e detyroi plakun të nxirrte ajrin nga mushkëritë dhe, me buzën e poshtme të varur, të thoshte me emfazë:

— Jo, jo, nuk do të flas për bletët! — dhe ajo veza e zier sikur i ngeci në fyt, por ai e kapërdiu me një nga ato të përplasurat e forta të buzëve.

Mjeku u mbështet në karrige dhe rrotulloi stilografin midis pëllëmbëve. Deri atë çast ai kishte qëndruar me bërnyla mbi tryezë dhe s'e kishte ndërprerë veçse rrallë xha Tahirin, veç kur ai kishte dashur të fliste për bletët. Përdërisa xha Tahiri zbrazte thesin e sekreteve të veta, në fillim mjeku tregoi shenja mërzitjeje (se edhe vështrimi i plakut ishte i bezdisshëm) po, kur tregimi u lidh vërtet me diçka të çuditshme e kur ai po i afrohej fundit, mjekun shpejtoi të shprehte me anën e fytyrës (gjithashtu të lodhur nga operacioni) një farë interesi, që u shoqërua me frymëmarrje të thella e me ndonjë ngrysje të fortë të ballit pa rrudha. Tashti ai dukej më i thjeshtë, sikur nuk ngjante me mjekun e emocionuar të disa minutave më parë, që kishte qenë aq i kujdesshëm, që i kishte dhënë aq rëndësi kush të hynte i pari në zyrë, që kishte mbyllur perdet nga dielli, që kishte nxjerrë një fije letër e një stilograf (!), që kishte fërkuar duart e që i kishte pëlqyer të thoshte: Dëgjoj! Tashti jo! Tashti dukej sikur i kishte harruar të gjitha këto, sikur ishte zhveshur nga çdo gjë e tepërt, nga çdo gjë e huaj dhe ishte vërtet i interesuar, bile edhe i gëzuar, që njëri nga pacientët kishte biseduar me të për çështje që kishin të bënin me fatin e një pacienti tjetër, e pse jo, edhe me rregullin e brendshëm të spitalit ku ai punonte.

Më në fund mjeku fërkoj fytyrën e sidomos ballin me pëllëmbën e butë, u mbështet në karrige dhe shikoi tavainin me pamje profesionale.

— Po, — përsëriti plaku me emfazë, — çunit i ka rënë një hall i madh! — Dhe një hije shqetësimi mbuloi fytyrën e tij të tharë. — Duhet ndihmuar Ar-diani!

Tha mjeku:

— Unë them të thërresim shokët që e shtruan dhe ata do të na i thonë të gjitha, po edhe ata vetë mund të mësojnë diçka të re. Deri tashti ne dinim se ishte penguar, ishte rrëzuar dhe asgjë më tepër! Kurse punët na qenkan ndry-y-she!

14

DEBATI

Dy ditë më vonë plaku doli nga spitali. Kishte ardhur në spital me dy vetë që e mbanin për krahu dhe që kthyer me ndihmën e një shkopi. Ishte në hall: a do të shërohej krejtësisht, a do të bëhej për të shkuar përsëri në punë, përsëri te bletët e veta? (Kështu i quante ai — po të mos ketë harruar lexuesi — bletët e shtetit, të vetat i quante!)

Sidoqoftë, plaku doli nga spitali dhe Ardian Dobini mbeti sërish vetëm. (Por të mos harrojmë se plaku tetëdhjetëvjeçar kishte lënë prapa hijen e trupit të tij të gjatë, që fshihte energji e qëndresë të rrallë, si dhe dëshirën për t'u kthyer medoemos në punë, pranë bletëve. Këtë hije e këtë kujtim i kishte lënë plaku Ardianit). E meqë mbeti vetëm në dhomë, Ardiani filloi, ose vazhdoi të ëndërronte ose të përfytyronte më lirisht (me sy mbyllur e me sy hapur) por filloi sërish edhe «të stërvitej» me anën e imagjinatës, sikur ngjitej lart, sikur e gudulisnin në brinjë për të kërcyer pastaj mënjanë si Astrit Caka, që shquhej midis të tjerëve për guximin, si edhe për sytë e nde-

zur e flokët e kuq. Ai kishte bindje se as ëndrrat, as përfytyrimet, as «stërvitjet» imagjinare nuk i shkonin kot, në asnjë mënyrë nuk i shkonin kot.

Ishte në këtë gjendje kur, në një orë jo të përshtatshme për vizita, kapërcyen pragun e dhomës Pal Moni, Astrit Caka dhe dy shokët e tjerë të pandarë të Pal Monit, Tafa, që fishkëllente këndshëm dhe Arbeni, pa shenja e karakteristika të veçanta. Tashmë Ardiani e dinte se që të katër këta, me Pal Monin në krye, ishin punëtorë nga më të dalluarit jo vetëm të sektorit që punonte në objektin 500, por të të gjithë Metalurgjikut. Me këto mendime në kokë Ardian Dobinit iu bë sikur në dhomën e tij u futën jo katër punëtorë, jo katër shokë të tij, por një bllok betonarmeje, aq shtrënguar e ngjitur kishin bërë ballë te pragu i derës. Një bllok që s'mund të shembet, as të shkërmoqet apo të thyhet, jo se jo me një e me dy të rëna, por as me dhjetë të tilla. Kështu mendoj ai kur i pa te pragu. Edhe hapat e tyre, me atë trokëllimë në unison nëpër pllakat e dhomës, si hapi i katër ushtarëve të stërvitur mirë, ia forcuan këtë mendim. Kurse Ardiani kishte marrë për detyrë pikërisht ta fillonte nga thyerja e këtij blloku njerëzish, me të cilët Pal Moni bënte punë të mira, punët kryesore e të vështira e po me këta mbronte konceptet e tekat e veta subjektive, duke u vënë caqe punës dhe mendimeve të të tjerëve.

Pas bllokut e pas hapave të fortë, që ishin përshtypja e parë, e dyta ishte se ata, kur u futën në dhomë, e shikuan Ardianin jo si zakonisht, por sikur ai të kishte zbritur nga një planet tjetër, jo nga Hëna, që fundja ishte shkelur nga këmba e njeriut, por nga një tjetër, shumë më i largët, ta zëmë nga Mërkuri apo nga Marsi, në mos nga Plutoni apo Karonti (që është zbuluar kohët e fundit).

— Pse dukeni si të çuditur? — s'u përmbajt Ardian Dobini.

Ata sikur kishin diçka, sikur dinin diçka, por nuk e shprehnin veçse me ato vështrime të çuditura.

Tha Pal Moni:

— Po afrohet dita të dalësh nga spitali!

— Po!

— Thamë të bisedojmë me ty për vendin ku do të punosh.

— Unë e kam vendin! — tha qetë Ardian Dobini.

— Me të dalë, unë mendoj të fillosh...

— Në kuotën 30, — e ndërpreu Ardiani.

— Së shpejti do të ngjitemi në kuotën 60, — tha Pali, duke u rënduar si me qëllim e si me inat fjalëve të fundit.

— Atëherë atje, në kuotën 60!

Tha Pali:

— Jo!

— Po, — tha Ardiani.

— Në asnjë mënyrë!

— Unë dua të punoj si gjithë të tjerët!

— Po si do të punosh si gjithë të tjerët?! — u trondit Pali dhe sytë e tij blu të kthjellët sikur u errësuan.

— E kam menduar mirë këtë gjë! — tha Ardiani dhe, si për t'u zbuluar ballin, që është epiqendra e mendimit, largoi nga ai krelën e zezë e të ashpër të flokëve.

Midis tyre ra një nga ato heshtje, që është bërë zakon të quhen të papëlqyeshme.

— Bile e kam parë edhe në ëndërr, — shtoi Ardiani me të qeshur.

Pas këtyre fjalëve Pal Moni nuk u përmbajt dot. Shikoi anëve bllokun e palëvizshëm të tre shokëve (ata ishin radhitur përkrah njëri-tjetrit paralel me krevatin,) i shikoi prapë dhe befas qeshi. Qeshi fort, aq sa u trondit jo dhoma, por ndoshta edhe spitali i tërë. Pas tij qeshën edhe tre të tjerët, Astriti, Tafa dhe Arbeni, qeshi edhe vetë Ardiani.

Te dera e dhomës u duk një skufje e bardhë, që s'ishte veçse një gjë e vogël në kokën e infermieres.

— Qetësi, shokë! — tha ajo. Dhe, pas qetësisë që u rivendos, skufja u tërhoq, për t'i dhënë mundësi derës të mbyllej.

Pyeti Pali:

— Në ëndërr, the?

— Po! — tha Ardiani me të qeshur e me seriozitet dhe

u shpjegoi shokëve ëndrrat e veta, po edhe mendimet apo dëshirat e veta, që s'ishin veçse të ngjashme me njëra-tjetrën e që s'kishin veçse një kuptim, veçse një domethënie.

Tha Pali:

— Këto punë s'bëhen me ëndrra e me dëshira!

Por Ardiani nguli prapë këmbë në këto ëndrra, në këto mendime e dëshira dhe ata qeshën prapë të pesë (përfshirë edhe Ardianin) por kësaj radhe me zë më të ulët. (Infermierja!)

Tha Astriti:

— Megjithatë, duhet parë kjo punë!

Por sytë e tij të ndezur sikur binin në kundërshtim me fytyrën, që shprehte dilemë, ekuivok dhe dyshim.

Pali bëri një gjest me dorë, që tregoi se nuk e kishte përfillur mendimin e Astritit dhe ky i fundit nuk foli më.

Tha Pali:

— Po si mund të ngjitesh lart, kur dihet se të merret mendja e kur të sjell trazime edhe në stomak? — Bëfas e ndërpreu fjalën. Diçka mendoi, diçka tha me vete, pastaj tha me zë: — I dimë ato ëndrrat e tua, i dimë të gjitha, dimë edhe... — dhe heshti si i penduar. Por shtoi: — E pamundur të punosh lart!

Ardian Dobini e shikoi Palin me dyshim për fjalët e tij të fundit, por e shikoi edhe me sytë e një njeriu që çuditet se si një gjë e tillë mund të ishte e pamundur.

Tha:

— Kam bindje për këtë që them!

— Ardian, ku bazohen bindjet e tua? — pyeti i interesuar Astrit Caka.

— Nuk e di, por kam bindje!

Pyeti Pali:

— Në ëndrrat?

— Ndoshta! — tha Ardiani. Tha prapë: — Jo vetëm në ëndrrat!

— Po ku?

— Në stërvitjet!

Pali, Astriti, Arbeni, Tafa shikuan prapë njëri-tjetrin me nënkuptim ose gati me nënkuptim.

— Shpjegohu! — tha Pali dhe trupi i tij i gjatë dhe i fuqishëm lëvizi me gjallëri, siç lëviz gjuetari kur i del gjahu në shteg.

— Në trarët e poligonit të braktisur në fund të oborrin të spitalit, — tha Ardiani dhe qeshi bashkë me ta ose pas tyre, sepse ata kishin filluar të qeshnin më parë se ai.

— Mos u tall! — këshilloi Pali.

— Jo, nuk tallem!

— Atëherë kjo stërvitje s'është aspak e mjaftë! — tha ftohtë Pali.

— Shpjegohu! — tha Astriti dhe e shikoi si për ta nxitur të shpjegohej më tej.

— Edhe këtu në dhomë, — tha Ardiani. — Ja kështu, rri prapët, shikoj tavanin dhe e detyroj veten të ngjitem tridhjetë metra lart.

Të qeshurat qenë tepruar, qenë mbaruar dhe kësaj radhe askush nuk qeshi.

— Shakara! — tha Pali.

— Sigurisht shakara! — foli me seriozitet Ardiani, por në zërin e tij kishte nuanca vetëbesimi.

— Le të shpjegohet! — tha Astriti po me aq seriozitet.

— Mjafton që unë e ndiej sikur vërtet ngjitem atje lart, — tha Ardiani, pa shikuar nga ata, po nga tavanin, si të ishin atje shkallët e ngushta e të pjerrëta, apo trarët e kalimit, apo elet e kapriatat. — E duke u ngjitur me mend, një herë, dhjetë herë, njëqind apo një mijë herë në ditë, po aq herë kam provuar po atë tronditje, po atë marramendje që provova herën e parë kur u rrëzova, pastaj kam provuar po atë gëzim dhe po atë gjendje që do të provoj kur të ngjitem me të dalë nga spitali.

Ata u shikuan të katër sy në sy dhe ia plasën prapë gazet, po më shumë se të gjithë qeshte vetë Ardiani, qeshte me lot, që i fshinte pastaj me kurrizin e dorës. Prapë qeshte, prapë përlotej, prapë i fshinte...

— Qetësi, shokë! — Infermierja kishte hapur derën dhe shikonte me qortim nga ata të pesë.

Qetësi.

Infermierja mbylli derën pas vetes.

— Unë do të ngjitem! — përsëriti si me vete Ardiani, por kësaj radhe me një ton të thellë e të menduar, që u ngjante më shumë evokimeve, po edhe dëshirave.

Në ndryshim nga ngjitja e parë (kur u rrëzua) e nga një e dy ngjitjet e tjera, në ngjitjen e tretë apo të fundit, kishte pasur raste, kishte pasur çaste, ndonëse fare të shkurtra, që e kishte ndier veten më të sigurtë atje lart, që e kishte mposhtur marramendjen, që e kishte pasur vështrimin të qartë dhe kishte shpresuar se... Por shpejt këto bindje ishin lëkundur dhe kishte filluar të lëvizte përsëri brenda qenies së tij ajo që quhej thjesht tronditje, ajo që vinte me marramendje, me turbullirë, jo vetëm në kokë, por edhe në stomak. Prapëseprapë ato çaste të pakta qartësie ai nuk i kishte harruar, prandaj përsëriti po atë frazë që e kishte thënë disa herë:

— Unë do të ngjitem!

Pal Monit si dhe tre shokëve të tjerë, si dëshmitarë të rrëzimit të tij, u vinte keq për Ardianin, që ishte hedhur në një betejë të dëshpëruar e të humbur. Ndoshta vendosmëria e Ardianit do t'i kishte detyruar të lëkundeshin sadopak, por tashti që dinin edhe për inkursionet e natës, edhe për dështimin e këtyre inkursioneve, nuk u mbetej veçse ta shikonin me dhimbsuri.

— Të mungojnë argumentet! — e kundërshtoi lehtë Pali, pa ditur ç'ti thoshte tjetër, sepse hëpërhë, mendonte ai, Ardianit nuk i duhej thënë e vërteta. E vërteta mund ta fyente, mund ta rrëzonte moralisht, gjë që do të ishte jo më pak sesa rrëzimi fizik, që e kishte sjellë në spital. E pse jo, këtë të vërtetë ai dhe ata ngurronin t'ia thoshin edhe për faktin tjetër se, si për Palin ashtu edhe për tre të tjerët, nuk mund të thuash që në thellësi e në brendësi bindjet e tyre nuk kishin pësuar asnjë lëkundje, nuk mund të thuash që nuk ndienin asgjë para vendosmërisë së Ardianit. Për ata ishte pak e çuditshme që, pas gjithë atyre dështimeve, vendosmëria e tij nuk ishte tulatur, as ekuilibri i mendimeve të tij nuk ishte prishur. Ai fliste thjesht e shumë qetë:

— Prapë nuk e besoni që unë do të ngjitem?! — pyeti ai i çuditur.

Tha Pali:

— Po ti, a nuk çuditesh me veten tënde?

— Pse duhet të çuditem?

— Sepse, padashur, je duke na gënjer të gjithë, po edhe veten!

— Do të çuditesha sikur të mendoja ndryshe, sikur të tërhiqesha. Më kupton?

Pal Moni u mendua gjatë.

— Jo, nuk të kuptoj! — tha pastaj.

— Përpiqu të më kuptosh!

— Po të ishte llogaritari ynë në këmbën time, — tha Pal Moni, — do të thoshte se nuk kam kohë në dispozicion të mendoj më tepër.

Qeshën të pesë, por qeshën butë dhe pushuan të gjithë menjëherë, si ta kishin bërë me fjalë. Pastaj brigadieri, që ishte ulur në cepin e krevatit të Ardianit (të tjerët ishin ulur në krevatin bosh, gjë që e kishte prishur figurën e bllokut) nuk kundërshtoi më, e la Ardianin të fliste derisa t'i zbrazte të gjitha ato që kishte në kokë. Në përgjithësi Pali ishte njeri i qetë, me përjashtim të syve blu, që i errësoheshin sa herë nuk i pëlqente diçka dhe, po t'i errësoheshin ata, vetëm atëherë të linte përshtypjen se ishte pak kryeneç. Ai donte që edhe Ardiani të fitonte plotësisht qetësinë, prandaj e lejoi t'i thoshte të gjitha, pa e ndërprerë.

Në fund, megjithatë, Pali (kryesisht) po edhe tre të tjerët (me gjysmë goje) e këshilluan prapë Ardianin të hiqte dorë nga dëshira e tij për të punuar medoemos në lartësi. (Pak punë kishte poshtë?!) Por këshillat e tyre sikur nuk e kishin vendosmërinë e fillimit, ndërsa Ardiani, që s'kishte tjetër përgjigje, largonte nga balli krelën e zezë dhe thoshte afërsisht se, po të mos arrinte të punonte si të gjithë montatorët, nuk i mbetej veçse të kthehej andej nga kishte ardhur e ta quante veten një... Sigurisht në bisedën e tij me Palin e me tre të tjerët ai nuk përmendi as dokumentin e Partisë, as detyrën dhe objektivin, dhe asgjë tjetër, vetëm se në zërin e tij (ashtu si në vështrimin e tij)

jehonte në mënyrë të përqendruar e të dendësuar ajo, që në leksikun e gjuhës shqipe quhet vendosmëri, po ndoshta edhe kokëfortësi.

Shpesh Pali, pasi kishte dëgjuar deri në fund afërsisht të njëjtat fjalë, apo të njëjtat përgjigje, themi afërsisht, sepse përmbajtja e përgjigjeve të Ardianit ishte e njëjtë, forma e renditjes së tyre ndryshonte, tundte kokën i pakënaqur, por edhe i menduar dhe e shikonte Ardianin butë me sytë e tij ngjyrë blu. Pas disa shikimeve të tilla, Ardianit i bëhej sikur Pali do të dorëzohej. Por jo, s'ishte ashtu. Ishte fjala për jetën e një njeriu. Dhe Pali ishte përgjegjësi kryesor për këtë jetë, pas Ardianit vetë. I menduar dhe i shqetësuar, më në fund Pali u kujtua se duhej të pinte një cigare. Nxori paketën «Partizani», e rrotulloi nëpër duar, u mendua pak, i zgjati një cigare Astritit, sytë e flokët e të cilit ndizeshin përjetë, vuri dhe vetë një tjetër në gojë, u dha edhe dy shokëve, Arbenit e Tafës, pastaj e ndezi me çakmak. Edhe Ardiani, si të qe kujtuar për këtë mungesë, nxori paketën nën jastëk, vuri një cigare në gojë, e ndezi dhe fijen e shkrepëses e hodhi larg, përmbi ish-krevatin e plakut e përmbi kokat e katër shokëve, të cilët qenë të detyruar të kërruseshin instinktivisht. Fija e shkrepëses fluturoi nëpër dritaren e hapur.

— Më falni! — tha ai shkurt dhe thatë.

Kur u ndanë nga ai (ata pastaj biseduan për shumë gjëra të tjera të ndryshme) Ardiani vuri re se Pali i kishte buzët tepër të shtrënguara (këtë e shikonte për herë të parë tek ai) dhe kishte marrë kështu një pamje më të menduar, por edhe më të plakur, sikur nga të tridhjetat, befasi të kishte shkelur në të dyzetat. Por dukej më i urtë e më i pjekur me ato buzë të shtrënguara, dukej edhe më i vendosur, gjë që s'i pëlqeu Ardianit. Ardianit nuk i pëlqeu edhe largimi i të katërve, të ngjeshur sup më sup (rastësisht ose jo) duke formuar përsëri figurën e bllokut betonarme, të cilën, zor ta çaje me një e me disa të goditura.

Një zemërim i fshehur më çdo qelizë të qenies së tij e që kishte vërshuar aq papritur e detyroi Ardianin t'u lëshonte nga prapa frazën e pandryshuar:

— Unë do të ngjitem!

Menjëherë pas kësaj fraze, Tafa lëshoi një nga ato fishkëllimat e tij, që Ardianit i tingëlloi si miratuese. Miratues iu duk edhe vështrimi i ndezur i Astrit Cakës. Arbeni shikoi vetëm Palin, kurse Pali, pa shikuar njeri, befas qëndroi me njëren këmbë në prag, me tjetrën në korridor. Pastaj, ngadalë, por vendosmërisht, ktheu kokën prapa dhe e mbuloi Ardianin me vështrimin e errësuar të syve. Pastaj i tërë trupi i tij i madh u rrotullua mbi thembra, u çapit drejt krevatit dhe, kur ishte fare mbi kokë të Ardianit, nxori nga xhepi një kasketë, e hodhi mbi krevat dhe tha, duke theksuar çdo fjalë veç e veç.

— E kishin gjetur shokët të ngecur diku në afërsi të kuotës 30!

Kur mbeti vetëm, duke rrotulluar nëpër duar kasketën, Ardian Dobini foli me vete, por foli me zë:

— Aq më mirë që e ditkeni, që e paskeni kuptuar! — dhe vazhdoi të rrotullonte nëpër duar kasketën e vet...

Në korridor sapo ishin shuar hapat e katër shokëve, të cilët, me sa kishte vënë re Ardiani, në kundërshtim me hapat e sigurtë që kishin ardhur, befas qenë çapraçitur, si të rekrutëve fare të rinj...

15

K T H I M I

Mëngjesi ishte i dendur me dritë e me ngjyra dhe ajri ishte mbushur me ngrohtësi korriku. I tillë kishte qenë edhe mëngjesi i parë i arritjes së tij në Metalurgjik — me dritë e me ngjyra — por jo korriku, ato kishin qenë drita

dhe ngjyra qershori... Atë ditë Ardiani zbriti shkallët e komitetit të partisë së rajonit të Kombinatit Metalurgjik dhe me çantën prej lëkure në sup mbeti një copë herë duke shikuar majat e oxhakëve. Ai duhet të jetë oxhaku njëqindënjëzetmetrash i lartë mendoj. Pastaj vështrimi i tij u ul mbi çatitë e uzinave e të dhjetëra objekteve të tjera. Në qoftë se këta oxhakë janë rëndom gjashtëdhjetë metra, tha prapë me vete, atëherë shumica e këtyre çative apo konstruksioneve nuk duhet të jenë më pak se tridhjetë. Vështrimi i tij u ul akoma më poshtë. Kudo kishte shtylla apo kolona prej çeliku e betonarmeje. Kolona të tjera prej çeliku, që vendoseshin me vinça mbi kolonat e para e kështu me radhë. Ai as kishte parë, as e kishte marrë dot me mend se mund të kishte një kantier kaq të madh e me kaq gjallëri. Kishte dëgjuar shumë të flitej për Metalurgjikun, por... Tashti ai kishte ulur sytë poshtë dhe po shikonte punëtorët që i kalonin pranë. Me të shikuar ata, që ishin të ngjashëm me të, që ishin si ai, që mendonin si ai dhe që ai u njihte mirë çdo qelizë të shpirtit e të mendimit, u çlirua menjëherë nga ajo tutje që e kishte mbërthyer, ndërsa shikonte atë vigan të papërfytyruar.

— O shok, ku është kantieri Nr.3 i montimit?

— Do të shkosh kështu... pastaj... ashtu... pastaj anës Çelikut, midis Tecit dhe Oksigjenit, rrëzë oxhakut të Aglomerimit... Ah, jo, gabova, zëre se nuk e dëgjove oxhakun e Aglomerimit... prapë djathtas...

Pasi i qe ngulitur në kokë një zigzage e pafund, Ardiani buzëqeshi, tha falemnderit dhe u nis. Tjetri, që e kuptoi se e kishte hutuar e ngatërruar me ato zigzage, i lëshoi zë:

— Ec e pyet në çdo njëqind metra!

— Po, — tha Ardiani. — Falemnderit!

— Me të pyetur gjendet Stambolli, thoshte gjyshi im!

— Edhe imi! — qeshi Ardiani. Qeshën të dy.

Ai u nis me çantën e lëkurës që i kolovitej pas supit e me vështrimin përpara. Por atë ditë qershori ai ecte përmes diçkaje krejt të panjohur, kurse tashti, gjashtë javë më pas, në këtë mëngjes të ngohtë korriku, megjithëse

s'kishte punuar më shumë se dhjetë ditë këtu, atij i bëhej sikur njihte çdo mur, çdo rrugë, çdo tullë, çdo tra e kolonë, çdo kapriatë e cle të këtij vigani. Kjo ndodhte, mendonte ai, sepse gjatë atyre dhjetë ditëve e gjatë kohës që qëndroi në spital ai kishte mundur të njihte shumë gjëra e mbi të gjitha kishte mundur të njihte shokët...

Megjithëse kishin kaluar pesë minuta, brigada s'kishte filluar nga puna. Një gjë e tillë ndodhte rrallë me Pal Monin, që shquhej si brigadier i përpiktë, që kërkonte rregull e disiplinë një më një, më parë nga vetja, pastaj nga të tjerët. Po kjo vonesë sikur s'ishte e rastit. Ata dikë prisnin dhe vështrimi i tyre drejtohej nga rruga e drejtë, që zgjatej paralel me trasenë e trenit.

— Po vjen! — tha njëri nga punëtorët.

Gati njëqind metra larg shquhej një trup hollak, me një kurorë flokësh që nxinte në rrezet e pjerrëta të mëngjesit. Pastaj, ai me trupin hollak kishte lënë rrugën pikërisht atje te kryqëzimi dhe qe futur në trasenë e trenit, që përshkonte përmes objektit 500. Pa e ngadalësuar, por as pa e shpejtuar hapin, ai u fut në barakën e gjelbër, ku brigada mbante rrobat, veglat e materialet e tjera të punës. Këtë ai e bëri po me atë mënyrën e tij të qetë e të vendosur, pa hedhur vështrimin rrotull, pa shikuar nga punëtorët e brigadierit, që vërtiteshin rreth shkallëve të ngushta, gati për ngjitje, por edhe që shikonin nga ai. Pastaj doli nga baraka, i veshur me kominoshe, me litarët e sigurimit rrotull belit e me torbën ku dukej koka e një çekani. Doli dhe eci drejt tyre, siç do të ecte një punëtor, që s'ishte ndarë nga ata veçse një ditë më parë, sikur ajo që bënte ai të ishte një gjë e ditur, e njohur dhe e zakonshme, të ishte një rit i përsëritur një mijë herë e më shumë se një mijë herë. Vetëm kur qe fare pranë, atëherë ai vendosi torbën në tokë dhe në fillim deshi t'ia bënte toka me shokët, që sakaq ishin grumbulluar rrotull tij, por në çastin e fundit ose u pendua, ose u ndikua nga qëndrimi i të tjerëve, dhe pothua në të njëjtën kohë u dëgjuan klithma gëzimi nga ana e tij dhe nga ana e shokëve. Kishte filluar seria e përqafimeve, rrahjet e shpatullave e puthjet. Ki-

shin filluar urimet e përgëzimet, që kishte shpëtuar shëndoshë e mirë (për këtë kishin pasur rast ta uronin edhe në spital) urimet e përgëzimet që ishte kthyer midis tyre dhe më tepër nga të gjithë ish-in gëzuar Mrica, Nadirja e xha Toli e pas tyre të gjithë të tjerët me Pal Monin në krye, megjithëse me këtë të fundit ai qe takuar më shpesh.

Vetëm një punëtor kishte mbetur pak si mënjanë, i palëvizshëm dhe e shikonte Ardianin me kokën të kërrusur, me mjekrën të mbështetur në gjoks e me sytë të përmbysur, i shqetësuar dhe i zverdhur, si të priste nga një çast në tjetrin të ndodhte një gjëmë e madhe.

Por, sado që qëndroi ashtu, pa lëvizur, si mohim i një statuje (sepse statujat nuk janë krijuar për të karakterizuar palëvizshmërinë) më në fund doli nga «piedestali» dhe iu hodh në qafë Ardianit, siç kishin bërë të gjithë të tjerët para tij.

— Ç'të duhet ai çekan? — e pyeti Loni.

Ardian Dobini vërtet e dëgjoji pyetjen, vërtet e shikoi çekanan, që e kishte lënë në tokë, por gojën nuk e hapi. Në vend të tij foli përsëri Loni:

— Ti do të punosh me ne këtu poshtë!

— Jo! — tha Ardiani, sikur kjo «jo» të ishte thënë për diçka pa rëndësi, për diçka fare të zakonshme.

— Brigadieri! — foli Loni, duke shikuar nga Pali, si të kishte plotësuar me këtë shikim frazën e pambaruar.

— Unë do të punoj atje! — tregoi me gisht Ardiani një nga kulmet e objektit 500, si të kishte qenë fjala përsëri për diçka fare të zakonshme, fare të njohur e të përsëritur.

Heshtja që ra pas këtyre fjalëve, u thye nga hapat e Ardianit, i cili ngriti torbën nga toka dhe eci përpara. Tha:

— Atje do të punosh edhe ti një ditë! — Ai kishte shikuar nga Loni.

Tha Pal Moni:

— Sikur të shkoje në shtëpi, pastaj shohim e bëjmë!

— Tha prapë: — Doktorët të kanë dhënë dy javë leje!

Ardian Dobini shikoi lart dhe tha:

— E kisha parashikuar këtë përgjigje! — Tha: — Përsëri në aksin B?

— Po, — iu përgjigj Astrit Caka, që e shikonte Ardianin me një farë domethënieje akoma të pashpjegueshme. Këtë domethënie ia jepnin sytë e ndezur, që sikur pasqyro- nin ngjyrën e kuqe si të përcëlluar të flokëve të tij. — Mba- ruam punimet e imta në aksin A dhe u kthyem përsëri aty ku ishim.

— Mund të të ndodhë ndonjë fatkeqësi! — tha Arbeni, që ishte rreshtuar pas Astritit.

— Një gjë e tillë nuk mund të parashikohet! — tha Ta- fa dhe lëshoi menjëherë fishkëllimën e tij melodioze.

Me Tafën ishte plotësuar trishja që rrethonte zako- nisht Pal Monin dhe Ardiani deshi t'i krahasonte përsëri me bllokun betonarme, që ishte zor të çahet, po të mos e kishte penguar vështrimi i ndezur i Astrit Cakës dhe fi- shkëllima melodioze e Tafës, që kishin qenë si një e çarë në mesin e tyre. Po edhe në fjalët apo në përgjigjet e tyre ai kishte ndier diçka...

Të tjerët heshtnin. Ndoshta sepse kishin folur mje- shtrit më të mirë të brigadës (e jo vetëm të brigadës) ndo- shta sepse nuk donin të merrnin përgjegjësi mbi vete, ndo- shta sepse nuk i dinin qëllimet dhe dëshirën e Ardianit apo më thjesht: nuk e dinin si qëndronte puna, dhe akoma më thjesht: s'kishin pasur kohë të mendonin për një gjë të tillë, ose fundja, një gjë e tillë i kishte zënë krejt në befasi. Po, sidoqoftë e cilado qoftë arsyeja e kësaj heshtjeje, serio- ziteti që kishte rënë në fytyrat e tyre, jo vetëm ishte si një rreze e ngrohtë në zemrën e Ardianit, por edhe një zbavitje, për të mos thënë një mbështetje për tashti e për më vonë, kur të vinte koha për t'u marrë me ato probleme, që ai i kishte rrahur me hollësi në mendjen e tij.

— Nuk do të ndodhë asgjë! (Kjo vlejti si përgjigje për dyshimet e Arbenit). Fundja, unë kërkoj nga ju të më ndih- moni.

Tha një punëtor prapa bllokut të të katërve:

— Po mirë o, po të jetë se nuk do të të ndodhë asgjë, e po të jetë se kërkon ndihmën tonë, eja të ngjitemi. Ç'është kjo... të ngjitesh atje...asgjë!

Tha një tjetër:

— Pse u rrëzua një herë, s'do të thotë se do të rrëzohet përsëri!

— Nuk ke ndryshuar mendim? — pyeti befaz Pal Moni dhe, si për t'i kujtuar diçka, po aq befaz nguli vështrimin mbi kasketën e Ardianit.

Ardiani mbeti një çast. Në të vërtetë prania e shkallëve të ngushta, të pjerrëta e vende-vende fare pingul, apo të thikta, lartësia e kuotës 30 dhe tërë ai konstruksion i zhveshur prej çeliku, sikur i thoshin diçka, sikur i kujtonin diçka, sikur i pëshpërisnin se ato tri ngjitje natën, pa sukses (vështrimi i Palit në drejtim të kasketës) si dhe «stër-vitjet» e tjera vetëm përmes imagjinatës në dhomën e spitalit, ishin një gjë, kurse të ndodheshe këtu e të ngjiteshe praktikisht, ishte një gjë tjetër. Po, sado që ishte kështu, sado që herë-herë vrulli i tulatej pak dhe vendimi që kishte marrë për t'u ngjitur sërish i dukej i dyshimtë, prapë-seprapë...

U kujtua se i kishin bërë një pyetje dhe ai duhej t'i përgjigjej. Shikoi nga Pal Moni.

Tha:

— Jo!

Tha prapë, duke shikuar gjithmonë nga Pal Moni:

— Pse duhet të ndryshoj mendim?

Shikoi nga ata të tre që i rrinin përkrah Pal Monit dhe pas tyre shikoi të tjerët.

Tha:

— A nuk u vonuam ca? — Këtë pyetje ua kishte drejtuar dy punëtorëve, që e kishin përkrahur hapur dhe të tjerëve që heshtnin, duke e vlerësuar pozitive heshtjen e tyre.

Pas pak Ardian Dobini u kërrus, hodhi torbën në sup dhe, duke shikuar prapë nga Pal Moni, u përpoq të gjente fjalët më të forta, por gjeti më të papërshtatshmet, që patën një tingull gati fëmijëror:

— E vëmë me bast?

Pas çdo çasti që kalonte, ai bindej më shumë për ato që thoshte. Dhe duhej të ishte i verbër të mos e vije re një gjë të tillë.

Ai përsëri u përpoq të gjente fjalë të forta, por pada-shur i shpëtuan sërish po ato katër fjalë, që një çast më parë ia kishin vrarë aq shumë veshët:

— E vëmë me bast?

(Për këto katër fjalë, e sidomos për përsëritjen e tyre, ai do të skuqej kur t'i kujtonte më vonë!)

— Jo! — tha Pal Moni, por akoma s'mund të kuptojë në ishte kundër apo pro. Pas fjalës «jo» Pali lidhi litarin e sigurimit në bel dhe tha si çdo mëngjes:

— Ngjitemi!

Hodhi edhe një hap. Qëndroi, u kthye nga Ardiani, që priste në heshtje dhe tha:

— Eja!

(Më vonë Ardian Dobini do t'u thoshte shokëve se, kur kishte dëgjuar këtë fjalë nga Pali, çdo dyshim e të gjitha dyshimet e lëkundjet, që mund t'i kishin mbetur, ishin shkrirë, siç shkrihet një copë akull në ujën e ngrohtë.)

Disa apo shumica e punëtorëve ishin të qetë: ata e kishin marrë vendimin e Palit si diçka të natyrshme e të domosdoshme. Po ndonjëri s'kishte marrë frymë, ishte stepur, ishte ngurosur, ndonjëri ishte bërë gati edhe të fliste, dikush edhe kishte folur afërsisht, po sikur...

Së fundi, edhe në këtë çast Ardian Dobini u kishte ardhur vetë në ndihmë. Para se dikush të nxirrte qoftë edhe një tingull tjetër, ose para se të shqiptonte qoftë edhe një gërmë tjetër, ai ishte shkëputur nga ata, kishte ecur dhe kishte filluar të ngjitej i pari nëpër shkallët e ngushta, të pjerrëta, që vende-vende ishin fare pingul, fare të thikta.

Pas tij filloi ngjitja e brigadës, por jo si zakonisht, jo me britma e me klithma gëzimi, jo me shakara e me të shara miqësore, por një ngjitje e heshtur, ku dëgjohej fërkimi i kominosheve, i maskave, i rripave, i çekanëve. Të gjithë ata që ngjiteshin shikonin vetëm në një drejtim, vetëm në një pikë, përpara lart: Ardian Dobinin.

(Më vonë Ardian Dobini do t'u thoshte shokëve se nga ajo heshtje, që shprehte kujdesin e tyre për jetën e tij, nga ato vështrime, që shikonin vetëm atë, nga të gjitha kë-

to e nga gjithçka tjetër, ai s'kishte pasur asnjëherë një mendim aq të guximshëm në jetë, dhe, me sa dukej, për një guxim e vetëbesim të tillë, i ishte dashur të ndodhej pa-tjetër në mes të shokëve. Kështu do t'u thoshte ai më vonë atyre!)

Por në jetën e montatorëve asgjë nuk qëndron gjatë në një vend. Ka të papritura, ka ndryshime të shpeshta që, fundja, bazohen në vetë natyrën e punës së tyre. Kështu ndodhi edhe atë mëngjes. Heshtja, që dukej se nuk do të mbaronte kurrë, mbaroi po aq papritur, siç edhe kishte filluar. Kur të gjithë u bindën ose pothuaj u bindën se kësaj radhe nuk do të ndodhte asgjë, nuk do të kishte aksident, se Ardian Dobini e kishte kapërcyer pikën kritike të marramendjes, e kishte mposhtur atë që quhej tronditje lartësie (bile aty nga mesi i shkallëve ai kishte guxuar të mbahej me një dorë e me tjetrën të përshëndeste atje poshtë xha Tolin, Mricën, Nadiren e Lonin, që edhe Loni kësaj radhe e kishte çliruar qafën, kishte harruar të shikonte me mjekrën të mbërthyer pas gjoksit) befas dhe krejt papritur brigada shpërtheu në klithma e britma gëzimi, në shakara e thumba, që ishin aq tipike për ngjitjet e për mëngjeset e saj.

Vetëm një herë u thye prapë ky rregull dhe kjo ndodhi kur Ardian Dobini, që kishte dalë në krye të shkallëve, qëndroi. Qëndroi e s'e hodhi hapin tutje, ashtu siç mund të bëjë një mushkë buzë një hendeku, kur është e bindur se nuk e kapërcen dot. Tashti ai kishte arritur para sheshit çlodhës, pikërisht para asaj pllake të trashë llamarinë, ku gjashtë javë më parë ishte lëkundur, ishte turbulluar, ishte hutuar dhe, duke pandehur se sheshi çlodhës, dmth pllaka e llamarinës që çmontuar e po shkonte poshtë, atëherë, si për ta mbajtur në ekuilibër, ai kishte humbur ekuilibrin e vet. Pikërisht aty ku ishte rrëzuar, ai s'kishte dashur të çapitej më tej. Por kjo zgjati vetëm një çast. Në çastin e dytë jo vetëm e mbloodhi veten, jo vetëm shkeli mbi sheshin e çlodhjes, por, befas, si ta kishin gudulisur në brinjë, ai u hodh anash dhe ra mbi traun e kalimit, siç bënte shpesh Astrit Caka, po edhe montatorët e tjerë. Në çastin e tretë

ky kërcim u shoqërua nga e gjithë brigada me britma e klithma, po veçanërisht me fishkëllima, jehona e të cilave shumëfishohej nga lartësia e nga pylli i dendur i kontureve të ndërlikuara të objektit 500.

Atëherë Ardian Dobini u kthye nga shokët, futi dy gishta në gojë dhe, në shenjë përgjigjeje, lëshoi fishkëllimën më të fortë e më të gjatë të jetës së vet.

16

PROLOGU

Në pushimin e drekës, si zakonisht, brigada u mbloodh pranë barakës së gjelbër për të ngrënë bukë e për të pirë një apo dy cigare. Siç e kemi thënë më sipër, apo më saktë, siç e kemi përshkruar në kapitullin e katërt të kësaj novele, titulluar «Cigarja», brigada vërtet ulej duke krijuar një rreth të vetëm, por brenda këtij rrethi ajo ishte ndarë në mënyrë të vetvetishme në dy grupe. Njërin grup e përbënin montatorët e lartësive, që ishin shumica, rreth njëzet vetë. Të tjerët, që ishin katër, xha Toli, Loni, Nadirja dhe Mrica uleshin pak si të veçuar, pak si mënjanë dhe bisedonin me zë të ulët. Këtë përshkrim kemi bërë në atë kapitull dhe gati po këtë mund të bënim edhe tashti, por me një ndryshim të vogël: atë ditë Ardian Dobini nuk ishte ulur me grupin e vogël prej katër vetësh, me të cilët ai pati punuar javën e parë në Metalurgjik, as me grupin e madh prej njëzet vetësh, që tashmë ai mund t'i quante shokët e vet të lartësisë, por që ulur në mes të të dyve, kështuqë, në të njëjtën kohë ai ishte në gjendje të bisedonte herë me njërin palë, herë me palën tjetër. Përveç

këtij ndryshimi të vogël, nëse mund të flasim për diçka të re, është ai rast, kur erdhi radha për të pirë cigaret. Por (kjo e re) nuk ndodhi që në çastet e para. Ajo (e reja) do të ndodhte pak më vonë, sepse në fillim u luajt apo u zhvillua po ajo skenë e vjetër. Pal Moni nxori «Partizanin» e tij të famshëm, duam të themi të pandryshueshëm, u zgjati nga një cigare Astrit Cakës, Tafës e Arbenit dhe së fundi mori edhe një për vete. Ndodhi gjithashtu, po në çastet e para, që Ardian Dobini i përhumbur në mendime, me vështrim të ulur poshtë, që në të vërtetë nuk shikonte as tokën as këmbët e veta, që nuk shikonte asgjë, nxori paketën e vet, nxori shkrepësen dhe në çastin kur po tërhiqte cigaren, pikërisht në këtë çast të shkurtër, sa një frymëmarrje, ndodhi ajo e reja, që sapo përmendëm.

— Ardi, merre një këtu! — dëgjoi ai befas emrin e vet të shkurtuar e intim. Ashtu e thërrisnin në shtëpi e në Lezhë: Ardi.

Ai kishte qenë zëri i Pal Monit. Edhe paketa e zgjatur ishte gjithashtu «Partizani» i Pal Monit.

Ardian Dobini e lëshoi në prehër paketën e vet dhe me dy gishta nxori një cigare nga ajo e Palit, e ndezi dhe e piu deri në fund, pothuaj në heshtje të plotë. Por në fund fare, kur bishti i cigares zuri t'i digjte gishtat, Ardiani e thithi edhe një herë, e thithi fort. Pastaj nxori disa fjolla të dendura nga hundët e nga goja. Pastaj e shoi cigaren në thembrën e këpucës. Pastaj shikoi Palin. Pastaj Pali shikoi Ardianin.

Duhet besuar se, pas cigares që Pali i zgjati Ardianit, edhe këto shikime shënojnë diçka të re në këtë prolog. Hë-përhë, ato shënonin vetëm një ndeshje të heshtur. Më vonë...

T A K T I

Drejtori kishte pamjen e një zogu të trembur. Ishte i vogël nga trupi dhe pranë dy shoferëve, që e dëgjomin në këmbë, ai dukej edhe më i vogël, edhe më i trembur. Por ky njeri i vogël zërin e kishte çuditërisht të fortë, me disa kumbime që s'të besohej se dilnin nga pejzat e atij fyti të hollë. Edhe duart i kishte të mëdha e me kallo. Nga mënyra si qëndronte ulur, nga mënyra si kërrusej para tryezës, nuk ishte vështirë të kuptoje se ai kishte ardhur aty nga timoni, se ai kishte qenë shofer jo një vit, as pesë, por tërë jetën e vet, ndoshta për një çerek shekulli me radhë, në qoftë se do t'i shtojmë moshës së tij vitet e rinisë.

Por dukej qartë se drejtori nuk ishte i shqetësuar për detyrën që po u ngarkonte. Në të vërtetë detyra ishte e rëndësishme, ata duhej të shkonin dy herë në Durrës, të ngarkonin secili nga një transformator dhe t'i sillnin në Kombinatit Metalurgjik sa më parë e sa më shpejt që të ishte e mundur... sepse kërkesa nga ndërmarrja e montimeve industriale Nr.1 ishte shumë urgjente. Udhëtimi gjithashtu paraqiste vështirësi, transformatorët ishin të lartë, kurse spondet e karrocërive ishin relativisht të ulëta, kështu që një prerje timoni pa vend, një rrëshqitje gomash – binte shi i imtë – kishte rrezik që ngarkesa e rëndë dhe me vlerë të gremisej në tokë. Megjithatë drejtorin sikur nuk e shqetësonin të gjitha këto që thamë, sikur nuk e shqetësonin as porositë që po u jepte, por diçka tjetër, diçka që qëndronte mbi porositë, diçka që varej diku

pezull në mes të të dy shoferëve — pikërisht në mes të të dyve — se edhe drejtori, pasi e kalonte vështrimin sa nga njëri te tjetri, më në fund i fiksonte sytë në një zonë asnjëse dhe kjo zonë asnjëse ndodhej aty, midis dy shoferëve, midis supeve të tyre dhe, nga mënyra se si ai shikonte, kjo diçka duhej të ishte më e rëndësishme se vetë porositë dhe detyra që po u ngarkonte. Kurse shoferët ishin të qetë, ata u jepnin rëndësi vetëm fjalëve apo urdhrit që dëgjonin dhe këto fjalë apo këtë urdhër ata e dëgjonin me respekt, jo pse po mësonin diçka të re, e jo pse nuk i dinin ato që dëgjonin, por sepse ashtu duhej, sepse ata, të gjithë shoferët e ndërmarrjes së furnizim-transportit të Kombinatit ishin bërë tepër të respektueshëm me drejtorin e ri, meqë për ndërmarrjen e tyre ai ishte i pari drejtor që kishte dalë nga radhët e shoferëve.

Vetëm rrallë, ai më i riu ngrinte njërën vetull, për t'i dhënë të kuptonte drejtorit se kjo punë do të kryhej pa rrezik, pa avari dhe në afatin e caktuar. Ai kishte një trup të tendosur, fytyrën të djegur nga dielli e nga erërat, hundën me kurriz, flokët të gjatë, por jo të dendur (sepse ishte biond) ngjyrën e syve e kishte të çelët, ballin të ngushtë, nofullat të mëdha dhe ishin këto nofulla. plus vetulla e ngritur, që e tregonin pak kryeneç, por të fortë e me vullnet, që me vështrimet e tij të shpejta, sidomos me vetullën e ngritur, dukej sikur sfidonte drejtorin, detyrën, transformatorët, që ishin të lartë e të rëndë e spondi i karrocerisë i ulët dhe i dobët. Gjatë gjithë kohës ai shikonte vetëm drejtorin, shikonte edhe në një pikë përmbi kokën e drejtorit, por jo shoferin tjetër, të cilin nuk e kishte shikuar asnjëherë, sikur aty pranë të mos kishte një njeri, por një hiç.

Tha drejtoni:

— Kështu, Van!

Ky quhej Van. Shoferi i ri, Jovan Thekra, dhe si për rastisje, edhe flokët Jovan Thekra i kishte në ngjyrën e thekrës së pjekur.

Shoferi tjetër ishte gati moshatar me drejtorin, ndoshta një vit më i madh, ndoshta një vit më i ri, me një fy-

tyrë të kuqe e me një kokë të madhe, si kokë luani, edhe flokët i kishte pak më të ndezur se të Vanit, i kishte në ngjyrën e krifës së luanit, që dukeshin si të djegur nga dielli dhe kishin marrë reflekset e diellit në agim. Ky shofer ngjante me ata tipa llërëtrashë, qafëmuskulozë që, kur ngulin këmbët në tokë, janë më afër shkëmbit se njeriut, më parë janë shkëmb, pastaj njeri. Mendimi ynë artistik dikur i ka bërë kritikë prirjes së ndonjë piktori për paraqitjen e këtyre tipave dhe në vija të përgjithshme duhet menduar se ka pasur dhe ka të drejtë, por ja që shoferi i dytë, krifëluani ishte i tillë, të paktën nga ana e jashtme të linte përshtypjen se ishte një njeri pa mendim, pa ndjenja, ishte më shumë kockë e muskuj, sesa qenie e gjallë, që merr frymë, që pi ujë, që ha, që fle, që ecën, e që gëzohet e dëshpërohet si të gjithë njerëzit e zakonshëm, me të cilët kemi të bëjmë çdo ditë. Por... (siç e shikoni pa «por» këto punë nuk bëhen) te ky njeri, apo te ky shofer, apo te ky personazh, kishte diçka që krijonte një kontrast të fortë me të gjithë pamjen e tij e që vlente për të zbutur sado pak skemën apo klisheën e kësaj figure dhe kjo diçka ishte vështrimi i tij i butë, ishin sytë e tij të mëdhenj e të butë, që shikonin gjithashtu vetëm drejtorin e diku në një pikë të papërcaktuar në murin e pasuvatuar, ku dukej e zhdukej bishti i një miu. Pastaj miu nxori turirin e hollë me veshët e vegjël përpjetë dhe prapë u zhduk dhe prapë tregoi vetëm bishtin. Kur të dy shoferët e kuptuan se po shikonin të njëjtën gjë, të njëjtin objekt, përpëlitën qepallat si të penduar, por edhe me një farë mospërfilljeje për njëri-tjetrim dhe, ndërsa krifëluani shikoi drejtorin, i riu shikoi dritaren, e përtej dritares qiellin me re.

— Sigurisht, miu, — tha drejtori po me atë zë kumbues, që kishte dhënë porosinë apo urdhrin pak më parë dhe vuri buzën në gaz. — Kur erdhëm në fillim në fushën e Bradasheshit, minjtë ishin me kilometra. Tashti ka mbetur ndonjë sa për mostër. Por kur të ndizen të gjithë konvertitorët e të gjitha furrat elektrike të çelikut, atëherë s'do të shikoni qoftë dhe një mi të vetëm. — Këto tha drejtori dhe duke e ndier se kishte folur pak gjatë për miun e vo-

gël, që kishte gjetur një të çarë midis dy tullave mbi këmbën e tij, e fshiu buzëqeshjen nga fytyra dhe tha:

— Mirë, Dik?

Shoferi i dytë quhej Dik, Sadik.

Kështu, atë mëngjes prilli Vani dhe Diku, ose për respekt moshe Diku dhe Vani ndezën makinat dhe u nisën për Durrës.

Te pragu i zyrës së improvizuar (kur të fillonte shfrytëzimi i uzinës, ajo zyrë do të kthehej në garderobë për punëtorët) drejtori shikoi si me dyshim dy shoferët kur hipën nëpër kabina, ngurrimin e tyre të shkurtër apo të vogël, kush të nisej më parë dhe prapë për respekt moshe, Vani lejoi që Diku të nisej i pari, ndërsa drejtori u tërhoq në zyrë me pamje të menduar.

Puna ose porosia ishte urgjente, ata ecën pa qëndruar gjëkund, ecën shpejt, sepse makinat ishin të lehta (kontrolli i kishte lejuar të udhëtonin pa ngarkesë) arritën në Durrës në kohën e duhur, ngarkuan me vinq dy transformatorët (një për secilin). Transformatorët ishin të bukur, në formën e këpurdhave të mëdha, plot me çelësa, plot me pllaka dhe, pasi i siguruan me aq sa mundën, dy shoferët morën menjëherë rrugën e kthimit. I kishin premtuar drejtorit se do ta bënë atë rrugë dy herë dhe do të transportonin brenda ditës katër transformatorë, të cilët pritejshin me padurim nga brigadat elektrike, jo vetëm sepse brigadat elektrike kishin mbetur pa punë, por edhe sepse transformatorët duheshin vendosur sa më shpejt për arsye plani, për arsye se u kishte ardhur koha, për arsye të rendit kronologjik, për arsye të harmonizimit të kryerjes së montimeve, gjë që do t'i hapte rrugën procesit të mëpastajmë të punimeve zinxhir. Këto fjalë u kishte thënë ose përsëritur pak a shumë drejtori, plus porosinë për t'u treguar të vëmendshëm, se transformatorët përmbanin në vetvete vlera të mëdha edhe në lekë, ishin një pjesë e pasurisë së popullit, e djersës së popullit, kështu u kishte theksuar në mënyrë të veçantë me atë zërin e tij kumbues.

Ata ktheheshin.

Në të dalë të Golemit apo në të hyrë të Kavajës, mo-

tori i makinës së Dikut lëshoi një zhurmë të dyshimtë. Jo vetëm zhurmë, po edhe ankesa. Ndoshta për peshën e rëndë që i kishin ngarkuar pa e pyetur e që ai ishte i detyruar ta tërhiqte. Këto mendoi Diku, zbuti klisheën e ashpër të fytyrës me një buzëqeshje, tundi krifën e luanit dhe vazhdoi rrugën me shpresë se motori do t'i nënshtrohej fatit. Jo sot, tha Diku me vete, le të priset një ditë tjetër, por sot jo. S'kishte kohë Diku të merrej me motorin atë ditë.

Kur kaloi Kavajën, zhurmat dhe ankesat e motorit sikur u përcaktuan. Diku mbajti vesh dhe kuptoi që ai punonte me pesë pistona. E vendosi makinën në ekstremin e anës së djathtë, për të mos penguar trafikun, zbriti, futi qafën midis supeve nga shiu i imtë dhe ngriti kofonin. Pas një shqyrtimi të shpejtë, tha me zë:

— Kandelet!

Vrapoi tek arka e çelësave, po çelësin që i duhej nuk e gjeti, nuk e kishte marrë me vete. U kujtua se ia kishte dhënë një shoku një ditë më parë, prandaj vendosi të priste. Cilin të priste? Vanin? Apo një tjetër? E la kofonin të ngritur dhe vetë u fut në kabinë me gjysmën e trupit brenda e këmbët jashtë. Nuk qëndroi shumë. Makina e Vanit po afrohej dhe ai zbriti, që të ishte i gatshëm.

Në fillim Vani e ngriti këmbën nga pedali i gazit dhe makina e preu shpejtësinë. Po befasi motori ulëriu. Si shofer që ishte, Diku e mori me mend se këmba e Vanit e kishte shtypur përsëri pedalin dhe duhej ta kishte shtypur shumë, duhej ta kishte shtypur menjëherë deri në fund, bile me nervozizëm, se çfarë shoferi ishte Diku po të mos kuptonte një gjë të tillë!

Rrotat e makinës së Vanit i kaluan pranë majave të këpucëve, dhe përtej xhamit të lagur Diku shqoi fytyrën e deformuar të shokut. Por ai e njihnte aq shumë atë fytyrë — tre vjet me radhë kishin punuar në Kombinatin krahe për krahe — sa me gjithë xhamin e lagur e të djersitur përbrenda, me gjithë shpejtësinë që rimori makina, ai shqoi fytyrën e re të Vanit, të djegur nga dielli e nga erërat, bustin e tij të tendosur, flokët e gjatë, por jo të dendur (se

ishte biond Vani) nofullat e mëdha kryeneçe e mospërfillëse, sidomos ai shqoi një rën vetull të ngritur lart në ballin e ngushtë dhe aty për aty Diku mendoi (jo pa keqardhje) se Vani po jetonte disa nga çastet e tij «të mëdha».

Ndërkaq rrotat e prapme të makinës së Vanit e spërkatën Dikun në fytyrë dhe ai e fshiu atë me mëngën e lagur të xhakëtës. Pastaj priti me gjysmën e trupit në kabinë, me këmbët jashtë kabinës. Pesë minuta më vonë stopoi një makinë dhe prej saj doli shoferi. Ishte një njeri pak mbi mesataren, ezmer, me mustaqe të shkurtra, me sy të zinj e me flokë të zinj, shkurt, ishte shofer dhe kishte pamje shoferi.

— Çfarë? — pyeti ai që zbriti.

Diku:

— Kandelet!

Shoferi flokëzi fryu hundët në rrugë.

Tha:

— Pse nuk e mbajte shokun?

Tha Diku:

— As ai nuk e ka çelësin që më duhet!

Kaq biseduan. Një çerek ore më vonë dy shoferët, Diku dhe ai tjetri, që ishte shofer dhe kishte pamje shoferi, lanë duart me benzinë, u ndanë dhe u nisën.

Te kthesa e parë Diku pa makinën e Vanit, që priste në anë të rrugës. I kaloi pranë dhe nuk e mposhti kërshërinë të mos e shikonte. Po ajo fytyrë e re, kryeneçe, mospërfillëse, me një rën vetull të ngritur lart në ballin e ngushtë.

Kaloi. Pas tij u nis Vani. Këtë gjest Vani e bënte për respekt moshe e për një rregull spontan, të vendosur midis tyre gjatë tre vjetëve që punonin bashkë. Vani prapa, Diku përpara.

Pasi i kaloi pak zëmërimi, pasi i qenë tulatur pak emocionet, që i kishin lindur nga zemërimi për Vanin, Diku zuri të fliste me vete, se disa njerëz kishin akoma mbeturina, se interesi personal të disa ishte më i fortë se të disa të tjerë, sidomos ajo që e detyronte ndonjërin të sillej keq në shoqëri e në punë ishte sedra, sedra e sëmu-

rë. Pak ta kritikojë tjetrin, (atë që e kishte sedrën të sëmurë) për shembull për pakujdesi në kursimin e karburantit, siç e kishte kritikuar Diku Vanin javën e fundit, të mbante mëri dhe ishte gati të bënte edhe gabime në kurrriz të punës, ose të shkelte disiplinën dhe detyrën e shoferit për të ndihmuar shokun në raste avarie, të shkelte kështu traditën që, me sa kishte dëgjuar Diku, ishte edhe kombëtare edhe ndërkombëtare. Ai kishte bindje se diçka ecte akoma keq në botë, dinte edhe çfarë ishte ajo, kishte kuptuar edhe rrënjët, por nuk dinte t'i shkulte ato rrënjë, por nuk dinte ta luftonte këtë të keqe, sidomos nuk dinte ta luftonte te të tjerët. Ai e dinte se kjo e keqe luftohej me punë e me ndërgjegje, dinte ta luftonte me punën e me ndërgjegjen e vet, por Diku qe bindur se nuk ishte e s'kishte qenë kurrë i zoti t'u mbushte mendjen atyre që gabonin të vepronin mirë e të ecnin drejt në jetë, të ishin punëtorë, të ishin besnikë. Për këto punë Diku nuk kishte as shkollë, as dhunti: Dikut nuk i rridhte fjala si disa të tjerëve. Prandaj në mbledhje, e kudo, Diku më shumë heshte se fliste, por punonte, se ishte njeri punëtor — këtë meritë ia dinte vetes, fshehtas sigurisht — dhe i ndihmonte shokët, se ishte shofer dhe shofer i vjetër. Kuint-esenca e kulturës dhe e filozofisë profesionale të Dikut mund të përmbliidhej në këtë aksiomë: Skënderbeu kishte lindur për të luftuar sulltanët, shoferi për të punuar shumë e për të ndihmuar shokët.

Ishte ditë prilli me shi. Gjithçka dukej si e fiksuar njëherë e përgjithmonë, gjithçka dukej sikur kishte qëndruar në vend. Dhe shiu binte, dhe bota flinte. Bile edhe vetë shiu, që binte i butë, ngadalë e me orë të tëra, edhe ai dukej sikur dremiste, edhe ai dukej sikur flinte me atë lëvizjen e tij monotone nga lart-poshtë, nga retë në tokë. Por, me të rënë në tokë, ai sikur zgjohej, sikur fillonte aktivitetin, krijonte vija, krijonte rrekeza, krikëllinte dhe ikte tutje, sigurisht ikte drejt detit.

Në të vërtetë Vamit i pëlqenin shirat e prillit. Ato i kishin pëlqyer gjithmonë. Në prill, kur binte shi, gjithçka ishte e qetë, gjithçka ishte e këndshme në natyrë, ishte

e këndshme në botë. Askush nuk lëvizte në rrugë, as karroca, as fëmijë (fëmijët, tashti që makina e Vanit ecte drejt Rrogozhinës, ishin futur nëpër shkolla) vetëm nëpër ara kishte njerëz, kishte traktorë. Disa ishin struktur me veglat e punës nën strehën e një stalle dhe shikonin qiellin. Ndoshta ata prisnin të pushonte shiu, mendonte Vani. Të tjerë punonin, hapnin një kanal. Ishte bukur dhe makina e Vanit lëvizte përmes kësaj bukurie. (Lëvizte edhe makina e Dikut aty përpara. Edhe makina e flokëziut, që kishte ndihmuar Dikun. Të gjithë mund ta ndihmonin dhe duhej ta ndihmonin Dikun, vetëm ai jo. Ai kishte një arsye të fortë). Kur binte shi ishte bukur në kabinë dhe po aq edhe në shtëpi. Vani dikur kishte ëndërruar të kishte një grua, të kishte më shumë se një fëmijë, të kishte një apartament të vogël, të kishte tryezë, karrige, stufë, mindere. Dhe sot Vani i kishte të gjitha. Nëpër mure kishte vënë edhe kuadro të piktorëve tanë, të riprodhuar nga poligrafia jonë e re dhe të shkëputur nga faqet e revistave tona. Në xhep Vani kishte edhe autorizimin për televizor. Ç'është e vërteta ai ishte zënë pak me gruan, me fjalë, sigurisht. Ajo kishte dashur të blinte ose frigorifer ose makinë larëse. Po Vani i kishte thënë jo. Vani kishte dashur të blinte televizor. Dhe ishte vendosur ashtu siç kishte dashur Vani. Autorizimin e kishte në xhep dhe ia kishte qejfi të mendonte se jeta ishte e bukur në kabinë e në shtëpi. Por bëhej më e bukur pas shiut. kur në asfalte e kudo shkëlqenin rrezet e diellit. Fundja, e bukur ishte edhe në dimër. Vani ishte i ri dhe e kishte jetën përpara. Po Diku e kishte kritikuar rëndë për pakujdesi në harxhimin e karburantit dhe për pak kolektivi kishte dashur t'i hiqte të drejtën e shoferit, t'i hiqte patentën. Diku kishte dashur t'ia cënonte këtë jetë dhe Vani e ndiente veten të fyer nga Diku.

Rruga ishte e drejtë dhe shtëpitë e fshatarëve ishin të bardha, ishin të ulëta dhe të reja. Vani dëgjonte radion. E dëgjonte prej disa orësh, që nga mëngjesi. Muzika i pëlqente shumë Vanit. Ai s'mund të rronte pa muzikë, sidomos kur udhëtonte buzë detit ose në afërsi të tij.

Vani ngriti këmbën nga pedali i gazit. Kjo ndodhi në të hyrë të Rrogozhinës. Makina e Dikut kishte qëndruar përsëri dhe përsëri kofoni i saj ishte ngritur lart. Por shpejt e mbloodhi veten Vani. Këmba e tij u mbështet sërisht në pedal dhe u mbështet si herën e parë, me nervozizëm, dhe përsëri si herën e parë, makina u hodh me kolpo, derisa fitoi shpejtësinë e nevojshme.

Kur gomat e makinës së Vanit rrëshqitën pranë majave të këpucëve të lagura të Dikut, fytyra dhe busti i Vanit ishin tendosur e kreshpëruar, po kjo tendosje e ky kreshpërim nuk mjaftuan, ata nuk ishin gjithçka. Tek po e parakalonte, Vani i hodhi Dikut një vështrim prej shoferi, që është mësuar t'i shikojë të tjerët nga lart poshtë, nga kabina në tokë, dhe, në shumicën e rasteve, t'i shikojë ata të tokës me pozën e njeriut që është i lirë të vendosë si të dojë, të marrë ose të lërë cilin të dojë, të qëndrojë ose të vazhdojë rrugën si t'ia ketë qejfi.

Vani i hodhi, pra, Dikut një vështrim prej shoferi dhe e parakaloi.

Fytyra e shoferit të vjetër tregoi hidhërim, tregoi zhgënjim e mallëngjim për diçka të humbur. Të humbur kundër dëshirës së vet. Ai sikur u plak dhjetë vjet. Sikur thinjat iu ngritën nga anët e veshëve në majë të kokës, ndërsa koka e lagur e kishte humbur pamjen e krifës së luanit. Shprehja e sfidës, që Diku kishte vënë re në fytyrën e Vanit, s'mund të harrohej lehtë. Ajo kishte qenë një shprehje që përmbledhte në vetvete krenari, kryeneçësi dhe gjithçka tjetër, vetëm solidaritetet jo.

Kësaj radhe Dikut i kishte dalë rripi i ventilatorit. Sigurisht, ai kishte filluar menjëherë nga puna. (Megjithëse nuk e kishte nevojën e të tjerëve, dhjetë minuta më vonë, pak para se të nisej, mbi kofonin e makinës së Dikut ishin grumbulluar tre shoferë, e përballë makinës së Dikut ishin rreshtuar tri makina).

Nuk vonoi dhe Diku u nis. Por jo me pamjen e zhgënjyer. Kjo ndodhte, sepse Diku s'ishte filozof. Ai u nis duke fishkëllyer melodinë e një kënge të re.

Në të dalë të Peqinit, Diku frenoi. Makina e Vanit

kishte shkarë me një rrotë në hendek dhe Vani bashkë me dy fshatarë kishin hedhur gurë e drurë para rrotës së prapme, që ajo të mos xhironte. Por ajo kishte xhiruar e xhironte vazhdimisht. Rrotat ishin futur thellë në hendek: kjo kuptohej edhe nga transformatori, që ishte anuar gati për të rënë në tokë.

Diku nxori kavon, e hoqi zvarrë nëpër asfalt, e lidhi në parakolpon e makinës së Vanit dhe tha:

— Van, hip në makinë!

Shiu kishte pushuar pa hyrë në Rrogozhinë. Flokët e Dikut ishin tharë, ishin ngritur përpjetë, të kuq e të gjatë si krifë luani.

Tha Diku për herë të dytë:

— Hip, Van!

Ai i thirri edhe një herë tjetër, sepse Vani kishte mbetur në këmbë me njëren vetull të ngritur lart (kryeneçësia e Vanit) e me tjetrën në pozicionin normal (çudia dhe mendimi i Vanit).

Pas pak Vani lëvizi drejt kabinës. Tashti lëvizjet e tij ngjanin me ato të një njeriu të hipnotizuar, që ecën, po nuk di se ku ecën. Hipi dhe ndezi makinën, dhe mbërttheu timonin me kujdes, dhe i vuri marshin e parë, dhe shikoi përpara kavon që u tendos, dhe i shkeli gazin, dhe ndjeu se makina e tij po luftonte me spondin e hendekut dhe, pas disa përpjekjesh, pas disa klithmave që lëshuan të dy motorët, makina e Vanit kishte dalë në rrugë.

Vani ishte djersitur. Ai e kuptoi se makina e transformatori mund të ishin përmbysur. Ai e kuptoi se makinën dhe transformatorin i kishte shpëtuar Diku. Diku, sigurisht, jo pa rrezikuar makinën e vet dhe transformatorin që mbartte në karrocërinë e makinës së vet.

Diku zbriti nga kabina, mblodhi kavon, si pa të keq, u afrua te kabina e Vanit, ndezi një cigare dhe tha:

— Shpëtuaam!

Vani fshiu djersët.

Tha Diku:

— Nisemi!

Por, para se të niseshin, Diku kishte mundur të shi-

konte njërën vetull të ngritur lart në ballin e ngushtë të Vanit (vetullën e keqe) tjetrën, që lëkundej midis së mirës e së keqes.

U nisën.

Vani shikonte karrocerinë e Dikut, që e manovronte bukur makinën nëpër kthesat, pa i shkaktuar asnjë lëkundje transformatorit dhe çuditej me kokën e vet, që e kishte fare bosh, të zbrazur, pa asnjë mendim. Po dalngadalë mendimet filluan t'i rridhnin dhe, kur ato e zotëruan plotësisht kokën e tij, atëherë tha:

— Sigurisht... Sigurisht!..

Vani zuri të përfytyronte mbledhjen e shkurtër, që do të nxiste Diku, sapo ata të kishin arritur në Metalurgjik, kritikën e Dikut për sjelljen e tij dhe vendimin e drejtorit, të sekretarit të partisë e të komunistëve të tjerë dhe të të gjithë kolektivit që Vanit, për gabimet e grumbulluara e për gabimin e fundit, t'i hiqej makina. Rrugën e dytë për në Durrës Diku do ta bënte me një shofer tjetër.

— Sigurisht... Sigurisht... më tërhoqi me kavo për të fituar pikë para kolektivit!

Këto gjëra mendonte Vani, ndërsa ecte pas makinës së Dikut. Fytyra e tij dukej e trishtuar, ai të linte përshtypjen e një njeriu të kapitulluar. Ai nuk do të kundërshtonte. Do t'i pranonte të gjitha. Do të pranonte se kishte njolla në ndërgjegje, se nuk e meritonte emrin e shoferit, se ai vetë do të dorëzonte makinën e do të priste në heshtje dënimin që do t'i jepnin shokët. Kështu mendoi Vani gjatë gjithë rrugës që makinat e tyre ecnin buzë Shkumbinit. Por kur nga larg filluan të shquheshin oxhakët e lartë të Metalurgjikut, kur filluan të ravijëzoheshin në qiellin gri të prillit konturet e konstruksionet e furnaltës, të koksit, të uzinave e të qindra objekteve të tjera, që rriteshin e lartoheshin orë e çast, si i thonë fjalës, që kishin mbirë aty nga hiçi, që disa vjet më parë shumica e atyre konstruksioneve apo uzinave s'kishin qenë fare, — kur i pa të gjitha këto Vani, kur doli te kthesa dhe para syve të tij u shfaq një qytet i tërë prej çeliku, nga gazgolderët deri te teleferiku shtatëkilometrash, atëherë atë e rrëmbeu përsëri ajo

ndjenjë e vjetër, e njohur, dhe ai e dinte fare mirë se kjo ndjenjë kishte të bënte me vetëdijen e me instinktin e vetëmbrojtjes. Kjo kishte ardhur padashur, si vetvetiu dhe ai tashti stërhollonte mbrojtjen e vet dhe rrëzonte poshtë një nga një akuzat e Dikut, që s'po i ndahej me kritikën e tij. Kështu, herë duke iu afruar makinës së Dikut (si për ta shtypur ose për ta vënë përpara Dikun) herë duke u larguar nga ajo (si të ruhej nga shigjetat e Dikut) ai përgatiste fjalët e frazat, që t'i kishte të gatshme për të gjitha variantet e akuzës e të mbrojtjes. Po t'i thoshte Diku kështu, Vani do t'i thoshte ashtu, po t'i thoshte Diku ashtu, Vani do t'i thoshte kështu. Meqë Vani ishte i bindur se Diku ia kishte me të keq, ashtu-të dhe kështu-të alternuan dhe zëvendësuan njëra-tjetrën, u bënë zinxhir, zinxhir i gjatë, derisa dy makinat, dy shoferët, dy transformatorët arritën në Metalurgjik. Kthimi i tyre në Metalurgjik nuk qe një gjë fare e zakonshme. Me t'u futur në zonën e Uzinës, atyre u dolën përpara drejtori, sekretari i partisë dhe pjesëtarë të brigadave elektrike. Tashti rrugët ishin të paasfaltuara ose të asfaltuara e të dëmtuara rëndë nga gjithë ajo lëvizje vinçash të të gjitha llojeve e të makinerive të të gjithë kalibrave, që lëvrinin nëpër rrugët e Metalurgjikut nga mëngjesi në mbrëmje e nga mbrëmja në mëngjes. Tashti Vani dhe Diku ose Diku dhe Vani i ngisnin makinat ngadalë, por nganjëherë u duhej të prisnin derisa të sheshohej ndonjë pjesë e rrugës, ose të mbulohej ndonjë gropë, sepse transformatorët nuk duhej të tronditeshin, pa zënë në gojë që nuk duhej të rrëzohehin.

Rreth orës katërmëdhjetë transformatorët ishin shkaruar dhe ata, Diku me Vanin, me drejtorin në mes, të tre së bashku, shkuan në njërin nga mensat e Metalurgjikut për të ngrënë drekën.

Si në mëngjes, Vani qëndronte i tendosur, ndërsa Diku hante me oreks dhe, kur hante, ai nuk të kujtonte fare atë njeriun me qafë muskuloze, që është vënë në shënjestër të kritikës artistike, por një tjetër Dik, një Dik të pajisur me mendim, me ndjenja e me shije në të ngrënë.

Tashti ai të kujtonte Dikun e çasteve kur qëndroi dhe i lidhi kavon makinës së Vanit. Ndërsa përtypej, krifa e luanit i tundej me ritmin e lëvizjes së nofullave. Drejtori, me trup të vogël, që përpara bustit të dy shoferave dukej edhe më i vogël, shikonte me vëmendje dy shoferët, si të zbulonte diçka prapa fytyrave të tyre, diçka që mund të fshihej e mund të zbulohej vetëm në thellësi të bebëzave të tyre. Si në mëngjes, ai kishte pamjen e zogut të trembur po, kur foli, zëri i doli i kumbueshëm dhe autoritar:

— Asnjë avari rrugës?

Vani pushoi së ngrëni, ashtu si shënuesi që pushon së marri frymë në çastin kur duhet të tërheqë këmbëzën e pushkës. Sigurisht... Tashti... flisnin sytë e tij. Por meqë përgjigjja (akuza) e Dikut u vonua, ai filloi të shikonte rrotull, si të kërkonte diçka, derisa më në fund e përqendroi shikimin mbi Dikun.

Tha Vani:

— Drejtori pyeti për avaritë!

Tha Diku:

— Asnjë avari!

Dhe qeshi.

U çudit Vani.

— Asnjë! — tha, po nuk qeshi si Diku.

— Asnjë! — përsëriti Diku.

Drejtori shikoi një herë njërin, pastaj tjetrin dhe tundi kokën në mënyrë të papërcaktuar.

— Po! — tha pas pak Vani.

Zotëroi një heshtje e shkurtër.

— Jo! — tha pas pak Diku.

— Jo, a po? — pyeti drejtori.

— Jo! — tha Diku dhe shtoi: — Jo! — Shtoi prapë duke shikuar si i habitur nga Vani: — Jo! — dhe qeshi.

Edhe drejtorit i erdhi për të qeshur, po nuk qeshi. Ai fërkoj duart me kallo, mori pozicionin e shoferit para timonit, se edhe ai shofer kishte qenë, lëshoi përgjysmë qepallat mbi sytë që zhbironin, dhe të gjitha këto ai i bëri me thjeshtësinë solemne të një gjykatësi profesionist dhe po

me atë thjeshtësi solemne u dha nga një cigare dy shofereve. Tha:

— O burra, nisuni!

Dihet, për respekt moshe e për një rregull të vendosur gjatë tre vjetëve që punonin bashkë, i pari u nis Diku. I dyti Vani.

Pas shumë kilometrash, përtej Kavajës dhe afër Golemit, Diku qëndroi, ngriti kofonin, u ul me gjysmën e trupit në kabinë e me këmbët jashtë kabinës dhe priti. Motori i makinës së Vanit një herë ulëriu, një herë gati u shua. E parakaloi po me atë nervozizëm që e kishte parakaluar në mëngjes, po me atë vendosmëri në ngritjen e në shkeljen e pedalit të gazit, por megjithatë kësaj radhe makina e Vanit stopoi disa metra përtej. Zbriti Vani nga kabina dhe vrapoi nëpër asfalt.

— Dik, çfarë të ndodhi?

— Kandelja! — tha Diku.

Vrapoi Vani te makina e vet, mori një çelës e një kandle dhe u kthye me vrap.

Tha Diku: — Ma jep çelësin!

Vani sikur mbeti i pakënaqur.

Tha Diku: — Unë vetë!

Vani s'lëvizi nga vendi.

Tha Diku: — Diçka pa rëndësi!

Vani deshi të zgjaste kokën në kofon.

Tha Diku: — Ti nisu! — Tha prapë Diku: — Unë të arrij pas pesë minutash!

Vani shikoi këmbët e veta. Heshti. Vetullat i qëndronin të shtrira normalisht mbi sytë. Ai sikur që çliruar nga tendosja dhe tashti trupi i tij i ri të kujtonte atletët përpara kërcimit.

Tha Diku:

— Si të duket, a nuk e meriton një kritikë tjetër për atë që bëre sot paradite?

Tha Vani:

— Po! — dhe u nis drejt makinës të vet.

Diku e shoqëroi me sy makinën e Vanit derisa ajo u zhduk pas kthesës. (Sipas zakonit, gjithmonë atje, pas kthe-

save e priste). Pastaj u hodhi një sy kandleve, që kësaj radhe ishin në rregull, pastaj kreu me gishta krifën e luanit, pastaj uli kofonin, hipi në kabinë, lëshoi çelësin e kandelën e Vanit në sedilje dhe e nisi makinën me një buzëqeshje, që u stampua në të gjithë fytyrën e tij. Pastaj ai bëri ose përsëriti shumë gjeste apo lëvizje të tjera dhe, së fundi, shikoi andej nga duhej të ishte deti e nga dihej se ishte deti, mori frymë thellë dhe iu bë sikur ndjeu aromën e tij të kripur.

ISHTE NGROHTE, ISHTE BUKUR

Lindita lexonte. Kur nuk i kuptonte ato që lexonte, fytyra e saj ngrysej, ose bëhej e mendueshme. Po dhe kur bëhej e mendueshme, ajo përsëri ngrysej. Pranë saj bubi nuhaste nëpër bar dhe kuiste. Dulke kuisur, afrohej te karrigia, ku ishte ulur Lindita. Ajo e kishte frikë bubin dhe ngrinte këmbët nga toka sa herë që bubi i afrohej. Kurse bubi nuhaste tokën pikërisht aty ku këpucët e saj kishin lënë gjurmë në bar. Ai nuhati një copë herë dhe Lindita i mbajti një copë herë këmbët pas karriges.

— Xha Miha!

Ai që punonte me cap tokën e shkrifët, ngriti sytë dhe shikoi vajzën. E shikoi kot, se mendjen e kishte gjetkë. Kushedi çfarë mendonte Mihali. Por kokën e ngriti, sepse kishte dëgjuar emrin e vet. Mbështeti duart në bishtin e gjatë të capit dhe buzëqeshi.

Tha vajza:

— Xha Miha, bubi!

— Do të ta fal? — pyeti Mihali.

Këlyshi ishte i zi. Ishte një këlysh qeni fare i vogël e me një pullë krejt të bardhë në ballë. Nuhaste dhe kuiste. Mihali e përçeshi:

— Ki-i-ki-i!

Lindita mbylli librin dhe zbardhi dy dhëmbët e parë si dy fasule. Ajo qeshi. Çudi. Xha Miha kuiste si qen i vogël. Kjo kishte shumë rëndësi, më tepër se çdo gjë tjetër

në botë. Bile në ato çaste, e gjithë bota përmbli dhej në kuisjet e xha Mihas.

Ishte maj. Pasdite. Zogjtë këndonin në degët e kumbullës. Oborri i shtëpisë ishte i bukur dhe i pastër. Nuk ishte i madh, por ishte i bukur. Kudo saksi me lule. Lule kishte edhe në dy anët e bordurave të rrugicës me kalldrëm, ku kalonte xha Mihali, i biri i xha Mihalit, që ishte inxhinier, nusja e xha Mihalit, që ishte punëtore dhe asnjë tjetër, se i biri i xha Mihalit ishte martuar një vit më parë dhe s'kishte akoma fëmijë. Ah, po, aty ecte edhe bubu, që xha Miha e ushqente me biberon. Me qumësht, sigurisht, se bubu ishte fare i vogël.

— Ki-i-ki-i! — përqeshi prapë Mihali.

Fytyra e Linditës shkëlqente nga gëzimi. Ndihej ngrohtësia e majit, aroma e majit dhe xha Miha që kuiste si bubu. Kurse bubu nuk donte të largohej nga këmbët e Linditës, që po i mpiheshin, duke i mbajtur të mbërthyer pas karriges.

Mihali kishte filluar sërish punën. I pëlqente Mihalit të copëtonte plisat, ose të shikonte t'i ngatërroheshin nëpër këmbë harabelat, që cicërinin e vraponin pas krimbave.

Tha vajza:

— Xha Miha, ky është një qen si gjithë të tjerët!

— Një qen i zakonshëm! — tha Mihali.

— Si ky gjenden plot! — tha vajza.

— Po.

— Ky qen nuk vlen asnjë grosh! — Tha pastaj: — Një qen i zakonshëm!

— Fare i zakonshëm! — tha Mihali. Pyeti pas pak: — Ku e di ti se është një qen i zakonshëm e nuk vlen asnjë grosh?

— Tha mami me babin! — tha Lindita.

Mihali shkërmoqi një plis.

Tha prapë Lindita:

— Ç'të duhet ky qen?

— Më duhet!

— Babi dhe mami thanë se një qen i këtillë nuk do ta

merrnin kurrë në shtëpi, edhe sikur t'u paguanin njëqind lekë!

Tha Mihali:

— Kështu thanë mami dhe babi?

— Po, — tha Lindita me këmbët të mbërthyer pas karriges e me librin të mbyllur në prehër.

Mihali shkërmoqi një plis.

— Po ti? — pyeti Mihali.

Tha vajza:

— Unë nuk e blej as pesë lekë, — dhe zgjati pëllëmbën përpara, për të saktësuar shifrën që kishte thënë.

Mihali shikoi pesë gishtat e vajzës. Përtej pesë gishtave shikoi edhe librin e mbyllur në prehrin e saj.

— Lexo, Lindita!

— S'dua!

— Nesër mësuesja do të të pyesë...

— S'dua!

— Dhe ti s'di asgjë!

— S'dua! — tha Lindita.

Mihali u mbështet ngadalë në bishtin e gjatë të capit, ngriti sytë dhe pa fytyrën e frikësuar të vajzës. Sytë e saj të zinj ishin më të frikësuar se fytyra.

— Uli këmbët në tokë, Lindita, — tha Mihali.

Tha vajza:

— Jo!

— Pse?

-- Kam frikë, xha Miha!

— Nga kush? — pyeti Mihali.

— Nga bubì! — tha Lindita.

Qeni i vogël me pullë të bardhë në ballë zgjati turirin drejt këmbëve të vajzës.

— Unë e di çfarë kërkon ai nga ti, — tha Mihali.

— Xha Miha, pyete qenin, çfarë kërkon ai nga unë?

— Ai do të dijë si e ke emrin!

Vajza qeshi, duke zbuluar dy dhëmbët e parë. Ajo qeshi për shakanë e xha Mihas, por megjithatë foli:

— Mua më quajnë Linda!

— Jo mua, thuaja bubit, — tha Mihali.

Lindita qeshi prapë, po megjithatë shikoi bubin dhe tha:

— Mua më quajnë Linda!

Qeni kuisi dhe vazhdoi si më parë, të nuhaste këpucët e Linditës.

— Xha Miha, ky nuk po largohet!?

— Po ti s'ia the emrin të plotë!

— Linda, i thashë unë!

— Jo, ai e do emrin të plotë!

Atëherë vajza shikoi prapë qenin dhe tha:

— Mua më quajnë Li-ndi-ta!

Bubi e shikoi vajzën në sy, kuisi dhe tundi bishtin, që e kishte fare të vogël, ashtu siç kishte të vogël edhe pullën e bardhë në mes të ballit.

Thirri Mihali:

— Bubi, largohu nga Lindita!

Qeni ngriti veshët dhe shikoi nga Mihali. Pastaj uli turirin dhe kuisi:

— Ki-i...

— Ki-i-ki-i, — kuisi edhe Mihali.

Lindita qeshi.

Ishte bukur. Mbrëmje maji. Por Lindita ishte tepër e vogël për t'iu magjepsur mbrëmjes së bukur të majit. Prandaj e gjithë vëmendja e saj ishte përqëndruar tek ato kuise të bubit e tek ato përqeshje të xha Mihas, që kuiste tamam si bubin. Kjo kishte shumë rëndësi për Linditën. Më shumë se çdo gjë tjetër në botë. Edhe ajo donte të kuiste si xha Miha e si bubin, por kishte frikë. Bubi mund të zemërohej. Bubi mund ta kafshonte.

— Ke frikë bubin? — pyeti Mihali.

— Jo!

— Ti u bërë shtatë vjeç!

— Unë nuk e kam frikë bubin, — tha Lindita.

— Aspak?

— A-ass-pak!

Fytyra e Linditës u bë tepër e mendueshme. Pastaj ajo uli këmbët. Qeni ia lëpiu. Ajo klithi, por jo shumë, i ngriti këmbët, por jo shumë. I uli prapë. Prapë klithi e prapë

i uli. Pastaj qeshi si me pahir nga një gudulisje kënaqësie.

Tha Lindita:

— Xha Miha, bubi nuk më kafshoi!

— Bubi nuk të kafshon, — tha Mihali.

Bubi, që e kishte shuar kureshtjen e tij, u largua.

Tha Mihali:

— E shikon, ti je nxënëse trime!

Tha Lindita:

— Xha Miha, e di ti historinë e atij punëtorit trim?

— Jo!

— Një ditë mësuesja na tregoi për një punëtor trim!

— Çfarë ju tha mësuesja për punëtorin trim?

Lindita kërciti gjuhën pas qiellzës dhe sytë e zinj sikur u përqëndruan.

— Mësuesja na tha, njëherë punëtorët punonin për të ngritur mure. — Sytë e vajzës sikur u turbulluan, por vetëm për një çast, se në çastin tjetër sytë i qeshën dhe ajo tha: — Punonin... ashtu... si punojnë punëtorët!

Mihali ngulte capin ngadalë dhe po ngadalë shkërmoqte plisat. Zogjtë cioërinin. Kishte diell. Kishte dritë të kuqërreme dhe hije të gjata.

— Edhe pastaj, mësuesja na tha, — foli Lindita, — se puna zgjati shumë. Po vinte mbrëmja. Ti e di, xha Miha, po errësohej, po bëhej e-errët, po bëhej natë e ze-e-ezë. Filloi të frynte edhe erë.

Pyeti Mihali:

— Ku bëhej kjo punë?

Tha Lindita:

— U-u-u, sa larg, xha Miha!

— Ku?

— Atje ku shkohet me autobus, në Kombinatin Metalurgjik!

— Punëtorët punonin lart në mure! — tha vajza pas pak.

— Kush ju tha lart në mure?

— Mësuesja, — tha Lindita. — Punëtorët ishin lart në mure, bënë llaç dhe vinin tulla, tha mësuesja.

— S'ka rëndësi, — tha Mihali.

— Ka rëndësi, xha Miha, — tha Lindita.

Pyeti Mihali:

— Pse ka rëndësi?

— Ishin lart në mure e s'mund të vraponin.

— Pse duhej të vraponin punëtorët?

Lindita vuri buzën në gaz e kënaqur, duke zbuluar dy dhëmbëfasulet e para.

— Ta them unë, xha Miha, pse duhej të vraponin punëtorët!

Pas pak Lindita kishte mbetur me sytë në qiell. Bebëzat e saj të zeza ishin turbulluar përsëri.

— Mur bënin? — pyeti kot Mihali, sa për ta shtyrë në bisedë.

— Shumë mure, — tha Lindita.

— Dhe?... — e shtyu bisedën Mihali, që e kuptoi se vajza e kishte humbur fillin e tregimit.

Tha prapë Mihali:

— Ti the se nuk mund të vraponin?

— Po, — tha Lindita me vështrim të turbullt.

— Pse duhej të vraponin?

— Edhe pastaj, — tha Lindita, — filloi të frynte erë e madhe, erë e ma-a-a-dhe! — Tundi kokën Lindita dhe foli duke e tundur prapë kokën sipas rrokjeve: — E-e-rë e ma-a-a-dhe, e di ti, xha Miha, erë si në dimër, bu-u-u!

Befas klithi:

Bubi i kishte lëpirë këmbën.

— Jo, bubu! — tha Lindita.

Bubi tundi bishtin dhe ngriti veshët.

Lindita i lëshoi këmbët në tokë dhe qëndroi serioze, qëndroi me trimëri, por prapa kësaj trimërie ndihej frika fëmijërore për atë që mund të ndodhte më vonë.

— Rri urtë, bubu! — tha Lindita.

— Ik, bubu! — tha Mihali.

Bubi iku, por në hapin e tretë shkeli mbi një lëvozhgë arre dhe u rrëzua.

— Ki-i, — qau bubu.

— Ja cilin ke frikë ti, — tha Mihali.

Qeshi Lindita.

Tha Lindita:

— Edhe pastaj... (gjuha pas qiellzës) Edhe pastaj... tha mësuesja, era frynte bu-u dhe një vinç i madh, o xha Miha, i madh sa një oxhak fabrike, tha mësuesja, rrëshqiti mbi shina. E di ti, xha Miha, si rrëshqet treni...

— E di, — tha Mihali.

— E di ti që treni ia bën ca-cap, ca-cap...

— E di!

— Ai s'bënte zhurmë si treni. Vinçi ecte pa zhurmë! — Tha prapë Lindita: — Vinçi i madh mbi shina!

— Bukur! — tha Mihali dhe ngriti capin ngadalë dhe po ngadalë qëlloi plisin.

Tha Lindita me pozën e mësueses:

— Punëtorët punonin. Ata s'dinin gjë. Ata puno e puno, era fryj e fryj. As dëgjonin. Edhe pastaj... një shok i tyre e pa vinçin që po ikte mbi shina drejt punëtorëve. — Lindita ngeci. Sytë e zinj ishin turbulluar. — Era fry-y-nte bu-u-u, — tha ajo.

— Bukur! — tha Mihali.

— Ah, — tha Lindita, — me ashtu... tha mësuesja, punëtorët do të shtypeshin të gjallë nga vinçi. Pastaj... edhe ai vinçi është blerë me djersën e popullit, kështu na tha mësuesja. Vinçi do thyhej... po është blerë me djersën e popullit, — vuri dorën në ballë Lindita. — Me lekë, xha Miha, — dhe numëroi paratë me gishta, si mësuesja.

Tha Lindita:

— E di ç'bëri ai punëtori?

— Jo, nuk e di, — tha Mihali, që punonte pak dhe dëgjonte shumë.

— Tha Lindita:

— Ai u thirri shokëve, ore-e-e... Po shokët s'e dëgjonin, era fry-y-y-nte, fry-y-y-nte. Ajo veçse frynte, ajo.

— Bu-u-u-kur! — tha Mihali me sytë te sytë e zinj të Linditës.

— Prit, si e quanin atë punëtorin?

— S'ka rëndësi!

— Jo, ka rëndësi, xha Miha. Ah, — klithi Lindita, — e quanin Gjysh, se ishte më i madh nga të gjithë. Dhjetë

vjet më i madh. Më shumë se dhjetë vjet! — tha ajo dhe hapi dhjetë gishtat e duarve

Mihalit gati i ra capì në tokë.

Lindita qeshi. Ajo kishte vënë re se, kur xha Mihasi binte capì në tokë, ai mezi ulej e mezi kërrusej për ta marrë.

— Shpëtove, xha Miha, nuk të ra në tokë!

Pamja e Mihalit sepse ishte rënduar, dhe ashtu, me pamje të rënduar, thinjat e tij binin më shumë në sy.

Mihali ktheu një plis.

Bubi lëpiu këmbën e Linditës. Lindita nuk e ngriti këmbën, por tha:

— Rri urtë, bubì, se të rrah, dëgjove?

Dhe u kthye nga Mihali. Po afrohej kulmi i tregimit dhe Lindita ishte e shqetësuar. Kjo shikohej ose lexohej në bebëzat e zeza të syve të saj, në vetullat e mbledhura, në ballin e tendosur, në zërin e saj, po edhe në frymëmarrjen gulçuese, aq sa mund t'i përshtatet kjo fjalë gulçimit të një fëmije.

Tha Lindita:

— Rri pra urtë, bubì. Ishim më mirë në shtëpinë e vjetër, te fqinjët e vjetër. U bë një javë që kemi ardhur këtu e ti një javë që qan, o qaraman! — foli Lindita tërë seriozitet e po me atë seriozitet u kthye nga Mihali: — Edhe pastaj, atë punëtorin e quanin Gjysh. Ky Gjyshi vrapoi drejt vinçit, tha mësuesja, gjeti një tra, e ngriti nga toka dhe vrapoi drejt vinçit. Edhe pastaj, xha Miha, ky punëtori i doli vinçit përpara!... Dëgjon ti, xha Miha?

— Dëgjoj!

— Me tra, tha mësuesja. Edhe pastaj (çdo «pastaj» i Linditës shoqërohej nga një pushim i vogël, si për të mbledhur fjalët apo mendimet që i duheshin) edhe pastaj ky vinçi iu afrua Gjyshit, atij punëtorit, që shokët e thërrisnin Gjysh, dhjetë hapa. Ky Gjyshi, — tha ajo duke shikuar Mihalin në sy, — edhe pesë hapa, e-edhe dy hapa, e-edhe një hap dhe bram, ia bëri mësuesja, bram e hodhi traum para rrotave të vinçit, që ishte i lartë sa një oxhak fabrike. Po të mos e mbante traum, vinçi do të kalonte mbi

trupin e Gjyshit, se rruga ku ecte vinçi ishte shumë e ngushtë, si kanal, e di vetë ti, mësuesja na e bëri në dërrasë të zezë.

Mihalit sikur i kaloi nëpër trup një rrymë elektrike. U drodh. Capi i ra nga duart dhe nuk u kërrus, nuk e ngriti, por pyeti i hutuar:

— Pastaj?

— Tha mësuesja, ky-y-y Gjyshi, kur e pa që trau nuk po i mbante rrotat e vinçit, i vuri kurrizin vinçit, ai e mori me vete Gjyshin dhe Gjyshi u thirri shokëve, por frynte erë dhe shokët nuk e dëgjonin.

(Gjuha pas qiellzës).

Tha Lindita me zë si të mësueses, po edhe me gjeste si të mësueses:

— Vinçi ecte, ai ecte ai... ecte... ecte ai... era bu-u-u, veç frynte.

Nuk iu durua Mihalit:

— A s'u lodhe, Lindita?

— Jo, — tha ajo.

— Një herë tjetër tregoje, tashti mëso këndimin!

— Dëgjo këtu, xha Miha!

Tha prapë Lindita:

— Unë jam mësuesja, ti je nxënësi!

— Mirë, — tha i penduar Mihali, — po dëgjoj!

— Gjyshi u thirri shokëve dhe shokët erdhën me vrap. Shokët ishin shumë. E ndaluan vinçin dhe e gjetën Gjyshin pa një këmbë dhe... dhe...

— S'ka rëndësi, — tha Mihali.

— Ka rëndësi, xha Miha, se Gjyshi u bë Hero i Punës Socialiste, ai shpëtoi shokët dhe vinçin.

Mihali, që mezi ishte kërrusur e mezi kishte ngritur çapin nga toka, tashti ishte mbështetur në bishtin e tij të gjatë.

— E gjetën edhe pa dy gishta të dorës! — tha Lindita.

Mihali fshehu njëren dorë prapa kurrizit.

Heshti Lindita. Heshti befas. Dhe mbeti një hop si në mëdyshje.

Mihali, me dorën prapa kurrizit, shikonte bubin që

ishte ngritur me dy këmbët e para dhe përpiqej të lëpinte jo më këmbët e Linditës, por fytyrën e saj, sepse Lindita ishte kërrusur për të marrë librin e këndimit, që i kishte rënë në tokë.

Kaloi kështu një minutë. Një minutë në heshtje. Gati edhe një minutë tjetër. Në fund të minutës së dytë, Lindita tha:

— Rri urtë, bubi! — Pastaj shikoi nga Mihali: — Nesër do ta tregoj fundin! — Pastaj shikoi qiellin: — Nesër mësuesja do të na e tregojë pjesën tjetër, se si Gjyshi vuri një këmbë prej druri dhe punon në një oficinë edhe sot. Nesër, tha mësuesja, do të na tregojë edhe se si shokët shpëtuan Gjyshin.

— Mirë, — tha Mihali me gjysmë zëri. Tha prapë: — Nesër! — dhe nga një lëvizje e pakujdesshme u dëgjua rënkimi i protezës së njërës këmbë.

— Nesër! — tha Lindita.

Tha Mihali:

— Lexo këndimin!

— Mirë, — tha Lindita.

Mihali ngrii capin ngadalë dhe po ngadalë capoi plisin. Por ai jo gjithmonë shikonte aty ku ngulej capi. Tashti ai shikonte më shpesh nga Lindita. Lindita lexonte: *Qemal Stafa luftoi me trimëri. Ai pranoi të vdiste, por nuk pranoi të dorëzohej...*

Bubi vrapoi: e kishte trembur një karkalec. Pastaj qëndroi, ngrii veshët dhe ndoqi me kureshtje e me frikë kërcimet e karkalecit mbi barin e ri.

— Ki-i-i, — kuisi Mihali.

Lindita qeshi. Shumë bukur. Xha Miha dinte të kuis-te shumë bukur.

Kishte dritë të kuqërreme, ishte mbrëmje dhe ishte ngrohtë, ishte maj. Zogjtë cicërinin.

— Ah, xha Miha, më fal! — tha një grua e re. — U vonuam pak në mbledhjen e bllokut.

Lindita vrapoi dhe u hodh në krahët e gruas së re.

— S'ka gjë, Adelinë, — tha Mihali.

— Të ka bërë zhurmë? — pyeti gruaja.

— Jo, — tha Mihali.
 — Të ka mërzhitur me pyetje?
 — Jo, — tha Mihali.
 — Unë, mami, i tregova xha Mihas një histori!
 — Po, — tha Mihali.
 — Sa për historira kjo, lëre mos e pyet! — tha gruaja e re. — Çdo ditë na sjell nga një histori.
 — Unë, mami, — tha Lindita, — i tregova xha Mihas historinë e një punëtori trim, që mbeti pa një këmbë e pa dy gishta, që shokët e thërrisnin Gjysh, se ishte më i madh se ata, se ishte edhe komunist, tha mësuesja.

Mihali dhe nëna e Linditës u shikuan sy në sy. U shikuan vetëm një çast, se në çastin tjetër nëna e Linditës kishte ulur sytë dhe jo vetëm kaq, por dukej edhe e mallëngjyer.

Ajo e zbriti Linditën në tokë.

— S'je më e vogël, — i tha e ëma. — U bërë shtatë vjeç, s'të mbaj më në krah!

— Nesër! — tha Lindita dhe shikoi nga Mihali, — mësuesja do të na tregojë gjysmën tjetër.

E ëma e mori Linditën për dore.

— U vonuam në mbledhje, — tha ose përsëriti ajo.

— Ç'kishte sot në mbledhjen e bllokut?

— Ja, ashtu, — tha ajo, — me rastin e zgjedhjeve të gruas. Familja. Edukimi i fëmijëve, pastërtia e të tjera, që i di vetë ti. U fol edhe për gjendjen e gruas në botë...

Me gjithë pamjen e qetë në dukje, kuptohej lehtë se Mihali kishte mbetur pak si i trullësuar dhe nuk i dëgjonte të gjitha ato që i thoshte fqinja e re. Ndoshta ai e kishte mendjen te Lindita. Nesër ajo do të mësonte se kush ishte ai punëtori që shokët e thërrisnin Gjysh. Deshi t'i mbyllte me një shaka Mihali këto mendime, që i kujtonin atë ngjarje të tre vjetëve më parë. Por evokimi i asaj ngjarjeje ishte aq i fortë, sa ai s'gjeti tjetër, veçse:

— Ki-i-i-ki-i, — kuisi Mihali.

Lindita qeshi. Lindita përplasi duart. Ishte bukur. Ishte shumë bukur. Ajo e donte shumë xha Mihan, edhe

bubin e donte, por xha Mihan, që bënte si bubu, e donte më shumë. Dhe gjithçka që i kishte ndodhur sot në oborrin e xha Mihës, kishte qenë jo vetëm e bukur, por shumë e rëndësishme, më e rëndësishme se çdo gjë tjetër në botë. Sot asaj i kishte dalë frika nga bubu dhe sot xha Miha kishte kuisur si bubu dhe më bukur se bubu.

Lindita tha:

— Xha Miha, nesër do të të tregoj gjysmën tjetër!

— Ki-i-ki-i, — bëri Mihali.

— Ki-i-ki-i, — bëri Lindita dhe shikoi me frikë nga bubu.

Të gjithë qeshën. Edhe Lindita vetë. Kurse bubu që i fundit që kuisi në mënyrë qesharake dhe në mënyrë qaramane.

Dielli ishte varur mbi çatitë. Ishte mbrëmje. Por kishte dritë, dritë të kuqërremtë. Dhe ishte ngrohtë. Ishte pranverë.

E ëma e puthi Linditën në cepin e buzëve.

Tha:

— Thuaj xha Mihës mirupafshim!

— Prit, mama, — tha Lindita.

— Çdo? — e pyeti mamaja.

Tha Lindita:

— Xha Miha, ç'do të thotë punonjës bujqësie?

Tha Mihali:

— Ata që bëjnë bukën që hamë ne!

— E kuptova, — tha Lindita.

E ëma qeshi dhe kapërceu pragun.

Tha Lindita:

— Prit, mama!

— Ç'do akoma? — pyeti e ëma, nga fytyra e së cilës nuk ishte fshirë e qeshura.

Lindita shikoi tokën që kishte punuar Mihali dhe tha:

— Xha Miha, pse punon kaq ngadalë ti?

E ëma:

— Li-ndi-ta!

Mihali:

— Jam plak, a s'më shikon?

Tha Lindita:

— Po ai Gjyshi a s'ishte plak që mbajti vinçin dhe shpëtoi shokët?

Mihali mbeti. Mihali e shikoi nën vetulla.

Tha Lindita:

— Ti s'ke punuar as kaq, — dhe hapi pëllëmbën e saj të vogël.

— Nesër do të punoj më shumë e më shpejt, — tha Mihali.

— Babi im punon më shumë se ti. Ta shikosh kur i futet ai oborrit, fiu (deshi të fishkëllente ajo) e përllan të gjithë!

Mihali dhe Adelina qeshën, por Lindita jo. Ajo kishte edhe një pyetje për të bërë:

— Xha Miha, ç'do të thotë kooperativist?

Tha mamaja:

— Fillove prapë nga pyetjet ti?

Dhe iku me të në krah, pa marrë parasysh kundërshtimin e saj.

— Ki-i, — kësaj radhe kishte kuisur bubi i vërtetë. Ai ishte penguar përsëri mbi një lëvozhgë arre.

Ishte mbrëmje. Mbrëmje maji. Dhe ishte ngrohtë. Dhe shumë bukur.

MIRAZH

(Novelë)

1

Një ditë dimri, kur dielli zverdhonte prapa cipës së hollë të reve, kur gjithçka ishte e ftohtë dhe e zymtë, Mira Goremi doli nga zyra e përgjegjësit të sektorit, dhe në vend që të fliste, iu hodh shoqeve në qafë. Ajo u përlot.

I thanë shoqet:

— Ç'ke?

Nuk u përgjigj Mira.

— Përsëri?

Mira fshiu lotët me mëngët e xhupit.

Tha:

— Jo, më liruan! — dhe një valë e re vaji i shtrembëroi fytyrën.

I thanë shoqet:

— Ti je e çuditshme!

Tha Mira:

— Pse jam e çuditshme?

— Shkove tri herë te përgjegjësi për t'u larguar, tashti, befaz, zure të përlolesh si fëmijët!

Mira nuk foli. Ajo u përlot prapë dhe qeshi. Ajo qeshte duke qarë dhe qante duke qeshur.

Mira kishte ardhur vullnetare në Kombinatin Metalurgjik, kishte punuar, kishte mbushur afatin, kishte punuar edhe një vit më tepër dhe tashti duhej të largohej. Kishte ardhur tetëmbëdhjetëvjeçare dhe po largohej njëzet e një. Çfarë t'u thoshte shoqeve? A s'e kuptonin ato

tronditjen apo mallëngjimin që mund të ndiente një vajzë si ajo, si Mira, apo si ato (se edhe dy shoqet, që e kishin pritur te dera e përgjegjësit të sektorit, ishin moshatare me të) me rastin e largimit nga një vend, ku ajo kishte punuar tre vjet? Sigurisht, ato i kuptonin të gjitha. Mira as u tha gjë, as iu përgjigj pyetjeve të tyre. Dhe ato nuk e trazuan më.

Të gjitha formalitetet e tjera, dorëzimi i teshave dhe i mjeteve të punës, libreza, vërtetimi i vitit të tretë të teknikumit të ndërtimit pa shkëputje nga puna, e ndonjë vërtetim tjetër, ndarja me brigadën e me dy shoqet e dhomës, u kryen në heshtje, më shumë me gjeste, sesa me fjalë, më shumë duke u skuqur se sa me përshëndetje.

Pas dy orësh hipi në autobusin që do ta çonte në Elbasan. Lamtumirë! Dhe shoqet e shokët erdhën duke u zvogëluar shumë shpejt, por jo konturet e Kombinatit. Ato u dukën për disa minuta në sfondin e qiellit me re të holla, pas të cilave ndriçonte dielli i verdhë apo i zbehtë i shkurtit. Gjatë udhëtimeve të përditshme, Mira e dinte me saktësi se në ç'pjesë të rrugës humbiste, ta zëmë çatia e Petëzimit të imtë apo të mesëm, ku zhdukej pamja e Furrnaltës, tubacionet e Oksigjenit, avujt apo oxhaku njëqind e njëzet metra i Tecit. Ku dhe për sa kohë akoma do të dukeshin një pjesë e çatisë së Çelikut apo të Koksit, profili i një kulle ftohjeje, apo profilet e Uzinës numër 12, konturet e Uzinës mekanike, dhjetëra ose qindra objekte të tjera anekse ose autonome e së fundi kullat e teleferikut shtatëkilometrash, që do të sillte gurët gëlqerorë nga shkëmbi i Letanit. Lamtumirë! Tek ajo kthesa, pas shinave të dyta të hekurudhës, që të çon në fabrikën e çimentos, nuk do të dukej më asgjë nga Kombinati. Ja dhe kthesa u arrit dhe Kombinati me të gjitha konturet e tij u zhduk krejt. Sytë e saj s'dihej kur do ta shikonin sërish qytetin prej hekuri që sapo kishte lënë prapa. Ndoshta me rastin e ndonjë ekskursioni, ndoshta do të vinte qëllimisht, ose nga dritaret e trenit, duke udhëtuar për Tiranë. Tashti s'kishte mbetur gjë tjetër, përveç qiellit gri mbi kokë, peisazhit të zhveshur dimëror nga e djathta dhe gjelbërimit të përje-

tshëm të ullinjve, që shtrihen valë-valë e kodra-kodra nga e majta e rrugës që të çon në Elbasan.

Ishte i bukur dhe në të njëjtën kohë ishte i trishtueshëm ky udhëtim i fundit në rrugën Kombinat-Elbasan. Sado që ajo u përpoq të shikonte vetëm gjelbërimin e errët të ullinjve (kjo pamje gjithmonë i kishte ngjallur gëzim e freski) trishtimi nuk iu hoq nga sytë e nga fytyra, ai nuk iu hoq as nga mendimet e as nga ndjenjat. Trishtim dhe gëzim. Ashtu siç ndodh shpesh nëpër udhëtime. Diçka e hedh prapa, diçka e shikon përpara. E shkuara dhe e ardhmja mpleksin në mënyrë të pazgjidhshme dhe shkaktojnë atë gjendje mikse e të paqëndrueshme, siç është edhe vetë lëvizja.

Kjo gjendje e shoqëroi Mirën edhe kur treni çante buzë Shkumbinit, futej nëpër lugina, futej në tunele, dilte përsëri në dritën gri të reve të holla, që mezi fshihnin prapa tyre shkëlqimet e zbehta të diellit dimëror.

Një kohë e këtille kishte qenë edhe tre vjet më parë, kur ajo vinte për të punuar vullnetarisht në Kombinat. Ishte dimër dhe retë e holla pengonin të binin deri në tokë rrezet e pjerrëta të diellit. Ishte muaji shkurt, ashtu siç ishte shkurt edhe këtë ditë që ajo bënte rrugën e kundërt, jo për në Metalurgjik, po në shtëpi, në qytetin e saj. Atëherë, tre vjet më parë, ajo shikonte përmes xhamave të autobusit (atëherë s'kishte tren, kishte vetëm vullnetarë që punonin për të shtruar shinat e trenit Librazhd-Përrenjas) dhe përpiqej të merrte me mend si do të ishte puna në Kombinat Metalurgjik, si do të ishin shoqet, shokët e shoqëria, si do të ishte brigadieri dhe çfarë profesioni do të mësonte atje, se atëherë ajo s'ishte veçse një vajzë fare e re, që kishte mbaruar një tetëvjeçare, që kishte larë shishe në një punishte dhe asgjë më tepër. Atëherë ajo shkonte drejt diçkaje të panjohur dhe kjo e panjohur sikur i rëndonte mbi shpatulla, sikur përpiqej ta gozhdonte në vend, por megjithatë ajo s'mund të rrinte pa shkuar atje. Të gjithë ishin në lëvizje. Të gjithë shkonin për diku. Dhe Kombinati Metalurgjik ishte bërë objekti që tërhiqte si me magnet rininë e vendit, rininë e qytetit të saj, dhe shoqet e saj ki-

shin shkuar disa muaj më parë, ndërsa ajo jo, asaj i ishte dashur të luftonte me prindërit, derisa, më në fund, ata ishin tërhequr, ishin bindur dhe i kishin thënë të shkonte. Dhe ajo po shkonte, por me një peshë në zemër për ato të panjohura që e prisnin përpara e që jeta e një kantieri të madh duhej të ishte e mbushur plot. Vetëm njëherë ajo nuk e ndjeu atë peshë (që i shembëllente me frikën) por kjo nuk zgjati shumë, kjo zgjati vetëm disa sekonda, për aq kohë sa ajo mundi të shikonte nga xhami i autobusit vullnetarët në një pjesë të vogël të hekurudhës në ndërtim e sipër. Po ata a s'ishin të rinj si ajo? Po ata a s'ishin ndarë nga prindërit siç ishte ndarë ajo? Po ata a s'ishin larguar nga shtëpia siç po largohej ajo? Të gjithë, të gjithë... e pse ajo duhej të qëndronte në shtëpi e të lante shishe në një punishte të vogël e prapë të kthehej në shtëpi? Përveç këtij rasti, ndodhi që përsëri ajo t'i harronte mendimet për të panjohurën në Metalurgjik dhe kjo ndodhi kur ajo pa një malësore të re nga fshatrat rrotull (vullnetare ose jo) që befasisht u gjend në mes të rrugës ballë për ballë me autobusin. Malësorja e shikonte si e ngurosur autobusin, që i afrohej gati për ta shtypur. Mirës, që e vuri re habinë dhe ngurosjen e malësores, iu kujtua një dokumentar që kishte parë kohët e fundit: pikërisht kështu kishte ngrirë një drenushë, me të dëgjuar zhurmën e makinës pranë vetes. Por Mira nuk ndjeu vetëm habinë e ngurosjen e malësores. Një çast më vonë ajo kishte vënë re edhe forcën e saj, edhe shpejtësinë e gjakftohtësinë e saj dhe për një sekondë, ose më pak se për një sekondë, malësorja kërceu në anë të rrugës, autobusi kaloi, gjarpëroi, malësorja nuk u duk më dhe atëherë Mirës iu kujtua se edhe drenusha, që dukej si e mbërthyer në vend, ashtu kishte kërcyer, pikërisht në çastin e fundit, pikërisht si malësorja. Por, këto qenë vetëm çaste, sepse e panjohura që e priste përpara e që i shkaktonte atë peshë të rëndë në zemër, e shqetësoi prapë.

Ishte hera e parë që Mira Goremi dilte nga shtëpia, hera e parë që ndahej nga prindërit, nga vëllezërit e nga motra dhe ishte hera e parë që ajo ndodhej pa të afërmit pranë.

Autobusi arriti në qytet kur ishte errësuar. Ishte dimër, bënte ftohtë dhe frynte erë, erë shkurti. Për të gjitha këto i kishin folur Mirës që në shtëpi. I kishin thënë, se do të arrinte në Elbasan kur të qe errësuar; se ishte ftohtë, më pak se në qytetin e tyre, por frynte një erë që elbasanasit e quanin erë Kraste; se atje, ku do të qëndronte autobusi, ishte jashtë qytetit, ishte gati periferi dhe asaj i duhej të ecte në këmbë një copë herë me valixhen në dorë, se do të shikonte shumë pemë e shumë kaçube derisa të futej në rrugët e ndriçuara të qytetit. Kështu i kishin thënë të afërmit dhe prindërit dhe e kishin porositur që të ecte bashkë me pasagjerët e tjerë dhe në asnjë mënyrë të mos ecte vetëm, se kushedi, dimër ishte, shkurt ishte, dhe dita ishte shumë e shkurtër. Mira ashtu bëri. Mori valixhen dhe eci prapa pasagjerëve. Por pasagjerët hynin monopateve të errëta. Të tjerë u binin përmes arave, përmes ndonjë sheshi apo kopshti. Atëhere ajo u qepez atyre që ecnin akoma gjatë rrugës së gjerë, por në një çast se si ndodhi dhe Mira u gjend vetëm, fare vetëm, e rrahur nga era (era e Krastës) e ndjekur, por edhe e penguar nga siluetat e heshtura të pemëve. Ku kishin shkuar njerëzit? Ishte errësirë dhe Mira nuk i dallonte çatitë e shtëpive të periferisë, ajo vështronte vetëm errësirën dhe siluetat e pemëve në errësirë, dëgjonte hapat që i kumbonin dhe i trembej vetmisë. Padashur, filloi të vraponte e, meqë ishte errët, njohu frikën, jo një frikë të zakonshme, nga ato që kishte provuar edhe në qytetin e vet apo në shtëpinë e vet, as nga ato frikërat e fëmijërisë që s'i kishte harruar e që s'do t'i harronte kurrë, por një frikë tjetër, një frikë të madhe, frikën e gjithë botës, të grumbulluar e të përqëndruar në një të vetme: frikën që kishte marrë fytyrën e një rruge të errët, të heshtur, fytyrën e një nate dimri të ftohtë e me erë. Ajo ishte frika e një vajze, që në mënyrë të befasishme ishte gjendur në një cep të panjohur të globit, frika e një vajze tetëmbëdhjetëvjeçare që gjendet larg shtëpisë e që gjendet vetëm. Thelbi i kësaj frike kishte të bënte me dëshpërimin e papritur se nuk do ta arrinte kurrë qytetin, se nuk do t'i arrinte dritat dhe njerëzit, se do

të humbiste rrugën, se do të fillonte të qante e të bërtiste dhe atëherë, gjëja e parë që do të bënte, do të hidhte valixhen për t'u çliruar nga pësha e saj. Pastaj... Ajo kujtoi porosinë e prindërve që të mos u ndahej të tjerëve dhe prapë u çudit si kishte mbetur vetëm, kujtoi prindërit që nuk e kishin lënë katër muaj më parë të shkonte vullnetare në Metalurgjik bashkë me shoqet e me shokët dhe...

Vrapoi. Por pastaj nuk mundi të vraponte më. Mira s'do t'i harronte kurrë ato zhurma misterioze të asaj mbrëmjeje në periferi apo gati në periferi të qytetit, lehtë e një qeni, krakëritjen e një laraske nga degët e selive në anë të rrugës, por edhe atë pamje të çuditshme që kishin marrë të gjitha gjërat mbi tokë. Pemët, që gjatë ditës as që i vinte re, po edhe në i vinte re, ato i qenë dukur gjithmonë të hijshme (sidomos ato me gjelbërim të përherëshëm, po edhe ato me bisqet e thara që nuk i ngjallnin as gëzim as trishtim, jo se jo frikë) tashti e tmerronin me palëvizshmërinë e tyre e që dukej aq e pazakonshme në errësirë. Këto ishin hijet e siluetat e natës të një vendi të panjohur, këto ishin hiçi i zi, qetësia e frikshme, boshllëku i mbushur me të panjohura e me të fshehta. Por më e tmerrshme ishte ndiesia se qenia e saj kishte shkëputur çdo lidhje me botën, me njerëzit, me jetën, se ajo, Mira Goremi ishte një qenie e humbur, që varej diku pezull, që ecte mbi tokë e që nuk e ndiente tokën nën këmbë. Dhe akoma më e keqe ishte përshlytja, se errësira s'ishte më errësirë, se era s'ishte më erë, se zhurmat s'ishin më zhurma, se edhe toka vetë, pemët, hijet e të gjitha sendet mbi tokë kishin humbur peshën e thelbin e tyre material dhe ishin kthyer në një hiç, ishin kthyer në frikë, në frikën e një vajze, që kishte mbetur e vetmuar dhe e veçuar nga bota, nga qyteti i vet, nga shtëpia, nga të afërmit, kishte mbetur në mëshirën e hijeve e të errësirave.

Ajo prapë vrapoi. Vrapoi derisa pa një dritë, derisa u fut në rrugët e qytetit dhe takoi njerëz, dëgjoji zërin e tyre, të qeshurat e tyre dhe atëherë Mira Goremi mori frymë e çliruar. (Më vonë, kur do t'i ndodhte ta bënte këtë rrugë vetëm, ditën apo natën, në dimër apo në verë, ajo do të qe-

shte me vete për frikën e natës së parë, sepse ajo rrugë, që atë natë iu duk e pafund, nuk ishte veçse pesëdhjetë metra e gjatë).

Por atë natë ajo nuk qeshi. Atë natë asaj i kishte hyrë frika dhe ajo më parë shkoi në postë, të merrte prindërit nga telefoni i fqinjës, pastaj të shkonte në konvikt, të zinte një krevat ku kishte edhe shoqe të tjera, e pastaj të flinte rëndë e të gërhiste nga lodhja e një udhëtimi e nga lodhja e një frike.

Tha Mira:

— Alo-o!

— Alo-o, — tha mamaja.

— Kam frikë! — tha Mira.

— Ç'ke, moj, si arrite? — pyeti mamaja e trembur.

— Kam frikë të jetoj vetëm! — tha Mira.

— E mjera unë!

— Kam frikë!

— A të vij nesër?

— Po!

— A të vimë të dy, unë dhe babai?

— Po!

Tashti treni futej në tunelin e gjatë të Librazhdit.

Ishte ditë e vrejtur, ishte ditë e ftohtë shkurti. Dhe Mira bisedonte pa zë me vete, me prindërit, me vëllezërit, me motrën e vogël e me të gjithë të afërmit e të njohurit e tjerë. Gjendja e saj shpirtërore pas një orë udhëtimi me tren nuk kishte ndryshuar. Ishte i bukur dhe në të njëjtën kohë i trishtueshëm ky udhëtim i fundit në rrugën e kthimit Elbasan-Korçë. Sado që ajo përpiqej të shikonte vetëm anën e mirë të këtij udhëtimi (dhe ky udhëtim pa dyshim e kishte anën e tij të mirë: ajo po kthehej në shtëpi) prapëseprapë trishtimi, ai trishtim i pakapshëm, që ia kishte shtrënguar e mpirë zemrën, kur përgjegjësi i sektorit e lejoi të largohej nga Metalurgjiku, nuk iu hoq nga sytë e nga fytyra, nuk iu hoq as nga mendimet e nga ndjenjat. Po kur kaloi Librazhdin, kur kaloi edhe tunele të tjera, kur kishte bërë gati gjysmën e rrugës me tren, padashur ajo filloi të thërriste pa zë:

— Prindërit e mi, vëllezërit e mi, motra ime e vogël, njerëzit e mi të dashur, njerëzit e mi të mirë!

Kështu fliste ajo me vete me apostrofe lirike, por pa eufemizma, pa i komplikuar shprehjet, përkundrazi Motra ime e dashur! — Motra ishte një. Prindërit ishin dy. Vëllezërit ishin dy. Të gjithë më të vegjël se ajo dhe prindërit dy herë e gjysmë mbi moshën e saj. Motra ishte një. Motra ime e dashur!... Prindërit e vëllezërit e mi të mirë!...

2

Kështu babai mori lejen vjetore (mamanë e kishte zëvendësuar një shoqe) dhe të nesërmen arritën në Elbasan. Mira i përqafoi e i puthi, si të ishte ndarë nga ata vite më parë. Pastaj zunë një dhomë me tre krevate në njerin nga hotelet.

Mëngjesin tjetër Mira me mamanë ndodheshin në zyrën e përgjegjësit të sektorit. Babai nuk u fut brenda. Ai priste jashtë. Atij i qe dukur e tepërt të futej brenda dhe, pastaj, dihej, fakt i njohur, se e shoqja ishte më e aftë për t'u marrë vesh me botën e jashtme. Ja, për shembull:

— Kjo është vajza ime, Mirka! — tha mamaja duke prekur me dorë supin e Mirës, si për ta dalluar atë midis dhjetë vajzave të tjera.

Përgjegjësi i sektorit të montimit ishte veshur me gozhupin e lëkurës, kishte ngritur jakën prej kastori dhe ishte vështirë të shquaje ku mbaronte jaka dhe ku fillonin flokët e tij të zinj e të ashpër si jaka e gozhupit. Në dhomë ishte ftohtë, sepse zakonisht në këtë kantier zyrat janë vendosur e vendosen provizorisht nëpër depot e ardhshme të objekteve ose nënobjekteve, tavani i të cilave shpesh i kapërcen të gjashtë metrat lartësi.

Përgjegjësi, që e kuptoi se kishte të bënte me një punë «civile», u ngrit në këmbë, u shtrëngoi dorën mamasë, vajzës dhe i zgjati karrigen mamasë, kurse për vete në fillim mbeti në këmbë, pastaj tërhoqi një arkë ambalazhi bosh dhe u ul. Arka rënkoi. Përgjegjësi ishte i madh nga trupi dhe mund të peshonte gati një kuintal.

Tha mamaja:

— Erdhi me vonesë!

Mira vuri buzën në gaz.

— Vullnetare për dy vjet! — tha mamaja.

— **Shumë mirë!** — **tha përgjegjësi i sektorit me zërin e kumbueshëm, si të kishte montuar në fyt një bori.**

— Nga Korça! — tha mamaja.

Përgjegjësi e shkuli vështrimin nga mamaja dhe e nguli tek e bija.

Pyeti mamaja:

— Ku do të punojë?

— Në montim! — tha përgjegjësi dhe, pasi shqyrtoi për një çast trupin e gjatë e të lidhur të Mirës, shtoi: — Në montim!

Mamaja qeshi:

— Ah! — tha.

Dhe pyeti:

— Ç'është ky montim?

Përgjegjësi hodhi sytë nga dera e hapur. (Këto zyra, që do të jenë depo të ardhshme, s'kanë dritare).

— Ja, — tha përgjegjësi, — do të merret me ngritjen e me mbërthimin e konstruksioneve të çelikut.

Mamaja dhe Mira kthyen kokën nga dera. Aty panë gjysmën e trupit të një burri të veshur me pallto të zezë. I buzëqeshën. Përtej burrit panë shtylla çeliku, trarë çeliku, vinça e ganxha çeliku, një botë çeliku, që ecte paralel, që binte pingul, që krijonte diagonale e tangente, e që të gjitha së bashku të kujtonin pëlhurat e merimangave kur ndrisin në diell.

Tha mamaja:

— Ermirën e kemi...! — Por fjala i ngeci në buzë, sepse sytë e saj kishin ndier peshën e vështrimit të së bijës.

— Hera e parë që largohet nga shtëpia, — tha mamaja. Përgjegjësi i sektorit vuri re se faqet e vajzës u shkugën.

— S'ka gjë, — tha ai.

Mamaja qeshi.

— Do të mësohet, — tha ai dhe shikoi Mirën.

Pyeti mamaja:

— Apo jo, Mirkë?!

Tha Mira:

— Po, sigurisht, do të mësohem, mama! — Ajo kishte folur me qortim në adresë të mamasë dhe me vështrim në sytë e mamasë.

— Si fillim Ermirën do ta vemë në brigadën e bojës, — tha përgjegjësi i sektorit.

Pyeti mamaja:

— Ç'është kjo brigadë boje?

Përgjegjësi qeshi:

— A-a, ç'është kjo brigadë boje?

Dhe shtoi:

— Çdo gjë që montohet, më parë duhet të lyhet!

Pyeti mamaja:

— Sipër?

— Jo, — tha përgjegjësi.

— Po ku?

— Në tokë, — tha përgjegjësi.

— Poshtë? — përsëriti mamaja.

— Këtu poshtë! — përsëriti përgjegjësi.

Mamaja shikoi nga dera. Burri me pallto të zezë bëri një shenjë me dorë: «Mirë». Mamaja nuk e kuptoi ose bëri sikur nuk e kuptoi, ose thjesht deshi të sigurohej më mirë, sepse këto ishin çaste të rëndësishme dhe një vendim i shpejtuar mund të peshonte shumë mbi kurrizin e Mirës së tyre. Shikoi prapë burrin me pallto të zezë. Ai bëri përsëri me dorë «Mirë», por tha edhe me zë diçka, që afërsisht mund të kuptohej: «Prano!»

— Mirë! — tha mamaja, por pas një çasti, pyeti:

— Me çfarë i lycjnë hekurishtet?

Përgjegjësi qeshi. Ai zërin e kishte të kumbueshëm, por të qeshurën e kishte të lehtë.

Pyeti mamaja me një farë toni të fshehtë alarmi:

— Mos përdorin gjëra elektrike kur lyejnë?

— Çfarë? — pyeti përgjegjësi.

Mamaja (po me atë ton alarmues):

— Me korent elektrik?

— Ah, jo! — tha përgjegjësi.

— Me çfarë?

— Me furçe!

Mamaja mbeti si e gozhduar.

Tha përgjegjësi:

— Me furçe të zakonshme!

Klithi mamaja:

— Si në shtëpi?

— Po!

— Si kur lyejmë qyngjet e stufës?

— Po, — tha përgjegjësi.

— Ah! — tha mamaja dhe shikoi nga dera burrin me pallto të zezë. Një çast më vonë shtoi: — Shumë mirë. — Shikoi nga e bija: — Kështu, Mira?

Mira kishte mbetur si e hutuar. Ajo s'ishte në gjendje të thoshte as po, as jo.

Mamaja shikoi prapë nga burri me pallto të zezë. Ai i bëri një shenjë.

— Ah! — u kujtua mamaja. Shikoi përgjegjësin: — Mirka ka bërë një vit shkollë të mesme pa shkëputje nga puna.

— Mos u bëj merak, — tha përgjegjësi. — Edhe këtu do të vazhdojë teknikumin e ndërtimit pa shkëputje nga puna.

— Shumë mirë! — Shikoi nga e bija: — Kështu, Mira?

Pas kësaj bisede (që dëshmoi edhe një herë për aftësitë e mamasë për t'u marrë vesh me botën e jashtme) ata u ngritën. Por, kur po dilnin nga dhoma, të përcjellë nga përgjegjësi i sektorit, mamaja qëndroi befaz dhe tha:

— Kam edhe një lutje!

— Mama! — foli me qortim Mira.

— Dua të mos ia ndërroni punën vajzës, se, siç e shikoni, e kemi të vogël.

Përgjegjësi i sektorit i hodhi edhe një vështrim trupit të gjatë të Mirës.

— Mos u me-ra-kos-ni për Mirën, — tha ai.

Me kaq ky takim mori fund.

Të nesërmen Mira Goremi filloi punë në brigadën e bojës.

Çdo mëngjes prindërit, pasi e shikonin në sy për të ekzaminuar gjendjen e saj shpirtërore, e përcillnin deri në stacion dhe nuk largoheshin prej aty pa u nisur autobusi, ose shpesh hipnin edhe ata dhe e përcillnin deri te porta e Kombinatit, pastaj ktheheshin në qytet, medoemos, pasi i kishin dhënë këshillat e rastit. Të mos ftohej, të mos grindej me shoqet e me shokët, të sillej mirë me përgjegjësit, të ruhej nga ndonjë hekur në kokë, të kursente bojë, të bënte punë të mirë që t'ia pëlqenin, sidomos mamaja i pëshpëriste në vesh që të ruhej nga ndonjë vagabond, se nuk ishte e mundur të mos kishte edhe vagabondë në mes të gjithë atij populli.

Në fund të turnit zakonisht ata e prisnin në stacionin e autobusëve në qytet, por, kur vonohej (dhe kjo ndodhte shpesh) atëherë ata e prisnin te porta e Metalurgikut.

Mira thoshte:

— Pse kot!

— Çfarë pse kot! — kërkonte shpjegim e ëma.

— Pse vini deri këtu!

— Mirr-kë! — mamaja e Mirës dinte të qortonte me të gjitha mjetet e mënyrat së bashku: me zërin, me qëndrimin e saj, me vështrimet, me lëvizjen e muskujve të fytyrës, me mimikën e me gjithçka dhe Mirës i bëhej sikur edhe kostumet, edhe mëngët e palltos së mamasë ishin mësuar ta shikonin me qortim. I ati kishte zakonin tjetër, zakonin e ekzaminimit: mos ishte lodhur e bija? Mos ishte vvarë gjëkund? Mos i kishte ndodhur ndonjë...? Mos...

Kështu kaluan dy javë. Mira sikur zuri të mërzitej nga prania e tyre. Tashti ajo kishte zënë shoqëri, ishte mësuar me punën dhe prindërit i dukeshin të tepërt. Por edhe prindërve u mbaroi leja. Edhe fëmijët u kishin telefonuar

nga Korça se nuk mund të qëndronin më, pasi rezervat ushqimore u ishin mbaruar ose ishin në të mbaruar.

Në krye të dy javëve sistemuan Mirën në një dhomë me dy shoqe të brigadës. I ati studioi arkitekturën e konviktit të Kombinatit, dhomën e çlodhjes apo të kulturës, bibliotekën, banjat, korridoret, zigzagjet e shkallëve, dritaret etj. dhe mbeti i kënaqur që e bija do të jetonte aty, ndërsa e ëma preku me duart e veta sustën e krevatit, dyshekun, batanijet, porositi të bijën të mos zgjatej në dritare, porositi të bijën dhe dy shoqet e së bijës të mos ktheheshin vonë se nata... etj.etj. dhe pas ekzaminimit të fundit që i bënë fytyrës së Mirës, dmth gjendjes së saj shpirtërore, të pesë së bashku (dy prindërit, Mira, tre, dy shoqet e Mirës, pesë) morën rrugën për në stacionin e trenit. Atje u ndanë me lot në sy (mamaja dhe Mira) babai tundi kokën me madhështi, se ishte burrë e s' duhej të përlolej, përqafoi të bijën, u dha dorën dy shoqeve dhe vrapuan në çastin e fundit, kur treni ishte nisur. Mamanë e ngritën gati peshë. Mira me dy shoqet e nga sipër e tërhoqi i shoqi, që ishte një burrë me trup të madh dhe të fuqishëm.

— Mirupafshim, Mirkë!

Palltoja e zezë e babait qëndronte palëvizur, në mënyrë madhështore.

— Mirkë, na shkruaj letra, na merr në tel...

Para Mirës rrëshqitën dritare të tjera, vagonë të tjerë, një dorë tundej diku, derisa treni u tregoi vagonin e fundit, që zakonisht është vagoni i mallrave. Ky s'qe veçse një çast. Në çastin tjetër kishte filluar jeta e pavarur e Mira Goremit.

Kur arriti në këtë pikë të mendimeve apo të kujtimeve të saj, treni, me të cilin ajo po kthehej në shtëpi, ishte duke kaluar urën e lartë të Bushtricës. Mira u ngrit nga sedilja, i kërkoi ndjesë një plake, që ishte ulur pranë dritares dhe nxori kokën jashtë për të parë më mirë lartësinë e kësaj ure, ose ndonjë makinë apo njeri, që mund të ishte duke ecur nën të. Kështu kishte bërë Mira edhe radhën e kaluar, para gjashtë muajsh, kur ishte kthyer në shtëpi me

leje të zakonshme. I pëlqente kjo urë, i pëlqente veçanërisht lartësia e saj, që i kujtonte konstruksionet e çatisë së çelikut, ku ajo kishte salduar bashkë me brigadën e saj gjatë vitit të fundit. Mendoi për një çast shokët që duhej të ishin atje lart, kaq lart sa kjo urë, dhe u tërhoq nga dritarja me një buzëqeshje të lehtë, që zëvendësoi ndjesën e dytë për shqetësimin që i kishte shkaktuar plakës së urtë, ulur pranë dritares.

Po me t'u ulur në vendin e vet...

...Në dhomën e përgjegjësit të sektorit, kësaj radhe ishte disi ngrohtë. Një tel i trashë skuqte rreth një tubi.

— Po, e di, — tha me zërin e tij të kumbueshëm përgjegjësi i sektorit. — Ja ku e kam shkruar emrin tënd!

Mira zgjati qafën dhe lexoi mbi një letër të bardhë: Ermira Goremi. Iu duk si çudi kur lexoi emrin e vet, të shkruar nga dora e madhe e përgjegjësit. Dhe s'dihet pse, për herë të parë mendoi se nuk e kishte të keq emrin.

Tha përgjegjësi:

— Në mos gaboj, është hera e tretë që vjen për të ma kujtuar!

— Po, — tha Mira. Ajo kishte folur me gjysmë zëri. Kjo kishte ndodhur, sepse midis shumë gjërave të pëlqyeshme që reflektonte fytyra e përgjegjësit, Mira kishte vënë re edhe diçka jo të mirë, diçka që ngjante me një pakënaqësi tepër të fshehtë, sa mezi vihej re, dhe që kishte zënë vend në cepin e shtrembëruar të buzëve të tij të trasha. Ajo gati ishte penduar për kërkesën e saj dhe ishte gati ta tërhiqte, por tha:

— Tre vjet mbusha, erdha për dy!

— E di, — tha përgjegjësi me fytyrë të çelur (por ajo pakënaqësia në cepin e buzëve nuk donte t'i zhdukej). — Në emër të komunistëve e të shokëve të sektorit unë të përgëzoj për tre vjetët që punove këtu e për punën e mirë që ke bërë!

Ajo ishte gati t'i thoshte: falemnderit, unë bëra detyrën, unë s'kam bërë asgjë të veçantë, por nuk tha as këto fjalë, as të tjera, nuk tha asgjë, sepse përgjegjësi që ngri-

tur në këmbë dhe, si të qe bërë pak nervoz nga madhësia e duarve të veta, i fshehu prapa gozhupit.

— Sa mirë, sikur t'i ishe përgjigjur edhe ti thirrjes sonë derisa të kishte nevojë fronti i punës! — tha ai befasi.

Mira deshi të fliste diçka (as ajo vetë nuk e dinte çfarë deshi të fliste) por atë çast ndjeu dorën e madhe të përgjegjësit, tek i shtrëngonte dorën e vogël, pastaj ai i zgjati një pusullë për shokët e administratës.

Ai e kishte liruar...

Plaka tha:

— Sa herë kaloj mbi këtë urë, unë dridhem dhe mbyll sytë!

Mira vuri buzën në gaz. Por kjo buzëqeshje s'kishte të bënte fare me plakën. Mira e kishte me përgjegjësin e sektorit, të cilit i kishte buzëqeshur pikërisht kur ajo po hidhte hapin e fundit përtej pragut të zyrës së tij. Por plaka, që e mori për vete atë buzëqeshje, që e mori si vazhdim ose si përgjigje të fjalëve të saj për urën dhe që kishte mbetur mjaft e kënaqur me sjelljen e çupkës së re, vuri dorën në gjurin e Mirës, si për të mbajtur ekuilibrin dhe tha:

— Po edhe kur i mbyll sytë, prapë më merren mendtë. Urë në majë të qiellit! Ç'është kjo?

3

Në brigadën e bojës Mira Goremi punonte me një burrë të thyer në moshë, por që nuk kishte dalë akoma në pension, sepse me përjashtim të dy djemve, njërin punëtor, tjetrin inxhinier, të dy në Metalurgjik, katër të tjerët i kishte në moshën shkollore. Ky burrë, që quhej Adem, Adem Dobulla, i kishte rënë alltyz (shprehje e tij) Shqipërisë, s'kishte lënë hidrocentral e vepër të madhe pa punuar (mekanik e saldator) derisa, më në fund, kur u lodh e mbu-

shi të gjashtëdhjetat, u kthye në Metalurgjik ku bënte dy punë menjëherë: e para, bojatiste konstrukcionet prej hekuri, e dyta, këndonte. Për Ademin pak kishte rëndësi nëse kordet apo penjëzat e zërit i kishte të lodhura dhe po aq pak kishte rëndësi edhe fakti tjetër, se, pothua, pa përjashtim, të gjitha akordet e këngëve të reja i këndonte si të ishin këngë popullore, për të cilat Ademi ishte mjeshtër, dhe, siç shpreheshin shokët për të, pus i pafund. Ai mund të bojatiste pa e ngritur kokën pesë orë me radhë dhe po aq mund të këndonte, pa e ndërprerë asnjëherë zinxhirin e këngëve popullore, por, po të domi, edhe të këngëve të reja. Ashtu siç ishte i gatshëm për të bërë çdo punë, ashtu këndonte çdo këngë e në çdo rrethanë, në hije e në diell, i lodhur ose jo, i ngrënë ose i pangrënë, punën e këngët ai nuk i ndërpriste, veçse kur e shkundnin shokët dhe i kujtonin se kishte ardhur koha për të pushuar a për të ngrënë drekë. Zakonisht, pasi këndonte nja pesë apo dhjetë këngë popullore, pasi u këndonte syve të shkruar, syve si filxhan, vetullave si gajtan, vetullave si hark e si qemer, balleve si mermer, buzëve si burbuqe, faqeve si shega, faqeve si molla, e një mijë faqeve të tjera dhe, pasi këndonte ndonjë ose pesë këngë të reja për vullnetarët e rinisë Përrenjas-Gur i Kug, pasi këndonte edhe një tjetër, edhe një të dytë e të tretë nga Festivali i Pesëmbëdhjetë i Këngës në Radio-Televizion, befas... një ditë ia hodhi me gojë të mbyllur një melodie të panjohur. Ai kishte vesh për muzikë, kishte belkanto, siç thoshte llogaritari, (që paskësh qenë dikur oficer dhe që i kishte ndodhur të drejtonte edhe kore gjatë karrierës së tij në ushtri) nuk stononte edhe në akordet më të vështira me djeze e me bemole, nuk stononte edhe kur hidhej nga një oktavë në tjetrën. Për këtë arsye, pikërisht sepse këndonte bukur, ndodhte shpesh që llogaritari ose të kalonte pranë qëllimisht, ose të qëndronte rastësisht për ta dëgjuar. Por, kur Ademi e tepronte me këngët popullore, llogaritari e kishte zakon t'i thoshte:

— Adem, idem!

— Ah, e kuptova! — thoshte Ademi dhe ja niste këngëve të reja. Por, një herë, kur Adem Dobulla zuri të kënd-

donte atë melodinë e panjohur me gojë të mbyllur, se fjalët nuk ia dinte, llogaritari, që merrte vesh nga muzika, u shqetësua, e humbi durimin (kjo ishte hera e parë që ai humbiste durimin me Ademin) u kthye përballë tij dhe thirri:

— Adem!

Melodia u ndërpre vetëm për një çast.

Thirri prapë:

— Adem!

Melodia me hundë, pa fjalë, me gojë të mbyllur u ndërpre përfundimisht. Përmbi turrën e llamarinave që bojatishin, u duk koka e madhe e Ademit si një kokë demi, që me vështrim demi shikoi llogaritarin e të gjithë të tjerët që u ndodhën aty, përfshirë edhe Mira Goremin, edhe dy shoqet e tjera të brigadës së bojës. Ademi thithi pipën. Një pipë të vjetër tërë gunga.

Tha:

— Shoku Baftjar, më thirre?

— Mos këndo! — tha ai, Baftjari, llogaritari.

— Pse, shoku Baftjar?

— Mos këndo!

— Partia ka thënë...

— Jo, kështu jo!

Por koka e Ademit si kokë demi me vështrim demi, as lëvizte nga turra e llamarinave, as donte të mposhtej.

— Adem! — tha ai, llogaritari, Baftjari.

— Fol, shoku Baftjar!

— Qetësi! — tha ai. — Ajo këngë s'është e përshtatshme

për ty!

— Unë këndo një mijë këngë!

— Ajo që po këndoje pa fjalë!

Pyeti Ademi:

— Pse?

— Ajo këndohet nëpër kafenerat e këqija të Evropës, ku nuk futet këmba e punëtorit, — tha ai.

Adem Dobulla thithi pipën e vjetër me gunga. Edhe tymi që doli nga goja e tij u duk i vjetër, me gunga.

— E-e-ej! — tha Ademi.

Baftjari, dmth llogaritari, duke vërtitur një laps mi-

dis gishtave, si të bënte trajning për xhongler (këtë ai e bënte në mënyrë të pandërgjegjshme) u kthye nga Mira.

— S'ka faj, — tha ai duke i treguar Adem. — Nuk e di ç'muzikë është ajo.

Fytyra e Ademit u skuq dhe flokët e bardhë iu dukën më të bardhë. U mbështet mbi fletën e lyer të llamarinës dhe u bë pis.

Tha:

— Këngë kafenesh, ë! — dhe ngriti supat më se i çuditur.

— Po, — tha llogaritari.

— A-a-ah!, Më kanë gënjer!

— Cilët?

— Rinia!

— Tanët këtu nuk i kam dëgjuar ta këndojnë këtë këngë!

Tha Ademi:

— Jo, nuk e kam fjalën për çunat e këtushëm!

— Për cilët? — pyeti ai.

— Për çunin e vogël në shtëpi, — tha Ademi.

— Atëherë i paske hesapet atje!

— Ia tregoj unë atij! — kërcënoi Ademi. — Këngët e kafeneve të Evropës, ë! — dhe koka e demit, bashkë me vështrimin e demit, u zhdukën prapa turrës së llamarinave që po lyente.

Të nesërmen dhe ditët e tjera Adem Dobulla nuk e këndoi më këngën e panjohur as me gojë të mbyllur as me gojë të hapur dhe, si për inat të saj, ai jo vetëm vazhdoi të këndonte repertorin e njohur të këngëve të tij të vjetra, popullore kryesisht, por e pasuroi atë me shumë këngë të reja, që Mira i dëgjonte për herë të parë. Po sado që Adem Dobulla ishte «pus pa fund», një ditë edhe repertori i tij u fiksua dhe mbeti i pandryshuar, me përjashtime të rralla e të parëndësishme. Po edhe puna ishte po ajo, e pandryshueshme ose gati e pandryshueshme. Çdo ditë nga mëngjesi në mbrëmje Mira Goremi, Adem Dobulla dhe dy gratë e tjera të brigadës së bojës lyenin krahët e vinç-urave, lyenin kolona, trarë e kapriata, të gjitha prej hekuri, si i thotë populli, dmth prej çeliku, lyenin kon-

struksione të ndryshme, fragmente konstruksionesh, llamarina të valëzuara e dhjetëra detaje të tjera, më e vogla nga të cilat mund të ishte tre metra dhe Mira e kuptonte destinacionin e tyre vetëm atëherë kur afrohej vinçi, lëshonte ganxhat mbi konstruksionin e rëndë ose fragmentin e rëndë të konstruksionit, që ata e kishin lyer me ditë të tëra, për ta ngritur në akset e ndryshme ose në katet e ndryshme të uzinës së çelikut. Atëherë Mira shikonte jo pa zili montatorët, që lëshoheshin mbi kurrizin e konstruksionit dhe niste atje sipër mbi kokën e saj një lojë apo një shfaqje e re dritash (saldatorët e saldatriçet) tingujsh (përçinuesit e çekanët) e dhjetëra zhurma e drita të tjera që shoqërojnë zakonisht e gjithmonë punën e brigadave të montatorëve. Mira shpesh e mbante kokën lart: ajo kishte thënë se puna e saldimit i pëlqente shumë. Këtë ia kishte thënë edhe përgjegjësit të sektorit.

Në brigadën e bojës Mira punoi gati tre muaj. Një ditë kaloi aty përgjegjësi i sektorit, e thirri Mirën e i tha:

— Ermira, dua të mbaj fjalën që të kam dhënë!

Mira heshti: ç'fjalë, pyeste vështrimi i saj.

Tha përgjegjësi me dyshim në sy:

— Apo të pëlqen të punosh në brigadën e bojës?

Tha Mira:

— Ah!

— Ç'farë ah!

— Ah! — tha Mira. — Më fal.

— Çfarë të fal?

— Që u turbullova!

— S'ka rëndësi!

Tha Mira me gishtin lart:

— Dua atje!

— S'ke ndryshuar mendim? — dhe me vështrim të shpejtë shqyrtoi trupin e saj të gjatë e të lidhur mirë. Po sado e gjatë që ishte Mira, përpara përgjegjësit të sektorit, gati dy metër e gati një kuintal, ajo dukej një vajzë e brishtë dhe e vogël.

Tha Mira:

— Nuk kam ndryshuar mendim!

— Po, — tha përgjegjësi. — Tha: — Nesër eja në zyrën

time.

Të nesërmen Mira u nda nga Adem Dobulla e nga dy gratë e tjera të brigadës së bojës (ajo ishte mësuar me ta, ata kishin qenë të gjithë të mirë dhe ajo u nda me lot në sy) pastaj u paraqit te brigadieri tjetër. U njoh me shoqet e me shokët e asaj brigade, shumica të rinj e më të rinj se të brigadës së bojës, gati moshatarë me të dhe u bë kë-shtu montatore në uzinën e çelikut, që ishte një uzinë plot dinjitet, me tërë atë pyll hekuri, e madhe sa një mal e që me arkitekturën e saj i kujtonte Mirës formën që i kishin dhënë botës së ardhshme disa shkrimtarë të romaneve fantastiko-shkencore, e që Mira i kishte lexuar me qejf e me kureshtje, sigurisht.

Ishte pranverë kur Mira u ngjit në lartësitë e çelikut dhe ishte verë kur Mirës i besuan saldimet e para, ndonë-se jo akoma në konstruksionet e rënda. Por kjo më vonë. Tashti Mira kishte realizuar ëndrrën e saj. U shkroi shoqeve në Korçë, u shkroi prindërve, por prindërit, sipas zakonit, e bombarduan me këshilla, e paralajmëruan se do të vinin vetë në Metalurgjik të bisedonin me përgjegjësin, se vajzës së tyre, që kishte larë shishe në një punishte, mund t'i merrej mendja nga lartësitë e mëdha, mund të rrëzohej e të vritej, e pse jo, mund t'i verboheshin edhe sytë nga shkëlqimi e nga shkëndijat e saldatriçes. Për t'i qetësuar sado pak, Mira u detyrua t'u shkruante një letër të dytë e një të tretë, bile u detyrua të bëhej edhe gënjeshtare, se ajo kot u kishte shkruar për lartësitë, se ajo vetëm një herë kishte salduar në një farë lartësie, se atë e kishin zbritur në tokë dhe ajo saldonte vetëm në tokë (për kolkën e mamit e të babit!) dhe përsa u përkiste syve, ajo u betohej dhe u premtonte se do të ishte shumë e kujdes-shme, se maska me syzet e zeza që i kishin dhënë asaj ishte e përsosur (!), ishte e vetnja maskë aq e përsosur në të gjithë Metalurgjikun.

Në kohën që u shkruante këtë letër, ose në kohën që u shkruante këto gënjeshtra apo gjysmë-gënjeshtra, puna e montatorëve shkonte gjithnjë duke u ngjitur në pikat më të larta të Uzinës së Çelikut dhe, nga këto lartësi të reja, Mira po mësohej ta shikonte botën në mënyrë të re. (Më vonë u mësuan edhe prindërit ta shiko-

nin punën e vajzës së tyre në mënyrë të re. Më vonë ata i mësuan të gjitha të vërtetat, por nuk e qortuan më, përkundrazi. Bile, më vonë akoma, ata i shkruanin Mirës të hapte sytë e të nderonte emrin e vet e të familjes, të mos bëhej ngaravece, të mos përtonte, të mos kursehej e të mos i trembej asgjëje. Por... këto do të ndodhnin më vonë!)

Dimri që i gjatë dhe i ftohtë dhe këtë e thoshte jo vetëm Mira, që e kishte dimrin e parë në një kantier, por të gjithë shokët, e gjithë bota, të gjithë thoshin se një dimër i atillë nuk mbahej mend prej vjetësh. Dhe aq më tepër në fushën e Bradasheshit, ku shpesh erërat fryjnë pa drejtim të caktuar ose ndryshojnë drejtim disa herë në ditë. Por as dimri nuk e pengonte Mirën ta shikonte botën nga lartësi të reja e në mënyrë të re. Ç'është e vërteta, ditët e para, kur frynte dhe era fishkëllente midis skeleteve të çeliktë dhe kur sqota i rrihte trupin, se fytyrën më të shumtën e kohës e kishte të mbuluar me maskën e syzeve, ose kur pluhuri që ngrihej nga poshtë e mbështillte si gjeratore e si turbinë, duke i vështirësuar frymëmarrjen, Mira mendonte të shkonte në zyrë të përgjegjësit dhe t'i ankohej për disa dhimbje të papërcaktuara në brinjë, ose t'i betohej se, me gjithë dëshirën që kishte të punonte në lartësi, shpesh i merrshin mendtë dhe ishte rrezik të rrezohet në tokë. Por, sa herë bëhej gati të shkonte te përgjegjësi, i prishej mendja, i vinte turp për trillimet e veta dhe kthehej prapë. Pak nga pak Mira u mësua me duart që i ngrinin, me veshët që duhej t'i fërkonte për t'i ngrohur, u mësua me pluhurin, me lodrat e numrat që i bënin shtëllungat e tij, kur i ngatërronin flokët, kur i mbushnin gojën me atë shijen e baltës së tharë që ka pluhuri e që në lartësi arrin tepër i hollë e tepër depërtues.

Por këto lëkundje ndodhën vetëm javët e para të dimrit. Pastaj ajo i harroi të gjitha: të ftohtët, pluhurin, lartësitë, erërat, që e rrezikonin në këto lartësi, të gjitha, të gjitha i harroi derisa një ditë u shkrua për Mirën në tabelën e emulacionit si për një saldatore të kujdesshme. Tashmi ajo kishte harruar, siç harrojnë të gjithë montatorët, se nuk ishte në tokë, kishte harruar se ishte në një lartësi, që po të binte poshtë... dhe cete, dhe bile vraponte ose

gati vraponte mbi traversat e mbi trarët prej çeliku, në mënyrë të përsosur, bile me një stil tepër të perfeksionuar, stil olimpik, bënin shaka shoqet e shokët për të. Elegancë gjatë kërcimeve në kryqëzimet e shtyllave, elegancë e guxim kur zbriste ose ngjiste pikat më të larta të çelikut për të bërë saldimet e fundit para se mbi kapriata e mbi lloj lloj trarësh dhe elesh të hidheshin llamarinat e valëzuara të çatisë.

Punonte kështu mbi dhjetë orë në ditë, punonte me orar të zgjatur. Nuk shtrihej në krevat para orës dhjetë të mbrëmjes dhe ngrihej nga krevati para orës pesë, që në dimër ishte akoma errët, akoma ftohtë e acar i natës. Ngrihej, vishej me rrobat e punës, që s'ishin më të reja, mbli-dhte bukë e sallam në letër (kur mendonte të mos shkonte në mensë) hante mëngjesin në restorantet e konvikteve dhe pastaj vraponte në qendër të qytetit, pranë sahatit të madh mbi kala. Aty ishte stacioni i autobusëve, aty kishte lëvizje, gjallëri, zhurmë dhe kjo jetë e zhurmshme do të vazhdonte gjithë ditën, gjithë pasditen e gjithë mbrëmjen, derisa të vinte ora dhjetë, derisa ajo të shtrihej përsëri në dyshek për t'u ngritur përsëri të nesërmen pa shkuar ora pesë.

Në pranverën e dytë, njëri nga djemtë e brigadës elektrike, që, paralel me punimet mekanike të brigadës së Mirës, bënte lidhjet elektrike në furrat ose diku rrotull tyre, e që quhej Shpëtim, që ishte tip i ekzaltuar e që Mira nuk e donte, pikërisht sepse ishte i ekzaltuar, thoshte për Mirën, se ajo përmbli-dhte në vetvete të gjitha gjërat e bukura që kishte krijuar toka. Vini re: Ekzaltimi! Sytë e saj, thoshte ai, i ngjanin detit, sy të thellë të pafund dhe... pas këtyre fjalëve, ky Shpëtim i kishte shfaqur dashurinë Mirës, i kishte propozuar të martoheshin, por Mira e kishte refuzuar. Shpëtimin ia kishte qejfi t'i mbante flokët pak të gjatë prapa qafës dhe i pëlqente t'i zgjaste basetat deri poshtë, afër cakut të fundit të veshëve, por nuk është e vërtetë se Mira e refuzoi Shpëtimin vetëm për flokët e gjatë. Edhe më vonë, kur Shpëtimi i shkurtoi flokët, Mira i tha:

— S'dua të të dashuroj!

Atëherë ai i shkurtoi basetat më tepër se sa duhej.

I tha prapë Mira:

— S'dua të të dashuroj!

— Po sikur...

— Nuk mund të të dashuroj!

— Unë mund t'i qeth fare flokët!

Mira qeshi.

— Mund t'u bie me brisk!

Mira u ngrys.

S'ishte puna te flokët, ose vetëm te flokët. Si tip i ekzaltuar, ai i kërkonte fjalët (toka, deti, thellësitë) ai ishte ceremonial. Kurse Mira mendonte se dashuria ishte një shfaqje më e thjeshtë, e mbushur me hollësira e detaje dhe ishin pikërisht këto hollësira e detaje, që krijojnë fizionominë e saj të vërtetë. Ja pse ajo nuk e donte Shpëtimin dhe këtë Shpëtim ajo nuk e dëshoi që në çastin e parë, kur ai i preu rrugën.

Para Shpëtimit edhe ndonjë tjetër kishte pasur dëshirë të njëjhej me të, edhe ndonjë tjetër ishte përpjekur t'i buzëqeshte ose të lidhte bisedë me te, por Mira i kishte prapsuar këto raste, ajo shpesh kishte kthyer kokën mënjane, bile e zemëruar, se në atë kohë Mirës nuk kishte filluar akoma t'i këndonte muza, mendja e saj fluturonte akoma drejt shtëpisë dhe gjente prehje ose ngopej në dashurinë me korrespondencë të prindërve (që ishin dy) në dashurinë e të vëllezërve (që ishin dy) e së motrës (që ishte një). Mirës filloi t'i këndonte muza pak më vonë, aty nga fundi i vitit të dytë apo nga fillimi i vitit të tretë pikërisht atëherë kur i vinte rrotull Shpëtimi, që ajo nuk e dëshoi kurrë.

Në këtë kohë, kur brigada e Mirës punonte në platformën rreth konvertitorëve (ku giza do të bëhej çelik) as ajo vetë nuk e di se si ra në dashuri me Agim Guraliun. Ky Agim i kishte flokët të verdhë e të butë si mëndafsh. Poshhtë kësaj kurore të verdhë, shkëlqenin sytë e tij kafe të ëmbël, pak të çelët, kafe të shkruar. Që në fjalët e para, Mira e kuptoi se ai ishte nga Korça, se ai njihje e dinte po ato gjëra që njihje e dinte edhe ajo. Nga e folura (me kolerit lokal) Mira kuptoi gjithashtu se edhe ai, si vetë Mira, qe larguar për herë të parë nga të afërmit e nga familja.

Në takimet e tjera, sigurisht, të Ishikur nga malli për qytetin e tyre, përmendën rrugët e rrugicat e Korçës, malet përreth, vendet klimaterike, vendet historike, monumentet, parqet, fushat, kooperativat ku kishin bërë punën vullnetare, pemët e këngët, tipat e ndryshëm, plakat e të rinjtë e shumë gjëra të tjera që u dukën sikur i afruan, sikur i lidhën me fije të padukshme, sikur i shkrinë e sikur i dashuruan. Në fillim ata kishin dëshirë t'i jepnin të kuptonin njëri-tjetrit se këtu, larg qytetit dhe familjes së tyre, se më këtë kantier, që ishte më i madh se një qytet, që ishte ose mund të ishte më i madh se Korça, ata nuk ishin vetëm, ata kishin njëri-tjetrin. Por ata u dashuruan ndoshta edhe sepse Agimi ishte djalë i urtë, nuk ishte llafazan si ndonjë tjetër, por ishte saldator i mirë dhe dinte ta mbante veten pastër, jo vetëm në mbrëmje, në bankat e shkollës (ata uleshin në një bankë) por edhe gjatë ditës në Kombinat e këdo ai mbahej pastër dhe nuk i zgjaste flokët si Shpëtimi, as gazetat. Sa herë që ndodhej pranë tij, Mirës i bëhej sikur djalit i mbante trupi erë të këndshme, erë sapuni të rrobave të lara dhe po këtë erë i mbante edhe goja dhe ajo e provoi këtë më vonë, kur ata u dashuruan. Mirës i kishte pëlqyer edhe mënyra si e kishte shtrënguar ai me krahët e tij të fuqishëm, edhe mënyra si e kishte puthur. Sigurisht ajo e kishte dashuruar Agimin edhe për erën e këndshme, megjithëse në fakt ajo nuk e dinte arsyen e vërtetë e të saktë të dashurisë që i kishte lindur për te. Por dinte se dashuria kishte filluar me një të shtrënguar e me një të puthur...

Mira ishte vajzë simpatike. Flokët e dendur i binin rëndë mbi supe, saldonte në lartësi dhe shikonte botën për qark me sytë e saj të mëdhenj, që dukeshin gjithnjë të habitur, sy të shkruar, të çiltër si të mëshqerrës. Por bukuria e Mirës s'ishte pa të meta, sidomos ajo s'para ra në sy muajt e parë, kur e pamësuar akoma me jetën e re, vrenjtej dhe padashur binte në mendime: atëherë tiparet e saj lëshoheshin, sikur rëndoheshin e vareshin poshtë e sikur humbisnin shumë nga forca tërheqëse e nga freskia e tyre rinore. Por, pas muajve të parë, Mira u kthye në natyrën e saj dhe, kur ajo qeshte ose kur buzëqeshte, ose kur

ishite në çastet e hoveve të punës e të jetës, tiparet sikur i mblihdeshin, sikur i freskoheshin, sikur i integroheshin në një harmoni më të plotë, duke krijuar kështu një tjetër Mirë, Mirën origjinale, Mirën simpatike. Po megjithatë jo kushdo që e shikonte Mirën, e vlerësonte menjëherë. Ajo s'ishite nga ato bukuri, as nga ato krijesa librash, të cilat dashurohen nga të gjithë të rinjtë e një qyteti, ose nga të gjithë oficerët apo ushtarët e një divizioni, të dislokuar në atë qytet ose në periferi të tij. Jo, Mira s'ishite nga ato! Ajo ishte thjesht një vajzë simpatike, që, me sytë e mëdhenj të mëshqerrës, e shikonte botën si e habitur. Ajo ishte tjetër tip, ajo të imponohej ngadalë, të imponohej me sjelljen, me dinjitetin e seriozitetin në shoqëri. Trupin, po, trupin e kishte të bukur Mira. Të gjatë, të bukur.

Pasi që mësuar me punën, me zhurmën dhe jetën e Kombinatit Metalurgjik, Mirës i ndodhi edhe diçka tjetër. Sa më shumë që ajo lidhej me kantierin e madh të çelikut, aq më shumë i rrallonte letrat me prindërit. Malli për qytetin e lindjes e për të afërmit e shtëpisë zuri t'i pakësohej e, t'i zbehej, t'i largohej me largësi reale: ajo ishte në Elbasan, ata ishin në Korçë.

Por pak më vonë, duke mbaruar viti i tretë, viti i afatit të qëndrimit në Metalurgji, ky raport, raporti i lidhjes së saj me kantierin e Metalurgjikut e me qytetin e vet, zuri të ndryshonte përsëri në favor të këtij të fundit. Largësia dhe marrëdhëniet reale ishin prishur ose po prishehin sërish. Mirën po e tërhiqte shtëpia.

Më vonë akoma ndodhi edhe diçka tjetër me Mirën: që nga dita që ajo u dashurua me Agim Guraliun, sidomos nga dita që ata u shtrënguan dhe u puthën (herë tjetër nuk kishin gjetur rast, ose nuk u ishte dhënë të shtrëngoreshin e të putheshin) dashurisë së tyre, përveç hoveve të para, sikur i munguan nxitjet e tjera, ajo (dashuria) sikur kishte ngecur në vend, sikur nuk po ecte. Kjo gjë e çuditë Mirën. Kjo ishte hera e parë që dashuronte dhe ajo nuk dinte si duhej të ishte e si duhej të vazhdonte dashuria. Kështu, me këtë dashuri, që s'ishite tamam dashuri, me këtë dashuri, që sikur kishte ngecur, ata qenë ndarë si të mpi-

rë, duke përshëndetur njëri-tjetrin me dorë, ai nga plat-forma e trenit, ajo nga dritarja e trenit...

Befas, ndërsa treni, me të cilin ajo kthehej në shtëpi, po i afrohej Prrenjasit, Mirës, që kishte zënë vend pranë dritares (plaka e urtë kishte zbritur në Qukës) iu shfaq një dëshirë e papërcaktuar, që herë ngjante me një mall të largët apo të afërt, herë me një keqardhje për gjithçka që kishte lënë prapa apo për gjithçka që e priste përpara. Mendimet dhe dëshirat e Mirës ishin tepër të turbullta dhe, për të zhdukur këtë gjendje, që i shkaktonte shqetësime, ajo e detyroi veten të përqëndrohej në peisazhin dimëror, që shtrihej e vraponte me shpejtësi përtej xhamave të trenit e paralel me trenin.

...Të ftohtët, pamja e zhveshur e natyrës, bardhësia e borës dhe skeletet e zes të kolonave të çelikut, fishkëllima e erërave mbi këto kolona e konstruksione e kishin emocionuar Mirën, sidomos në çastin e fundit, kur ajo po largohej nga Kombinati Metalurgjik. Shefi i llogarisë rrëshqiti nga këndi i godinës, si gjithmonë, me xhepat e me duart plot me letra. Ai kurrë nuk shikohej pa letra në xhepa e në duar. I buzëqeshi Mirës.

— Ç'më shikon me aq vëmendje? — pyeti ai.

— Ti po më shikon me vëmendje! — tha Mira.

Tha shefi i llogarisë:

— Pres të nxjerrësh një mikroskop e të studjosh porët e plakura të lëkurës sime!

— Po! — u kujtua Mira, — më duhet vërtetimi për prejen e marëdhënjeve financiare.

Shefi i llogarisë tundi shkresat që kishte në duar:

— Këtu e kam, sa t'i vë vulën!

Pyeti Mira:

— Nuk ia ke vënë vulën?

— Jo! — tha ai.

— S'është nevoja! — tha Mira në mëdyshje.

Shefi i llogarisë përzjeu letrat që mbante në duar, shikoi Mirën përtej vetullave të thinjura dhe tha:

— Moj vajzë, çfarë kërkon nga unë?!

— Asgjë!

— Përgjegjësi i sektorit më lajmëroi se ti po largohesh,

— tha shefi i llogarisë dhe Mira vuri re vetullat e tij të thijnjura, që nuk shprehnin as një çudi, as gëzim, as keqardhje, nuk shprehnin asgjë.

Tha Mira:

— Xha Idriz, mos u zemëro me mua!

— Jo, nuk zemërohem, — tha Idrizi, — po mos më ngatërro!

— Jo, nuk të ngatërroj!

— A do të ikësh?

— Jo... po...

— Po?

— Po!

— Idem, kështu thuaj!

...Mira dëgjoi një të qeshur të fortë. Qeshte njëri nga dy të rinjtë, që kishin hipur në Librazhd. Ajo shikoi përtej xhamave të trenit arat e mbuluara me borë, shikoi matet e bardha, që ngriheshin menjëherë pas arave apo pas kodrave. Dëgjoi prapë të qeshurën e atij të riut, që ishte ulur përballë saj.

Tha ai që qeshte:

— Dikensi, Fildingu e Smoletti shkruanin se nënat viktoriane përpiqeshin t'i gjenin burrë vajzës gjatë sezonit të pushimeve në Bate ose në Tanbrixh Uells!

Tha tjetri:

— A do të ta them mendimin tim?

— Po, — tha ai që qeshte e që ishte ulur përballë Mirës.

— Me tri fjalë!

— Me sa të duash!

— Ti je konservator!

Ai që qeshte e që ishte ulur përballë Mirës, pyeti:

— Çfarë i duhet njeriut më shumë, zgjuarsia, temperamentit apo karakterit?

Tha tjetri:

— Nuk jap provim para teje!

— Atëherë hesht!

— Por motrën mos e marto me ndërmjetës!

— Sa të kthehem në shtëpi!

— Je plakur në shpirt e në mendime!

— Dhe si e martuar rishtas, as e çoj në aksion!

Tha Mira:

— Kjo ndodh!

Dy të rinjtë ndërprejnë bisedën dhe hodhën vështrime pyetëse nga Mira.

Nga vështrimet e tyre, Mira kuptoi se kishte folur me zë, ktheu kokën nga xhami dhe shikoi peisazhin dimëror, që shtrihej e vraponte bashkë me trenin: bardhësia e borës, skeletet e zeza (po ato skelete) dhe fishkëllima e erërave rrotull korpusit të çelikut.

Përtej derës së përgjegjësit të sektorit, Mira dëgjoji zërin e tij të fortë:

— U bëre nervoz?... S'të pëlqen kjo që po të them unë, s'të pëlqejnë këto që po shikon në Kombinat?

Pyeti tjetri:

— Pse të bëhem nervoz e pse të mos më pëlqejnë këto që shikoj këtu?

— Sepse janë gjëra të reja, — tha përgjegjësi në rolin e akuzuesit.

— E çuditshme! — tha ai që kundërshtonte. — Sipas teje, meqë kjo që po ndodh këtu është diçka e re, unë duhet të jem patjetër kundër?

— Jo, sigurisht, jo patjetër, por për moshën tënde, kjo që them unë s'është për t'u çuditur. Vetëm fëmijëve u pëlqejnë menjëherë gjërat e reja. Çdo e re atyre u jep kënaqësi. Disa të rritur, sidomos disa të moshuar si ti, ndodh që të mos e pranojnë menjëherë gjënë e re.

— Do që të flasim hapur?

— Po!

— Ti ke të drejtë. Diçka e kuptoj, diçka e kuptoj vetëm përgjysmë ose nuk e kuptoj fare!

— Për shembull?

— Për ato që biseduam, për vërshimin e grave e të vajzave në kantieret e ndërtimit e të montimit. Më duket se...

— Bjeri shkurt, vajzën nuk ta jap! — tha prerë përgjegjësi i sektorit. — Ajo s'ka mbushur as javën që ka ardhur!

— Unë jam babai!

— E ke biseduar me vajzën?

— Jo!

— Bisedoje!

— Kurrë!

— Atëherë as ne nuk ta japim, as vajza nuk do! — Përgjegjësi shikoi nga dera, ku priste Mira: — Po ajo a s'është e re si vajza jote?

Përtej derës Mira qëndronte në këmbë, e mbledhur me gozhupin e ri që sapo ia kishin dhënë dhe priste brigadierin ta furnizonte me bojë. Era fishkëllente përmes skelletit gjysmë të mbuluar të çelikut, ajo fishkëllente edhe poshtë, ku një tufë letrash zvarriteshin nëpër këmbët e saj. Binte borë dhe kudo bardhësia të vriste sytë. Por mbi të gjitha frynte erë...

— Kushedi ç'erë fryn jashtë! — tha njëri nga dy të rinjtë. — I shikon pemët si tunden?

— Çfarë pemësh? — pyeti Mira pa zë.

Ajo ishte gati t'u thoshte të rinjve se në Metalurgjik s'kishte asnjë pemë, ato i kishin prerë disa vjet më parë dhe vendin e tyre e kishin zënë korpuset prej çeliku, por, megjithëse u kthye nga ata, nuk u tha gjë, sepse në çastin e fundit kishte ardhur në vete. Mira kishte dëgjuar për mirazhet në shkretëtirën e Saharasë e në shkretëtira të tjera, por nuk i kishte shkuar kurrë në mendje dhe as që e kishte dëgjuar e lexuar gjëkund se këto mirazhe mund të shfaqeshin edhe aty në tren, përtej dritares dhe se tërë ai Metalurgjik mund të ecte bashkë me trenin e paralel me trenin.

Në Përrenjas, Mira zbriti nga treni, hipi në autobus, shikoi natyrën nga maja e Qafës së Thanës, u mahnit me bukurinë e liqenit në kohën e ngricave të dimrit dhe, padashur, tashti që ndodhej më afër shtëpisë dhe më larg Metalurgjikut, ajo klithi prapë me vete: Prindërit e mi... Prindërit e mi të dashur!... Prindërit e mi të mirë!... Vëllezërit e mi të dashur!... Vëllezërit e mi të mirë!... Motra ime!... Motra ime e dashur... Motra ime e mirë!...

Gëzimi e dashuria për ata dhe për gjithçka tjetër arritën pikën më të lartë kur ajo zbriti nga autobusi në qendër të qytetit. Ndoshta s'kishte bërë keq që nuk qën-

droi në brigadë edhe një vit... Pastaj edhe një tjetër... Dhe vitet s'kishin të mbaruar... Tashti, që ndodhej në qendër të qytetit të lindjes, ku ajo njihte çdo gjë, ku njihte hi- jet e dritat (autobusi kishte arritur natën) trotualet, gurët, muret e çatitë e deri ajrin (mushkëritë e saj e njihnin ajrin e qytetit të lindjes) tashti Mirës i qe zhdukur lëkundja apo dyshimi më i vogël, që e kishte munduar gjatë rrugës me tren e me autobus, që i kishte shkaktuar atë gjendje të kapërthyer gëzimi e trishtimi bashkë, që e kishte detyruar në mëngjes të dilte nga dhoma e përgjegjësit të sektorit e përlotur, që pastaj kishte qarë e kishte qeshur bashkë.

Tashti kishin kaluar të gjitha. Të gjitha kishin mbe- tur prapa dhe ajo ishte kthyer në shtëpinë e vet (pas një viti do të kthehej edhe Agimi) dhe ishte kthyer papritur. Ajo nuk i kishte lajmëruar prindërit. Ajo kishte dashur të kthehej papritur dhe ashtu kishte bërë.

Binte borë dhe era të priste si brisk. Rrugës takoi pak njerëz, që ecnin gati të thyer më dysh për të përballuar erën. Edhe Mira u kërrus si të tjerët, u kërrus akoma, ndër- **sa bora godiste shtyllat, rrethonte dritat e neonëve, për- plasej pas mureve, pas dritareve e pas xhamave, që hidh- nin shkëlqime të përthyerë nëpër rrugët e ngrira.**

E dinte Mira, ajo e kishte ditur që më parë, ajo kishte besim të patundur në parandjenjën e saj, se qyteti i lind- jes do ta priste me borë e me erë.

Dhe ashtu e priti.

4

Valixhja ishte e rëndë, Mira ishte lodhur dhe ashtu e lodhur arriti në shtëpi, pa qëndruar gjëkund.

Lëvizti me gisht nga jashtë llozin e portës, mënyrë që

c dinin vetëm të shtëpisë dhe u fut brenda. Me të parë oborrin, me të parë ato kënde të njohura të oborrit e të shtëpisë, Mira Goremit diçka i ndodhi (gjithmonë në atë mënyrën e saj si të papritur). Por se çfarë i ndodhi, as ajo vetë nuk e dinte akoma. Oborri iu duk shumë i vogël Mirës, po ashtu edhe silueta e zezë e shtëpisë (sigurisht të gjitha këto në krahasim me uzinën e çelikut, me të cilën qenë mësuar sytë e saj gjatë tre vjetëve të fundit.) Vetëm kaq mund të thoshte hëpërhë: i vogël oborri, e vogël silueta e shtëpisë. Për një çast iu bë sikur iu prenë këmbët, sikur do t'i merrej fryma, sikur s'do të mund të jetonte aty. E megjithatë, në të njëjtën kohë, ajo ishte edhe e kënaqur që ndodhej në shtëpi. Sidomos kur hipi në verandë dhe pa tryezën, rreth së cilës ata rrinin verës deri në orët e vona të mbrëmjeve. Kurse uzina e çelikut, konturet e uzinave të tjera të ndërtuara, apo korpuset e panumërta të objekteve të ndryshme në ndërtim e sipër, herë i afroheshin me madhësitë e tyre reale, herë i largoheshin atje ku ishin, në Elbasan, dhe i shfaqeshin fare të vogla, aq sa i gjithë Kombinati Metalurgjik i shëmbëllente me një maket, që mund të vendosej në një kënd të verandës. Përshtypje të tilla, mendoj ajo, mund t'i ndodhnin njeriut vetëm në ëndërr, ose në ekranin e kinemasë, kur operatori afron dhe largon objektet, për të treguar, sipas rastit, luhatjet, pavendosmërinë, disekuilibrin dhe vuajtjet e tjera shpirtërore të personazheve.

Ashtu ishte. Shtëpi e vogël, por e dashur. E vogël, por e ngrohtë. E megjithatë, në një kënd të trurit të saj e të ndërgjegjjes së saj, Mira do të dëshironte të ndodhej në të njëjtën kohë edhe në shtëpi edhe në Metalurgjik.

Me të arritur te dritarja, vuri valixhen pranë këmbëve, gjeti një të çarë midis perdeve dhe përgjoi. Dy vëllezërit ishin kërrusur mbi tryezë dhe bënë mësime. Por nuk harronin të ngacmoheshin herë pas here: i vogli i tërhiqte të madhit vizoren, që ishte një trekëndësh plastik me ngjyrë të kuqe të fortë. I madhi e kërcënonte.

— Mama, Artani!

— Tankë! — thirri mamaja në adresë të të voglit.

Mira i dëgjonte vetëm zërin mamasë. Ajo duhej të ishte diku në këndin e dhomës ku ndodhej bufeja.

— Nini s'më jep vizoren! — tha i vogli.

— Ninkë! — thirri mamaja, — s'është koha!

— Ai e do vetëm pse është e kuqe! — tha Nini.

Heshtje.

— Vizoret duhen blerë vetëm të verdha! — tha Nini.

Mira u mallëngjye. Po ato skena si dikur, po ai zë i mamasë, zë i shurdhër, pak i ngjirur, tepër i shurdhër, por i dashur.

Mira hodhi sytë në këndin tjetër, ku dëgjohej zhurma e ujit e ku ishte lavapjati. Atje pa motrën (Motra ime e dashur!) pesë vjet më e vogël se ajo. Dukej sapo kishin ngrënë darkë. U përpoq të shikonte edhe mamanë, por i dëgjoi sërish vetëm zërin:

— Ditkë, ngadalë moj korbë, se mos i thyen!

Por Ditka nuk e ngadalësoi lëvizjen e duarve. Bile aq shpejt i lëvizte, aq shpejt i rrotullonte gotat, sa dukej sikur stërvitej për të mësuar një pantomimë, që do t'i duhej kushedi se kur. Ato duar, Mira i krahasoi me ciflat e borës, që, të ndriçuara aty-këtu nga drita e dhomës, vërtiteshin e spërdridheshin nëpër oborr me një pantomimë të çakërgjosur.

Mira u mallëngjye prapë. Mbi frigorifer ajo pa fotografinë e vet në kornizë. Atë fotografi Mira e kishte bërë në Metalurgjik ditën që i dhanë syzet dhe pincën e saldatrives. Ajo qeshte (në fotografi) dhe qeshte aq shumë, sa mund të thuash se i dukeshin të tridhjetë e dy dhëmbët, që i kishte të ngjeshur e tepër të bardhë.

I ati, sigurisht, rrinte mbështetur në divan. Ja cepi i divanit, ja çorapët ngjyrë blu. Ajo e merrte me mend se ai pinte duhan, shikonte tavanin dhe kushedi çfarë mendonte. Pas buke i ati gjithmonë pinte duhan dhe binte në mendime.

Pastaj në të çarën e perdes u duk e ëma. Mira e donte mamanë, jo vetëm se ishte e dashur, e gëzuar dhe e gojës (për aftësitë e saj për t'u marrë vesh me botën e jashtme, lexuesi ynë ka prova të mjaftueshme, nëse i kujtohet biseda me përgjegjësin e sektorit!) por ajo e ki-

shte dashur gjithmonë mamanë edhe për diçka tjetër. Mamaja dinte të vishej pastër për vete dhe dinte të mbante pastër edhe të tjerët, babanë, dy vëllezërit, Mirën, motrën e Mirës. Shtëpia e tyre ishte gjithashtu e pastër, gjithashtu në rregull në çdo kohë e në çdo orë të ditës e të natës dhe ishte një shtëpi e gëzueshme, plot me lule, emrat e të cilave i dinte vetëm mamaja. Qilimat, sidomos qilimat ishin gjëja më e bukur e më e mirëmbajtur e shtëpisë. Edhe në punë mamaja shquhej, ajo kishte marrë disa fletë-nderi. Jo më kot ishte mësuese e ekonomisë shtëpiake se edhe gjellët i bënte të shijshme. Për këte të fundit, për gjellët e shijshme, babai e donte shumë mamanë, më shumë se për të gjitha meritat e tjera të marra së bashku. Ai, si specialist në një punishte ku regjeshin perime nëpër fuçira të mëdha, për analogji ishte edhe vetë i madh nga trupi, por megjithatë, babai i Mirës karakterizohej nga dy gjëra të kundërta: i madh e i fortë fizikisht, por i tutshëm dhe i qetë, ndërsa dihej botërisht se në shtëpinë e Goremëve mbretëronte gruaja. Ishin martuar me dashuri dhe Mira e merrte me mend trajektoren e mëtejshme të jetës së tyre: gjithmonë të afërt, të dashur dhe intimë me njëri-tjetrin, derisa një ditë do të plakeshin e një ditë tjetër do të vdisnin.

Sikur e qortoi veten për këto mendime e për këto përshlypje tek i ngjallnin gëzim e mërzi të qe ishte larguar nga Metalurgjiku. Por duke shikuar përtej perdes këta njerëz të njohur, këta njerëz, midis të cilëve ajo ishte rritur, Mira mezi po përmbahej që t'u thërriste një nga një në emër, të lëshohej në dhomë, t'i përqafohte e t'u thoshte se e kishte marrë malli për ta dhe se kishte ardhur për të jetuar përgjithmonë me ta. Por nuk thirri. As nuk shkoi. Shtrëngoi buzët dhe mbajti këmbët. Dhe ky s'qe veçse një çast, se në çastin tjetër ajo kishte dëshirë të qante, dhe, pasi të kishte qarë, të kthehej prapë, të ikte, të flinte një natë te një shoqe dhe të nesërmen të paraqitej në Metalurgjik. E ndjeu se nuk ishte më ajo e dikurshme, se ajo kishte ndryshuar shumë, se nuk mund të jetonte më aq ngushtë, ajo donte hapësira, donte diell dhe ajër, ajo donte kantiere të mëdha, donte maskën e pincën, ajo

ishte montatore dhe si e tillë ajo donte edhe lëvizjen, edhe ndryshimin. I kujtohej Mirës kur filloi punën në Uzinën e Çelikut, se brigada kishte një barakë të vogël, ku punëtorët zhvisheshin e visheshin çdo ditë e ku mbaheshin mjetet e punës, teneqera me bojë, kavo të ndryshme, karrele e llamba, maska e elektroda, litarë e çizme etj. etj. Por më vonë Mira vuri re se kjo barakë qe shkullur e qe mbërthyer disa herë në vit diku gjetkë, në pika të ndryshme, sepse me përparimin e punimeve, ajo herë binte viktimë e rrjetit inxhinierik, herë e ndërtimeve të mëdha e të vogla. Aty ku kishte qenë ajo, fillonte, bie fjala të hapej një kanal tubacionesh, apo fillonte ndërtimi i një nënstacioni, apo themelet e një kesoni, apo fundja një VC nga më të zakonshmet për uzinën e ardhshme. Kjo e fundit kishte shkaktuar edhe të qeshura për barakën e xha Llazit, që hidhej e pritej si top futbollit edhe nga një VC. E ku ta dish, mendonte Mira, po të mos kishte qenë tre vjet në Metalurgjik, po të mos i qe bërë zakon lëvizja e sendeve apo e objekteve (baraka ishte një e njëqindta që ajo kishte parë të lëviznin) ndoshta nuk do t'i kishin ngjallur mërzitje sendet e shtëpisë, as vetë shtëpia. Por ja që, tashmë ajo kishte punuar tri vjet në Metalurgjik dhe të gjitha këto ç'ishin: pasqyra, stufa e bufera. lavapjata, tryeza e nime, të fiksuara përjetë aty ku kishin qenë, sepse i ngjallnin Mira Goremit një ndjenjë mërzitjeje apo diçka të përafërt me të.

Tha Mira:

— Prindërit e mi... Vëllezërit e mi... Motra ime e dashur!...

Ngriti valixhen, zbriti nga veranda dhe aty në shkallën e fundit i doli para syve një pakënaqësi e fshehtë, e grumbulluar në ca buzë të trasha, dhe po aty iu bë sikur dëgjoi një zë të fortë... *T'i ishte përgjigjur thirrjes sonë, derisa të kishte nevojë fronti i punës.* Me të dëgjuar këtë zë, i tërë lëmshi i ndërlikuar i asaj dite, të gjitha ato dyzime, që e kishin munduar nga çasti kur kaloi pragun e zyrës së përgjegjësit e deri në pragun e shtëpisë së vet, sikur u tretën si vesa para diellit. Aty ajo kuptoi se kryesorja kishte qenë dhe ishte ajo thirrje për

të mos u larguar nga brigada, kurse të gjitha të tjerat, që shpreheshin në përfytyrimet e saj për ngushticën e shtëpisë, për zakonet e reja që ajo kishte përfutuar në Metalurgjik e që nuk mund të gjenin menjëherë pasqyrim në ambientin e njohur të njerëzve e të sendeve po aq të njohura, — të gjitha këto s'ishin veçse pasoja të asaj pakënaqësie, që kishte zënë vend në cepat e atyre buzëve e në timbrin e atij zëri, që kishte thënë... Thirrja, pastaj të tjerat... Mira ndjeu t'i përloleshin sytë, ndjeu dhimbje në zemër, ndjeu dashuri të madhe për të gjithë ata që po linte prapa dhe kur ishte në oborr, buzët iu shtrembëruan nga gulshet e përmbajtura të gjoksit. Pastaj ajo eci drejt portës, pastaj u hutua, i ra valixhja nga duart, bëri zhurmë, u pengua mbi valixhe dhe befasi dëgjoi:

— Mira, ti jë?

Tha Mira:

— Unë!

— Ma ndolli zemra. Me të dëgjuar zhurmën, thashë me vete, Mira, ajo do të jetë, Mira, thashë, ajo e ka zakon të vijë papritur, si atëherë, të kujtohet?

Motrat u përçafuan. Drita e verandës u ndez. Kur motra e vogël pa lotët e motrës së madhe, atëherë u përlot edhe ajo. Me përjashtim të të atit, që ishte burrë (!), të gjithë u përlotën, e ëma, dy vëllezërit. Mira ishte kthyer në shtëpi.

5

Të nesërmen në mëngjes, kur hapi sytë, Mira Goremi shikonte tavanin e dhomës së gjumit dhe aty për aty u bind njëherë e përgjithmonë se ajo nuk po provonte atë gëzim që kishte pandehur e që kishte përfytyruar, kur do

të hapte sytë mëngjesin e parë në shtëpi. Ndoshta kjo ndodhte, sepse udhëtimi i djeshëm dhe dyzimet e djeshme, që e kishin tronditur gjatë rrugës në tren e në autobus, e lodhën Mirën dhe këtë lodhje ajo e ndiente më tepër sot. Ndoshta kjo ndodhte edhe sepse ishte vetëm: prindërit, vëllezërit e motra kishin shkuar në punë e në shkollë. Po, ndoshta edhe sepse dhoma e gjumit ishte akoma e ftohtë. E gjithë shtëpia ishte e ftohtë. Stufa sapo ishte nderur. E kishte nderur mamaja para se të ikte.

Ashtu siç ishte shtrirë në krevat, Mira hodhi sytë në tavan dhe u çudit që ai iu duk shumë më i ulët nga sa i që dukur më parë. Pastaj ajo shikoi përtej dritares. Kudo borë, kudo bardhësi, kudo... skelete të zeza prej çeliku, që fishkëllenin nga erërat, të cilat bridhnin lirisht nëpër kantierin e madh. Mira fërkonte duart, u frynte gishtave dhe mezi mbante furçën e bojës në dorë. Ajo pa t'i afrohej xha Llazi e t'i thoshte me zërin e butë:

— Mira, mos nuk dëshiron të bëhesh saldatore?

Xha Llazi, që ishte Hero i Punës Socialiste e që kur dëshironte të të shpjegonte një punë, ose kur dëshironte të të ndërronte vendin e punës, apo të të ngarkonte me një detyrë më të vështirë, apo thjesht të të mësonte diçka të re, e kishte zakon të mos ta thoshte drejtpërdrejt, por tërthor dhe ta thoshte kështu:

— Mira, mos nuk dëshiron të bëhesh saldatore?

— Jo, pse, xha Llazi? — foli e hutuar Mira.

Ajo e shikoi në sy xha Llazin, si për të kuptuar nga ata sy çfarë do t'i thoshte ai më tej, por e penguan vetullat e tij të thinjura, që i binin poshtë dhe ata u shikuan një copë herë, siç mund të shikohen dy vetë përmes kangjellave të ngarkuara me borë.

— Jo, thashë, — tha xha Llazi, — ndoshta s'të pëlqen...

— Unë shishe kam larë në një punishte pranë shtëpisë dhe këtu...

— Jo, thashë, — tha xha Llazi, — ndoshta nuk ke dëshirë të bëhesh saldatore.

...Mira hodhi përsëri vështrimin përtej dritares. Ku-

do borë. Kudo bardhësi. Po duke shikuar e duke hetuar këndet e oborrit të njohur të shtëpisë mbuluar nën këtë bardhësi, Mirës iu kujtua edhe diçka tjetër: mbrëmë, ndërsa shikonte fytyrën e mamasë, ajo i qe dukur më e bardhë se zakonisht. Kështu edhe fytyra e së motrës i qe dukur po aq e bardhë sa e mamasë, fytyra të rritura më shumë në hije se në diell. Edhe fytyrat e të vëllezërve, të njëjta, të bardha, idem. Idem, i erdhi në mendje shprehja e llogaritarit të montimit të çelikut. Idem. Atëherë Mira u kujtua se edhe në tren, edhe në autobus njerëzit i qenë dukur të bardhë, idem me të shtëpisë e jo si fytyrat e punëtorëve, midis të cilëve ajo kishte punuar tri vjet. Kur u u kujtua se asaj i qe bërë zakon që çdo gjë ta krahasonte me jetën e Kombinatit, atëherë u bind se edhe fytyrat e të afërmeve të saj s'ishin aq të bardha, ato ishin të zakonshme, por vetëm Mirës i qenë dukur si të tilla, sepse Mira duhej të kishte pësuar ndryshime, sepse ajo ishte mësuar tashmë me tjetër shije, ajo ishte mësuar me fytyrat e argasura nga dielli e nga era të ndërtuesve e montatorëve të kantierit të madh. (Një gjë e tillë i kishte ndodhur njëherë e një vit Mirës në plazh me ata që ishin nxirë e me ata që vinin rishtas). Pasi u bind se shijet e saj kishin pësuar ndryshime, ajo fërkoj sytë si për t'u çpërgjumur e si për të larguar përfytyrimet dhe u ngrit me një kërcim të shpejtë. Kështu ngriheshin çdo mëngjes ajo dhe shoqet në konviktet e Kombinatit Metalurgjik, me një kërcim të shpejtë! Po, kur u ngrit, befas ndjeu një si krisje në gjoks. Pak më vonë kjo krisje iu kthye në një kujtim nga një ngjarje që kishte ndodhur në brigadën e saj e që kishte të bënte me komunistin e vetëm të brigadës. Ky komunist ishte mjaft i shoqërueshëm dhe punëtor i palodhur, që me punën e tij kishte luajtur gjithmonë rol të madh për mbarëvajtjen e brigadës. Sidomos ishte njeri i drejtë dhe ai kishte ditur t'i ngrinte njerëzit mbi mbeturinat mikroborgjeze, mbi shpirtin e vogël individualist, siç e quanin punëtorët atje, kur ndonjë shok i tyre tërhiqej më shumë nga interesat e veta të ngushta. Komunisti kishte luftuar dhe ia kishte arritur gjithmonë qëllimit për t'u shtyrë

afatin e qëndrimit në kantier të gjithë atyre, për të cilët kantieri kishte nevojë. Por, kur erdhi koha të largohej vetë e kur shokët i bënë thirrje të shtynte afatin, ky komunist nxorri një mijë arsye e shkaqe, që vetëm e vetëm të largohej. Jo gruaja e kishte punën larg, jo tre fëmijët, njëri më i vogël se tjetri, jo nëna plakë, që kishte zënë këndin etj. etj., derisa arriti të merrte shkëputjen. Por ç'ndodhi në të vërtetë me komunistin? Mira nuk i dinte hollësitë se çfarë kishte ndodhur me komunistin, por dinte dhe kishte dëgjuar se komunisti, që s'kishte fjetur gjithë natën, në mëngjes herët kishte zënë shkallët e Komitetit të Partisë, kishte pritur sekretarin, i kishte dhënë fletëlidhjen, ishte kthyer menjëherë në brigadë, u kishte kërkuar falje shokëve, kishte bërë autokritikë (kthimin e tij dhe autokritikën e tij Mira i kishte parë e dëgjuar vetë) dhe tashti, ndërsa ajo kishte kërcyer në këmbë me atë të krisur që sikur e kishte ndarë më dysh Mira Goremin, komunisti punonte akoma në Kombinatin, në një brigadë tjetër e në një sektor tjetër nga më të vështirët...

6

Mira Goremi priti dy javë sa të gjente punë. Por gjatë këtyre dy javëve ajo sikur u dembelos, sikur i ikën të gjitha dëshirat, sikur nuk i përmblihte mendimet. Jetonte në një gjendje të lëshuar fizike, por edhe shpirtërore. Kishte të ftohtë gjithë ditën dhe gjithë natën. Edhe kur gjeti punë, jo më në punishte për të larë shishe, por teknike pranë Ndërmarrjes së Ndërtimeve, kjo gjendje e lëshuar fizike e shpirtërore nuk iu largua, ajo nuk po e merrte veten, ajo po dembelosej shumë e më shumë. Sidomos mëngjeset ishin pika më e dobët, sidomos ato çar-

stet kur duhej të ngrihej nga krevati ishin të padurueshme. Kishte dëshirë të flinte. Kishte dëshirë të rrinte shtrirë. Edhe kur i dilte gjumi, kishte dëshirë të shikonte tavanin e të merrej me një mendim, por edhe mendimet i mungonin. Atëherë ajo prapë mbyllte sytë, dhe, pa e kuptuar as vetë, binte sërish në një si dremitje apo në një si liturgji. Shkurt: nuk i ngrihej, nuk i pëlqente të mërduhte, nuk e tërhiqte as puna, as zyra nuk e tërhiqte, nuk i pëlqenin as ato tabela më shumë të gjëra se të gjata, dy metra të gjëra, një metër të gjata: materialet, nomenklatura, realizimet, kostoja, hyrjet e daljet dhe të gjitha këto llogari dhe e gjithë kjo mënyrë pune sikur ia shtypte gjymtyrët e qelizat, sikur ia vriste indet e trupit të ri. Mira ishte vazhdimisht e lodhur, vazhdimisht si e mpirë dhe kjo gjendje sikur i shpejtonte plakjen e trupit e të shpirtit, të paktën kështu mendonte ajo, ashtu sikurse mendonte se me këtë punë do të ishte mirë të angazhohej jo sot, por pas tridhjetë vjetësh. Dhe mendimi i fundit i dukej Mirës më i drejti, më i shëndoshi, më i preri e më i përcaktuari dhe ndoshta i vetmi mendim që kishte mundur të formulonte ajo që nga dita e kthimit në shtëpi. Tashti trupi i saj i ri e gjithçka tjetër e kapshme dhe e pakapshme në trupin e saj, kërkonte lëvizje, kërkonte tjetër gjallëri, tjetër hapësirë e tjetër ngrohtësi. Po ku t'i gjepte të gjitha këto?

Edhe në shtëpi Mira nuk kthehej me qejf. Ishte bërë e ftohtë dhe flegmatike ndaj çdo gjëje, edhe ndaj të afërmeve. Vetëm motra e vogël, Drita, e priste me gëzim, por edhe në thirrjen e në fjalët e saj kishte diçka jo të natyrshme.

Ajo thoshte:

— U kthye Mira! — Përplaste duart: — U kthye Ermira nga puna!

— Pse më thua Ermira! — kundërshtonte dhe kërkonte shpjegim Mira, megjithëse e kuptonte se kjo thirrje spontane e motrës së vogël dëshmonte për largësi spontane e për ftohtësi spontane.

E ëma, që kishte nuhatur diçka në qëndrimin e Mirës, që ndiqte me vëmendje lëvizjet e gjendjen e saj, që e

shikonte në sytë e trishtuar, bisedoi me të shoqin dhe që të dy menduan se kjo gjendje e lodhur i vinte Mirës ndoshta ngaqë kishte ardhur koha për t'u martuar. Dhe vendosën ta martonin. Zunë t'i kujtonin Mirës emra djemsh, emra familjesh, zunë t'i piketonin ca shtëpira dykateshe, ndonjë vilë rrethuar me kangjella, ca apartamente në katën e tretë apo në katin e gjashtë me ngrohje qëndrore etj. etj. I kujtuan ca Kiçëra e ca Koçëra, ca Gaqëra, ca Tilëra e ca Agronëra, ca Janëra e Alfredëra etj. etj., që Mira edhe i njihnte, edhe jo, por që këto shtëpira me oborre e me porta hekuri, këto emra e këta djem, ndonëse të lëvduar e njerëz të punës, nuk i zgjonin Mirës asnjë interes. Ajo nuk mund t'u thoshte atyre (prindërve) se diçka ishte thyer në shpirtin e saj, se ajo kishte të ftohtë dhe një të keqe që nuk e shpjegonte dot.

Një javë pasi Mira kishte dhënë provimet e maturës të Teknikumit të Ndërtimit pa shikëputje nga puna, ajo mori një letër nga shoqet e shokët dhe një tjetër nga Agimi. Përmes rreshtave të atyre letrave ajo shikonte qytetin e hekurt të mbushur me jetë, me gjallëri e me ngrohtësi, ashtu siç e njihnte ajo dhe siç ishin mësuar ta shikonin sytë e saj. I lexoi përsëri nga rreshti i parë deri tek i fundit. Lexoi dy herë edhe datat në fund. Lexoi edhe titujt. «Shoqja jonë, Mira!» (shoqet dhe shokët). Thjesht: «Mira» (Agimi!) Nga të dyja këto letra ajo u kënaq dhe jetoi çaste Metalurgjiku, çaste që i kishte jetuar dikur, të përsëritura, po megjithatë të këndshme.

Nga letra e Agimit ajo nxori një përfundim, thelbi i të cilit s'kishte të bënte fare me të papriturat e me befasishtë, por që ishte mbrujtur dalngadalë, që nga dita e largimit të saj nga Kombinati, bile edhe para se ajo të largohej nga Kombinati; ky përfundim kishte të bënte me një dyshim të dikurshëm; atë mbrëmje kur ajo mbaroi së lexuari për herë të dytë letrën e Agimit, dyshimi u kthye në fakt: Mira nuk e donte më Agimin. Por edhe Agimi ndoshta nuk e donte Mirën, ose nuk e donte aq sa e kishte dashur në fillimet e dashurisë së tyre. Diçka e tillë fshihej si padashur e si vetvetiu prapa frazave të letrës së tij. Të tilla ishin fjalët e ndjenjat. Të qeta, të ngathëta dhe për

një instinkt të natyrshëm Mira ndjeu se dashuria e vërtetë s'kishte asgjë të përbashkët me frazat e me fjalët e qeta, të dremitura e të ftohta, si hej akulli që nuk i mungonin atij dimri. E këtillë është jeta, mendonte Mira. Askujt nuk i lejohet të ngutet. Mira njihte një shoqe që ishte ngutur e që pas një viti ishte ndarë nga i shoqi. Kryesore të mos ngutesh. Mendoj këto dhe i shkroi përgjigjen Agimit, ku nuk i thoshte asgjë se nuk e donte, por kjo dukej, kjo ndihej kudo, në rreshtat e në fjalët, midis tyre e përmes tyre, ajo ndihej vetiu, ata s'ishin krijuar për njëri-tjetrin dhe po ta pyesje Mirën, përse nuk e donte më Agimin, hëpërhë ajo mund të thoshte, se nuk mund ta dashuronte vetëm pse ishte punëtor i mirë, vetëm pse ishte i pastër dhe pse goja i mbante erë të këndshme. Dashuria ishte diçka tjetër, që ajo nuk e dinte akoma çfarë ishte, por dinte se nuk e kishte gjetur tek Agimi, dinte gjithashtu, se nga dashuria e tyre s'kishte mbetur veçse një kujtim, që lidhej me një shtirëngim të vetëm e me një të puthur të vetme. Lamtumirë! Por në letër nuk flitej asgjë për këtë lamtumirë, përkundrazi, aty flitej për mall, për gëzim, për të ardhshmen, por vetëm për një të ardhshme të përgjithshme, jo të tyren, personale, intime. Së fundi ajo e lajmëroi Agimin, që e kishte dhënë me sukses maturën e Teknikumit etj. etj.. Kur e mbylli letrën, nuk dinte pse, Mirës iu kujtuan disa dashuri të tjera, që i kishin lexuar në ndonjë libër të vjetër, ku flitej për ca mbrëmje, për ca rrugë të fshehta, të errëta, për ngrica të mëdha apo për ekuatore, për ankthe, për pallate misterioze dhe për gjithçka tjetër, që ishte vetëm e keqe, që ishin vetëm të pakuptueshme, që s'kishin arsye e që nuk u gjendej kurrë kjo arsye. Dhe e gjithë kjo e keqe e kishte burimin se Ajo nuk e donte më Atë dhe Ai përkëdhelte mendimin ta vriste Atë. Pam! Zhurma e revoles ose një rrokullisje metalike nëpër dysheme. Ndërsa përhapej gjaku i viktimës, Mira braktiste librin e vjetër dhe ndiente përbuzje për këto dashuri, herë të çakërgjosura, herë të sheqerosura, siç i quante ajo.

Kështu Mira Goremit nuk e erdhi keq për dashurinë e vet, që ishte shuar në lindje e sipër. I dërgoi ca përshën-

detje Agimit, bile edhe e përqafoi. U mendua pak të pri-shte «përqaftimin» apo «përshëndetjet», i la të dyja, i vuri datën, e mbylli zarfin dhe pastaj lexoi përsëri letrën e shoqeve e të shokëve. Kur u shkroi atyre përgjigjen, kur i mori të dyja letrat dhe doli në mbrëmje vonë për t'i postuar, Mira nuk mendoi më për Agimin, ajo gati e kishte harruar. Tashti, ndërsa postonte letrat, ndërsa lexonte për herë të fundit mbi zarf adresën dhe emrin e Llazi Mihalit, padashur, siç i ndodhte gjithmonë, Mira Goremi përfytyroi fytyrën e tij të ngjeshur, me vetullat e thinjura e të dendura si furçë, dhe.. diçka kujtoi...

...Veshi kominoshet, mori maskën e pincat, futi elektrodën në çizme (xha Llazi i fuste gjithmonë elektrodën në qafën e çizmeve) dhe, duke shikuar vazhdimisht lart, zuri t'u ngjitej shkallëve të ngushta e të pjerrëta, që shkonin përpjetë me zigzage. Atë ditë ajo nuk shikoi si zvogëloheshin njerëzit poshtë, nuk përshëndeti ata që punonin në platformën e parë apo të dytë, nuk i foli as Agimit, që punonte në pulsin e komandimit të energjisë elektrike, por u ngjiti me hap jo të zakonshëm, që ishte i rrëmbyer dhe i shpejtë, po të kishte parasysh pjerrësinë e shkallëve dhe ngushtësinë e tyre. Shumë kohë më vonë Mira do të kujtohej se edhe kur qe ngjitur në vendin e punës, ku kishte marrë për detyrë të saldonte disa tubacione, ajo s'para e kishte pasur mendjen te rreziku se mund të pengohej në një tra, se mund t'i rrëshqiste këmba mbi një kapriatë a transversë e të binte poshtë në tokë. Më vonë do të kujtohej për këtë pakujdesi, do të kujtohej pikërisht atëherë kur kishte arritur atje e kur ishte gati jashtë çdo rreziku. E kishin paralajmëruar Mirën se puna qe e vështirë, ajo kërkonte jo vetëm të gjithë mjeshtërinë e saldatorit, por kërkonte këmbëngulje, përqëndrim e vullnet, se presioni që do të kalonte nëpër ato tuba, do të ishte shumë i madh. Tegeli i saldimit duhej të dilte kompakt dhe xha Llazi kishte paralajmëruar se nuk do të pranonte as edhe një pore të vetme.

Para së gjithash Mira u lidh me litarin e sigurimit rreth kapriatës më të afërt. Po rreth kapriatës lidhi pincën, pastaj vuri maskën dhe filloi. Kërkoi nja dy-tri herë

t'i çlironin kabllin, që kishte ngecur diku poshtë. Thirri:

— Tërhiqe kabllin!

Thirri prapë:

— Tërhiqe!

Pastaj Mirës i kujtohej, se për herë të parë në jetë qenia e saj ishte shkrirë në një të vetme me zhurmën e motosaldatriçes, që arrinte e lehtë dhe e ëmbël deri atje lart, ajo ishte shkrirë me elektrodën që shkëndijonte me një flakë portokalle si në të kuqe (ngjyra më e bukur në botë, mendonte Mira) dhe aq shumë ishte dhënë pas punës, sa kishte harruar të shikonte orën e dorës (ora e masës) dhe as që e kishte vënë re xha Llazin, që përmes vetullave të tij të thinjura shqyrtonte tegelin e saldimit gjatë tubit.

Pastaj Mirës gati i pushoi zemra.

Tha xha Llazi:

— Pa ta shikojmë pak punën tënde!

Mira shikoi fytyrën e xha Llazit dhe fytyra e xha Llazit iu duk e rreptë.

Tha xha Llazi:

— Mos më shiko mua, por hiq skorien mbi tegel!

Mira nuk e shpjegon dot edhe sot pse u vonua, pse nuk lëvizi dorën të merrte çekiçin, pse atë (çekiçin) e mori më parë xha Llazi dhe hoqi vetë një pjesë të skories. Diçka shqyrtoi me kujdes. U kërrus. Goditi përsëri skorien me majën e çekiçit, shqyrtoi përsëri tegelin e saldimit dhe prapë u kërrus dhe prapë hoqi skorien e prapë shqyrtoi saldimit deri në fund, deri aty ku mbaronte puna e Mirës për atë ditë.

Ja, kur të më thotë, mendonte Mira, saldimit yt, moj vajzë, është poroz, është skarco dhe duhet filluar nga e para. E kushedi ç'mendime të tjera rrahu Mira, se xha Llazit fliste rrallë, nuk ngutej dhe fliste vetëm pasi ta kishte shqyrtuar mirë punën, vetëm pasi të ishte bindur për rezultatet, për cilësinë apo për skarcitetin e saj.

Por, sado që të zgjateshin këto çaste, sado që të zgjateshte hetimi i xha Llazit, më në fund çasti i vlerësimit kishte ardhur.

Aj tha me të folurën e tij të tërthortë:

— Mos është hera e parë kjo që ti bën punë të pavarur?

— Po, xha Llazi, — tha Mira e ngrirë. — Ti e di më mirë se unë! — tha prapë ajo.

Ai e shikonte përmes vetullave të rrëzuara mbi sy, si ta shikonte përmes kangjellave prej hekuri. Mirës mund t'i ishin kujtuar dhjetëra krahasime të tjera, por asaj iu kujtuan vetëm kangjellat, se në të vërtetë saldimi i saj i parë kishte të bënte pikërisht me kangjellat e shkallëve, që të çonin në sheshin e furrave elektrike.

— Mos nuk është puna e parë në tubat e gazit?

— E para, xha Llazi!

— Mos nuk është më e vështira?

Mira ngriti supet. Nuk i përkiste asaj të kategorizonte punët e vështira e punët e lehta. Ajo ishte dhe quhej nga të gjithë saldatore e re.

Xha Llazi tundi kokën e madhe me flokët të ngritur përpjetë nga era që frynte atje lart, u kthye përgjysmë për të ikur, por, në çastin që do të hidhte hapin e parë, tha:

— Saldimi është kompakt!

Mira lëshoi pincën, që u var e u tund nën kapriatë, befas iu hodh në qafë xha Llazit dhe e puthi në faqet, që priteshin vetëm nga një rrudhë e thellë rrëzë hundës. Gjithçka kishte ndodhur brenda një çasti.

— Mos, moj vajzë, se na rrëzove! — briti xha Llazi dhe mezi mundi të mbahej në cepin e një trau.

Diku u dëgjua një klithmë. Disa montatorë hodhën hapin të shqetësuar drejt tyre, ata që ishin më larg ngritën vetëm kokën.

Mira erdhi në vete.

— Xha Llazi, më fal! — tha ajo.

...Pasi postoi letrat, doli nga posta e menduar e me hap të ngadalshëm. Sa herë që i ndodhte të komunikonte me shoqet e shokët e Metalurgjikut, Mira Goremi bëhej jo vetëm e menduar, por çuditërisht ajo e ndiente qenien apo jetën e saj të ndarë më dysh. Njëra pjesë ishte aty, në shtëpi e në Korçë, pjesa tjetër kishte mbetur atje në Metalurgjik, atje jetonte e punonte, në kujtime, në evokime e

në digresione. Por kjo gjendje po bëhej gjithnjë më e vështirë. Dita-ditës ajo po bindej se kështu nuk mund të jetohej më. Duhej të merrte gjysmën që i kishte mbetur në Metalurgjik e ta bashkonte me gjysmën tjetër të Korçës, ose të bënte të kundërtën: gjysmën e Korçës ta çonte e ta bashkonte me atë të Metalurgjikut. Mira shpejtoi hapin me një buzëqeshje të fshehtë për këto anasjellje, që, si figuracion e si krahasime, mund të ishin ose qesharake ose lojë fjalësh, por si përmbajtje ishin vetëm shqetësim i vërtetë.

7

Ndërkaq, me kalimin e kohës, Mira Goremi kishte vënë re, se edhe në familjen e saj jeta nuk ishte e fjetur dhe e përgjumur, siç i qe dukur në ditët e para. Ndodhi që atë dimër vëllai i vogël të pranohej fatos, tjetri, më i rrituri, u pranua pionier. Të dyja këto data, të dyja këto mbrëmje u festuan me gjallëri në shtëpi, sidomos, meritat kryesore i përkisnin mamasë, që, si mësuese e ekonomisë shtëpiake, dinte t'i organizonte bukur këto festa. Vetë mamaja mori fletë-nderi si mësuese e dalluar, që kishte ditur (shkruhej në fletën e nderit) ta harmonizonte mësimin e ekonomisë shtëpiake me boshtin ideologjik të edukimit shkollor e me tre komponentët e tij kryesorë: mësim — punë prodhuese — edukim fizik e ushtarak. Edhe fleta e nderit u festua në shtëpi, bile vërtet rastësisht, por jo vetëm me të shtëpisë. Kurse babai mori shpërblimin më të madh ato ditë. Gazezat shkruanin për të si për një patriot që, me punën e tij të zellshme, kishte kuptuar rëndësinë e kursimit, si një mjet për fuqizimin e mbrojtjes e të ekonomisë sonë.

Për të gjitha këto, Mira Goremi ishte e ndërgjegjshme,

ajo i kishte jetuar dhe po i jetonte këto ngjarje dhe ishte e bindur se, ashtu si në të gjithë vendin tonë, si në çdo familje edhe në familjen e saj jeta vlonte me të gjitha ngjyrrat, por... megjithatë, një mëngjes ajo tha:

— Mama!

E ëma ktheu kokën dhe e pa si e trembur. Zëri i Mirës kishte qenë i ndryshëm:

Tha Mira:

— Unë po të dua, iki!

— Ku? — pyeti e ëma gjithmonë e trembur.

Tha Mira:

— Në Kombinatin Metalurgjik!

— Pse të ikësh? — pyeti e ëma.

— Atje dua, atje më pëlqen! — tha Mira.

Tha e ëma:

— Ti, ose ke pësuar diçka, ose ke një të fshehtë!

— Unë as kam pësuar diçka, as kam të fshehtë!

— Po çfarë atëherë?

— Më pëlqen jeta në Metalurgjik, më pëlqen të punoj nëpër kantiere të mëdha!

Tha prapë Mira:

— Do të shkoj!

E ëma e kapi për krahu e shqetësuar.

— Jo, mos shko! — dhe zëri iu drodh.

Tha prapë e ëma:

— Qëndro këtu me ne!

— Nuk dua!

— Unë dua të qëndrosh!

— Unë nuk dua!

— Të gjithë duan të qëndrosh këtu. — Tha prapë: —

Babai, motra, vëllezërit!

— Do të shkoj! — tha Mira dhe e shikoi të ëmën e turpëruar.

— Thashë unë, — tha e ëma, — mos ka ndodhur diçka me ty?

— Po, më ka ndodhur!

— Çfarë?

— Më bënë thirrje të qëndroja atje sa të kishte nevojë fronti i punës, një vit, dy...

— Pastaj?

— Unë nuk qëndrova. Braktisa frontin. — Tha: — Braktisa pozicionin. — Tha: — Kam dezertuar!

E ëma u mendua. Pasi u mendua, shikoi Mirën në sy, si për ta hetuar.

— Këte s'na e kishe thënë! — tha ajo.

— Më vinte turp! — tha Mira.

E ëma u mendua prapë.

— Jo, ti nuk do të shkosh. Fundja edhe këtu ka kantiere ndërtimi. Mund t'i përgjigjesh thirrjes po me të njëjtën punë. A s'është njësoj? — Kështu tha e ëma, por, nga zëri i saj e nga mënyra si e kishte kundërshtuar e si i kishte thënë ato fjalë, Mira kuptoi se e ëma ishte lëkundur.

Këto biseduan atë mëngjes. Pastaj ato heshtën. Heshtja sikur i zbuti gjakrat, sikur i vuri një kapak shqetësimit. Sikur i afroi. Dhe ato u ndanë me buzëqeshje, e ëma në shkollën e vet, Mira në zyrë.

Mirës i aprovua lutja pas disa ditësh. Përsëri rreth saj u dukën bombola e oksigjenit, apo motosaldatriçet, gazogjeni, kanela, elektrodën, pinca, maska e saldimit. Përsëri u riprodhuan shkëndija nga nxehtësia trimijëgradëshe. Ajo saldoi poshtë në tokë e në lartësi. Ajo u përpoq të ishte e gjallë, e gëzueshme, optimiste, siç ishte kur punonte në Metalurgjik. Por jo! Megjithëse në uzinën që ngrihej në qytetin e saj puna kishte po atë shkëlqim, po atë bukuri, po atë dinjitet, po atë konsideratë, megjithëse edhe në këte uzinë punohej me ritmin e Metalurgjikut dhe njerëzit ishin po aq të zot, po aq mjeshtër e të sakrificës si në Metalurgjik, prapëseprapë Mirës i kishte mbetur mendja atje, te kolektivi shumëmirësjesh, te konviktet, te stacionet e autobusëve, së fundi te uzina e çelikut, tek ajo zyra me tavanin gjashtë metra lartësi, te cepi i atyre buzëve që kishin shprehur pakënaqësi, te thirrja.

Dhe kur qëllimi i saj për t'ju përgjigjur thirrjes, qoftë dhe me vonësë, ishte kthyer në aksiomë, apo në maksimum, atëherë Mirës iu duk sikur nuk ishte më e lumtur. Iu duk sikur tërë ajo lumturi, që kishte grumbulluar gjatë jetës së vet, po dilte nga trupi i saj, po dilte nga të gjitha porët

dhe po tretej, po avullohej ose po largohej nga ajo, kurse vendin e saj po e zinin disa dyshime, që kur i kujtonte, skuqej dhe i vinte turp që s'kishte qëndruar në Kombinatin Metalurgjik bashkë me të tjerët derisa... Hëpërhë atje ishte fronti i betejës për Mira Goremin, atje ishte pozicioni që i kishin besuar dhe që ajo duhej ta mbronte pa marrë parasysh asgjë.

Atë të diel ajo nuk ishte ngritur akoma nga shtrati, kur një shi i rrëmbyer goditi xhamat e dhomës.

Ndoshta u bë shkak ky shi, që Mira Goremit t'i kujtohej (po në atë mënyrë «të papritur» si gjithmonë) një nga ngjarjet më të mëdha të jetës së saj trivjeçare në Kombinatin Metalurgjik.

...Një mëngjes shtatori xha Llazi i shikoi shokët e shoket e brigadës nën qimet e përmbysura të vetullave të trasha dhe tha:

— Ka ndodhur diçka e jashtëzakonshme! — Zëri i tij, si zakonisht, ishte i butë e pak i ngjirur. Edhe fytyra e tij e qetë nuk reflektonte asgjë të jashtëzakonshme. Por ata që e njihnin xha Llazin ishin mësuar të mos e vlerësonin asnjëherë gjendjen e vërtetë nga zëri e nga fytyra e tij. Po të thoshte xha Llazi se gjendja ishte e jashtëzakonshme, e tillë duhej të ishte. Aq më tepër që atë ditë ai nuk foli as me tërthore. E, kur xha Llazi nuk fliste me tërthore, gjendja duhej të ishte dy herë e jashtëzakonshme. — Komiteti i Partisë dhe drejtorja e kantierit kanë urdhëruar që shumica e brigadave mekanike të shkojnë për të punuar në objektin 7. Sipas informatave të stacionit meteorologjik pritet që nesër në mëngjes të fillojë një rrebesh i madh. Janë bërë ca llogarira, atje ku bëhen këto llogari, në qoftë se ky rrebesh i madh do ta gjejë objektin 7 në gjendjen që është tashti, dëmet do të jenë të shumta në materiale, në makineri, që po montohet, do të shkojnë kot dy ditët e dy netët e betonimit të madh të brigadave të ndërtimit e shumë dëme të tjera. Kështu thanë, dëme në milionëra. — Xha Llazi mbajti frymën dhe heshti. S'mbahej mend që ai të kishte folur ndonjëherë kaq gjatë. Ai u mendua pak, pastaj tha: — Me lekë të rinj, milionëra, e morët vesh? Por s'është puna vetëm te milionërat. Dëmet do të jenë të tilla, që do ta

shtyjnë për tre muaj afatin e dorëzimit të objektit 7. Jua thashë këto, sa për ta ditur rëndësinë e punës që ju pret përpara. Hani mirë mëngjes, se, me sa duket, do të punojmë tërë ditën pa u shkëputur nga puna, po mund të na duhet të punojmë edhe natën. Kush do të lodhet, të më thotë mua. Kujt do t'i merren mendtë, të më thotë mua. Dakord?

— Dakord, xha Llazi, — i tha një punëtor. — Por nuk na the çfarë ka ndodhur?

Xha Llazi, që nuk ishte më i ri, afër të pesëdhjetave, qëndronte para punëtorëve me trupin e tij të ngjeshur, me krahët e gjatë e me duart e mëdha plot kallo të lëshuara poshtë, i fuqishëm si një ari mali dhe po aq i qetë sa ç'ishte edhe i fuqishëm. Dihej nga të gjithë që ai sëmurej rrallë, që akoma më rrallë pinte ndonjë aspirin e që s'kishte munguar kurrë në punë pa pasur një shkak të fortë. Ai ngriti qimet e njërës vetull, që dukej se i pengonin vështrimin dhe tha:

— Merrni gjithçka që ju duhet dhe ejani pas meje. Në rrugë e sipër do t'ju them çfarë ka ndodhur!

Gjatë rrugës ai u tregoi se rreziku qëndronte te çatia e te qyngjet. Çatia e objektit 7 kishte një sipërfaqe gati shtatë hektarë. Disa nga qyngjet e ujit ishin lidhur me ullukët e çatisë, por nuk ishin futur në pusetat e kanalizimeve. Të tjerë ishin mbërthyer e montuar, por nuk ishin salduar. Disa qyngje nuk ishin vënë fare. Në këtë gjendje çatia gati shtatëhektarëshe, mbuluar me llamarinë të valëzuar e që ishte e pjerrët vetëm nga njëra anë, do ta derdhte të gjithë ujin e grumbulluar brenda në objekt, e pikërisht në qendër të saj. Por të mos montoheshin qyngjet deri të nesërmen në mëngjes, po të fillonte rrebeshi (rrebeshi i papritur — vera dhe fillimi i shtatorit kishin qenë të thata) do të ishte baraz si të kalonte përmes objektit një lumë i fryrë, që, për pozicionin e terrenit, ky lumë do të ishte edhe i rrëmbyer. Kjo ishte gjendja. Kjo ishte e gjitha.

Para se të fillonin, dmth para se të ngjiteshin, sepse puna do të fillonte me montimin e ullukëve buzë çatisë (pastaj qyngjet e saldimit) xha Llazi kishte qëndruar një çast i hutuar para Adem Dobullës.

— Edhe ti! — i tha ai.

— Ç'të bëj tjetër?
— Të qëndrosh atje!
— E pse?
— Të lyesh llamarinat!
— Sot jo!
— Je invalid nga sytë, kurse sot puna kryesore është saldimi!

Adem Dobulla tundi kokën e madhe si të demit kryeneç, por vështrimin e syve, pavarësisht nga mosha e nga rremat e tyre të kuq, si gjithmonë e kishte të ëmbël. E me këta sy e shikoi dhe tha:

— Pesë vjet që s'kam zënë pincë e elektrodë me dorë!
— Tha prapë: — Pesë vjet s'kam vënë maskë në kokë. — Tha prapë: — Po nuk punova sot, kur do të punoj?

U shikuan një herë në sy. Ai, Ademi, me sytë e skuqur, tjetri, Llazi, me sytë që gati i fshiheshin prapa vetullave të përmbysura e të trasha si furçe.

Tha me inat Llazi:

— Jo!

Tha prapë:

— Ruaji sytë. Do të punosh këtu poshtë. Qyngjet e ullukët duhen lidhur në ganxhat e vinçave për t'u transportuar lart!

Adem Dobulla, që e njihte mirë vendimin e Llazit, tha me gjysmë zëri:

— Mirë!

Tha prapë:

— Por këtu poshtë, ti e di, këngët s'do t'i ndaloj dot!

Ndërsa të tjerët qeshën e vazhdonin të qeshnin me fjalët e Ademit, xha Llazi që kthyer nga Mira Goremi dhe po e shikonte me kujdes. Fytyra e tij tregonte se kishte një mendim për të shprehur, lidhur me Mirën. Ishte muaji i pestë që Mira punonte si saldatore. Por shpejt xha Llazi vërtiti kraahun para fytyrës, si për ta larguar atë mendim dhe tha:

— Ngjitu, ngjitu.

Kur u ngjät lart buzë çatisë, se atje do ta fillonte saldimin, kur u lidh me litarin e sigurimit, atëherë Mira Goremi pati kohë të shikonte e të dëgjonte çfarë bëhej në

objektin 7. Tridhjetë e ca metra poshtë lëvrinin punëtorë e kamionë: betonoheshin kesonët e objektit, që ishin gro-pa apo puse të thella dhe ata që punonin në fund të kesonëve, i ndanin nga Mira jo më pak se pesëdhjetë metra. Mira humbi për disa çaste e tërhequr nga lëvizjet e punëtorëve të betonimit, që xha Llazi apo dikush tjetër kishte thënë, se, kur betonohet, sheshi i ngjan një kronometri të madh. Ja ç'do të ndodhë, mendoi Mira, të parët do të përmbysten kesonët...

Kishte rënë bilbili i xha Llazit. Kushedi pse, Mira e mori për vete. Deshi ta shikonte ku ishte, por hoqi shpejt dorë. Atje poshtë ishte zor ta shquaje xha Llazin. Atje lëviznin me qindra ndërtesues e montatorë, me qindra të tjerë, me litarët e sigurimit pas belit, me maskë apo me çekan në dorë, mësynin nga të gjitha anët objektin 7. Nga të gjitha anët vinin kamionë, vinça bik e vinça buld e lloj-lloj vinçash të tjerë. Disa nga ata kishin filluar të çonin hundën lart, duke tundur në ganxhat e tyre qyngjet e ullukët, që i prisnin punëtorët për t'i montuar. Beteja e qyngjeve, e quajti Mira me vete. Beteja e ullukëve. Beteja e çatëve. Ajo mund të kishte vazhduar gjatë me këto krahasime, po të mos kishte filluar zhurma e çekanëve. Këto zhurma dhe bilbili i dytë i xha Llazit e detyruan Mira Goremin të kërruste kokën e të fillonte punën. Edhe Mira, ashtu si punëtorët e tjerë të brigadës, kishte arritur, më në fund, ta dallonte timbrin e atij bilbili midis dhjetëra të tjerëve: xha Llazi, në kundërshtim me qetësinë e trupit e të karakterit të tij, vibracionet e bilbilit i shoqëronte vazhdimisht me disa nuanca që të kujtonin ulërimat e një ariu të zemëruar. Edhe ky kontrast midis tingujve nervozë të bilbilit dhe natyrës së tij të qetë, kishte të bënte me plotësimin e figurës së xha Llazit. Shikoi për të fundit herë një punëtor, që ishte sa një pikë në hundën pesëdhjetëmetërshe të gjatë të një vinçi, por që, me flamurët që mbante në dorë, dukej sikur hunda e përbindëshit i qe nënshtruar pikërisht asaj pike të zezë, e cila ndiqte pa vonesë drejtimin e dhënë të flamurëve. Punëtori shkonte drejt kulmit më të lartë të çatisë. Ky moment e shumë të tjerë si ky, janë ato që vërtetojnë edhe një herë nënshtrimin e plotë të hekurit ndaj

njeriut, mendoj Mira. Kaq. Pastaj ajo uli maskën dhe elektrodat nxorën shkëndijat e para.

Poshtë kronometri i madh njerëzor betononte kesonët.

Doli ashtu siç kishte thënë xha Llazi. Ata punuan tërë ditën pa ngrënë, kurse Adem Dobulla tërë ditën ngarkoi ullukë e qyngje dhe tërë ditën këndoi. Kur këndonte, dukej çuditërisht i ri, dukej tamam si dem, me kokë demi e me vështrim prej demi. Tashti ai nuk u këndonte më me fjalë syve si filxhan, vetullave si shushunjëzë, balleve si mermer e flokëve si pendë korb, por këndonte thjesht me një tra-la-la dhe një herë bile shtoi me reçitativë: tra-la-la, zura një galë. Kur Adem Dobulla zinte galën në gojë, kjo donte të thoshte se ai i kishte mbaruar këngët e fjalët dhe tashti nxirrte vetëm zhurma.

— Adem, idem! — i tha llogaritari, që kishte ardhur të ndihmonte Ademin.

— E kuptova! — tha Ademi! dhe ia nisi këngëve të reja. Por repertorin e këngëve të reja nuk e mbaroi të gjithë. Kjo ndodhi për arsye të brigadierit, Llazi Mihalit, që ishte në telash e pak i mërziur për informatat e reja metereologjike, që sapo kishin ardhur.

Tha Llazi:

— Adem, nuk u lodhe së kënduari?

Tha Ademi:

— Jo, shoku Llazi! — Por Ademi s'ishte budalla, shikoi me vëmendje dhe shtoi: — Po të duash ti, po bëj sikur u lodha!

— Mirë, — tha Llazi. — Bëj sikur u lodhe!

Tha Ademi:

— U lodha! — dhe koka iu zhduk prapa qyngjeve stivë. Por, pa u zhdukur mirë, u dëgjua reçitativi i tij: tra-la-la, tra-la-la, se Ademi kishte bërë be të mos këndonte, por jo të mos reçitonte!

Vetëm afër mbrëmjes punëtorët zbritën të gjithë poshtë (i kishte zbritur bilbili i xha Llazit) dhe shkuan në mensë. Gjatë rrugës për në mensë, për herë të parë ata panë nga perëndimi ca re, që lëviznin e ngjiteshin me shpejtësi drejt kupës së qiellit, kaltërsia e të cilit qe ve-

shur si me një cipë të hollë ngjyë manushaqe. Kur dolën nga mensa, dielli kishte perënduar, retë qenë bashkuar në grumbuj, qenë nxirë, qenë ulur dhe ca vetëtima të largëta, që ndizeshin andej poshtë nga perëndimi, shoqëroheshin me një zhurmë të mbytur bubullimash. Këto vetëtima të largëta e këto bubullima më të largëta, sikur u kujtuan punëtorëve se duhej të shpejtonin hapin. Hapin e kishin shpejtuar edhe brigadat e tjera, që ose shkëputeshin nga objekti e shkonin në mensë, ose dilnin nga mensa dhe shkonin drejt objektit 7. Buzë asaj mbrëmjeje rruqa mensë-objekt ishte plot, si një shëtitore, me të vetmin ndryshim, se në shëtitore njerëzit janë të veshur ndryshe dhe ecin ngadalë, kurse këta nxitonin drejt objektit, që për dymbëdhjetë orë rresht ziente e zhurmonte si një fushë beteje.

Kur secili zuri vendin e vet dhe filloi punën, vetëtimat dhe gjënimet erdhën mbi kokë dhe që nga ai çast u duk sikur zhvillohej një duel i madh midis tokës dhe qiellit.

Poshtë punëtorët vazhdonin betonimin.

Pastaj erdhi nata. Vetëtimat asgjësonin për disa çaste dritat e projektorëve dhe dritën e kuqe në portokalle të elektrodave. Rrokulliseshin gjëmime, binin rrufe, që mbulonin zhurmën e çekanëve e çdo zhurmë tjetër. Por vetëm për një çast. Se në çastin tjetër zhurmat e objektit 7 gjallëroheshin, projektorët e saldatriçet ndriçonin konstruksionin e tij, që dukej gjithnjë i dyfishuar nga dritat dhe hijet e tyre. Kurrë s'do ta harroj këtë natë, thoshte Mira me vete dhe më kot kishte bërë disa herë përpjekje të numëronte vatrat e shkëndijave portokalle në korpusin e objektit. Ato ishin me qindra dhe Mira nuk i numëroi dot asnjëherë.

Kur filloi të agonte, një agim i zyrtë me retë që trazoheshin mbi majat e oxhaqeve të Metalurgjikut, befas vetëtimat u ndërprejnë, u ndërprejnë edhe gjënimet dhe po aq befas mbi çatinë shitatëhektarëshe të objektit 7 ra me zhurmë një shi i dendur, përzier me breshër kokërrmadh.

Ujërat filluan të mblidheshin nëpër ullukët, filluan

të krëkëllinin nëpër qyngjet, të zbrisnin poshtë e të zhdukeshin nëpër rrjetin e dendur të kanalizimeve.

Në një çast të caktuar dikush goditi me çekan apo me një copë hekur, me çfarë i erdhi për dore qyngun, ose traun ose kapriatën më të afërt. Këtë goditje e pasoi një e dytë, një e tretë... një e dhjetë, e një minutë më vonë, mund të thuash se i gjithë objekti gjëmonte e jehonte nga këto goditje, që ishin me qindra, që ishin një mijë e më shumë se një mijë. Edhe Mira Goremi e goditi qyngun, që sapo kishte salduar dhe, sa më shumë e më shpesh godiste, sa më shumë bashkohej e shkrihej me jehonën e përbashkët, aq më shumë lotët i rridhnin nga një gëzim apo nga një mallëngjim që ajo nuk e kuptonte nga i vinte dhe pse duhej t'i vinte.

Shiu vazhdonte.

Poshtë punëtorët betononin. Ata ishin të vetmit që nuk shikonin rrotull, që nuk e ngrenin kokën lart, që nuk merrenin pjesë në gëzimin e përgjithshëm.

Kur çangat e të gjitha jehonat e zhurmat e tjera kishin heshtur, atëherë u dëgjua befas një çangë e vetmuar atje poshtë. Ajo u dëgjua me vonesë, sepse, kur të tjerët u binin çangave në atë kohë Adem Dobulla shikonte punën e vet (shprehje e tij) dmth këndonte (shpjegimi ynë). Ai e kishte dëgjuar të gjithë zallahinë, po si mund ta ndërpriste këngën në gjysmë Adem Dobulla? Kështu ndodhi që çanga e tij filloi e vetmuar dhe mbeti e vetmuar deri në fund. Merret me mend, çanga e Ademit u bë shkak që ky aksion masiv të mbyllej me një të qeshur gjithashtu masive.

Atë ditë Mira Goremin e kishte çuditur qetësia dhe heshtja e punëtorëve kur zbrisnin poshtë. Asnjë fjalë, asnjë koment. Sikur s'kishte ndodhur asgjë, sikur çdo gjë kishte qenë e zakonshme. Pastaj ata shkuan drejt stacionit të autobusëve, siç shkonin çdo ditë, me gjysmëpërshendetjet e tyre, ose me një të lëvizur të lehtë të kokës apo të duarve. Shkuan nëpër shi...

...Përtej xhamave të dhomës binte shi. Shi me rrëmbim e me frushullimë. Ndoshita për këtë kujtim ishte bërë shkak diçka e vogël (për këto kujtime gjithmonë bëhej

shkak diçka e vogël) ndoshta ishte bërë shkak ai shi i rrëmbyer që atë mëngjes rrihte çatinë e shtëpisë së Mirës... ndoshta edhe vendimi që kishte marrë ajo për t'u kthyer tek ata...

8

U përlotën. Si atë ditë kur u takuan. E para u përlot motra e vogël. Pastaj Mira. Pastaj mamaja. Për fat të mirë me kaq lotët morën fund. Dy vëllezërit nuk dihet pse shtypën vetëm majën e hundës së tyre. Emocionet? Përdëllimi? Mallëngjimi? Kurse i ati, i futur jo më në pallton e zezë, por në një pardesy të hollë, të gjatë një pällëmbë mbi thembër, qëndroi i patrandur, si një statujë madhështore. Ai ishte burrë.

Një orë më vonë autobusi ecte përtej Maliqit. Pastaj në Përrenjas. Treni...

Ishte pranverë. Mira Goremi shikonte natyrën e rilindur, ku gjithçka dukej sikur thithte nga qielli ngjyrën e tij kaltëroshe dhe mendimet e saj ndiqnin ritmin e trenit, ritmin e rrotave mbi shina. Ajo mendonte për njerëzit e afërt që kishte lënë prapa, mendonte për krevatin, për kuvertat, për tryezat, për karriget, po edhe për qilimët, për shoqët e shoqet e uzinës ku punoi gati dy muaj, për gjithçka që kishte mbetur prapa, që kishte mbetur në Korçë, ku ajo kishte lindur dhe ishte rritur, ku ajo mund të kthehej sërisht pas një viti, ndoshta pas dy e pas tre, ndoshta... Një hije mirëqenieje e lumturie e kishte mbuluar fytyrën e saj të freskët.

Prindërit e mi! Prindërit e mi të mirë! Vëllezërit e mi të dashur! Motra ime e mirë! Motra ime!...

Me kokën jashtë xhamit të trenit, me flokët që i shpu-

puriseshin dhe i zgjateshin në drejtimin e kundërt, ajo përfytyroi ato çaste kur do të takohej sërish me shokët e brigadës. Tashti ishte prill dhe ata duhej të kishin kaluar në aksin C, apo në repartin e kovave lëkundëse, apo në atë të dekromimit. Me të parë Mirën, ata do të vraponin pupthi mbi trarë e kapriata dhe do t'i hidheshin në qafë, duke harruar se nuk ishin në tokë dhe këtë gjë do t'ua kujtonte xha Llazi, që ishte jo vetëm brigadier, por, duke qenë brigadier, ishte përgjegjës edhe për sigurimin teknik të punëtorëve të brigadës së vet.

Pastaj... pinca, elektrodën, maska e saldimit...

Kudo një botë me shkëndija! Portokalle në të kuqe, që ishte ngjyra më e bukur në mes të të gjitha ngjyrave të tjera!

Ishte pranverë dhe çdo stinë e re shënon një fillim të ri.

N E D E T

Tha ai që mbante një laps të kuq në dorë:

— Ishte errësuar, kur unë bashkë me dy ushtarë tjetërë u nisëm për të marrë shërbimin e rojës.

Ai tha se posta ishte diku në afërsi të liqenit dhe shërbimi i tyre kryhej gjatë vijës bregdetare, që ndërpritej nga një va, i cili lidhte detin me liqenin e që s'ishte veçse pesëdhjetë metra i gjatë dhe gatti dyzet i gjerë.

Ndërsa ai vazhdonte tregimin, në dhomë u fut drejtori i konvikteve të montimit të Kombinatit Metalurgjik dhe u ul me vështrim jo tek ai që tregonte — atë tregim ai e kishte dëgjuar — por tek unë, që isha i ri në atë ambient e që e dëgjoja për herë të parë tregimin. Aty ishte edhe një tjetër, magazinieri i konvikteve, me një fytyrë të rrumbullakët, disi të vrarë nga vitet, me sy të vegjël, e ndoshta pikërisht pse ishin të vegjël, e tregonin tepër të vëmendshëm e të përqendruar.

— Ishte fundi i tetorit, — tha ai.

— Jo, Sami, — tha ose korrigjoi ose kundërshtoi magazinieri. — Nuk ishte fundi i tetorit. Ishte mesi i tetorit. Kështu më ke thënë.

— Po, — tha ai që mbante një laps të kuq në dorë e që quhej Sami. — Po, ishte mesi i tetorit të vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë dhe gjithë atë ditë kishte qenë një kohë si kjo e sotmja.

Instinktivisht, të katër ne që ishim në dhomë, hodhëm

sytë në dritare. Ishte një pasdite gri në ngjyrën e hekurit të ndryshkur. Frynte dhe retë trazoheshin, sikur përgatitshin të lëshonin shi.

— Atë natë frynte erë e fortë, — tha ai. — Rastësisht, peshkatarët kishin lënë një barkë në buzë të vaut. Kjo na kishte ndodhur edhe herë të tjera. Përfituam të mos zhvisheshim, hipëm të tre dhe me shkopin e gjatë, që zëvendësonte lopatat, e shtymë barkën në ujë. E shtymë përsëri nga mesi, e shtymë disa herë, duke dëgjuar llapashitjen e barkës në ujin e vaut midis detit dhe liqenit. Zakonisht, uji i vaut arrinte deri në gju, por, po të mos e njihje, mund të futeshe deri në brez e në disa vende të të mbulononte fare. Ishte një va tinëzar. Po të binin shira sado pak e sado larg, domethënë, po të shtoheshin reshjet e derdhjet në liqen e po të dallgëzonte deti, ai fryhej befas e bëhej i thellë, po në sipërfaqe nuk tregonte asgjë, përveç atyre valëvitjeve që i vinin nga deti. Ne ec e dëgjo, shtyj e dëgjo llapashitjen e barkës, po edhe kandrat e natës e bretkosat i dëgjonim. Atje ku mbaronte vau, ngrihej gjëmimi i detit e, duke dëgjuar atë, unë shikoja me sytë e mendjes kreshtat e larta të dallgëve, që ngriheshin si mal i bardhë e pastaj shikoja se si ky mal i bardhë thërrmohej në milionëra grimca apo pikla, që binin përsëri në det si shi i rrëmbyer.

— Fuqia e madhe qenka zemëruar sonte! — tha njëri nga shokët.

— Kam vënë re, — tha tjetri, — sa herë që era fryn nga toka, fuqia e madhe zemërohet e gjëmon!

— Dolëm në bregun tjetër. — tha ai që mbante lapsin e kuq në dorë e që quhej Sami. — Lidhëm barkën dhe u nisëm gjatë rripit të tokës, që ishte zona jonë e rojës, diku atje mbi Shëngjin e afër Bunës.

Ai tha se era në fillim u frynte përpara, pastaj prapa, tha se errësira ishte e plotë dhe ata nuk shikonin retë, por e ndienin se mund të binte rrebesh dhe këtë e kuptonin nga lagështia e ajrit, ose më mirë, këtë e kuptonte njëri nga ata të tre, që kishte qenë peshkatar në brigjet e Durrësit përpara se të thirrej në ushtri.

Magaziniери i konvikteve kishte hapur një regjistër dhe po shënonte diçka me laps, po megjithatë dukej qar-

të se nuk e kishte mendjen te regjistri, përkundrazi, ndërsa shkruante, ndërsa bënte llogaritë, vështrimi i tij kthehej herë-herë tek ai që tregonte. Drejtori i konvikteve të Kombinatit Metalurgjik, si më parë, shikonte nga unë, si për të rivlerësuar gjendjen time shpirtërore, durimin tim, interesin, që në këtë pjesë të tregimit duhej të kishte rënë pak ose diçka më tepër se pak. Po tregimtari, që në përgjithësi ishte njeri i qetë, vazhdonte të tregonte qetë, të më shikonte qetë, me atë vështrimin e tij të zi të bebëzave të zeza. Dhe atje, në thellësi të atyre bebëzave të zeza, ndihej se ai kishte besim tek ato që tregonte, sidomos tek ato që prisnin radhën të tregoheshin.

— Po ktheheshim nga shërbimi i rojës, — tha ai. — Ishte errësirë e plotë dhe ne, megjithëse e njihnim vendin pëllëmbë për pëllëmbë, megjithëse na kishte ndodhur të binim edhe në gjurmët e diversantëve, dy herë atë natë e humbëm rrugën, derisa mezi dolëm në vaun midis liqenit dhe detit.

— Tashti e kishim më lehtë, aq më tepër që atë natë nuk do të zhvishnim këpucët e pantallonat për të kaluar vaun. Hipëm në barkë dhe unë e largova atë me anën e shkopit. Ishte shumë errët dhe ne të tre i mbanim veshët ngritur se mos e drejtonim barkën gabimisht drejt detit. Thashë, atë natë deti kishte dallgë të mëdha dhe vau s'ishte më i qetë.

— Në mes të vaut, — tha ai dhe heshti. Pas pak tha: — Ku ta dish ku ndodheshim, në mes të vaut apo jo, kjo s'ka rëndësi, rëndësi ka që barka ngeci në rërë. U përpoqëm ta shtynim me shkop, po barka kishte ngecur. Njeri nga shokët tanë, ai Durrsaku kishte të ftohtë, ishte pak i sëmurë. Atëherë tjetri zbriti, e mori në krah dhe u nis me hamendje drejt bregut, që nuk e shikonim dot. Unë dëgjova zhurmën e hapave të shokut, që ishte zhytur në ujë deri në gju, pastaj zbrita dhe e tërhoqa barkën nga zinxhiri. Pushkën dhe vezmet, për çdo rast, se mos më binin në ujë ose më lageshin, i lashë në barkë. Në barkë kisha edhe shkopin.

— Pastaj unë nuk e dëgjova më zhurmën e hapave të shokut që mbante në krah të sëmurin. Mendova se dy sho-

kët kishin dalë në breg, ndërsa unë vazhdoja të tërhiqja barkën. Nga ana e poshtme e vaut dëgjoja uturimën e dallgëve, që duhej të ishin të mëdha, kurse nga ana e sipërme e vaut dëgjoja zhurmat e natës. Dihet, zhurmat e natës janë gjithmonë të dyshimta. Kandrat cicërimin. Bretkosat çirreshin në kor. Ishte kohë për diversantët. Ju i dini ato vite...

— Unë eca, nuk më kujtohet sa mund të kem ecur duke tërhequr barkën, — tha ai. — Por, duke ecur, vura re se uji m'u ngrit mbi gjunjë dhe barka u lehtësua. Atëherë vendosa të hipja mbi të dhe ta shtyja me shkop drejt bregut.

Tha:

— Pas ca metrash barka jo që nuk cikte më në rërë, por edhe shkopi, me të cilin e shtyja, po futej gjithnjë më thellë. Bile aq thellë, sa ishte e pazakonshme për thellësinë e vaut. Pak më vonë shkopi nuk zuri fare në tokë, ose në rërë, si ta themi.

E ndërpreu tregimin për një çast, si për të marrë frymë. Tashti ai nuk shikonte asnjërin nga ne. Ishte mbledhur në vetvete. Jetonte e tregonte për vete. Edhe sytë sikur i shikonin brenda vetes.

— Përgjova. — tha ai. — Përgjova prapë dhe u çudita që nuk dëgjoja më as bretkosat as kandrat e natës. Asnjë zhurmë nuk dëgjoja, përveç dallgëve të detit, që në errësi të dukeshin sikur do të më kërcenin mbi kokë. Fërkova sytë, i shtrëngova, i hapa, por nuk shikova asgjë. Vetëm m'u ngjall një dyshim, kur ndjeva erën e kripur të detit të më rrihte fytyrën. E provova përsëri shkopin, por nuk takoi. Nuk takoi as kur unë u shtriva përmbys në anën e barkës dhe zhyta në ujë jo vetëm shkopin tre metra të gjatë, por edhe krahun. Nuk e di, isha i hutuar, i frikësuar, nuk e di, por më kujtohet që e kisha humbur dhe nuk i besova shkopit. Mbërttheva zinxhirin e barkës me njërin dorë dhe u zhyta vetë në ujë. Unë nuk dija not, po me ujën isha mësuar disi. Kur isha zhytur i tëri, kur ishin zhytur edhe dora edhe zinxhiri, që ishte më se dy metra i gjatë, atëherë dola mbi ujë dhe mora frymë. Nuk kisha takuar.

— Hipa në barkë, — tha ai, — dhe kur hipa në barkë, i lagur dhe i ftohur, me ujën që më kullonte nga mjekra, nga duart, nga xhaketa e nga nuk më kullonte, vura re se barka zuri të lëkundej më shumë. Atëherë mendova t'u thërrisja shokëve, megjithëse roja i kufirit e ka të ndaluar të thërresë. Diversantët. Ata kishin ardhur shpesh në brigjet tona. Dhe ne ishim ndeshur shpesh me ta. Herë kishin ardhur nga toka, herë nga deti.

— Pas një minute barka zuri të lëkundej gjithnjë më shumë. Një minutë më vonë stërkalat e dallgëve më ranë në fytyrë. Në minutën tjetër unë isha në det. Në një det të egërsuar. Atëherë vendosa dhe u thirra shokëve. U thirra shumë. Sado që thërrisja, isha i sigurt se zëri im humbiste midis gjëmimeve të dallgëve. Tashti unë e merrja me mend se ku ndodhesha. Sa herë e kisha parë nga bregu atë pjesë midis dy skajeve shkëmbore, ku derdhej vau në det. Aty ishte thellë dhe kishte gjithmonë dallgë edhe kur deti ishte i qetë.

E ndërpriu përsëri tregimin si për të marrë frymë, por edhe për t'i dhënë rëndësi asaj që do të thoshte. Jo për efekt. Ai nuk ishte njeri i efekteve. Ai vetëm donte që të tjerët të ndiqnin ngjarjen, e cila i kishte ndodhur më se një çerek shekulli më parë, në një natë tetori të vitit 1949. Unë vura re se tashti atë e shqetësonin lëvizjet tona, sado të vogla që të ishin, e shqetësonin edhe vështrimet tona, kur i dukeshin se ato ishin të shpërndara. Na shikoi të gjithë një për një, por, kur u bind se na kishte përmbledhur në orbitën e tregimit të vet, befas një shqetësim i ri lëvriu në sytë e tij të butë: nga dera e hapur e zyrës u duk lëvizja e punëtorëve nëpër shkallët e konviktit. Kishte arrietur nga Kombinati autokolona e autobusëve të turnit të parë.

Dhoma e përgjegjësit, dmth e Samiut ndodhej në katin e dytë, përballë shkallëve të katit të tretë. Kishte raste që deri te ne dëgjohej nëpër ato shkallë një si zhurmë e veçantë, që s'kishte të bënte aq me zhurmën që bëjnë zakonisht njerëzit kur ngjitin ose zbresin shkallët. Nga dera e hapur e zyrës ne shikonim ndonjë punëtor, që shtrëngonte një rënë dorë, ngushtonte supet, kërruste trupin dhe «hop»

hidhej përpara me kërcim të gjatë, pastaj ne nuk e shikonim më, vetëm dëgjonim atë zhurmën e veçantë që bënim këpucët, ose zhurmën e mbytur të çizmeve me baltë që, pasi kishin kaluar pa përfillur një ose dy shkallë, binin në shkallën e tretë.

— Mos u çudit, — më tha me të qeshur drejtori. — U kemi thënë inxhinierëve apo arkitektëve që shkallët e konvikteve të montatorëve duhet t'i bëjnë më të larta. Montatorët s'para kanë durim të çapiten në çdo shkallare.

Para syve tanë lumi i punëtorëve vazhdonte të ngjitej e të zhurmonte. Bluzat e pulovrat e tyre, sidomos golfet apo xhaketat me zinxhir, pantallonat bluxhins apo thjesht pantallonat e vjetra, pa bërë fjalë për kominoshet e për çizmet, doemos të përveshura apo të përthyera deri në mes të pulpëve — këto karakteristika në veshje e shumë të tjera si këto, plus ajo mënyrë e veçantë të ecuri apo të shkëluri me hap të gjatë e të lehtë si në të kërcyer, që është pronë vetëm e montatorëve, plus kërcimet e vërteta të shkallëve, të gërshetuara me tingujt e transistorëve e me zëra të ngritur në oktavat më të larta — këto e shumë të tjera si këto ose do të të kujtojnë Kombinatin Metalurgjik ku ata punojnë e prej nga sapo vijnë, ose do të të japin përfytyrimin sikur këta punëtorë, me atë mënyrë ngjitjeje plot gjallëri e zhurmë, sjellin e mbartin me vete copëza nga Kombinati, akorde nga zhurmat e kontureve prej çeliku dhe për një çast do të të duket sikur bashkë me ta ka ardhur aty, po ngjit shkallët e po zhurmon e bërtet vetë Kombinati. Bile edhe copëzat e përthara të baltës në pantallonat e tyre, të futura gjithmonë në qafat e çizmeve të përveshura, s'janë tjetër veçse pjesëza molekulare që mbajnë erë Kombinat ose më thjesht: erë çelik.

Tha ai duke vërtitur lapsin e kuq:

— Ka raste që i zbresin... — Ai e ndërpreu fjalën, se atë çast valët e ajrit sollën deri te ne tingujt e një zhurme, e cila ndryshonte nga ato që kishim dëgjuar më parë.

— Ky është Skëndoja, montator i ri! — tha ai. — Rekord! — shtoi dhe u duk sikur e nënvizoi fjalën e fundit me lëvizjen horizontale të lapsit të kuq.

Ne mbanim vesh.

— Ja, dëgjojeni! — tha ai.

Një zhurmë.

— Katër shkallë! — tha ai, — por është më e lehta se të gjitha të tjerat. (Ajo ishte vërtet një zhurmë e lehtë dhe e ndryshme nga të tjerat.)

Kërcimi te shkallët u përsërit.

— Do t'i tërheq vërejtjen, — tha ai.

— Skëndo! — e thirri.

— Shoku Sami, — u dëgjua zëri i tjetrit, — më thirr?

— Skëndo, hajde këtu!

— Erdha!

Te dera u duk një djalë i ri rreth njëzet vjeç, i imtë, me flokë të ashpër përpjetë, me pantallona bluxhins, me zhilet jeshil e me një transistor në dorë. Dëgjohej zëri i një këngëtari të ri.

— Ulja zërin, — tha ai.

Tha Skëndoja:

— Ja ku ja ula!

— Të kam thënë, — tha ai, — t'i kapërcesh shkallët të paktën dy nga dy.

— Më ke thënë, — tha Skëndoja dhe një tis i kuqërremtë mezi u shqua në faqet e tij të nxira nga dielli. — Më ke thënë, — tha dhe e shoi fare transistorin. Kësaj radhe ai shikonte nga ne dhe shikonte si i turpëruar.

— Po pse e përsërit! — Zëri i Samiut ishte i qetë. Dukej sheshit se ai kishte dobësi për Skëndon dhe me zor e qortonte.

Skëndoja heshti dhe tisi i kuqërremtë sikur ia ndezi përbrenda lëkurën e zeshkët. Samiu vërtiti lapsin e kuq, si për t'i bërë një shenjë në ballë.

— Mos e përsërit më, — i tha. — Merr shembull nga më të mirët!

Tha Skëndoja:

— Po, — dhe u tërhoq, si për t'i shpëtuar goditjes së lapsit të kuq.

— Mirë, pra, Skëndo!

— Ika, — tha Skëndoja, kur ishte zbrapsur tre hapa.

Ne nuk e shikonim më Skëndon që po largohej, po dy sekonda pas largimit të tij dëgjuam transistorin që u ndez.

Tashti nuk këndonte më këngëtari i ri. Në eter përhapshin tingujt e një melodie me gajde.

— Janë të mirë, — tha Samiu dhe vërtiti nëpër gish-ta lapsin e kuq, si për të paralajmëruar se së shpejti do të rifillonte tregimin e ndërprerë. Shikoi nga ne. — Janë të mirë. Punojnë, pastaj, ta merr mendja, djem të rinj, disa ngjisin ose zbresin shkallët dy e nga tri dhe sulm drejt qytetit, kudo sulm, sulm rinie, në bulevardë, në restorante dhe Elbasani është rinuar krejt. Kurse ai Skëndoja, që i hipën shkallët nga tri dhe i zbrit nga katër, kur shkova një ditë dhe e pashë tek saldonte ca si kuzanë të mëdhenj, të them të drejtën, mbeta i çuditur. Ata kuzanë quhen gazgolderë, që shërbejnë për të mbledhur e përpunuar gazrat e avujt e helmuar të Kombinatit dhe kam dëgjuar se saldimi i tyre është jo vetëm punë me zarar, por edhe nga më të vështirët. Gazgolderët janë ato kodrat jeshile, të larta sa turizmi i Elbasanit, që shikohen të shpërndara nëpër Kombinat. Më thanë se ai po saldonte, poshtë në tokë, pjesët më të trasha e më të vështira të tyre. Dëgjoni Samiun, para punës që bëjnë këta djem, kjo që po ju tregoj unë s'është gjë fare.

— Lëri krahasimet! — tha drejtori.

— Isha në det të hapur, — tha ai pas pak. — Po se ku ndodhesha, ku ishte bregu, ku shkoja, ku rrihnin dallgët, të gjitha këto unë nuk i dija. Nuk i shikoja dallgët veçse me sytë e mendjes. Nga bregu i kisha parë kaq herë kur vraponin, pa e zënë kurrë njëra-tjetrën. Nga bregu duke-shin të bukura. Peisazh, si i thonë. Por atë natë unë e ndjeva mbi kurrizin tim bu-ku-ri-në e tyre. Më vinte për të vjellë. Desha të provoja edhe një herë thellësinë, por shkopipi nuk takoi gjëkund. Një dallgë gati më përmbysi. Shkopipi më ra nga duart. Por nuk u dëshpërova për shkopin, ai nuk vlente më. Tashti unë do të shkoja nga të më çonin dallgët. Thashë me vete, po të fryjnë erërat drejt bregut, do të dal në breg, po të fryjnë nga toka, do të eci mesit të detit, atëherë...

— Barka rrëshqiste me shpejtësi mbi ujë. Harrova t'ju them se pushkën e kisha vendosur nën këmbët e mia. Vetëm po të përmbysesj barka mund të binte në det ajo. Por,

po të përmbysej barka, më parë do të bija unë e jo pushka. Kujdes kisha edhe për vezmet, fishekët.

Ai e ndërpreu tregimin, më shikoi me sy të transfiguruar. Unë pashë në ata sy një gjendje të atillë, që ndoshta i ndodh njeriut kur ai sapo ka marrë një vendim të tmerrshëm. Të gjitha shpresat ishin shuar në ato bebëza të zeza. Ai po jetonte çastet më se një çerek shekulli më parë.

Foli ngadalë, si një mësues i vjetër:

— Megjithatë, vendosa! — tha ai.

— Çfarë? — e pyeta unë, që nuk besoja të dëgjoja ndonjë gjë të bukur në ato çaste.

— Të shtrihesha në barkë, — tha ai me zërin e mësuesit të vjetër dhe këto dy fjalë i tha prapë ngadalë. — Të mbytesha. — Tha prapë: — Pse ta zgjasja? Aty ishte deti, ishte barka, isha unë, unë që nuk i kisha kuptuar ujërat e vaut, që ishin fryrë papritur e që më hodhën në det po aq papritur e po aq tinëzisht.

— E dimi ç'bëra? U shtriva në barkë dhe prita që ajo të përmbysej. Vetëm për një gjë më vinte keq. Dy vjet qëndrova në atë rrip toke të bregdetit mbi Lezhë, dy vjet nuk e shkrepja një herë pushkën kundër diversantëve. Shokët e mi ishin përleshur, kishin vrrarë e kishin zënë rob, ishin plagosur, ishin shtruar spitaleve, ishin shëruar dhe ishin kthyer prapë, kurse unë... Nuk më qëlloi të ndeshesha asnjëherë ballë për ballë me diversantët. Vetëm kisha rënë në gjurmët e tyre dhe vetëm i kisha ndjekur.

— Deti, dallgët, — tha ai, — përplaseshin në anët e barkës dhe unë, i shtrirë në fundin e saj, numëroja minutat që më kishin mbetur për të jetuar. Duke numëruar këto minuta, mendova njëherë të shtija. Të paktën t'u tregoja shokëve se vdekjen e kisha gjetur në det. E ngrita pushkën. Ajo ishte lagur. Më erdhi keq. E kisha fshirë e vajosur atë ditë. Lëvizja llozin dhe e ngrita grykën përperjetë, fare pingul, se nuk e dija nga ishte bregu.

— Por nuk shtiva, — tha ai.

— I erdhi keq për fishekun! — tha drejtori.

Askush nuk qeshi. As drejtori nuk qeshi. Një çast më

vonë u duk qartë se ai nuk e kishte thënë atë frazë për të qeshur. E kishte thënë kot.

— Nuk shtiva, — tha ai. — Nuk është e lejueshme për ushtarin e kufirit të shtjerë, veçse kur shikon armikun të shkelë kufirin! Nuk shtiva, dhe prita vdekjen. Por, duke pritur vdekjen, befaz më rrëmbeu një mendim apo një dëshirë. Kjo dëshirë më erdhi kur barka po fundosej dhe gjysma e trupit tim ndodhej e zhytur në ujë. Unë mendoja, tashti vallë të jetë shpuar kjo barkë apo e kishin lënë peshkatarët të shpuar buzë vaut? Menjëherë pas kësaj vogëlsie u ngrita ndenjtur. Barka, e mbushur përgjysmë me ujë, gati u mbulua nga dallgët, gati u përmbys, por nuk u përmbys.

— E dini pse u ngrita? — pyeti ai. — Sepse e quajta marrëzi të pranoja vdekjen duarkryq. Aq më kishte hipur të jetoja sa, nga hiçi, nga pritja pasive e vdekjes, me gjysmën e trupit të zhytur në ujë, u ngrita dhe i sforcova fuqitë dhe mendjen time në maksimum. E gjithë puna ishte të jetoja, të mos mbytesha për turp në det. Ash-tu më hipi në kokë ta quaja, një vdekje të turpshme, megjithëse s'kishte të bënte fare me turpin. Në fillim as më kishte shkuar mendja se mund të shpëtoja nga ai det. Vetëm. Me një barkë të shpuar. Pa lopata. Në një natë tatori me re, me erë e me dallgë. Sa herë që e shikonim nga bregu e sa herë që deti ishte i shqetësuar dhe i ngrinte dallgët përtpjetë, komisari ynë e quante fuqi e madhe. Fuqi e madhe por, po ta kesh zemrën të fortë, thoshte komi-sari, e çan edhe në kohën e dallgëve më të tmerrshme. Kështu pra, dhe unë vendosa të luftoja. Po me çfarë të luftoja? Barka po mbushej me ujë. Ndoshta pas një gjys-më ore unë do të ndodhesha në fund të detit. kurse barka, do të gjendej të nesërmen fërtele në ndonjërin nga brigjet tona ose në brigjet e huaja. Fillova t'i flisja detit me të mirë, fillova t'i lutesha me një mirësjellje e me fjalë të atilla, që edhe vetë çuditesha nga më buronin. I thashë detit se isha një shqiptar i thjeshtë, që, para se të vishesha ushtar, kisha punuar tokën me parmendë prej druri, me Kuqon e me Balashin. Bile i thashë detit se Balashin e kishim tonin, por Kuqon e merrnim te xhaxhai. Që të mos çuditej deti, i thashë pastaj se, kur i vinte ra-

dha, atëherë ishte xhaxhai ai që merrte Balashin tonë. I premtova detit se, me të mbaruar ushtrinë (s'më kishin mbetur veçse dy javë) do të kthehesha në fshat e do të bëja ç'mos t'i mbushja mendjen babait të futej në kooperativë. Fshati ynë ishte kooperativë nga të parat, por vetëm gjysma e shtëpive ishin futur. I fola edhe për të fejuarën. E çfarë nuk fola me detin, e çfarë s'iu luta. Në errësirë, në mes të dallgëve, që më ngrinin lart me gjithë barkë e pastaj më lëshonin në hummerë, m'u duk vetja sikur u besoja bestytive, megjithëse në fshat e në ushtri, sidomos në ushtri na e kishin bërë zhele e më keq se zhele çdo zot, çdo fe e çdo bestytini. Së fundi fillova t'u lutesha dallgëve, që të mos ma rrihnin aq shumë barkën, se ajo ishte e vogël, ishte e vjetër, ajo ishte e shpuar, ajo s'kishte as lopata (kur të tjerat kishin helika të fuqishme) ajo ishte e pafajshme, ashtu siç isha edhe unë i pafajshëm. Ç'faj mund të kisha unë, kur forcat tinëzare e të errëta të natyrës dhe rrymat e pakuptueshme të ujërave e të erërave më kishin hedhur pa dëshirën time në tallazet e detit? Po të mos kishin mbirë këto forca të prapa e të errëta, tashti unë do të prehesha në krevat, barka në buzë të vaut, ose ndoshta peshkatarët do ta kishin marrë e do ta kishin bashkuar me shoqet e tjera. Po, ndërsa unë i flisja detit me fjalë të mira, ai më përgjigjej duke më hedhur dallgët në fytyrë. I niste ato njëren pas tjetrës. Ato vinin duke u ngritur. E dyta më e madhe se e para, e treta më e madhe se e dyta... e katërta më hidhte përpjetë si në një majë mali, pastaj banka lëshohej poshtë dhe mua më bëhej sikur do të paloseshja midis ujërave. Mësova të numëroja dallgët dhe, meqë nuk i shikoja me sy, mësova t'u vija numrat që u përkisnin, duke gjykuar nga vrulli e nga lartësia, nga zhurma e nga uturima që ato bënin. Nga e para tek e katërta. Dhe prapë nga e para tek e katërta. Katër ballë. Por këtë mos e merrni të sigurt ju. Të paktën kështu më dukej mua. Kështu m'i kishte shpjeguar ballët e detit një shok. Deri tek e nënta, më kishte thënë ai. Kur m'u duk se barka që mbushej me ujë do të fundosej, atëherë bëra diçka që më erdhi si vetvetiu. Them kështu, sepse më bëhej sikur as e kisha menduar, as e kisha

thënë, por e vura në jetë menjëherë. Kjo ndodhi pak më vonë, kur uji mbuloi dërrasën mbi të cilën isha ulur e mbi të cilën ulen zakonisht ata që u japin lopatave, ose ata që rrinë ulur kur bëjnë shëtitje në dete e në liqene. Atëherë, për një çast më rrëmbyen emocionet. Thirra me vete, nuk më kujtohet, ndoshta kam thirrur edhe me zë: Mjaft u lute Sami! Kështu më bëhet sikur thirra. Deti më hodhi në fytyrë dallgën e katërt dhe gati më nxori nga barka. Atëherë hoqa kësulën dhe me ndihmën e saj fillova të zbrazja ujin. Jepi, Sami, i thashë vetes.

— Jepi, Sami, — tha ai për herë të tretë, si të ishte jo aty në zyrë, por në detin me dallgë.

— Po kësula u zbut fare dhe nuk vlente më për të nxjerrë ujë. E lëshova në barkë po shpejt e ngrita dhe e futa në rripin e xhakëtës. Si do të paraqitesha në repart pa kësulë? E pse? Dallgët! Justifikim ishte ky? Kështu mendova dhe e futa kësulën në rripin e xhakëtës.

— Prapë bëra diçka, — tha ai. — Më parë e bëra sesa e mendova. Hoqa njërën këpucë dhe menjëherë u binda se tashti kisha gjetur mjetin e përshtatshëm për të zbrazje ujin. Pas disa minutash, vura re se këpuca ime zbrazte ujë më tepër sesa fushin të çarat e barkës së vjetër. Por kur e boshatisa ujin, dëgjova disa zhurma të reja, nga ato që nuk i kisha dëgjuar deri atëherë. Deti është si qenie e gjallë, thashë me vete. Ato zhurma më ngjanin me një keqkuptim ujërash, me një përzjerje absurde, sikur deti ishte ndarë në copëra që s'merreshin vesh me njëra-tjetrën.

Tha magazinieri:

— Kishte humbur unitetin!

Ne qeshëm. Por jo me zë. Nuk deshëm të qeshnim me zë. Qeshëm vetëm me buzë.

— Pikërisht, — tha ai, — sikur disa ujëra nguteshin drejt sipërfaqes, të tjera shkonin poshtë. M'u duk se edhe barka, tashmë e boshatisur dhe e lehtësuar, e ndjeu këtë ndryshim. Dërrasat e saj të vjetra filluan të rënkonin. Thashë, ajo e kishte ndër menjëherë ndryshimin, kurse unë do ta kuptoja pak më vonë. Dallgët kishin kapërcyer në një cak të ri ballësh. Pesë ballë. Kështu më dukej mua!

— Tashti unë e dija, deti pesëballësh i përmbys barkat e vogla. E kisha dëgjuar nga ai shoku. Ajo zuri të tundej si një lëvozhgë dhe mua më erdhi të vjellët në grykë. Mbarova, thashë me vete. Po prapë m'u ngjallën po ato emocione, kur vendosa të mos vdisja duarlidhur.

— Po çfarë të bëja, — tha ai. — Se mos kisha lopata? Një çudi: m'u tek të pija një cigare, por mendjen ama e kisha te dallgët që afroheshin. Kur ishin larg, ato zienin përbrenda me ca zhurma sikur mijëra përbindsha zvarriseshin drejt meje. Është gabim të mendosh që zhurmat e dallgëve ngjajnë me njëra-tjetrën, ose janë monotone. Aspak. Sa herë ngrihej një dallgë e re, aq herë ndryshonte edhe zhurma. Por gjithmonë ajo ishte zhurme uji, që errësira e bënte më të frikshme. Prapë një çudi tjetër: kur dallga i afrohej barkës, ajo bëhej e heshtur, gati tënëzare, por mjaft e fuqishme. Fuqinë e saj unë e ndieja në shollët e këmbëve, që i mbaja të mbërthyera fort pas fundit të barkës. Shollët sikur zienin, ziente fundi i barkës, ziente deti. Pastaj, një të shtyrë dhe barka fluturonte përpjetë, kurse kreshtat e dallgës më përplasnin në fytyrë milionëra grimca uji, që largoheshin apo shkërmoqeshin menjëherë dhe shkonin tutje, të tërhequra si me magnet nga vetë dallga. T'ju them të drejtën, sikur kisha filluar të mësohesha me rreziqet e detit. Rreziku nuk vinte vetëm nga mbushja e barkës me ujë, por edhe nga përmbysja e saj e menjëhershme. Ishte edhe rreziku që ajo të shpartallohej nga teftiku i dallgëve. Pesë ballë. Det për anije të mëdha. Nga bregu unë kisha parë shpesh anije të mëdha mbi dhjetëmijë tonëshe të ecnin në detin me dallgë e të tundeshin bashkë me dallgët. Po kjo barka ime! Fillova ta doja barkën. Ajo rënkonte, por nuk çahaj. Thashë me vete, nuk shpartallohet kjo, jo, e kamë ndrequr duart e shqipove. Edhe lisi është shqiptar...

Pastaj ai mbeti pak si i hutuar dhe, si të kujtohej për diçka, befas majën e lapsit të kuq e nguli mbi një pusullë që mbante përpara.

Tha prapë:

— Megjithatë, ju e keni të vështirë ta kuptoni sa e tmerrshme ishte të ndodheshe vetëm në detin e egërsuar.

Ai largoi majën e lapsit të kuq nga pusulla, ngriti pusullën dhe e lexoi duke e mbajtur pak larg.

— Li-i-i-te-e-e! — thirri ai.

— Li-i-i-te-ee! — thirri prapë.

— Mi-i-i-ne-e-e! — thirri ai.

— Mi-i-i-ne-e-e! — thirri prapë.

Te dera e zyrës u dukën dy sanitaret, që quheshin Lite dhe Mine. E para ezmere, e dyta bionde, ose më saktë, gjysmëbionde.

Tashti konvikti ishte qetësuar. Ishin rralluar shumë hyrjet e daljet, hipjet dhe zbritjet. Shumica e punëtorëve kishin hequr kominoshet ose rrobat e punës, kishin veshur kostumet dhe kishin sulmuar rrugët dhe restorantet. Unë e merrja me mend si gëlonin ato, si gëlonin pjesët e qytetit të vjetër e pjesët e qytetit të ri.

Tha ai:

— Në dhomën tetëdhjetë e gjashtë, në katin e pestë, — dhe tregoi pjesët e krevatit të mbështetur pas murit përpara zyrës.

— Pak më vonë, shoku Sami, — thanë sanitaret.

— Jo, tashti, — tha ai. — Tashti kthehet. Ai i dhomës tetëdhjetë e gjashtë është montator. Duhet ta gjejë krevatin gati. Mund të dojë të çlodhet.

Sanitarët thanë:

— Mirë, — dhe u erdhën rrotull pjesëve të çmontuara të krevatit. Por mënyra si ato i vinin rrotull, tregonte se do ta kishin të vështirë montimin. Atëherë Samiu lëshoi lapsin e kuq mbi tryezë, si të ishte peshk e s'mund të dilte jashtë akuariumit, shikoi këndeve të dhomës, rrëmbeu një hekur të rëndë, doli në korridor, u tha dy sanitareve:

— Ruhuni! — dhe zuri të rrihte krevatin që, në konviktin disi të qetësuar, jehonte jo më pak se llamarinat në çatinë e Uzinës së Çelikut e jo më pak se çekanët pneumatikë në përcënimin e konstruksioneve po të kësaj uzine.

Gjatë kohës që ai rrihte krevatin, ne ndezëm nga një cigare. Ndërkaq në veshët tanë bëhej integrimi i zhurmeve. Zhurma dallgësh, zhurma hekurash. Po edhe thirrje konviktorësh nëpër shkallë. Thjesht thirrje. E ndonjë nga ato kërcimet.

Ai u kthye i djersitur nga korridori dhe, si për të fituar kohën e humbur, filloi të tregonte që nga pragu:

— Ju thashë, — tha ai, — që më ishte tekur të pija një cigare. Nxora paketën, por u detyrova të hiqja dorë nga cigarja. Ajo s'ishte më paketë, as cigare. Ajo ishte kthyer në një lëmsh të zhytur në ujë. Edhe unë isha kthyer në një lëmsh i zhytur në ujë. Vetëm fishekët në vezme shpre-soja të më kishin mbetur akoma të thatë. Poshtë, në fundin e barkës, të mbushur gjithmonë me ujë, mbaja të mbërthyer me këmbë pushkën. I kisha premtuar pushkës se do ta pastroja sapo të dilja në breg — tha ai dhe qeshi nën hundë, sigurisht për bisedat e tij me qeniet pa shpirt.

— Në këto çaste më ndodhi gjëja më e tmerrshme, që edhe sot e kësaj dite nuk e kuptoj si e qysh më ndodhi. Nuk di ç't'ju them... Vetëm di që u gjenda i zhytur në det... Sigurisht, një dallgë do të më kishte hedhur jashtë barkës. Nuk e di prapë si e qysh ndodhi, por di që njëra nga duart e mia ose ishte kapur pas buzës së barkës, ose kishte ngecur aty vetvetiu. Barka, si më parë e më shumë se më parë, sepse tashti s'kishte as peshën e trupit tim, tundej e lëkundej, ngrihej si në majën e një mali dhe zhytej si në fundin e një grope. Provova disa herë t'u jepja trupit e duarve për t'u futur në barkë, por ishte fare e pamundur. Krahët m'u lodhën që në përpjekjen e parë. Trupi më qe ftohur dhe deti më thithte gjithnjë poshtë. Më bëhej sikur më kishte zënë një përbindësh për këmbësh. Thashë se mbarova. Qëndrova ashtu pa lëvizur, me qëllim që të çlodhesha pak. Kur i çlirova muskujt dhe u lëshova në ujë, duke mbajtur jashtë vetëm gojën, qepallat e syve më ranë dhe mua më pëlqeu të dremisja, me njërën dorë të mbërthyer pas barkës. Nuk di sa qëndrova ashtu, nuk di sa dremita, por di që ndjeva rehat dhe m'u mbush mendja se ishte e kotë të përpiqesha për t'u ngjitur prapë në barkë. Më mirë ashtu. Më bëhej sikur gjatë tërë kohës kisha pasur vapë, kisha vrapuar nëpër një shkretëtirë, kurse tashti kishin kaluar të gjitha mundimet, tashti ndodhesha në ujë dhe freskohesha. Pak më vonë nuk m'u duk aspak e tmerrshme sikur edhe të vdisja. Duhet ta kem shtrirë të gjithë krahun dhe duhet ta kem zhytur brenda në ujë edhe

kokën, sepse nuk mund të shpjegohet ndryshe, që shpesh më merrej fryma dhe vetvetiu nxirrja buzët mbi ujë. Por kjo u përsërit disa herë, derisa m'u mbush mendja t'i jepja fund jetës. Bile me një farë gëzimi. Isha si në ëndërr, kur deti zuri të më thithte dhe unë çlirova dorën e vetme, që e mbaja të mbërthyer te barka. Kur trupi më ra poshtë si plumb, unë, që s'isha aspak i tmerruar, e quajta veten të vdekur se, edhe po të dija not, edhe po të doja të ngrihesha lart, nuk mund të arrija më në sipërfaqe. Po edhe po të arrija në sipërfaqe, ku vallë do ta gjeja barkën në atë dallgë dhe në atë errësirë? U lashë lamtumirën të gjithëve dhe gjithçkaje dhe prapë vura re me gëzim se vdekja nuk po më dukej aq e tmerrshme. Por një herë se ku m'u përplas koka, më shkoi mendja te shkëmbinjtë e detit, që na kishte shpjeguar komisari, ndjeva pak dhimbje, kjo dhimbje sikur më solli në vete dhe befas desha të mbushesha me frymë. Mushkëritë po më pëlçisnin. Brofa përpjetë për të kërkuar ajër. Shkurt: isha penduar përsëri, nuk më pëlqente vdekja. Po si të shpëtoja, kur nuk dija not? Mirëpo, para se të më pëlçisnin mushkëritë, diçka e fuqishme, ta zëmë një dorë e hekurt më kapi për flokësh e më ngriti lart. Unë dola mbi sipërfaqe dhe pashë errësirën e qiellit. Bile dëgjova edhe ca të qeshura të ashpra. Më në fund, veshët më buçitën nga një zë i fortë:

— Të gjetëm! Të gjetëm!

Shokët, thashë me vete. Hapa sytë. Si më parë, dora ime, ose më mirë vetëm njëri gisht kishte mbetur i mbërthyer pas barkës. Rrotull zhurma e dallgëve, errësira, deti, unë dhe një yll që u mbulua menjëherë nga retë. Sa kishte zgjatur kjo dremitje, nuk e di. U mbërtheva me të dyja duart dhe përsëri provova të ngjitesha në barkë, por ishte fare e kotë. Herë duart e krahët e mi nuk punonin, herë barka më largohej, shkëputej nga trupi im dhe ngrihej bashkë me dallgën. Mendova: po sikur nga të ftohtët të më ngrinin duart e trupi?... Kishin filluar të më kërcisnin nofullat, kurse deti më tërhiqte vazhdimisht poshtë... Ja, kështu, ç't'ju them më tepër... Di vetëm që pak më vonë u gjenda përmbys brenda në barkë. Kjo mund të ketë ndodhur në ato çaste kur unë përpiqesha të ngrihesha. Një dall-

gë do ta ketë anuar dhe do ta ketë shtyrë barkën drejt meje. Puna e parë që bëra, shikova pushkën... Aty... Atëherë fillova të zbrazja ujë me këpucën që notonte nga mesi i barkës.

— Pasi u sigurova se kisha shpëtuar edhe kësaj radhe, koka filloi të më bluante ca gjëra të tjera. Për këtë u bë në shkak disa drita të zbehta që pashë nga larg. Mendja më thoshte se ato duhej të ishin drita të vaporëve tregtarë apo të flotave ushtarake, që i kisha parë zakonisht me dylbi nga bregu. Kjo tregonte, gjithashtu, se mund t'i kisha kaluar ujërat territoriale. Atëherë më lindi mendimi, po sikur të më kapnin flotat e huaja, ose dallgët të më hidhnin në brigjet e huaja, çfarë do të bëja? Që nga ai çast fillova të jetoja midis dy rreziqeve. Rrezikut të detit dhe rrezikut se mund të bija në duart e fuqive të huaja. Tashti mendimet e mia ishin ndarë më dysh. Një pjesë jetonte me barkën. Pjesa tjetër stërhollonte e përballonte situatat më të ndërlikuara përpara të huajve, që mund të më merrnin si njeri të futur me qëllim.

— Po të më kapnin vaporët e tyre, — tha ai, — ose luftanijet e tyre, ose po të më hidhte deti në brigjet e tyre, me një fjalë, po të bija në duart e tyre, e dini çfarë kisha sajuar t'u thosha?

(Vura re se në këtë pikë të tregimit, fytyra e tij zeshkane ishte bërë tepër e rëndë, tepër serioze, për një çast ajo dukej sikur ndodhej vërtet në bodrumet e zbulimeve të huaja, përpara njerëzve të huaj, që shikoheshin reciprokisht me mosbesim. Vura re, gjithashtu, se edhe sot, gati pas tridhjetë vjetësh nga ajo ngjarje, ai ishte tepër nervoz e nga nervozizmi tepër i zverdhur, që nuk kishte mundur të kuptonte aso kohe dredhitë e forcave të errëta të natyrës, të cilat e kishin detyruar të jepte ato shfaqje imagjinare e të panevojshme në bodrumet e huaja, në një kohë kur ai dhe shokët e tij do të ishin duke bërë gjumin e ëmbël të mëngjesit, ose, po të ishte pasdite, ai do të ndodhej në sallën e leximit, ose duke u shkruar prindërve në fshat, ose duke bërë stërvitje. Kështu, ai ishte nervoz dhe i zverdhur. Kjo kuptohej e shikohej menjëherë. Këtë e ndiente, këtë e dinte edhe ai vetë.)

— Do t'u thosha shkurt, — tha ai, — po ju, zotërinj, a i ruani kufijtë tuaj? Ata do të më thoshin «Po». Atëherë unë do t'u thosha: «Edhe unë kufijtë po ruaja, kur më kapën njerëzit tuaj ose kur më hodhi dallga në brigjet tuaja». Ai ose ata do të më thoshin: «Me një barkë të shpuar i ruani kufijtë ju?» Unë do të ngrija kokën me kryelartësi e do t'u thosha: «Po».

— E di, e di, — tha ai. — Këto shprehje sot tingëllojnë tepër naive, edhe mua tashti më duken naive, por jo atëherë. Atëherë unë isha i ri, njëzet vjeç dhe kisha besim se fraza si këto mund të bënin efekt të madh. Mos harroni kryesoren: kur mendoja kështu, isha në mes të detit me dallgë, në mes të fuqisë së madhe, siç e kishte zakon ta quante komisari, isha i trullosur dhe i troshitur, po edhe i friksuar, sidoqoftë. E ç'mendime të tjera mund të më vinin në atë gjendje që isha unë?

— Me këto mendime më zuri mëngjesi në det. Tashti, që i shikoja me sy dallgët, deti më dukej si një tokë me male shumë, me kodra e me gropa shumë, që lëviznin, ngriheshin, sheshoheshin, binin në humnerë e që, duke spërdredhur kreshtën, duke spërkatur milionëra stërkala, duke ngritur shi dhe shkumë të bardhë, formonin përsëri male e gropa të tjera. male uji dhe gropa uji. Dhe unë, mbi një barkë të vjetër, të shpuar e pa lopata, pa u hedhur kurrë në ujë, kisha shpresuar tërë natën të shpëtoja, kisha shpresuar të arrija diku. Por, megjithatë, — vazhdoi ai dhe u duk sikur ato që do të thoshte më poshtë i shkroi më parë me majën e lapsit të kuq: — vdekjen nuk e afroja. Shikoja rreth horizontit. Nga të tria anët dukej vetëm det. Nga njëra anë kishte mjegull. Prita sa të agonte mirë. Thashë me vete se atje ku kishte mjegull, duhej të kishte tokë. Po, kur drita ra mirë dhe kur mjegulla u zhduk, syri nuk më zuri gjëkundit tokë. Isha pra i rrethuar nga uji. Po të flasim me gjuhën e komisarit, isha i rrethuar nga fuqia e madhe, i rrethuar nga të gjitha anët. Po ndërsa merresha me këto mendime e shpresa, vura re një fenomen të detit, që s'e kisha parë kurrë nga bregu. E kam fjalën për dallgët e për zhurmat, — shtoi ai.

Ai tha se dallgët që kishin rrahur barkën me orë të

tëra, filluan të binin, filluan të shtroheshin, të ulnin kreshtat, të ishin më pak të fuqishme, të prishnin rreshtat dhe sipërfaqja e detit të merrte një formë tjetër. Por, duke thënë kështu, ai e krahasoi këtë gjendje me zhurmat rrotull nesh, me zhurmat e njohura të shkallëve të konviktit, sepse edhe ato, si zhurmat e detit, kishin rënë me kohë, ishin bërë më të buta e më të rralla dhe, kur ai tha kështu, atëherë këto dy zhurma paralele, zhurmat e detit e zhurmat e punëtorëve sikur u afruan me njëra-tjetrën, sikur fituan një ngjasim të ri, sikur u integruan plotësisht dhe në padashur ballafaquam detin me Kombinatin Metalurgjik, në konviktet e të cilat dëgjonim këtë histori të vjetër. Pastaj ai tha se disa minuta më vonë, ndoshta dhjetë minuta më vonë, deti i ngjante një gungaçi me disa gunga në kurriz. Por këto ishin ujëra që ngriheshin e zhdulkeshin, ishin gunga e kodra uji që vinin nga poshtë dhe e trazonin sipërfaqen vetëm nga poshtë, siç ngrihen e rrjedhin nga poshtë ujërat e burimeve. Ai tha se tashti edhe barka tundej ndryshe, vertikalisht, sikur një dorë e mijëra duar të padukshme e vendosnin midis apo në majë të atyre kodrave të buta, të cilat vinin duke u zbutur akoma, ose duke u sheshuar fare. Dhjetë minuta më vonë – dhjetë minuta të tjera – ndodhi fenomeni, që ai nuk e shpjegonte as sot e kësaj dite. Gungat e kodrat qenë zhdukur, sipërfaqja e detit që sheshuar krejt dhe në vend të ujit të kaltër si në të gjelbër tashti ai shikonte vetëm shkumë, shkumë të bardhë, që ziente, që flluckonte e që në këto flluckime pasqyronte si në milionëra spektra të vegjël ngjyrat e diellit, si ngjyrat e ylberit. Ai tha se kishte dëgjuar edhe zhurma dhe ato zhurma i kishin shëmbëllyer me britmat e bretkosave në liqenin pranë postës së kufirit, apo me një mijë britma të tjera të njohura të krijesave të gjalla. Ai tha, me aq sa kishte kuptuar, këto zhurma i shkaktonte flluckimet, flluckimet që kishin krijuar edhe spektrin e diellit. Ai tha se kishte qenë shumë i lodhur, se ndoshta mbi sipërfaqen e detit s'kishte ndodhur asgjë, as spektra, as flluckime, as këngë bretkosash e të një mijë krijesave të tjera (dhe sigurisht kështu duhej të ishte) por kishin qenë sytë e tij të përgjumur dhe veshët që... Po megjithëse i përgjumur, ai kuptonte dhe ndiente se në ato mi-

nuta kishte parë bukurinë më të madhe gjatë tërë jetës së vet. Përshtypjet e shprehjet e tij mund të përmblihdheshin me këto fraza: ajo që po ndodhte në det, mund të krahasohej me një aventurë të këndshme. Ajo kishte qenë art. Zbulim. Muzikë. Kishte qenë e bukur si një fushë beteje. Si një arë me grurë të pjekur, që valëvitet e që pret draprin ose kombajnën. Dielli ishte i ngrohtë. I shkëlqyeshëm. Me pasqyrime. Dhe deti, nga një arë me grurë të pjekur, kthehej në një livadh me luledhensh. Ah, kjo e fundit, tha ai, ishte më afër së vërtetës. Livadh me luledhensh. Për një çast ai e kishte humbur. Ai kishte dashur të dilte nga barka dhe të hidhej mbi atë livadh, të shtrihej, të ngrohej në diell si në fëmijëri dhe... «Do të vdesësh!» kishte dëgjuar një zë. Por atij prapë i qe dukur se ajo s'ishte vdekje. S'mund të quhej vdekje. Ajo mund të quhej gjithçka, por vetëm vdekje jo. Përkundrazi, ajo i qe dukur diçka e nevojshme, diçka e dobishme, e domosdoshme, një adhurim... Por në çastin kur do të hidhej, domethënë, në çastin tjetër ishte kujtuar se ndodhej në det dhe mezi ishte përmbajtur të mos binte në ato flluckime joshëse e mashtruese.

— Ajo që shikoja, — tha ai, — ishte një bukuri e rrallë, një mrekulli, më tepër se një mrekulli!

— Pastaj, se si hodha sytë andej nga ishte shtrirë pak më parë mjegulla. Tokë. Tokë, thirra. Një rrip i largët toke. Atëherë unë kuptova se nuk ndodhesha në mes të detit. Nuk isha afër, por nuk ndodhesha në mes të detit.

— Po ç'tokë ishte ajo? — tha ai. — Shqiptare? Jo? Si-
dlogoftë, unë duhej të shkoja drejt saj. Po si të shkoja kur
dallgët ishin zhdukur dhe barka kishte ngecur në mes të atyre flluckimeve të çuditshme? Ah, një lopatë, qoftë dhe një lopatë e vetme, thirra unë, thirra me zë: «Një lopatë!» Edhe diçka tjetër: tashti që dallgët nuk përplaseshin pas barkës, unë ndieja kënaqësi kur dëgjoja zërin tim.

Pastaj ai tha afërsisht se ishte tragjike të ndodheshe thellë në det, një natë të tërë, një mëngjes tjetër pas natës që kishte kaluar dhe të mos kishe me cilin të bisedoje një fjalë. Ai tha afërsisht se ishte e trishtueshme kur ndodheshe në ato rrethana e nuk njihje gjuhën e detit, gjuhën e barkës, të diellit, të erës, të dallgëve. Afërsisht këto gjëra

ishte duke menduar ai e, ndërsa vriste mendjen çfarë të bënte, barka e tij, pa u vënë re, kishte filluar të ecte. Ca rryma të papritura, si lumenj në det, ose nën det e kishin vënë barkën përpara dhe e shtynin tutje. Në fillim këto rryma e kishin shtyrë paralel me rripin e tokës. Pastaj drejt tokës. Pastaj nga e kundërta. Pastaj e kishin vërtitur rrotull një gjeneratorje. Ai s'kishte lopata, ai s'kishte ç'të bënte. Ai hiqte vetëm ujën me ndihmën e këpucës dhe shikonte rripin e largët të tokës. Shikonte dhe pushkën në fund të barkës. Shikonte edhe vezmet dhe gëzohej që fishekët i kishte aty. Dhe çdo gjë tjetër e kishte lënë në harresë: mendimet, shpjegimet po të ndodhej në brigje të huaja, të gjitha i kishte lënë në harresë. Kryesorja ishte të dilte në breg, të arrinte i gjallë në tokë, pastaj të tjerat, të gjitha të tjerat pastaj.

— Befas, — tha ai, — gati mbi kokën time kërceu diçka e madhe. Unë u kërrusa, megjithëse në çastin tjetër e kuptova se ajo gjë e madhe nuk kishte kërcyer mbi kokën time, por disa metra më tej. Pas së parës kërceu dhe u zhyt një e dytë. Një e tretë. Delfinët, thashë me vete. Unë i njihja delfinët. I kisha parë disa herë nga bregu, kur ata në njëshkolonë kërcenin e zhyteshin në ujë, largoheshin dhe ktheheshin prapë. E meqë kisha dëgjuar shumë fjalë të mira për delfinët, si kafshë të zgjuara e miq të njeriut, ata delfinë m'u dukën shumë të bukura dhe elegantë. Të mëdhenj. Të fuqishëm. Të gjatë.

— Ndërsa unë ndiqja me sy delfinët, vura re se sipërfaqja e ujit s'ishte më e shkumbëzuar, ishin zhdukur edhe fluckimet e spektrat, bile kishin filluar dallgë të reja. Po më parë se dallgët kishte filluar të frynte një erë tjetër, në një tjetër drejtim nga era që më kishte rrahur tërë natën. Unë thirra, nuk më kujtohet çfarë thirra, por di që thirra nga gëzimi, se era nuk frynte më nga toka, por nga deti, në drejtim të kundërt të tokës. Nëse gjatë natës unë nuk dija as nga binte toka, nuk dija as nga ishte lindja apo perëndimi, qielli ishte i zi pus, pa një yll, pa një Arushë e pa një Vije Qumështi, tashti që ishte ditë, puna ndryshonte dhe unë e kuptoja se, më në fund, shkoja drejt bregut, ngadalë, po drejt bregut. Thashë me vete, të kisha një velë,

por e thashë kot, se as barka ime s' ishte për vela, as unë s' e kisha idenë e ngritjes e të përdorimit të një vele.

Samiu bëri një gjë, që e kishte bërë edhe më parë: kishte ndërprerë rrëfimin për të marrë frymë e për t'i dhënë rëndësi asaj që do të thoshte. Vetëm për një çast.

— Mendova, gjithashtu, me keqardhje, — tha ai, — se, po të kishin dhënë alarmin e të kishin dalë në det të më kërkonin, tashti do ta kishin përsëri vështirë të më gjenin. Përfytyroni një barkë të vogël, një lëvozhgë midis brazdave të thella të dallgëve, që përsëri po bëheshin po aq të fuqishme e të larta sa të parat. Tashti që ishte ditë, unë shikoja bashin e barkës të fundosej krejt, por ishte çudi se si dilte nga uji, dhe jo vetëm dilte, por ngrihej lart, thuajse do të shponte qiellin, ose ato të pakta re që kishin mbetur në një cep të horizontit. Edhe i lodhur isha për vdekje. Nuk di si t'jua shpjegoj, po atë lodhje e ndjeva menjëherë, në një çast të caktuar, kur kisha ngritur kokën dhe s'më kujtohet çfarë po shikoja, sigurisht s'po shikoja asgjë, sepse e ndjeva veten menjëherë aq të lodhur, sa nuk isha në gjendje të shikoja as diellin, as rripin e tokës, asgjë. Këmbët, sidomos këmbët, që i kisha në ujë prej më se dhjetë orësh, më ishin mpirë fare. Po edhe trupin e kisha si të zbrëthyer, sikur çdo gjymtyrë e çdo gjë tjetër ishte e huaj dhe mund t'i përkiste kujt do, por vetëm mua jo. Po barka mbushej me ujë dhe unë me këpucë në dorë thosha shpesh, a t'i ngre edhe një herë duart? Po. Duhet. A t'i ngre edhe...

Kështu nuk di sa kohë punova, duke zbratur ujë. Nuk di sa orë, po di që niveli i ujit ishte ngritur deri në gjysmë të barkës.

— Befas, tha ai, — barka diku ngeci. Kur erdhi dallga tjetër, e ngriti prej andej, e çoi përpara dhe atje ngeci prapë. Unë isha aq i lodhur, sa kjo ngjarje e re, ky ndryshim, kjo ngecje, nuk m'u futën menjëherë në ndërgegjeje. Ngri-ta kokën dhe shikova bregun aty afër, shikoja turbull, por bregu ishte fare afër. Ishte një breg nga më të zakonshmit. Rërë, pastaj shkurre. Shkurre. Prapa shkurreve disa kodra të buta. Në thellësi pllaja, gryka. Më larg sytë nuk më shikonin, po mua ma kishte qejfi që në thellësi të kishte male. Peisazhi m'u duk shqiptar, me dritë, me diell. — Ai bu-

zëqeshi. — Këto fjalë i kam dëgjuar në Ekspozitën e 35 Vjetorit të Arteve Figurative në Tiranë. Ndenja një copë herë me këpucën në dorë, derisa u kujtova se dallga më kishte nxjerrë në breg. Tashti, që deti kishte mbetur prapa, për mua mori rëndësi të madhe se çfarë bregu ishte ai. Por isha shumë i lodhur dhe, kur mendova se kisha shpëtuar nga vdekja e detit, e ndjeva veten edhe më të lodhur, u këputa fare, aq sa më bëhej se, po të shtrihesha aty mbi ujë, mund të më zinte gjumi menjëherë.

Pastaj tregoi se, kur barka kishte ngecur përfundimisht afër bregut, ai kishte dëshirë të ngrihej në këmbë, por gjunjët nuk e kishin mbajtur. Dhe kishte mbetur ashtu i ulur, i zhytur në ujë deri në brez, si një mumje gjysmë e kërrusur, që disa kërkues të panjohur reliqesh, sapo e kishin nxjerrë nga thellësitë e detit. Mbante mend se kurrizin ia kishin rrahur shkumërat e fundit të dallgëve para se ato të tulateshin, para se ato të puthnin rërën e të ktheeshin prapë në det.

— Kushedi si dukesha në atë gjendje të dremitur nga lodhja, — tha ai për atë që unë e krahasova me mumjet.

Pastaj ai tha se kishte dalë nga dremitja, kishte marrë pushkën në fund të barkës dhe këpucën në dorën tjetër, që ngritur, kishte zbritur nga barka, kishte ecur deri në brez në ujë, gjithmonë i rrahur nga dallgët, kishte dalë në breg dhe atje i kujtohej se kishte qeshur. Kishte qeshur gjatë. Pastaj kishte përplasur këmbët në rërën e thatë. Pastaj në tokë. S'kishte gjë më të shkëlqyeshme sesa të ecje në tokë, të ecje e të mbaheshe me këmbët e tua. Dhe ai nuk ecte, por kërcente, me disa kërcime të çuditshme, që ndoshta kishin lidhje me dobësinë e gjunjëve të tij. Ecte si duke kërcyer. Digka më tepër se duke kërcyer. Ai thoshte se ishte një mrekulli, kur këmbët e tij shkëputeshin nga toka dhe kur ai e dinte se ato së shpejti do të binin përsëri në tokë. Në tokën e fortë. Ishte i gjallë, ishte mish e kockë, ishte më tepër se i gjallë. Me një farë vetëdije u largua nga bregu. Në breg mund të binte në sy menjëherë. A ishte mirë të binte në sy menjëherë, kur ai ishte aq i lodhur, aq i shkalafitur dhe s'kishte pasur as kohë, as mundësi për të përmbledhur mendimet e fundit?! Shkeli

mbi një livadh, u afrua pranë disa shkurreve dhe atje u shtri për të fjetur, ose më mirë u rrëzua. I kujtohej se si kishte vënë pushkën në vend të jastëkut, këpucën pranë kokës dhe para se të mbyllte sytë, ose para se ata t'i mbylleshin, ai kishte parë hijen e trupit të vet dhe mbi hijen e trupit kishte parë avullin që ngrihej nga rrobat e lagura. Kaq.

— Kur u zgjova, — tha ai, — isha tharë në diellin e terorit dhe kisha një etje të tërbuar. Përsëri i harrova të gjitha pikëpyetjet, ku ndodhesha e çfarë duhej të bëja në rast se... vetëm një qëllim kisha, një dëshirë, të gjeja një burim, të pija ujë. Vura kësulën, që e pata vënë në rripin e xhaketës, mbatha këpucën, po, kur erdhi radha të hidhja pushkën në sup, atëherë përmblodha mendimet, shikova tytën e qytën e saj, që kishin marrë atë ngjyrë e atë pamje që marrin pushkët kur janë lagur në shi e kur nga ato është zhdukur edhe pilka e fundit e vajit. Vendosa ta fshija, t'i pastroja viaskat, shulim, kondakun dhe pastaj të nisesha. Kështu ishte turp të më shikonin shokët. Dhe më turp të më shikonin të huajt, po të kisha rënë në tokë të huaj. Grisa astarin e xhepave dhe, pasi e bëra disi këtë punë dhe kur m'u duk se hekuri dhe qyta e pushkës filluan disi të shkëlqenin, aq sa mund të shkëlqejë një pushkë e pavajisur, ktheva mbi sy kësulën, shtrëngova mirë lidhëset e këpucëve, rregullova dollakët, xhaketën, kollanin e mesit dhe sulm për të gjetur një burim. Digjesha nga etja.

Pastaj ai tha se kishte gjetur një vrragë, që ndoshta të çonte në një burim, tha se kishte parë gjurmë nëpër atë vrragë, tha se ato gjurmë i ishin dukur shqiptarë dhe kur magazinieri e ndërpreu dhe e pyeti me interes se ç'gjë të veçantë kishin ato gjurmë që mund të ishin shqiptarë, ai ngriti supet dhe tha se nuk e dinte atë gjë të veçantë që duhej të kishin gjurmët shqiptarë, por megjithatë ai kishte qenë i bindur se i kishte njohur ato gjurmë, gjurmët shqiptarë. Ai tha se kishte parë një curril uji që humbiste shkurreve dhe prapë shkurret e njomështia i qenë dukur shqiptarë. Dhe ajri, dhe qielli, dhe gjelbërimi i artë i terorit, të gjitha e gjithçka iu dukën se i përkisnin tokës shqip-

tare. Edhe ai vetë e dinte se ishte duke menduar gjëra qesharake, ose gati qesharake, se toka, qielli, shkurret, ajri dhe të gjitha të tjerat, aq më tepër ajri, mund të ishin të ngjashme në shumë vende të botës, në mos në të gjitha vendet e botës. Por vetëm një gjë mund të mos ishte e ngjashme e mund të mos e gabonte ai: gjurmën. Gjurmën e opingës prej gome apo prej lëkure lope, po edhe prej lepuri, që lidhet me retra të gjata pas pulpës së këmbëve. Këtë gjurmë, gjurmën e opingës, ai nuk mund ta gabonte kurrë. Dhe ishte kjo gjurmë, që e nxiste atë të ecte pak a shumë më i shkujdesur. Të gjitha këto shqetësime, këto mendime, luhatje dhe hamendje gjetën shpjegim menjëherë kur arriti të burimi. Ai burim ndodhej pranë një rrapi të madh; rrapin e madh ai e njihte mirë; nën hijen e atij rrapi ishte çlodhur shpesh me shokët pas shërbimit të rojës; burimi rridhte midis disa gurëve e guvave; rreth e rrotull kishte zambakë të bardhë; sipër këndonin zogjtë, poshtë çirreshin bretkosat, nga ato që, sipas Samiut, zor se mund të gjenden aq llafazane në tërë botën. Shqipëri! Këmbë e kokë Shqipëri! Deti e kishte shtyrë përpjetë, nga veriu, drejt Bishtit të Bunës. Tetë kilometra larg nga posta kufitare e liqenit. Ai tha se pak më vonë, pranë burimit i kishte zënë syri një plak, që e kishte mjekrën akoma të lagur nga uji i burimit, që ishte ulur me pushkën në prehër e me kutinë e duhanit në prehër, me një pagur të vjetër në prehër e me lodhjen në... fytyrë. Ai tha se në çastet e para kishte lindur një ekuivok midis tyre. Plaku mund ta kishte marrë për hajdut, për dezertor ose ndoshta edhe për diversant etj. etj. Kjo e kishte turbulluar Samiun dhe i kishte ngjallur shqetësim. Të gjitha këto dyshime ishin shprehur vetëm përmes vështrimeve të plakut e përmes vështrimeve reciproke të të dyve. Pastaj...

— Mirëdita, gjysh, e përshëndeta unë.

— Plaku u kthye ngadalë nga unë, — tha ai, — dhe më shikoi në heshtje. Më shikoi gjatë. Më shikonte edhe me dyshim, edhe me gëzim. Nuk ishte i sigurt plaku për identifikimin tim. Ushtar i lagur, ushtar i tharë, ushtar i zhubrosur, edhe një diversant mund të vishej si ushtarët tanë, ku ta dish se ç'përshtypje tjetër i kisha lënë, se edhe unë

vetë nuk e kisha parë akoma veten në pasqyrë. I thashë unë:

— A ma jep pak pagurin ta mbush me ujë?

— Pse jo, bujrrëm, tha plaku.

— Dhe ma vuri pagurin në dorë, — tha ai. — Ky është ujë i mrekullueshëm, i thashë unë, është më i miri në botë.

— E ke provuar, pyeti plaku.

— Këtu kam bërë vitin e parë të ushtrisë, i thashë unë, mbusha pagurin dhe e piva të gjithë pa marrë frymë.

— Ke të drejtë, tha plaku, s'ka ujë më të mirë se ky!

— Unë u kërrusa. Kisha dëshirë të pija drejt në burim, por më pengonin gurët. E mbusha pagurin dhe e piva prapë pa marrë frymë. Më kujtohet që, ndërsa pija, më vinte për të qeshur, prandaj, me të mbaruar pagurin e dytë, ia plasa gazit. Plaku ndezi cigaren dhe më shikoi i çuditur. Unë ndieja freskinë e ujit tek më shpërmdahej nëpër trup, ujë i ftohtë dhe i lehtë, i themi ne, me një shije, që vetëm ujërat e burimeve tona mund ta kenë, e më erdhi për të qeshur dhe qesha. Plaku më shikonte gjithnjë i çuditur.

— Ke pirë dy pagurë me ujë, tha plaku.

— Po, i thashë unë dhe e mbusha për herë të tretë. Ka një erë e një shije aq të mirë, i thashë plakut, sa nuk e krahasoj me asgjë tjetër.

E ndërpreu drejtori pa të keq:

— Fizika thotë se uji është pa erë, pa ngjyrë e pa shije!

— Le të thotë! — tha ai dhe heshti pak. Tha prapë: — Ajo fizika jote do të bëjë mirë ta përjashtojë këtë ujin tonë nga rregullat e veta!

— Pastaj e ngrita pagurin e tretë dhe e piva prapë pa marrë frymë, e ndërsa pija, vështroja me bisht të syrit fytyrën e çuditur të plakut dhe dëgjoja tek më thoshte:

— E besoj, e besoj, përsëriti plaku. S'do të ketë ujë më të mirë se ky yni!

— Më mbeti ca ujë në fund të pagurit dhe e derdha, — tha ai. — Në ato pika uji që hodha në erë e që morën ngjyrën e diellit, ngjyrën e vjeshtës, ku përziheshin bashkë e gjelbra, e verdha dhe e kuqja, unë shikoja Shqipërinë, gjithë pastërtinë, freskinë dhe çiltërsinë tonë, të vërtetën tonë!

në, thjeshtësinë dhe lirinë që gëzonim dhe jetonim prej pesë vjetësh.

— Qenke një ushtar i fortë, tha plaku. Nuk më ka qëlluar të shoh një njeri të pijë gati tre pagurë ujë njërin pas tjetrit. Sa kohë ke që s'ke pirë?

— Unë ngrita kokën, — tha ai, — dhe pashë diellin mbi majën e rrapit. I thashë se kisha gati trembëdhjetë orë pa pirë.

— Ti qenke ai, pyeti plaku.

— Cili ai, thashë unë.

— Ai që deshi të kalonte vaun mbi një barkë të vogël dhe ra në det.

— Unë jam!

— Dhe era të shtyu thellë!

— Unë jam!

— Atëherë plaku u ngrit në këmbë, — tha ai, — dhe erdhi pranë meje. Plaku ishte i gjatë, ishte ajo kohë midis mëngjesit dhe drekës, dhe hija e tij ishte e gjatë, ajo shtrihet përmes sheshit të rrapit. U kthye ngadalë nga unë, më shikoi një copë herë me sytë e tij të zvogëluar, vura re se mbeti i kënaqur, hoqi pushkën nga supi dhe shtiu dy herë drejt majës së rrapit. Pas pak diku në një largësi u dëgjuan dy krisma të tjera. Dhe më larg dy të tjera. E me radhë...

— Të gjeta, tha plaku.

— Më gjete, thashë unë.

— Kjo që të ndodhi ty, tha plaku, u ka ndodhur edhe peshkatarëve më të vjetër e më të zotë! Ai va është i qetë vetëm përsipër, të gënjen, tha plaku.

— Këto fjalë sikur më ngushëlluan, — tha ai. — Të paktën shokët nuk do të më quanin leshko!

— Paske qenë ushtar i fortë, më tha plaku. Notar i madh.

— Unë s'di not, i thashë, as lopata s'kisha, edhe barkën e kisha të shpuar.

— E po çfarë paske pasur atëherë, më pyeti plaku.

— Nuk e di, i thashë dhe nuk e dija me të vërtetë si dhe pse kisha dalë i gjallë në breg. Më vonë komisari më tha se, për të dalë i gjallë në breg, më kishte ndihmuar

gjakftohtësia. Kjo kishte qenë arma ime kryesore. Mjafton që zure mëngjesin, më tha komisari, të tjerat s'kishin aq rëndësi. Po të mos të të kishte nxjerrë era në breg, atë punë do ta bënin anijet e motovedetat, do ta bënin ata qindra peshkatarë, që ishin hedhur në det për të të gjetur, dhe herët a vonë do të të gjenin. Kështu më tha komisari disa ditë më vonë, kur unë po i tregoja ngjarjen. Por e kishim fjalën te plaku. Ai më pyeti:

— Mos të gjetën peshkatarët dhe të ndihmuan?

— Jo, i thashë, ashtu, as vetë nuk e di, hiq ujë me këpucë e...

— Si-i-i?!... kështu bërtiti plaku.

— Duke luftuar kot më kot, i thashë unë. Po menjëherë pas kësaj fraze se si m'u ndriçua mendja dhe i thashë se kisha shpëtuar, duke luftuar kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm.

— E-e-ej! u çudit plaku e më nguli ata sytë e tij të zgjuar, por të lodhur. Mos do të thuash se luftove me diversantët e me kulakët në det?

— Gjysh, i thashë unë, ujërat e egërsuara, dallgët ishin diversantët, kurse të çarat e brimat e barkës, ishin kulakët, që u hapën portat armiqve të jashtëm!

— Unë nuk mund të them, — vazhdoi ai, — nëse kisha folur me shaka apo me seriozitet. Vetëm di që kështu foli, kurse plaku më vështroi me sy të turbulluar, tha nja dy herë si me vete, e-e-e, pastaj shpatullat e tij u shkundën nga një e qeshur e fortë.

— Po ti, more bir, s'qenke as i madh nga trupi, tha plaku.

— Ashtu, gjysh, i thashë unë, dy duar për një kokë dhe vura buzën në gaz i penduar, sepse m'u duk sikur isha mburrur ca, kurse në të vërtetë s'kisha pse të mburresha, deti më kishte tërhequr thellë, deti më kishte hedhur në breg.

— Plaku më shikoi përsëri gjatë, — tha ai, — me atë vështrimin e tij të zgjuar e të lodhur. Ushtimat e fundit të pushkëve po shuheshin, kur befas nga luginat e kodrat u dëgjuan tinguj këmbanash e çangash. Ata tinguj ishin të ndryshëm, dridheshin e përplaseshin me njëri-tjetrin, shu-

heshin dhe prapë jehonin. Ndofta plaku e kuptoi që unë kisha mbetur i çuditur nga krismat e nga çangat, që vazhdonin zinxhir, si një stafetë gjatë bregut të detit, prandaj më tha se ato krisma, çanga e këmbana binin për mua, jepnin lajmin se ushtari ishte kthyer i gjallë nga deti, se alarmi ishte dhënë menjëherë që një natë më parë. Një pampor, tha plaku, e të tjerë më të vegjël, ishin nisur nga Durrësi për të kontrolluar ujërat në thellësi, kurse peshkatarët e zonës kishin dalë në det për të më kërkuar. Ne pleqtë, tha plaku, bënim rojë në tokë e në breg por, duke parë çuditë në time, plaku bërtiti:

— E po e gjithë Shqipëria e di që një ushtar ndodhet në rrezik në mes të detit!

Briti prapë:

— Të duket çudi ty!

— U përqaftuam, — tha ai i emocionuar dhe lapsi i kuq i ra nga duart. — U përqaftuam, u puthëm dhe pastaj unë përfytyrova si do të takohesha me shokët, si... por vetëm kaq munda të përfytyroja, sepse një çast më vonë ndjeva dobësi të madhe, nuk di çfarë më ndodhi, sigurisht tensioni dhe lodhja në det dhe vetëm të nesërmen në mëngjes u zgjova në spitalin e Lezhës.

Tashti që tregimi kishte mbaruar, ne dëgjonim sërish zhurmat e njohura përballë derës së hapur të zyrës ku ishim ulur. Punëtorët, pasi kishin ngrënë, apo, pasi kishin shëtitur, po ktheheshin në konvikt. Po ato thirrje gëzimi, habie, qortimi, po ato copëza të shkëputura bisedash, shpesh pa kuptim, e pse jo, edhe ndonjë kërrusje koke, ose duar që mbërtheheshin pas parmakëve, ngushtim supesh, e ndonjë kërcim, që nuk përfillte radhën e shkallëve, siç i kishte projektuar arkitekti.

Fundja, ne ishim mësuar prej më se një ore me këto zhurma e skena, ne ishim mësuar me këtë jetë që gëlonte aty midis montatorëve. Ajo ishte bërë pjesë përbërëse e tregimit tonë, ajo ishte bërë sfondi i tij i pandashëm dhe për më tepër, përmes asaj jete dhe zhurme, ne përsërisnim me vete copëza nga tregimi që sapo kishim dëgjuar dhe me ndihmën e tyre përfytyronim edhe detin, edhe Kombinatin Metalurgjik, tek qëndronin përballë njëri-tjetrit.

UDHËTIMI I MBRETËRVE ME TRENIN E PARË ELBASAN—TIRANË

— Qerosi iu lut mbretit t'i jepte një punë, se Qerosi kishte mbetur pa punë. Mbreti i tha se nuk kishte punë, por i tha se po të donte, le t'i ruante të dyzet lepujt që kishte. I tha se, po t'ia sillte të dyzet lepujt në darkë, do t'i jepte...

— Kush i tha? — pyeti plaku që ishte ulur në krah të vajzës.

— Mos e ndërpre vajzën! — qortoi me të butë ai më i riu, që ishte ulur përballë vajzës e përballë plakut.

— Mbreti i tha, o gjysh! — foli vajza me vonesë.

— Ah, po! — tha gjyshi — Shikoi nga i riu, ose nga ai që ishte më i ri e që ishte ulur përballë tij: — Ti, Vangjel, mos më mëso mua. Di unë kur e ndërpres vajzën!

Ai më i riu, që quhej Vangjel, ndenji pa lëvizur, si të kërkonte ndjesë në heshtje. Qetësia e tij, plus pozicioni që i jepte trupit, të kujtonin perënditë e Olimpët, që midis shumë cilësive të ndryshme që u kanë vënë, këto perëndi i karakterizon dhe i bashkon një cilësi e vetme dhe që brez pas brezi historianë e shkrimtarë e kanë bërë zakon ta quajnë: qetësi olimpike. I tillë ishte qëndrimi i atij që quhej Vangjel.

— Mbreti i tha Qerosit se, po t'ia kthente të dyzet lepujt në pallat, do t'i jepte për grua vajzën e vet. Dëgjon ti, mami?

Atë çast, kur vajza iu drejtua së ëmës, që ishte ulur në krah të Vangjelit, ngjitur me xhamin e vagonit, ajo shikonte me vetulla të mbledhura errësirën dhe dritat e rrala të fshatrave, që po zgjoheshin një nga një. Kur mblihdhte vetullat, asaj i krijohesh një rrudhë e thellë midis tyre, dhe kjo rrudhë ishte treguesi më i mirë që dëshmonte se diçka ishte duke menduar. Po cili ishte shkaku apo arsyeja e këtyre mendimeve, kjo nuk dihej, ishte e panjohur, ose gati e panjohur. Ajo, ashtu si Vangjeli e si vjehri (ngjitur me vajzën) nuk ishte shprehur asnjëherë, që të kuptohesh se çfarë i pëlqente e çfarë jo te përrallat që kishte treguar kohët e fundit e bija. Të paktën ajo ndryshonte nga vjehri, sepse ky i fundit dëgjonte me vëmendje, ajo jo. Ndryshonte nga i shoqi, sepse ai e ndihmonte vajzën, ajo jo. Ndryshonte nga ai tjetri që ishte ulur në krah të Vangjelit e që ishte një shok i fëmijërisë së Vangjelit, një Tajar apo një Bujar (emrin e tij Vangjeli vetëm një herë e kishte zënë në gojë dhe kjo kishte ndodhur kur u takuan në vagon dhe zunë vendet që kishin tashti) sepse ai kishte hapur një libër dhe lexonte, sikur rreth tij të mos kishte jetë të gjallë.

— Dëgjon ti, mami? — përsëriti vajza.

E ëma nuk e hoqi vështrimin nga errësira përtej dritares dhe nuk u përgjigj. Ajo rrudhë e thellë midis vetullave të saj ishte bërë më e thellë, që kur ai i panjohuri, që i shoqi ia kishte paraqitur si shok të fëmijërisë, ishte ulur në krah të Vangjelit dhe kishte bërë një vërejtje për përrallat e vajzës.

Tha vjehri:

— Elsa, pse nuk i përgjigjesh Mimosës?

Elsa shikonte përtej dritares.

Tha vjehri:

— Lëre vajzën të flasë lirisht!

— Unë nuk po e pengoj, — tha Elsa, pa e kthyer kokën nga ai.

— Atëherë thuaj Mimosës që po e dëgjon! — tha vjehri.

Elsa fërkoj padashur diamantin e unazës që, në llambat e vagonit hidhte reflekse rreth gishtit tregues, hoqi

vështrimin nga errësira dhe, në vend të përgjigjes, pohoi me kokë, dmth e dëgjonte. Por ajo rrudha midis vetullave të saj nuk u zhduk. Dhe ishte kjo rrudhë që e tregonte Elsen një grua rreth të tridhjetepesave. E bukur s'ishte Elsa, por ishte diçka. Kishte një hundë të rregullt, kishte mollëza të rrumbullakëta, kishte mjekër me burmë, pak gushë (që dëshmonte për moshën) sytë të mëdhenj e mjaft të zinj e këta sy të zinj bënin kontrast me lëkurën e fytyrës, që e kishte tepër të hollë, tepër të pastër, tepër të bardhë, dhe ishin pikërisht këta sy e kjo lëkurë që të nxisnin të thoshe se e bukur nuk ishte, por diçka ishte. Diçka ishte edhe e bija, që i ngjante ose që ishte një kopje e vogël e mamasë.

Vajza, me të vënë re atë «po» të heshtur, vazhdoi:

— Po m'i prure për darkë të dyzet lepujt, le që çupën do të ta jap për grua, por do të të fal edhe mbretërinë time. Po nuk m'i prure, do të të pritet koka ashtu si të tjerëve!

— Të mesërmen Qerosi i mblodhi lepujt e mbretit dhe i çoi për t'i kullotur në një çair aty afër. Lepujt nuk qëndruan në çair, por një nga një ikën të gjithë...

— Me leje? — tha një burrë i ri.

— Po? — pyeti Vangjeli i hutuar.

— A mund të ulem? — pyeti burri i ri plakun që s'dihej, në shikonte hijen e kokës së vet tek i tundej pranë këmbëve në pozën e një riti të lashtë, që thjesht dremiste, po ndoshta edhe flinte.

— Mund të uleni, posi! — tha Vangjeli në vend të të atit.

Plaku, që një çast më parë dukej sikur dremiste, e kishte liruar vendin para se i biri të mbaronte frazën. Po edhe i porsaardhuri ishte ulur para se Vangjeli të thoshte fjalën e tij të fundit. Kjo ndodhi në stacionin e Paprit. I porsaardhuri, pasi dëgjoi nga vajza se Qerosi, që i kishin humbur të dyzet lepujt e mbretit, kishte zënë të qante, zgurdulloi sytë dhe në fillim shikoi vajzën, pastaj shikoi një për një ata që dëgjonin vajzën.

— Në këtë kohë, — vazhdoi Mimoza, — një plakë, që kaloi aty rastësisht, i dha Qerosit një cyle për t'i rënë sa herë të mërзитеj, e kur Qerosi, pasi qau e qau, iu tek t'i bin-

te cyles, të dyzet lepujt dolën nga ferrat dhe iu ngjitën prapa...

I porsaardhuri shikoi një herë rrotull vetes, si të bindëj se ishte ulur gabimisht aty e menjëherë, si të qe kujtuar për diçka të harruar, u ngrit në këmbë, me vështrim të ngulur te vajza e vogël që atë çast po tregonte fundin e përrallës (Qerosi i kishte sjellë të dyzet lepujt, e bija e mbretit po martohej me Qerosin) dhe i porsaardhuri u largua menjëherë nga ata, siç mund të largohet një njeri kur kupton se është ulur në mes të lebrozëve, apo në mes të të qmendurve. Tha ose u duk sikur tha:

— Më falni! — dhe iku.

Plaku lëvizi dhe zuri vendin e mëparshëm. Me sa dukej, atij i vinte keq ta ngushtonte mbesën.

— Iku! — tha Vangjeli, por asnjeri nuk e shikoi e nuk iu përgjigj. Ai kishte folur me zë, po kishte folur me vete dhe të tjerët e kishin kuptuar që kishte folur me vete. Por, pikërisht në këtë kohë, shoku i fëmijërisë (Tajari apo Bujari) kishte ndërprerë leximin dhe, sepse i kishte hedhur Vangjelit një vështrim të çuditshëm, të shoqëruar me një si buzëqeshje pak therëse e pak ironike.

Befas Mimoza tha:

— A t'ju tregoj edhe përrallën e mbretit me çobanin? Rrotat trokisinin mbi shina.

Shoku i fëmijërisë (Tajari apo Bujari) kur dëgjoi se vajza e vogël kishte ndër mend të tregonte një përrallë të dytë, ngriti kokën, shikoi vajzën dhe po instinktivisht e çoi trupin prapa si të desh me këtë të zgjatonte sa më shumë rrezën midis vajzës dhe vetes, të ishte sa më larg zërit të saj, sa më larg përrallës.

— A ta tregoj përrallën e mbretit me çobanin? — kësaj radhe ajo kishte pyetur të ëmën.

Por Elsa, si më parë, shikonte në errësirë, atje ku dritat e fshatrave ishin bërë më të shumta e ku Ylli i Mëngjesit dridhej me një mijë pirueta. Ishte mars. Ishte katër mars dhe dita po i merrte natës. Pastaj Elsa shikoi brenda në vagon ata që vërtiteshin për të gjetur vend.

— A të ulem? — pyeti një pasagjer që shoqërohej nga një ri.

— Po.

I porsaardhuri që u ul në krah të gjyshit, ishte një burrë i ngjallur, i gëzuar, me dhëmbët të bardhë e të ngjeshur dhe Elsës i kujtoi «Tregtarin» e Rubensit. Burri i ngjallur apo «Tregtari» i Rubensit, që me sa dukej kishte dëgjuar dëshirën e vajzës për të treguar një përrallë, me tërë fizionominë e tij ishte gati t'i lulej apo t'i thoshte «Fillo!»

— Fillo, Moza! — Këtë fjalë nuk e kishte thënë e ëma, as «Tregtari» i Rubensit, por Vangjeli, që e kishte ndier menjëherë interesin e të porsaardhurit për përrallat.

Mimoza filloi. Por në çastin e parë të fillimit apo në çastin e dytë, kur vajza kishte arritur të shqiptonte vetëm germën e parë të fjalës së parë, shoku i fëmijërisë (që zakonisht, kur treni qëndronte në stacion, nuk lexonte, sepse dritat vagëlleshin e zbeheshin) foli diçka nëpër dhëmbë, që afërsisht mund të kuptohej kështu:

— Prapë përralla me mbret?! — dhe që përtej gjyzykëve i hodhi një vështrim të shpejtë Vangjelit. Sytë e tij të thellë u dukën sikur e shpuan Vangjelin tejpertej: tik, tik, tik.

Vangjeli, që e kishte kokën një pëllëmbë mbi kokën e së shoqes në krahun e djathtë e një pëllëmbë mbi kokën e shokut në krahun e majtë, e rrotulloi atë bashkë me bustin (se Vangjeli e kishte qafën të trashë e të shkurtër) dhe e shikoi i habitur e si me dyshim shokun e fëmijërisë. Vërtet i kishte dëgjuar ato fjalë, apo i kishin bërë veshët? Këtë kuptim mund të kishte ai shikim. Diçka deshi ta pyeste ose ta kundërshtonte shokun e fëmijërisë, por nuk arriti, sepse pranë tyre e pranë atij që rrinte në këmbë u duk faktorinoja, e cila foli me zërin e saj të njëjtë e monoton, si të mos dilte nga grykë njeriu. Në përgjithësi, zërat e këtij profesioni dëgjohen e tingëllojnë të njëjtë e monotonë, të ftohtë e të thatë në çdo kohë, në dimër a në verë, në mëngjes a në mbrëmje.

— Peqimi, bi-le-tat!

— Na ishte njëherë! — Zëri i Mimosës tingëlloi i pastër, i qartë. Ai zë sepse të kujtonte argjendin. — Rronte diku një çu-pë mbre-ti shu-më e bu-kur, që kishte vënë dashuri

me një zograf. — Mimoza shikoi nga e ëma. Dhe shtoi: — Zograf, si mamaja ime!

— Unë jam mësuese pikturë! — tha e ëma, pa e hequr vështrimin nga gjysmerrësira, që kishte filluar të zbulonte relievin e tokës, apo konturet e saj, apo ato forma që ishin e që dukeshin akoma si imazhe, sepse së shpejti pritej të zbriste nga larg agu i parë i mëngjesit. — Mësuese! — shtoi ajo. — E pikturës! — shtoi prapë.

— Vajza e mbretit la takim me zografin në çezmën me çati, po, kur ajo shikoi te çezma me çati, në vend të zografit gjeti në gjumë një djalë tjetër, që nuk e njihte. Ej, ej, cili je ti, i thirri ajo. Unë jam një çoban, i tha ai, më zuri nata këtu dhe rashë e fjeta. Si mbaruan këto fjalë, vajza e mbretit e hipi çobanin në kalë dhe duke ecur i tha: «Ti do të jesh burri im!

Ai («Tregtari» i Rubensit) që ishte ulur pranë gjyshit, i ra gjurit me pëllëmbë dhe qeshi, ha-ha-ha. I kënaqur dhe i çuditur qeshi prapë dhe, sa herë që qeshte dhe sa herë që i binte gjurit me pëllëmbë, fytyra e tij gjallërohej dhe të dukej sikur me ata dhëmbët e bardhë, të ngjeshur e të mëdhenj, ai sapo e kishte shqyer gjelin e fundit ose të parafundit të dimrit, sepse dihet, që peqinasit dhe jo vetëm peqinasit, gjelat e detit i hanë deri më katërmëdhjetë mars që është festa e ditës së verës. Tjetri, që mund të ishte i nipi ose i biri, nuk reagonte. Ai qëndronte në këmbë i zhytur në mendimet e veta.

— Oj, oj, m'i lumtë atij derro çobani! — dhe paf gjurit me pëllëmbën e madhe dhe ha-ha-ha me buzët e mëdha. Tha prapë: — Këtij i them fat unë, të jesh çoban dhe të martohesh me vajzën e mbretit, po ty, moj gocë, si të quajnë?

— Mimoza, — tha vajza duke shikuar me frikë dhëmbët e bardhë e të mëdhenj të atij që e kishte pyetur.

— Mi-nimo! — u ngatërrua tjetri, përplasi pëllëmbën pas gjurit dhe tha: — Paç ymër. Ti e paske gojën brisk, he mashalla. He vallahi, he bilahi, s'e ka dëgjuar ndonjëherë lala një fëmijë të tregojë kaq bukur. Sa vjeç je?

— Tetë!

— Në ç'klasë?

— Të tretën!

— Të lumtë! — I ra gjurit. — Pastaj? Hë? Ç'ndodhi pastaj me çobanin e me të bijën e mbretit?

Ai tjetri, që rrinte në këmbë pranë burrit me dhëmbë të bardhë e të ngjeshur dhe që ishte fare i ri, rreth njëzet vjeç, nuk fliste, bile tashti dukej sikur as dëgjonte, as buzëqeshte, as lëvizte, as shikonte njeri, si të mos ishte aty, si të ishte, ta zëmë në Shistavec të Kukësit, apo në Koni-spol të Sarandës, apo në Madagaskar e Honolulu, bile në skajin më verior të Polit Verior, se ashtu dukej: njeri i ftohtë, që zor se e ngrohte edhe dielli i ekuatorit.

Vangjeli, që ishte një kokë më lart se e shoqja e se shoku i fëmijërisë, shikoi një herë të shoqen, pastaj shokun, pastaj të bijën, pastaj të atin (i ati dremiste) pastaj pasagjerin që kishte hipur në Peqin e që sapo kishte shprehur kënaqësinë e tij për rrëfimin e bukur të Mimosës.

Tha Vangjeli:

— E kam thënë unë, Moza ka talent, ka elokuencë! — Vangjeli kishte një të metë, nëse mund ta quajmë të tillë: zërin e kishte më të fortë se vullnetin. Kështu dukej. Këtë përshtypje të jepte tek e shikoje apo tek e dëgjoje të fliste. Por këtë të metë Vangjeli e plotësonte me entuziazmin e tij tepër elokuent (po të flasim me gjuhën e Vangjelit).

— Ka rrjedhshmëri Moza dhe të bën për vete me mënyrën si i tregon përrallat! — tha ai. Tha prapë: — E se mos vetëm përrallat!

— E pastaj, moj çupë, ç'ndodhi? — pyeti ai që kishte hipur në Peqin e që i shkëlqenin dhëmbët e bardhë.

Shoku i fëmijërisë, ai që quhej Tajar apo Bujar, mbylli librin, pa e hequr gishtin nga faqja, hoqi gjyzlykët dhe shikoi rrotull me një vështrim të qetë, të privuar nga çdo shenjë entuziazmi apo armiqësie. Ai dukej gjakftohtë si një hetues, se edhe pamjen e kishte prej hetuesi: shikimi i tij ishte një hetim nëpër tiparet e tjetrit, pastaj po ai shikim futej thellë përtej tipareve, futej në kokë e në zemër të tjetrit. I tillë ishte dukur që në çastin kur u takuan e këmbyen me Vangjelin kujtimet e përbashkëta të fëmijërisë së tyre, por tashti që Vangjeli ishte ngjitur në kulmet e en-

tuziazmeve të tij për rrëfimet e Mimosës, gjakftohtësia e shokut, që ishte një gjakftohtësi profesionale ose gati profesionale, ia kishte thyer disi zemrën, ia kishte prishur disi humorin, ia kishte tulatur disi entuziazmin Vangjelit.

Tha ai:

— S'është ashtu, Vangjel, jo!

Vangjeli nuk e zgjati. Shoku e kishte kundërshtuar me një zë aq të thellë, sa fjalët e tij më shumë qenë kuptuar me intuitë sesa qenë dëgjuar. E njihje ai shokun e vet me sa zor fliste, e dinte që e kishte zakon të fliste aq pak sa, për të nxjerrë diçka nga ato që thoshte, duhej të ishte paleontolog ose ta vije veten në pozitën e paleontologut i cili, duke u nisur nga një copë kockë, ka për detyrë të përcaktojë jo vetëm çfarë kafshe ka qenë, ku e kur e si ka jetuar, në ujë apo në tokë, me këmbë apo me fletë, çfarë fiziku apo skeleti ka pasur, por edhe cilat kanë qenë zakonet e saj dhe me çfarë është ushqyer, ka qenë vegjetariane, mishngrënëse etj. etj.

Ja, pse, mendoi Vangjeli, nuk ia vlente t'ia zgjaste apo të kërkonte shpjegime nga ai që ishte shoku i fëmijërisë. E për të treguar se s'kishte ndër mend të bisedonte me të, ose për të treguar se nuk i kishte dhënë rëndësi frazës së tij, apo nuk e kishte kuptuar, apo thjesht nuk e kishte dëgjuar zërin e tij të thellë (shoku i fëmijërisë zërin e kishte pasur gjithmonë të dobët) Vangjeli shikoi nga Mimoza me pamje të fryrë dhe entuziaste, si një aktor pa talent, dhe me mimikën e tij të ngjallur, ta zëmë se i tha: «Jepi, Moza!» Dhe Moza ishte gati të fillonte, kur një instikt i fshehtë dhe i papritur ia shpoi nervat Vangjelit si gjilpërë.

— Stefan, o vëlla, — tha ai befas. — Ç'më flet kaq i përnduar!

Ai që nuk quhej as Tajar as Bujar, por që quhej Stefan, e që kuptoi se tjetrit i qenë acaruar pak nervat, e pa të udhës të mos lëvizte as edhe një muskul të fytyrës, kurse Vangjeli, që kishte cilësinë të orientohet menjëherë, vuri në veprim mimikën në drejtim të vajzës «Jepi!»

Në të njëjtën kohë që e bija filloi të tregonte përrallën e mbretit dhe të çobanit që mori për grua të bijën e

mbretit, nga altoparlanti i vagonit u dëgjuan akordet e gëzuara të një kompozitori shqiptar.

Përralla e mbretit dhe e çobanit, që mori jo një, jo dy, por tri gra e që të tria vajza mbretërisht e që ngriti një pallat më të madh se të tre mbretërit bashkë e që jetoi i lumtur me tri gratë, zgjati nga Peqini në Kavajë. Gjatë tërë kohës që Mimoza tregonte se si çobani e mbushi botën me trëndafila për vjehrrin apo mbretin e parë, se si çobani me ndihmën e shpezëve të zeza e mbushi botën me vreshta rrushi, sa të hante e tërë ushtria e mbretit, apo e vjehrrit të dytë, se si çobani vrau kuçedrën, kusht i mbretit apo i vjehrrit të tretë, ai pasagjeri i ngjallur, me dhëmbët e bardhë e të mëdhenj, një e dy mbeti duke qeshur, duke miratuar, duke i rënë gjyshit me bërryl (gjyshi trishtohej e dremiste prapë) por sidomos atij iu skuqën pëllëmbët duke i rënë gjurit të vet dhjetë herë për çdo nuse të re që merrte çobani.

— Sa bukur! Sa bukur! — thoshte ai. — Unë nuk kam dëgjuar një fëmijë të tregojë kaq bukur!

— E kam thënë unë! — thoshte herë-herë Vangjeli Shoku i fëmijërisë Stefani ngriti për një çast fytyrën nga libri. Fytyra e tij u duk krejt e zhgënjyer.

Elsa nuk i hiqte sytë nga ngjyrat e arta të qiellit. Malet e pyjet, që pak më parë qenë dukur si njolla të zeza apo të errëta, tashti qenë bërë të gjelbra e vjollcë. Vjollcë u bënë edhe luginat, edhe qielli sipër tyre. Kishte aguar.

— Apo jo, Elsa! — ngacmoi Vangjeli të shoqen me bërryl. Tha prapë: — Dëgjoje, moj Elsa, Mozën tënde!

Vangjeli nuk ishte nga ata që mund t'i shpëtonin hollësisht. Ai e kishte vënë re menjëherë fytyrën e zhgënjyer të Stefanit dhe, i bindur se Stefani ishte penduar për qëndrimin mospërfillës ndaj përrallave të Mimosës, tha jo pa ironi:

— Ç'na thua, shoku Stefan!

Por të kuptohemi: gjithçka te Vangjeli ishte përpunuar me një farë finesë, prandaj edhe ironia në zërin e tij qe plotësisht e matur apo e graduar, aq sa Stefani mundi ta duronte pa vështirësi, vetëm se e shikoi Vangjelin po me atë vështrim të çuditshëm që e kishte shikuar kur Mimo-

za tregonte ose mbaronte përrallën e mbretit me Qerosin dhe sërish, si pak më parë, këtë vështrim e shoqëroi gjithashtu me një buzëqeshje, që nuk ishte e zhveshur nga disa nuanca therëse... se edhe Stefami e kishte treguar aftësinë e tij ironike, se edhe ai dinte të të shponte me sytë e tij të thellë që prapa gjyzykëve.

Kështu, Vangjeli e pa të arsyeshme të hiqte prapë dorë nga shoku i fëmijërisë (të cilit s'dihej sepse i pëlqente të heshte) e të kthehej sërish nga e shoqja:

— Po ti, Elsa...

— I kam dëgjuar dhe një herë tjetër këto përralla, — tha ajo e mërzhitur e me vetulla të mbledhura. Rrudha midis tyre ishte bërë më e thellë.

— E pastaj, se i paske dëgjuar?

— Më lër të shijoj mëngjesin e këtij marsi!

— Po-o, sigurisht! — u tall me kujdes Vangjeli. — Mos je duke menduar se këto pamje janë të përsosura si vizatimi i Rafaelit? Apo si ngjyrat e Rubensit? Apo mos do të thuash se ky mëngjes marsi është larë në ngjyrat e ngrohta të Rembrandit. Ë-ë-ë-?! — e ngacmoi ai të shoqen me bërryl dhe nënqeshi miqësisht.

E shoqja nuk qeshi, por buzën në gaz e vuri. Dhe tha ose përsëriti:

— Vangjel, më lër, pra, të shijoj mëngjesin e këtij marsi!

Vangjeli vërtet dukej sikur nuk e lodhte trurin, por alegoritë, ose të paktën ato që atij i dukeshin si alegori (ashtu si ironitë) i kuptonte menjëherë. Tha:

— E ke fjalën me romuze?

— Ç'romuze? — pyeti e çuditur e shoqja dhe s'dihet pse e mbuloi diamantin e unazës me pëllëmbën tjetër. Ai diamant i zburste akoma më shumë ngjyrat mëngjesore të pranverës së parakohshme, i bënte kështu më të bukura, dhe si të tilla i bënte ireale, si përrallat e Mimosës.

— Mos të duket shpejt për moshën e Mimosës të tregojë një përrallë që zgjat gati një gjysmë ore?

Elsa e shikoi në sy. Në sytë e saj kishte njëqind pikëpyetje.

Gjyshi i Mimosës ngriti kokën dhe tha:

— Çfarë ndriçimi!

Ndoshta edhe fjalët e të atit, Vangjeli i mori për alegori, por me të atin ai sillej mirë e me edukatë. Pyeti:

— Baba, e ke fjalën për dritat e vagonit apo për dritat e mëngjesit?

— Çfarë?

— Edhe ti për mëngjesin e këtij marsi?

— Nuk të kuptoj! — tha i ati dhe uli kokën në pozën e ritit të lashtë, dmth në pozën e dremitjes.

Ai tjetri, i shtati, djali njëzetvjeçar që qëndronte në këmbë e që kishte hipur bashkë me burrin dhëmbëbardhë, dhëmbëgjeshur e dhëmbëmadh nuk fliste fare, ai sikur nuk ishte aty, bile të dukej sikur nga Madagaskari apo Shishtaveci tashti kishte fluturuar në hënë, aq të huaj e aq të largët e ndiente veten nga gjithë ato biseda që bëheshin për përrallat e Mimosës apo për ndriçimet e mëngjesit të marsit.

Muzika e kompozitorëve shqiptarë u ndërpre dhe nga mikrofoni i vagonit lajmëruan se treni kishte arritur në Kavajë.

— A-a, për pak harruam të zbrisnim, — tha burri dhëmbëgjeshur dhe, para se të ngrihej, lëshoi edhe një herë pëllëmbën e tij të madhe mbi gjurin e vet. — Mirë mbetshi, — tha ai dhe, pasi bëri dy hapa, shikoi djalin e ri, që s'kishte lëvizur nga vendi e që dukej se nuk dëshiron-te ta ndiqte pas ose edhe po ta ndiqte, diku do të shkëputej nga ai. — Erdhëm në Kavajë me nipin, se duam ta martojmë, — tha dhëmbëgjeshuri apo «Tregtari» i Rubensit dhe shikoi me inat nga i nipi.

Pastaj nipi, si të kishte zbritur nga hëna, hoqi këmbët zvarrë pas xhaxhait dhe një minutë më vonë u zhdukën të dy në vorbullën e njerëzve që hipnin e në vorbullën e njerëzve që zbrisnin.

Vangjeli (që, siç kemi thënë, i vinte re hollësiat) tha me zë të zgjatur:

— I paska i-i-ikur nipi nga duart!

Fytyra e Stefanit shkëlqeu. Me atë shkëlqim ai sikur deshë të tregonte se ishte i një mendjeje me Vangjelin.

Meqë hëpërhë Mimoza po bënte një pushim e meqë

Vangjeli, për shkak të atij shkëlqimi e ndjeu veten të afruar me shokun e fëmijërisë, befas e pyeti:

— Sa do të qëndrosh në Tiranë, Stefan?

— Nuk e di, ca ditë!

— Sa vjet t'u bënë që shkrin çeliku?

— Tërë jetën, — pohoi tjetri.

— Në Metalurgjik sa?

— Që nga fillimi!

— Brigadier i montimeve, sigurisht?

— Po. Vitin e fundit shkrires në njëren nga furrat elektrike.

Kur tha kështu, Mimoza nguli vështrimin e pastër e të zgjuar mbi këtë xhaxha, që kishte qenë mik fëmijërie me të atin e që punonte në Metalurgjik, ku ajo kishte qenë një herë, kishte parë ata që ngulnin në tokë shtylla të rënda, kishte parë ata që saldonin me atë flakën e fortë që të verbonte sytë dhe pastaj mësuesja i kishte çuar edhe në furrat elektrike, ku shkrihej çeliku. Po atje Mimoza s'kishte qëndruar shumë. Jo vetëm ajo, edhe shoqet e saj. Edhe çunat, që mbaheshin më trima s'kishin qëndruar shumë. Atje flaka ishte e madhe, atje kishte ca hekura të skuqur që po t'u afroheshe, bëheshe thëngjill i skuqur menjëherë. Ajo që quhej furrë elektrike, ulërinte më shumë se një aeroplan në qiell, ulërinte më shumë se të gjitha kuçedrat e përrallave që kishte dëgjuar ajo. Ja, atje, tek ajo furrë kishte thënë se punonte edhe ky xhaxhi që s'ishte aq i thinjur por që ishte me gjyzykë. Mimoza dhe shoqet e saj ishin larguar shpejt nga furra, mësuesja kishte qeshur dhe kishte shkuar pas tyre.

Ajo kishte qejf t'ia thoshte xhaxhit të gjitha këto përshtypje, por i ati vazhdoi bisedën me shokun e tij të fëmijërisë.

— Me leje, sigurisht! — tha Vangjeli.

— Jo, në një aktiv!

— Për çelikun? — dhe vetvetiu sytë e Vangjelit u ngulën në duart me kallo e si të përzhitura të Stefanit.

— Jo, për disa probleme të gjykatave!

— Pse-e-e?

— Tri ditë më parë më lajmëruan se do të punoj në një nga gjykatat e rretheve.

— Shiko, shiko, nuk të shkoi kot Fakulteti i Drejtësisë.
— Me leje, mund të ulem? — tha dikush i veshur me rroba pune.

Para se Vangjeli të thoshte «posi», i ati, që ishte përhapur sërish në vendin bosh, kishte shkuar pranë Mimosës dhe pasagjeri ishte ulur.

Me të filluar rrotat e trenit të godisnin ritmikisht mbi shina, si të ishte kjo goditje një sinjal i domosdoshëm, apo fundja, edhe një refleks, Mimoza tha:

— O babi, a ta tregoj edhe atë përrallën e djalit të mbretit me dervishin?

— Tregoje! — i tha Vangjeli.

— Apo të tregoj përrallën e djalit peshkatar që mori nuse të bijën e mbretit?

— Cilën të duash!

— Mirë atëherë, po tregoj këtë të fundit.

...Kur e bija e mbretit i dha të birit të peshkatarit, që ishte shu-u-u-më i bukur, një pjesë të thesarit të mbretit, fshehurazi nga i ati, dhe e porositi të shkonte në Evropë, të vishej bukur e sipas modës, me gjërat më të kushtueshme, e, pasi të kishte mësuar kulturën, sjelljen dhe jetën e Europës, të blinte ca mallra nga më të bukurat e pastaj të kthehej në Shqipëri e të hapte një dyqan që të mos ishte parë kurrë, kur përralla e Mimosës arriti në këtë pikë, ai që ishte ulur në krah të gjyshit e që ishte veshur me rroba pune, lëvizi njërin dorë dhe u duk aq i çuditur, si të ishte duke dëgjuar për bëmat biblike ortodokse ose për legjendat e Mesopotamisë ose për përrallat e popujve të Veriut. Mund të thuash se fjalët, apo disa fjalë të Mimosës, dmth fjalët apo disa fjalë të përrallës, iu dukën gjëra të rralla e njëkohësisht të tmerrshme.

Tha ai:

— Mos, vajzë, lëre peshkatarin të qetë, se nuk e bën të pasur mbreti, as nuk e bën të kulturuar moda e huaj!

— Kur u kthye i biri i peshkatarit në Shqipëri, — vazhdoi Mimoza për nder, — dhe hapi dyqanin, atëherë mbreti i shkoi për vizitë, sepse kishte dëgjuar shumë fjalë të mira për atë djalë të pasur dhe ia kishte qejfi t'i jepte të bijën për grua...

Dora e tjetrit kishte lëvizur përsëri:

— Sikur ta dije ti, moj vajzë, ç'helm na sjell ajo modë e huaj e sikur ta dije ç'kemi hequr ne kur patëm mbretin, nuk do ta tregoje këtë përrallë! — tha ai që ishte veshur me rroba pune. Dora e tij ishte ulur, ishte fiksuar dhe tashiti, me atë dorë ai mbante një cigare të ndezur. Mënyra si e thithte cigaren dhe si e hidhte tymin përtej, si të mos ishte tym, por curril uji, të gjitha këto e gjithçka tjetër dëshmonin për tensionin që varej mbi kokat e atyre që ishin ulur aty pranë.

Tha Vangjeli:

— Le të tregojë, more shok! Nuk është mirë t'u pritet iniciativa të vegjëlve. Kurrë nuk duhet t'u pritet iniciativa.

— I ati jeni ju? — Ai që pyeti kishte një zë të ulët, si nota e parë e gamës muzikore.

— Po!

— Unë them se nuk është mirë të tregojë përralla të tilla!

— Pse-e?

— Gabim!

— Nuk duhet t'u pritet iniciativa të vegjëlve! — tha prapë Vangjeli.

— Nuk është mirë! — tha tjetri me zërin që tashti e kishte ngritur në notën e dytë të gamës. — Gabim!

— Mos të duken përralla të gjata?

— Nuk e kam aty!

— Nuk të kuptoj!

— Këto s'janë përralla të mira, more shok, — tha tjetri. — Më fal, po...

Ndërsa ai me rroba pune fliste e shpjegonte përse ishte gabim, befas Vangjeli bëri një kthesë në qëndrimin e tij. Ai, ose nuk gjeti fjalë për ta kundërshtuar, ose nuk dëshoi ta zgjaste debatin aty në tren. Më shumë dëgjoi, më shumë heshti, më shumë buzëqeshi dhe buzëqeshjet e tij ishin si pa kockë, ishin si të shtira, ose kishin kuptim të dyanshëm: mirë dhe keq, pro dhe kundër, po dhe jo. Këtë donin të thoshin ato buzëqeshje e këtë donte të thoshte qëndrimi i tij me ekuivoqe e me ato tundje të kokës po aq ekuivoqe. Në këtë qëndrim të Vangjelit, ndoshta vepron-

te edhe ndikimi i së shoqes e cila, pa e hequr vështrimin nga dritarja e vagonit (mu sikur nga vështrimi i saj atje jashtë të varej shpëtimi i botës) shtrëngonte herë-herë krahun e të shoqit. Por këtë punë ajo e bënte me takt, që të mos binte në sy e të mos e vinte në pozitë të ngushtë të shoqin. Kjo gjendje vazhdoi derisa ai njeriu me rroba pune zbriti në Durrës.

Gjyshi, që kishte dalë nga dremitja (ashtu dalin ata që dremisin kur treni qëndron) që shikonte këmbët e veta e që dukej tepër asnjanes, e çliroi përsëri Mimosën duke u shtyrë në cepin e ndenjës.

Në Durrës ndodhi që nuk u ul më njeri pranë tyre dhe familja, plus shoku i fëmijërisë, Stefani, mbetën vetëm.

Vangjeli, që ishte më i madh nga trupi e që gjatë gjithë kohës kishte qëndruar i mbështetur në ndenjësë, i ngjallur e pa formë, si një kontinent i mbuluar nga mjegullat e përherëshme, tashti u duk sikur qëndronte si mbi gjëmba, dhe as që mund të bëhej më fjalë për atë gjendje euforie ku qe ngjitur pak më parë. Për më tepër, tashti ai qëndronte në mes të njerëzve të vet e pranë shokut të vet, i menduar, bile edhe pak i hidhëruar dhe, kur buzëqeshte me pahir, atëherë e zbulonte më shumë hidhërimin. Po sidoqoftë, Vangjeli nuk ishte nga ata që jepen lehtë. Kur trupi i tij i madh doli nga mjegullat e tunelit të Rrashbullit, befaz u kthye nga shoku i fëmijërisë dhe pyeti:

— Po ti, Stefan, çfarë mendon për këto që dëgjove?

Ai kështu e pyeti, por aty për aty u pendua, se jo vetëm që Stefani ishte shprehur edhe më parë, por, edhe sikur të mos ishte shprehur, mjaftonte ai zhgënjim në fytyrën e shoqut, që Vangjeli të kuptonte cili do të ishte qëndrimi i tij. Ky qëndrim lexohej si në një libër të hapur, në sytë, në gojën, bile edhe në thinjat e Stefanit, që i kishte të ashpra e vende-vende të ngritura përpyetë si shtiza në drejtim të Vangjelit. Po Stefani ishte njeri i qetë — i tillë kishte qenë edhe në fëmijëri — nuk ngutej kurrë dhe zërin e kishte të graduuar, ose më mirë, pa tingull, por gjithmonë të graduuar, e meqë ishte njeri i qetë, ai nuk foli menjëherë. Edhe këtë e dinte që më parë Vangjeli. E, megjil-

thëse e dinte, nuk priti sa shoku të mbliidhte mendimet për t'i dhënë sentencën, por foli vetë:

— Djalli ta marrë, s'jam njeri pa amur-propër. — Tha sërisht: — Të kujtohet kur zemëroheshim në fëmijëri, sepse ndodhte që ti të më kundërshtoje? Edhe tashti, pas bisedës që bëra me atë shokun që zbriti në Durrës, e ndiej veten shumë keq, m'u duk sikur nuk më kuptoi, sikur nuk u bind, që asgjë nuk i vjen Mozës nga pesë përralla me mbret, kur ajo s'ka lënë pa lexuar pothuajse asnjë libër të shkrimtarëve tanë për fëmijë, kur ajo mund të ketë lexuar më se njëqind përralla me hidrocentrale e me punëtorë. E vura re, megjithëse ia thashë të gjitha, prapëseprapë ai s'deshi t'ia dinte, ishte tepër i ngushtë, mund të them dogmatik, si kalë karroce, po, djalli ta marrë, njeriu s'është kalë karroce, njeriu është njeri. Ai edhe nga pamja m'u duk shumë arkaik e shumë primitiv. Në vend që njerëzit të çuditen e të kënaqen për talentin e një fëmije, shpejtojnë të thonë kushedi çfarë, sikur Moza ime po bëhet shkaktare për shembjen e botës.

Heshtën një çast apo më shumë se një çast.

— Të flasim pa egoizëm, — tha Vangjeli kokulur, me eufori të avulluar e me hidhërim të përqëndruar. — Unë e di që njeriu s'duhet të jetë egoist. Nga egoja kanë lindur të gjitha të këqijat: zilia, pabesia, tradhtia, grykësia, djalli e ku ta di unë. Ca thonë se edhe vetë bota ka lindur nga egoja. Këto që po t'i them, i kam lexuar te një shkrimtar i huaj.

Ai u mendua një hop.

Tha:

— Po edhe fare pa ego e pa ambicie njeriu nuk duhet të jetë. Edhe unë kam një plan për Mozën time! — Këto tha Vangjeli dhe kësaj radhe heshtja e tij qe e gjatë, si të ishte penduar për zbulimin e këtij plani.

— Çfarë plani? — pyeti Stefani!

— Që Moza të bëhet aktore e madhe. Nëse nuk bëhet aktore e madhe, të bëhet historiane e madhe. Në qoftë se nuk bëhet historiane e madhe, të bëhet shkrimtare e madhe. Ti e dëgjove vetë sa bukur e sa rrjedhshëm tregon, ti e pe vetë çfarë kujtесе ka. Unë pikërisht kësaj ane i jap

rëndësi në rrëfimet e Mozës e jo çfarë thotë, por si e thotë. Mua më intereson t'i zhvillohen fantazia, iniciativa, elo-kuenca, si i thonë disa, dhe përsa i takon edukimit, që thua... ti, që thonë disa, që tha ai që zbriti në Durrës, edukimin ajo do ta gjejë në shkollë, në shoqëri, në fa-mil-je, në Institutin e Lartë të Arteve, në trupën e Teatrit Popullor, në Institutin e Historisë, në Lidhjen e Shkrimtarëve. Atje ia ndreqin samarin po i shkoi shtrembër, është populli, pub-liku, është Partia mbi të gjitha, që ua tregojnë njerëzve rrugën nga të ecin e si të ecin.

Pas këtyre fjalëve zotëroi përsëri një heshtje e gjatë. Dëgjoheshin rrotat e trenit mbi shina.

Gjyshi dremiste. Koka e tij tundej dhe shoqëronte lëvizjet e vagonit.

Elsa shikonte përtej dritares.

Stefani hetoi një copë herë fytyrën e Elsës. Ai kuptoi se ajo tjetër gjë shikonte, tjetër gjë mendonte. Iu kujtua një vizitë në kinostudio. Sinkronizimi i zërit me kuadrin. Sinkronizimi i vështrimit me mendimet. Asinkron.

Pas pak Stefani u bind se edhe gjyshi nuk dremiste më, ai përgjonte dhe kjo kuptohej nga koka e tij, që nuk tundej e nuk i shoqëronte më lëvizjet me lëkundjet e vagonit.

Mimoza kishte mbetur si një zog i plagosur dhe plaga që kishte marrë nuk e lejonte të fluturonte hëpërhë. Ajo shikonte herë të ëmën, herë të atin, por nuk harronte të shikonte edhe gjyshin, edhe xhaxhi Stefanin, që i shikonte të gjithë një për një, që shikonte shumë por fliste pak.

Heshtja vazhdonte dhe kjo heshtje ia ngriti nervat më shumë Vangjelit. Ai deshi ta thyente atë, deshi të fliste me çdo kusht, deshi mendimin e të tjerëve dhe s'dihet pse qe pikërisht e shoqja ajo që u bë viktimë e parë e zemërimi të tij.

— Po ti, mos je duke zbuluar përtej dritares kontinentin e gjashtë të botës? — gati bërtiti ai.

— Po ç'të bëj? — pyeti Elsa e zënë në befasi.

— Të japësh mendimin tënd për këto që dëgjove këtu!

Pas këtyre fjalëve ajo e shikoi të shoqin me vështrimin të përqëndruar të piktorit në çastin e frymëzimit, në

çastin kur ai me laps apo me penel në dorë fillon të hedhë format apo ngjyrat e para të portretit. Koka e Vangjelit ishte si një katërkëndësh, e gjatë dhe e ngushtë: ajo ngjante me kokën e «Udhëtarit» të Rembrandit, por ai, me qëndrimin që mbante, kishte ditur t'i jepte kësaj rëndësinë dhe pozicionin e kokës së një mbreti. I tillë iu duk i shoqi në ato çaste, mbret e perëndi bashkë, që përpiqet ta rrethojë veten nga aureola e qetësisë olimpikë.

— Mendimin tim unë ta kam dhënë më parë... — Elsa i rralloi fjalët, gati i ndërpreu. Ajo e dinte se Vangjeli, po ta humbiste pak, po të bëhej nervoz, ishte në gjendje të nxirrte nga goja edhe absurditete. Por ajo e dinte gjithashtu se, po ta kritikojë, ai prapë gjente fuqi të tërhiqej, të pranonte fajin, por midis vrullit të parë dhe pranimit të fajit duhej të kalonte një kohë, duhej që ai t'i kishte zbrazur absurditetet e veta dhe Elsa pikërisht këtij çasti i ruhej, nuk i pëlqente që aty në tren të zemërohej e të bënte skena me të shoqin. Duke parë se u vonua në përgjigjen e saj, duke ndeshur me vështrimin këmbëngulës të Vangjelit, ajo tha:

— Po, jam gati të pranoj mendimet... e tua! — Por mënyra si i tha këto fjalë, mënyra si i shqiptoi, mënyra si e mbaroi frazën me një farë ndërprerjeje e sidomos intonacioni i zërit të saj, tregonin se në fund të kësaj përgjigjeje kishte një «por» të pashprehur.

Edhe Vangjeli e vuri re këtë «por», edhe ai vuri re se nga sytë e saj, pikërisht ndërsa fliste, kishte lindur një zinxhir i gjatë mendimesh kontradiktore, por edhe mendimesh që e kundërshtonin hapur atë. Megjithatë edhe ai, si e shoqja, nuk desh të bënte skena në tren, heshti dhe heshtja e dytë vazhdoi më gjatë se e para.

Gjyshi doli prapë nga dremitja, shkundi kokën, fërkoj me gishta sytë, shikoi rrotull, u çudit për heshtjen e për fytyrat e menduara të të tjerëve, dhe si për t'i nxjerrë nga kjo gjendje, u kthye nga e mbesa duke thënë:

— A s'do të na tregosh një përrallë tjetër, moj vajzë?

Pas këtyre fjalëve të gjyshit, befas shpërtheu një e qeshur e përgjithshme. Sytë e gjyshit u shpërgjumën dhe u bënë esëll.

Ndërkaq ato spazmat e zemërimit të parë të Vangjelit, kur ndeshi në kundërshtimin e të tjerëve e në përgjigjet e dyshimta të së shoqes, kishin rënë pak, qenë zbutur sepse, me sa mbante mend Stefani, humori i keq nuk e kishte mbajtur kurrë gjatë Vangjelin. Por kishin kaluar kaq vjete pa u takuar dhe Stefani mendoi të ishte më i kujdesshëm.

— S'je i kënaqur me mendimet e mia? — pyeti befaz Vangjeli drejtpërdrejt shokun e vet.

— Jo! — tha Stefani, po për të zbutur sa më shumë efektin acarues që mund të bënte kjo «jo», ai u përpoq të përdorte notat më intime të zërit të vet.

— Mos pañdeh ti se jam njeri pa bindje e pa mendime? — Kur tha këto fjalë, fytyrën e Vangjelit e kishte mbuluar një seriozitet solemn e përmbi këtë solemnitet që shtrirë një buzëqeshje kryeneçe.

Tha Stefani:

— Jo, nuk pandeh! — Dua të them se bindje e mendime ke, por duhen harrur, u duhen hequr skoriet?

— Ti, Stefan, ke një të metë, që më duket se e ke pasur që në fëmijëri.

— Ç'të metë? — pyeti Stefani.

Tha Vangjeli: — Që nuk kënaqesh me pak!

— Tashti nuk të kuptoj unë ty!

Tha Vangjeli: — Nuk kënaqesh lehtë!

— Prapë nuk të kuptoj!

Tha Vangjeli: — Nuk kënaqesh asnjëherë!

— E pse, mos duhet të kënaqem gjithmonë?

Heshtën një çast.

Tha Stefani: — Po ti?

— Unë kënaqem me pak. Unë... nuk e di!

Tha Stefani: — Ka gjëra me të cilat nuk duhet të luajmë!

— Për shembull?

Tha Stefani: — Me përrallat e sotme të Mimosës. Çështje koncepti. Sot pesë përralla, nesër kushedi çfarë skoriesh të tjera mund të mos i pastrosh nga çeliku ynë!

Mimoza, që kishte marrë me kohë pamjen e një zogu të plagosur, u duk sikur shkundi puplat.

Tha Vangjeli si duke qeshur:

— Unë s'di të ketë dalë ndonjë urdhëresë që të ndalojë fëmijët të mos tregojnë përralla me mbret! — Ashtu foli, si duke qeshur, por në të vërtetë hidhërimi ishte dyfishuar në fytyrën e tij.

— Vangjel! — foli e shoqja. Edhe sytë, edhe zëri i saj tshin kthyer në sinonim të qortimit.

— Jo... po... — tha gjyshi me një ton mitologjik.

Sakaq pamja e Vangjelit që bërë arrogante, sidomos hunda që, si në disa përralla, dukej sikur kishte rënë nën pushtetin e djallit. Tashti ai shikonte të tjerët, por jo në sy, ishte hunda arrogante ajo që shikonte, dhe në këtë pozë nuk ishte aspak vështirë të kuptoje se qetësia olimpike e Vangjelit që tronditur dhe siguria e tij prej mbreti që lëkundur. Kishte mbetur thjesht «Udhëtari» i Rembrandit me kokën në formë katërkëndëshi, më shumë të gjatë e fare pak të gjerë në fund.

— Ti je shumë e re, — tha Vangjeli, duke shikuar nga e shoqja, — dhe ti je shumë plak, — tha Vangjeli, duke shikuar nga i ati, — për të kuptuar çfarë dua të them unë!

— Unë... asgjë! — tha i ati i zënë ngushtë. — Mua më pëlqejnë përrallat e Mozës.

Tha Stefani:

— Vangjel, mos u merr shumë me moshën e me pamjen e njerëzve. Ti the se ai...e kishte pamjen arkaike, dhe unë po shtoj nga ana ime se pamjen mund ta kishte arkaike, por mendimet jo.

Ndërhyrja e Stefanit e bëri të heshte Vangjelin. Po fytyra e tij e ngjallur dhe si e ngrirë tregonte se ai s'kishte ndër mend të pajtohej me vërejtjet që i bënin. Prandaj hendër shtja e tij nuk zgjati më shumë se një çast. Në çastin tjetër, duke shikuar jo Stefanin, por gjyzlykët e Stefanit, mbi të cilët thyhej shkëlqimi i rrezeve të pjerrëta të mëngjesit, Vangjeli tha:

— Po le të dëfrehet Moza edhe ca kohë, përderisa është akoma e vogël. — Duke u kujtuar se afërsisht këtë mendim e kishte shprehur më parë, shtoi: — Edhe ne kemi folur

e kemi treguar si ajo kur ishim të vegjël. — Iu duk se kishte kapur një mendim interesant. Tha i frymëzuar: — Moza do të ketë kohë për ta mësuar marksizmin, bile më mirë se ne. — Vangjeli e ngriti zërin si triumfator: — Ç'të keqe patëm ne dyzetepesëvjeçarët e sotshëm, që u rritëm pa na mësuar njeri nga këto gjëra? A s'kemi lexuar përralla me mbretër të mirë sa jemi shqepur, e megjithatë sot jemi qytetarë të socializmit? Qytetarë të nderuar!

Përtej gjyzlykëve, Vangjeli ndjeu sytë e Stefanit që e shpuan. Jo vetëm kaq. Një çast më vonë, Vangjeli ndjeu gjithashtu se vështrimi i tij kishte qenë asgjësues. Ai, Stefani, që mezi kishte pritur të mbaronte Vangjeli, tha me zërin e tij të butë e të ulur, që dukej sikur nuk kritikonte e nuk qortonte, po përkundrazi, sikur përkëdhelte:

— Po ne duam që brezi i ri të ngjitet më lart se ne!

Elsa, që e kishte hequr vështrimin nga fushat e nga kodrat e Vorës (ndoshta sepse rrezet e pjerrëta të diellit i vrisnin sytë) pas fjalëve të fundit të Stefanit do të dëshironte ta krahasonte të shoqin me «Danielin në gropën e Luanëve» të Delakruasë. Po një krahasim i tillë nuk mund të bëhej, se Vangjeli nuk mund të shpëtonte si Danieli, ai s'ishte personazh biblik, ai duhej të fliste me gjuhën e njerëzve të kohës sonë dhe Elsa vuri re se ai pikërisht këtë gjuhë e kishte të vështirë. Ajo dhe vetëm ajo dinte ta lexonte më mirë se cilido tjetër fytyrën e të shoqit, që në të njëjtën kohë shprehte siguri dhe qetësi e në të njëjtën kohë pasiguri e shqetësim. Kështu dukej. Dhe kështu duhej të ishte.

Tha ajo:

— Vangjel, dëgjo edhe të tjerët çfarë të thonë:

Busti i madh i Vangjelit sikur u drodh ose të paktën u duk sikur u drodh. Por ishte fytyra e ngjallur ajo që e tradhtonte Vangjelin, sepse, me një mimikë të shkathët e të shpejtë, fjalët e së shoqes ai i hodhi përtej, si të mos ishin fjalë, por një copë bukë e mbushur me miza.

Tik, tik-tik e shpuan sytë e Stefanit përtej gjyzlykëve. Vangjeli që, me sa dukej, ishte mërëzitur nga ato vështrime, tha afërsisht po ato që kishte thënë:

— Fundja, ç'u duhet njerëzve të interesohen kaq shu-

më për fatkeqësinë time, në qoftë se edhe pesë përralla të Mozës janë një fatkeqësi?

Tha Stefani me zërin e butë:

— Atëherë mbyllu në guackën tënde.

— Kush, unë? — briti Vangjeli dhe nga toni i zërit të tij u duk sikur e kishim akuzuar se çfarë kishte bërë ai në çastin kur Hitleri firmoste urdhrin për ngritjen e kampeve të shfarosjes! — Kush, unë? Unë të mbyllem në guackën time?! Unë, që gdhihem në laborator e që fle aty sa herë më sjellin kampione të reja?

Tha Stefani:

— Në këto çështje, bile më tepër se në laboratorin tënd, që kërkon kalkulime të sakta, nuk duhet as t'i zbutësh gjërat, as t'i mprehësh më tepër sesa janë. S'është e nevojshme që të vërtetën ta veshim me celofan. Ajo duhet zbuluar ashtu siç e ka krijuar koha!

— O babi, — tha befas Mimoza, si të ishte kujtuar për diçka të harruar, — mësuesja na porositi të mos i tregojmë këto përralla. Përrallat me mbret. Mësuesja i tha një shoqes sime, që na i tregoi e para, ta pres kokën...

— Oj, ta pres kokën! — u çudit Vangjeli. — Mësuesja!

— Mos u kap pas frazave, — tha Stefani. — E vërteta është se jo vetëm ti, po shumë nga ne u bëjmë lëshime fëmijëve. Sa herë ndodh t'i dëgjojmë të recitojnë vargje të papërshtatshme ose të tregojnë gjëra të papërshtatshme, kurse ne u buzëqeshim dhe i përkëdhelim, të kënaqur për zgjuarsinë, në thonjëza, e fëmijës sonë, të kënaqur se fëmija po rritet e tjerë, e tjerë.

Vangjeli vuri buzën në gaz, si t'i thoshte: «Referat?!».

Nganjëherë, vështrimi i Vangjelit të kujtonte një njeri të trembur pikërisht në çastin kur është duke hedhur një hap prapa. Kurse në buzëqeshjen e tij të fundit, Elsa kishte vënë re një hije të lehtë armiqësie për shokun e fëmijërisë. Ajo nuk foli, po, si në fillim, kur e bija kishte nisur të tregonte përrallat me mbret, mbuloi diamantin e unazës me dorën tjetër dhe prapë midis vetullave të holla iu krijua një rrudhë e thellë, që dëshmonte për shqetësimin e saj. Mos vallë ajo kishte filluar të ndiente një farë li-

dhjeje midis përrallave që kishte treguar e bija dhe atij diamanti, që fliste me gjuhën e reflekseve të jashtme?!..

Edhe Stefani, si ta kishte kuptuar buzëqeshjen jo të këndshme të Vangjelit, që përpëlitej e nuk donte të dorëzohej, tha gjithashtu me të qeshur:

— Nuk mendoj se e mbyllëm me kaq këtë bisedë. Do të takohemi!

— Do të takohemi, — tha pa të keq Vangjeli dhe u mbështet në ndenjësë si një mbret i rënë në fatikeqësi, kurse Stefani, pasi tha me vete se Vangjeli kishte «amour-propre» shumë të zhvilluar, mbylli librin (treni i qe afruar stacionit, kishte prerë vrullin) hoqi gjyzykët dhe zuri t'i fshinte.

— I fshij, — tha Stefani, — sepse në orën nëntë fillon aktivi. — Tha prapë: — E kam zët kur filloj mbledhjen me fshirjen e gjyzykëve!

— Kurse unë kam zët të kolliturat e disave kur sapo marrin fjalën në mbledhje.

Gjyshi, s'dihet pse vuri buzën në gaz. Ai kishte dalë përfundimisht nga dremitjet.

Elsa dhe Mimoza po merreshin me rregullimin e çantave e të trastave.

Kur zbritën, platforma e stacionit ishte plot, siç mbushen rrugët që të çojnë në stadiume apo në bulevardet e shëtitjes. Njëra turmë dilte nga stacioni, tjetra futej për të shkuar në Laç. Ka një tren të tillë që vjen në mëngjes herët nga Shqipëria e Mesme, ka edhe një tjetër tren, që disa minuta më vonë mbushet me udhëtarë dhe niset drejt veriut të Shqipërisë, në Laç.

Platforma dhe rruga që të çon në platformë gumëzhinin nga zëra e zhurma të ndryshme dhe të gjitha këto zhurma e gumëzhima bashkoheshin në një akord të vetëm mëngjesor plot tinguj e nuanca.

Ata u ndanë menjëherë në trotuarin e rrugës së gjerrë. Vangjeli me familjen e tij duhej të merrnin unazën, Stefani do të merrte autobusin e kuq në ballë të Maternitetit, apo disa metra mbi Fakultetin e Shkencave.

Kur Stefani ktheu kokën dhe pa për herë të fundit Vangjelin, iu duk se Vangjeli ecte sikur të urrente diçka, sikur të shtypte diçka me këmbët e tij të mëdha dhe, në kundërshtim me mëngjesin e bukur të ditëve të para të atij marsi të vitit 1977, fytyra e Vangjelit e kishte humbur atë siguri të tepruar në vetvete dhe kishte rënë në mendime... në mendime...

1944-1977

TREGIMI I PARË

— Ishte natë dhe qentë lehnin kudo. Natë dimri. Dukej sikur botës po i vinte fundi, — tha ai dhe fshiu nga buzët shkumën e kafes. — Gjithçka ishte e keqe atë natë, gjithçka të dukej sikur ishte e gabuar. Errësira, ngrica, qentë, krismat e rralla, që shërbenin për të mbajtur palët kundërshtare në tension, të gjitha ishin të këqija e të gabuara. Kështu të dukej.

Tha ai:

— Në përgjithësi ai dimër ka qenë i egër edhe për ne, edhe për gjermanët, për të gjithë të gjallët. Në vështrim të parë, çdo gjë e gjallë, njerëz, bagëti e kafshë, bile edhe zogjtë e bishat e egra të pyllit dukej sikur prisnin të vdisnin apo të ngordhnin. Sidomos fëmijët. Asnjë nga fëmijët që takonim fshatrave nuk ishte i gëzuar. Edhe lodrat e tyre ishin të ngrysura. E gjithë bota ishte e ngrysur, të mëdhenj e të vegjël, të gjithë ishin të trishtuar e të ngrysur. Të copëtohej zemra. Por kjo përshtypje s'ishte reale, ajo ishte një përshtypje e sipërfaqëshme, siç thashë, vetëm në vështrim të parë, sepse në të vërtetë njerëzit nuk ishin ligështuar, nuk ishin mposhtur, nuk ishin dorëzuar. Sa më shumë që vdekja u vërtitej mbi kokë, aq më shumë ata

luftonin. Luftonin partizanët, luftonin gjermanët. Bam e bum. Sa t'i shikonin majën e gishtit apo majën e hundës njëri-tjetrit, kriste pushka, hajde-e-e...

I riu përballë tij shënonte çdo gjë që thoshte ai tjetri e që ishte veshur partizan. Ai i qe lutur vetë, që partizani t'i tregonte ndonjë nga ngjarjet e Luftës. Kishte dëgjuar se Kolë Boçari dinte shumë historira, se Kola kishte parë e kishte luftuar shumë dhe përveç kësaj, dinte të tregonte edhe bukur, megjithëse edhe Kola ishte vetë i ri, ndoshta pesë vjet më i madh se i riu që mbante shënime, por flokët i qenë zbardhur në tëmtha e përmbi veshë dhe thinjat po i ngjiteshin drejt çaçkës së kokës.

Tha ai (dmth Kolë Boçari):

— Ujë, ujë, më thoshte rrëzë veshit Bujari dhe unë i thosha se do t'i jepja një kazan me ujë, por vetëm të duronte edhe pak, se shtëpia e fshatarit ku duhej ta shtroja atë natë nuk ishte larg. Kishim udhëtuar gjithë natën, por ecnim ngadalë. Bujari ishte plagosur në stomak, doktori e kishte operuar para disa orësh dhe na kishte porositur që të mos i jepnim ujë, mua dhe një fshatar, që kishte ardhur vullnetar pikërisht kur kishte marrë vesh se të plagosurit e spitalit partizan do t'i vendosnim nëpër të njohur e nëpër baza. Nja tre nga ata (Bujari midis tyre) duheshin çuar meqomos në bazat e qytetit, për ku ishte nisur edhe vetë doktori (me dy të tjerët në rrugë tjetër) sepse vetëm në qytet, kishte thënë ai, mund të gjendeshin mjetet e mundshme për t'i mbajtur gjallë e për t'i shpëtuar.

— Ujë mos i jepni, se ju vdes nëpër duar, na kishte thënë doktori. Ai na kishte thënë, — foli përsëri Kola, — as buzët të mos ia lagnim me ujë. Ujë jo! Asgjë! Por sidomos ujë! Jo e jo, kështu na kishte thënë doktori. Ai na kishte thënë të ecnim me kujdes, të mos e trondisnim, të mos e troshisnim. Kjo ishte porosia e dytë e doktorit. Po të troshitej, Bujari do të na vdiste nëpër duar. Kështu na kishte thënë doktori. Dhe ne ecnim me kujdes, ecnim ngadalë. Nga errësira, nga cikma, nga lodhja, nga vigu që na pengonte në ecje, nga gjermanët që mund të ndodheshin kudo, nga gjermanët e nga ballistët.

— Ujë, ujë, më thoshte Bujari rrëzë veshit dhe unë i

thosha se do t'i jepja një kazan me ujë, po vetëm të duronte edhe pak, sa të arrinin në shtëpinë e fshatarit pranë qytetit.

Tha ai:

— Vetëkuptohet, unë e gënjeja, unë s'do t'i jepja ujë as atje!

— Fshatari, që e kishte zënë vigun nga këmbët, heshte. Vetëm nganjëherë më thoshte ta vendosnim në tokë, largohej, përgjonte, pastaj unë shikoja siluetën e tij që afrohej, ose dëgjoja opingat e tij, që kërcisnin mbi gjethet e thara të pyllit. Ai ishte udhërrëfyesi. Ai e njihte krahinën. Unë, megjithëse kisha luftuar në ato anë, natën e kisha vështirë të orientohesha. Sidomos në një natë dimri si ajo, të errët, të ftohtë, me gjermanë e me ujq që ulërinin.

— Ujë, ujë, rënkonte Bujari dhe unë i thashë fshatarit ta ulnim vigun. Më kishte trembur zëri i Bujarit. Ish-te një zë i llahtarshëm. I ngjirur dhe i llahtarshëm, zë vdekjeje, ose që të kujtonte vdekjen. Se edhe doktori më kishte pëshpëritur mënjanë: po e shpëtuam Bujarin, do të thotë se ia kemi zhvatur vdekjes nga kthetrat.

— E ulëm vigun, po, kur e ulëm, Bujari heshti fare. Unë u kërrusa. U kërrusa akoma. M'u duk sikur nuk merrete frymë, m'u duk sikur kishte vdekur. Mendova se kisha bërë gabim që i kisha qëndruar aq besnik porosisë së doktorit. T'i kisha dhënë një pikë ujë, vetëm një pikë, se ndoshta nuk do të vdiste. Vetëm një pikë. Ujë! Ujë! Ujë, zura të flisja edhe unë si Bujari, bile edhe zëri më ishte ngjirur si i Bujarit. Ujë, ujë, ujë!

— Po ti, më tha fshatari, çfarë ke, u çmende? — Kolë Boçari nguli vështrimin tek ai që mbante shënime. Tha:

— Në përgjithësi, fshatari ishte i urtë, ai heshte, po një herë që më foli, më foli prerë dhe rëndë.

— Jo, nuk jam çmendur, thashë unë.

— Shyqyr, tha fshatari.

— Por më vjen keq për Bujarin, thashë unë.

— T'i kishim dhënë një pikë ujë, tha fshatari.

Kola vazhdoi tregimin:

— I vura veshin te buzët. Buzët i kishte të ftohta. Të të them të drejtën, as të ftohta, as të ngrohta. Ne ishim

bërë kallkan dhe as kuptonim, as ndienim gjë. Por Bujari nuk merrte frymë. Për veshët e mi ai kishte vdekur. Kishin vdekur edhe veshët e mi. Diçka duhej të bënim. Qëndrimi në vend ishte rrezik i sigurt. Ngrica ishte e madhe e mund të ngrininim. Më erdhi inat tek përfytyrova gëzimin e armiqve, kur të gjenin të nesërmen në mëngjes tre partizanë të ngrirë.

— Më mirë të vdisnim duke luftuar, — tha ai, Kolë Boçari, dhe thithi cigaren thellë, e thithi fort, por i riu që mbante shënime, vuri re dhe u bind, se partizani (Kolë Boçari) me pushkën në mes të këmbëve e me gjerdanin kryq e tërthor gjoksit, me bombat që i vareshin në rripin e brezit, nuk e kishte mendjen fare te duhani. Ai e thithte ashtu kot, e thithte shumë, por mendjen e kishte tek ato që kishin ngjarë e tek ato që do të ngjanin. — Tha ose përsëriti Kola: — Më mirë të vdisnim duke luftuar. Nuk mund të ndaheshim në errësirë nga shoku i vdekur. Vendosa të ndizja një fije shkrepëse. Edhe një tjetër. Edhe një të tretë. Bile të gjithë kutinë, po të ishte e nevojshme. Duhej patjetër ta shikonim Bujarin në dritë, të shikonim vdekjen e të bindeshim edhe me sy për vdekjen e tij. Sa për gjermanët e ballistët, që mund të na diktonin po të ndiznim dritë, aq më bënte, më mirë të vdisnim duke luftuar.

— E pyeta fshatarin, a ta ndez një fije shkrepëse? Ai, sikur të ishte në mendjen time, më tha që të ndizja të gjithë shkrepësen po të ishte nevoja. Kështu më tha dhe unë ndeza shkrepësen e parë, por nga errësira e plotë nuk e shquam dot fytyrën e Bujarit, se na u vranë sytë. Ndeza shkrepësen e dytë. Atëherë pamë fytyrën e Bujarit, ose pamë fytyrën e vdekjes. Ajo ishte zverdhur, gati ishte nxirë, po edhe tharë, sytë e groposur i ishin zvogëluar, buzët i ishin fishkur, ndoshta për ujë, mendova unë.

— T'i kishim dhënë një pikë ujë, thashë unë.

— T'i kishim dhënë, tha fshatari.

— Po ti e dëgjove doktorin?!

— E dëgjova, tha fshatari.

— Ai na porositi asnjë pikë!

— Doktorët nuk i dinë të gjitha, tha fshatari!

— T'i kishim dhënë një pikë ujë, thashë unë dhe nde-

za shkrepësen e tretë. Po kur ndeza shkrepësen e tretë, vura re, ose m'u bë sikur vura re se Bujari lëvizi buzët. M'u prish mendja. Edhe i vdekur është i mirë, i urtë e shakaxhi, thashë me vete. Sigurisht që isha tepër i turbulluar kur thashë këto fjalë. Në përgjithësi shokët e tallnin pak Bujarin, sigurisht e tallnin pa të keq e me ngrohtësi për natyrën e tij prej poeti, se Bujari shkruante vjersha, — kurse ne i këndonim. Ishte poet, ose të paktën shkruante vjersha. Ishte edhe trim, si shumica apo si të gjithë partizanët. Edhe shëndetin e kishte të mirë. Mbi të gjitha ishte poet dhe kishte shëndet të mirë. Të mbërthen-te për beli dhe të hidhte përtej. Kishte qenë marangoz para se të dilte partizan, prandaj edhe krahët i kishte të fuqishëm. Edhe vjershat ashtu i kishte. Me bomba e me flamur. Ne ia pëlqenim dhe ia këndonim. Por tashti ky Bujar ishte mbledhur mbi vig sa një grusht, kurse fytyra i që zvogëluar sa një pikë, sa një pikë e verdhë. Po buzët e tharra pse i dridheshin dhe i lëviznin?

Tha Kola:

— Gjallë, tha i pari fshatari. Thirra dhe unë, gjallë. Disa herë thirra gjallë, gjallë...

— Ujë, ujë, kërkoi Bujari.

— Jepi ujë, tha fshatari dhe e zuri për gryke pagurin tim, që e mbaja të varur pas rripit të mesit, ja këtu pranë bombave.

— Ujë, se vdiqa, kërkoi Bujari.

— Jo, thashë unë dhe e largova dorën e fshatarit nga paguri.

— Ujë, ujë, kërkoi Bujari.

— Jepi ujë, tha fshatari.

— Jo, thashë unë, harrove çfarë na porositi doktori?

Tha Kola:

— Fshatari ishte i urtë dhe u tërhoq përsëri në botën e tij të heshtjes.

Tashti që tregimi i tij kishte arritur deri në çastin kur, me gjithë lutjet e Bujarit e me gjithë nxitjen e fshatarit për t'i dhënë ujë, Kola, që pas disa lëkundjeve kishte kun-

dërshtuar, pikërisht në këtë kohë Kolë Boçari u duk si i penduar për ato që po tregonte, sikur nuk deshi ta vazhonte tregimin, bile për disa çaste sikur vendosi ta mbyllte me kaq. Thithi thellë tymin e duhanit, e mbajti gati një minutë, pastaj fjollat i dolën me vërtik nga hundët e nga goja. Por, në çastet që vazhduan, diçka e shtyu të ndryshonte mendim. Dhe vazhdoi, duke e shikuar ngultas të riun, që mbante shënime e që herë-herë, në pauzat e rralla, krihte me gishtat e dorës së majtë flokët e zinj gati mbi vetulla, aq të dendur i kishte.

Përtej xhamave të klubit apo të shtëpisë së kulturës, ku ishin ulur ata, qyteti gumëzhinte. Dëgjohej kënga e bakrit në rrugicën e bakërxhinjve. Dëgjohej çekani i kovaçëve më tej, sharra dhe zdruku më pramë. Dëgjohehin këngë partizane nga një grup nxënësish, që shkonin diku të organizuar e në rresht, si të ishin ushtarë. Herë pas here dëgjohehin hingëllima kuajsh që tërhiqnin karroca me tessa, me rërë, me gëlqere, me gurë, me bukë, me bidona, që mund të kishin qumësht, po mund të kishin edhe kri-pë, edhe miell, edhe zarzavate ndodhte të kishin: ishte viti i parë i Çlirimit, ishte vjeshtë e vitit 1945.

— Të thashë, ishte dimër, — tha Kolë Boçari dhe thithi thellë cigaren, e mbajti gati një minutë pa e nxjerrë tymin, pastaj buçitën jashtë nga goja e nga hundët fjollat e dendura. — Dimër i ftohtë, me ciknë e me erë. Të thashë, ishte natë dhe qentë lihnin kudo. Dukej sikur botës po i vinte fundi. — Kola ktheu kokën nga bufetieri. Dy kafe! — porositi.

Tha djali, që mbante shënime:

— Mezi piva të parën!

Tha Kola, pa e shikuar në sy:

— Lëri llafet! — dhe duke u kthyer nga kamerieri, thirri prapë: — Dy kafe me pak!

— Unë e pi me sheqer! — tha djali.

— Lëri llafet, ç'kafe është ajo që pi ti, kafe me sheqer! — dhe duke shikuar prapë kamerierin, tha: — Vazhdo punën ti!

Kamerieri i hodhi një vështrim djalit që mbante shënime (ata ishin moshatarë) dhe i shkeli syrin.

Tha Kola:

— Ai... ujë... ujë... s'dinte gjë tjetër Bujari. Ujë, ujë, ujë. Ne ngjitu me vigun nëpër duar, ne dredho e gjarpëro e zbrit monopateve me vigun nëpër duar, futu përretnje, përgjo e çlodhu, ai ujë... ujë... ujë...

— Por, të të them të drejtën, — tha Kola, — më kishte zënë edhe mua një etje e më bëhej sikur do të pëlçisja nga një zjarr që më ndizej në gjoks. Çurg djersët e mia nga lodhja. Megjithëse nuk kisha ndër mend t'i jepja ujë Bujarit, prapëseprapë, pagurin e vetëm që kisha me ujë, e ruaja për çdo rast. Udhëtim ishte, udhëtim me një të plagosur rëndë e me një të operuar rëndë. Ishte edhe natë e errët, e ku ta gjenim ujin në një natë të tillë me ballistë e me gjermanë?

— Dua të të them, — tha Kola, — se tashti që më kishte zënë edhe mua një etje e madhe, megjithëse unë e fshatari kishim pirë një herë në një përrua që hasëm rrugës, tashti Bujari më dhimbsej më shumë, më vinte keq për të, i qaja hallin të ziut, që s'na lejohej t'i jepnim një filxhan ujë. Atëherë, pse ishim ne, kur s'mund t'i jepnim shokut as edhe një filxhan ujë? Vetëm për ta mbartur? Për ta troshitur? Për ta munduar?

Fshiu buzët Kola nga llumi i kafesë dhe tha:

— Kur shikova Yllin e Mëngjesit, thashë me vete se vuajtjet tona kishin marrë fund. Dhe vërtet, me të rënë drita e parë, vumë re se ndodheshim rrëzë fshatit që kërkonim. Ai ishte një fshat pranë Shkumbinit dhe afër Elbasanit. Qëllimi ynë ishte që në rastin më të parë ta vendosnim në bazën e qytetit, se edhe doktori e priste jo më vonë se pas dymbëdhjetë orësh, përndryshe, i sëmuri nuk do të duronte, na kishte thënë doktori. Ky ishte qëllimi ynë dhe unë mbeta i kënaqur kur pashë se ndodheshim në një rrapishte pranë Bradasheshit. Aty pashë gjithashtu edhe fshatarin që më shoqëronte. Ishte një burrë afër të dyzetave, me një palë mustaqe të gjata, të thinjura pjesërisht por ata që të binin më shumë në sy ishin krahet e tij të shkurtër e të trashë dhe gishtat e duarve që i

kishte fare të shkurtër e fare të trashë, kurse këmbët i kishte veçanërisht të mëdha, opingat e tij dukeshin si një barkë e çartallosur dhe unë tërë natën dy gjëra kisha dëgjuar, rënkimet e Bujarit për ujë dhe lluq-luqin e opingave të fshatarit. Po me gjithë krahët e shkurtër e gishatat e duarve fare të shkurtër vigun ai s'e kishte për gjë. Sikur u ngushëllova. Mustaqet e gjata ishin ngushëllimi i parë dhe i madh. Ato mustaqe e tregonin trim. Vërbet që shpatullat i kishte të ngushta si të grave, por ishte i fuqishëm. Mendova, sido që të ndodhte, me një bashkudhëtar e bashkëlufëtari si ai, do të dilnim të gjallë. I thashë të shkonte në fshat, të shikonte si ishte gjendja, pastaj të çonim të plagosurin. Ai shkoi dhe u kthye shpejt. Fshati ishte plot me gjermanë e ballistë. Bile që një çudi si ishim futur natën aty pa rënë në sy, në atë rrethim aq të ngjeshur. Edhe shtëpitë e kasollet ishin rrethuar, njerëzit i kishin mbyllur brenda dhe ai s'kishte mundur të takohej me asnjë, përveç me një plak që kishte mbetur rastësisht para se të vinin gjermanët, në një stan të vogël jashtë fshatit. Stop. Mbetëm në rrapishte gjithë ditën. Gjithë ditën Bujari kërkoi ujë. Fshatari ngulte këmbë që t'i jepja ujë dhe shtonte se nuk ishte dëgjuar ndonjëherë, që i sëmuri të kërkonte ujë dhe të tjerët të mos i jepnin. Në mbrëmje, kur rrezet e fundit të diellit rrëshqitën nga majat e maleve, Bujari e humbi fare. Thamë se u çmend. Thamë se vdiq. Zgjaste duart drejt pagurit, thërriste, ujë, ujë, ne lagnim pëllëmbën, ia vinim mbi buzë, kurse ai zgurdullonte e çapërente sytë dhe pastaj tulatej si i vdekur.

Tha Kola:

— Të të them të drejtën, m'u veshën sytë. Hajt, sikter, thashë, me gjithë doktor. Me gjithë shkencë. Porosia s'm'u duk asgjë, kurse yuajtjet e Bujarit gjithçka, ato më kishin mbërthyer për gryke.

Pastaj Kola tregoi se si e kishte lëshuar pushkën mbi gjethet e thara apo të kalbura të rrapishtes, se si e kishte shqitur me gjithë zinxhir pagurin nga brezi, se si i kishte zhvidhosur tapën, se si e kishte zgjatur në drejtim të Bujarit. Por tha ai, ishte vonë, Bujari s'kishte pasur më fuqi të pinte ujë. Ai kishte rënë në agoni, në kom dhe gjithçka

ishite qetësuar rrotull tyre. Vetëm qentë nuk ishin qetësuar, edhe gjermanët e ballistët, që shtinin rrallë e tek brenda në fshat e rrotull tij. Pastaj, Kolë Boçari tha se Bujari kishte vdekur në mëngjes. Fshatari kishte shkuar përsëri deri te stani i vogël, kishte marrë çfarë ishin ndodhur në stan, një kazmë e një lopatë e ca dërrasa pishe, bashkë me të kishte ardhur edhe vetë plaku, kishin hapur një varr në rrapishte, toka kishte qenë argjilore dhe ata mezi e kishin hapur varrin. Pastaj kishin zbritur kufomën, kishin futur pasaportën e Bujarit brenda në pagur, kishin futur edhe një letër brenda. *Këtu është varrosur partizani Bujar Tamili* dhe poshtë kishin shkruar emrat e tyre, emrin e vet, *Kolë Boçari* dhe emrin e fshatarit. *Hysen Hysa*, dhe më poshtë datën *15.II.1944*. Pastaj kishin vënë pagurin si jastëk nën kokën e Bujarit, kishin vënë dërrasat përsipër (fshatari dhe plaku i stanit e kishin punuar varrin me kujdes të madh, thoshte Kola) dhe e kishin mbuluar shokun e tyre. Kur e kishin mbuluar, Kolës i qenë marrë mendtë dhe i qe dukur sikur toka ishte zhytur në një kaos të madh. Ata kishin qëndruar aty deri në mbrëmje, derisa ishte errësuar, pastaj kishin ikur pyll më pyll e mal më mal. Me shokët qenë takuar pas disa ditësh.

Djali i ri, pesë e më shumë vjet më i ri se Kola, që krihte flokët e zinj me gishtat e dorës së majtë, tashti jo vetëm shkruante, por i shkruante të gjitha ato që i thoshte Kola, se Kola kurrë nuk e përsëriste dy herë të njëjtën gjë.

Në rrugë nxënësit e shkollës ktheheshin duke kënduar këngë partizane. Diku po shembnin çatinë e një shtëpie të vjetër. Tjegullat kërcisnin, disa thyheshin. Ata që ishin poshtë u bërtisnin atyre që ishin lart, të kishin kujdes.

Ishte viti i parë i Çlirimit. Ishte vjeshtë e vitit 1945.

TREGIMI I DYTË

Ishte një ditë e ngrohtë pranvere dhe në të njëjtën kohë mund të mendoje se e gjithë bota çlodhej, ose e gjithë bota punonte dhe djersitej. Por nuk mund të mendoje në asnjë mënyrë që bota flinte ose dremiste. Jo. Këtë nuk mund ta mendoje, megjithëse nga dritaret e hotel «Turizmit», ku ishin ulur ata të dy, të dukej sikur gjithçka kishte qëndruar në vend, nuk lëvizte dhe ishte shumë e qetë dhe shumë e heshtur. Nëpër rrugë e rrugica s'para kishte lëvizje, nëpunësit ishin futur nëpër zyra, nxënësit nëpër shkolla, përtej mureve të shkollave dëgjohej murmuritja e tyre e gëzueshme, si një e vërtetë tokësore. Dielli ishte i këndshëm, gjelbërimi fare i ri, dhe ishte bukur të jetoje në ato ditë të ngrohta pranvere, ku e gjithë bota punonte, ose e gjithë bota i gëzohej shkëlqimit të diellit dhe gjelbërimit të ri.

Tha ai:

— Ishte një shtëpi e vogël, mbuluar me tjegulla të kuqe, me korridor të ngushtë, me saksu lulesh, me verandë rrethuar me xhama, me tri dhoma e një kuzhinë, me oborr, me një tendë rrushi mbi oborr, me lule e ndonjë pemë tjetër që nuk më kujtohet, me portë të re të sapolyer me bojë vaji. Brenda kishte stufë nëntëmijëlekëshe, kishte mobilie, tryeza e karrige, kishte edhe një këllëf të hapur violine varur në mur dhe pranë këllëfit një ilustrim, shkëputur nga një revistë, ku dukej një plakë që rrinte ulur e të shikonte drejt në sy.

— Mendova, — tha ai, — kjo do të jetë e ëma. Megjithëse tepër plakë, me fytyrën plot me rrudha që prisnin njëra-tjetrën horizontalisht e vertikalisht e me sytë të zvoqëluar nga pleqëria, prapëseprapë në fizionominë e saj të përgjithshme unë vura re disa karakteristika të Bujar Tamilit, si bie fjala, ballin e gjerë, mjekrën pak të kthyer dhe sidomos vështrimin gri, vështrim i lehtë, që s'të mundonte e s'të rëndonte për asgjë. Vështrim poetësh thashë me

vete duke kujtuar vjershat e Bujarit, ndonjërën nga të cilat, siç e di edhe ti, ne e këndonim gjatë luftës. Plaka mund të ishte mbi të tetëdhjetat, kurse unë sapo kisha mbushur të gjashtëdhjetat. Nuk ishte e gjatë si Bujari, Bujari kishte qenë i gjatë, por fytyra e saj ishte nga ato, për të cilat mund të betohesh se nuk kanë bërë asnjë të keqe gjatë gjithë jetës së tyre. Në Shqipëri ka shumë njerëz, shumë pleq, sidomos plaka, veçanërisht plaka, të cilat jo që s'kanë bërë asnjë të keqe gjatë tërë jetës së tyre, por as e kanë çuar nëpër mend një gjë të tillë. Kjo shikohet sidomos në fytyrën e tyre të butë, po, tepër të butë.

— Djali i dytë i plakës, domethënë vëllai i Bujarit, ishte afër të dyzetave. Nusen e kishte më të re. Kishin dy vajza në tetëvjeçare, kurse violina ishte e nuses, mësuese në shkollën e muzikës. Atë ditë në dhomën tjetër ajo po i binte disa melodive të gëzueshme dhe plaka më tha se nusja bënte pjesë në orkestrën e shtëpisë së kulturës.

— Në mur ishte varur fotografia e Bujarit. Më vonë, pasi kishim pirë kafën, plaka më tha se Bujari e kishte bërë atë fotografi ditën që do të shkonte partizan. Pastaj plaka më tha se Bujari ishte veshur si fshatar, ajo e kishte përcjellë deri larg, Bujari ishte ndarë nga ajo, e kishte puthur, po nuk ishte nisur, ishte kthyer dhe e kishte puthur prapë. Ata kishin qeshur e ishin përlotur të dy dhe kështu ishin ndarë, për të mos u parë kurrë më. Fotografinë e kishin sjellë pas një jave, ajo i kishte paguar paratë fotografit dhe e kishte zmadhuar. Bujari ishte djali i madh.

— Pastaj, plaka më tregoi shumë gjëra nga jeta e tij që kur e lindi e deri ditën që e përcolli partizan. Ajo m'i tregoi ato sepse unë i thashë që isha shok i Bujarit, i kisha kërkuar falje që e takoja me kaq vonesë, isha justifikuar, se pothua gjithë kohën kisha punuar në Elbasan e kudo nëpër Shqipëri, kurse Bujari ishte nga Vlora dhe asnjëherë nuk më kishte rastisur të shkoja deri në Vlorë. Por, duke u justifikuar, unë e ndjeva disa herë që u skuqa e u zverdha nga turpi, nga gënjeshttra, sepse, ti mund ta marrësh me mend arsyen. Unë nuk e kisha vizituar asnjëherë këtë nënë, djali i së cilës vërtet kishte vdekur në krahët e mi, por varrin nuk kisha mundur t'ia gjeja për shumë ko-

hë. Me ç'sy e faqe do t'i flisja për të birin, që e kisha pasur shok luftime që e kisha varrosur vetë? Ç'do t'i thosha unë, kur ajo të më pyeste për varrin e Bujarit?

Tha ai:

— I vëllai kërkoi falje se kishte punë dhe iku. E shoqja na dha likeret e kafen dhe iku. Mori edhe violinën. Fëmijët luanin në oborr. E kishin shkollën pasdite. Mbetëm unë dhe nëna e Bujar Tamilit.

— Bëmë shumë biseda, — tha ai. — Plaka e mbante mirë veten, lexonte edhe gazeta, kishte mësuar shkrim e këndim pas Çlirimit. Biseduam për misrin e për grurin. Për foletë katrore e për kubikët. Biseduam për nipin e mbesën, që herë hynin e dilnin, herë kërkonin bukë me reçel, herë diçka tjetër. Biseduam për vitet që kalonin, për kujtimet që mbeteshin të gjalla, për ato që i harronte koha e për ato që nuk i harronte. Unë i kisha folur për Bujarin, për luftën e tij e për shokët e tij, por jo për vdekjen, jo për mënyrën si kishte vdekur, as për faktin tjetër, që unë vetë kisha shkuar disa herë me radhë bashkë me fshatarin që e varrosëm, me Hysen Hysën e me plakun e fshatit, i cili vdiq shpejt pas Çlirimit, kishim gërmuar nëpër rrapishte, nëpër vendet ku ne ishim të sigurtë, por s'kishim gjetur asgjë. Pastaj, thamë se tokat mund të kishin pësuar shembje, mund të kishin rrëshqitur, koha dhe erozionet kishin bërë të vetën, derisa hoqëm dorë nga kërkimet e mëpastajme. Hoqëm dorë për njëzet vjet. Po nënës së Bujarit nuk i thashë asnjë fjalë për të gjitha këto.

— Ti e di, — tha ai, — që menjëherë pas Çlirimit vazhdova zanatin tim, punëtor ndërtimi. Më bënë brigadier dhe mund të them se bashkë me brigadën kam shëtitur në shumë kantiere të mëdha të Shqipërisë. Më në fund, aty nga mesi i vitit 1972, nga Vau i Dejës u kthyem në Bradashesh të Elbasanit, ku si objekt të parë të madh patëm Furrnaltën dhe pas saj buldozeri iu fut mbeturinave të një rrapishteje, që ishte ajo rrapishte, ku kishim varrosur Bujar Tamilin plot tridhjetë vjet më parë. Aty brigada do të bënte ca punime nën tokë për rrjetin inxhinierik, që do të shërbente për Uzinën e Çelikut e që, për mendimin tim, është zemra e Kombinatit Metalurgjik. Sigurisht, ti e kup-

ton, që m'u përtëri e kaluara, ajo natë e flohtë dimri, rënkimet e Bujarit, paguri, vdekja e Bujarit, varri e tjerë, e tjerë. Të gjitha m'u përtërinë edhe një herë, kur buldozeri e kishte bërë punën e tij, kur mbeturinat e rrapishtes ishin rrafshuar dhe kur ekskavatori kishte ardhur për të hapur gropën apo themelet, ku ne do të ndërtonim tunelin apo kanalet e ndryshme për vendosjen e rrjetit inxhinierik. Ti prapë e kupton, se m'u përtërinë edhe kujtimet e viteve të para të pasçlirimit, kur unë bashkë me Hysen Hysën kishim ardhur disa herë deri këtu, kishim gërmuar, por... asgjë.

— Ndodhi, — tha ai, — që rrjeti inxhinierik i uzinës të ishte projektuar pikërisht aty ku unë dyshoja se ishte varri i Bujar Tamilit. Dhe ashtu ngjau. Deri në dy apo tri metra thellësi ekskavatoristi punoi me kujdes. Unë i kisha folur për hallin tim dhe ekskavatoristi kishte tundur kokën. Në një farë thellësie, më thellë nga sa e kishim varrosur ne, sigurisht erozionet, u dukën shenjat e para të një varri. Në fillim ca copa të kalbura dërrasash, pastaj... — Kolë Boçari kishte heshtur, si t'ia kishte mbyllur dikush gojën me dorë. Tha: — Kjo duket si rastësi, por unë them jo. Të paktën kjo s'është rastësi e zakonshme. Aty, ku tri-dhjetë vjet më parë kishim varrosur shokun tonë, aty do të thureshin damarët, që do të ushqenin me energji elektrike e me gjithçka tjetër atë uzinë që do të shkrinte çelikun e parë të markave shqiptare. Një gazetar më tha një ditë se ky rast fliste për një simbol, ishte simboli më i gjallë që mund të ketë ndodhur ndonjëherë. Edhe veteranët që u interesuan për dëshmorin Bujar Tamili, kur i çuan eshtrat e tij në Vlorë, kur i varrosën në varrezat e dëshmorëve, në fjalën që kishin mbajtur në emër të rrethit tonë, kishin thënë afërsisht një gjë të tillë, kishin thënë se eshtrat e dëshmorëve janë vënë në themelet e ndërtimit të socializmit. Kështu kishin thënë afërsisht. Nejse... këto punë, themelet e simbolet, ju që shkruani, i kuptoni vetë... Për të mos bërë përsëritje të atyre që më panë sytë ditën që zbuluam varrin, unë po vazhdoj të tregoj se ç'më ndodhi me nënën e Bujarit në vizitën time të parë, të cilën e bëra atë javë, që kisha mbushur të gjashtëdhjetat. Por nënës së

Bujarit nuk i fola asgjë. Mendova, në qoftë se ajo vetë nuk donte të më pyeste kur e si kishte ndodhur që ishte gjetur varri i të birit, atëherë pse duhej që unë t'i flisja për këtë? Pse duhej t'i hapja plagë të vjetra? Fundja, pse të flisnim për varrin, apo për mënyrën si e qysh kishte vdekur, kur ishte më mirë të flisnim për trimëritë e Bujarit, ashtu siç kishim bërë deri tash? Dhe nuk i fola.

Tha ai:

— Kështu biseduam për shumë gjëra të tjera, por për vdekjen e varrin e Bujarit, jo. Pastaj qeshëm me nipin e mbesën, që luanin kukafshehtas pas kurrizit tonë, qeshëm edhe me gjëra të tjera pa rëndësi. Plaka më dha përsëri karamelë, më bëri edhe një kafe tjetër, më dha edhe një shurup dhe, kur unë po bëhesha gati të largohesha, befas ajo u ngrit, vuri pëllëmbën e zvogëluar mbi gjurin tim, si të më thoshte, prit, dhe doli jashtë.

Nga oborret e shtëpive përhapej apo kundërmonde era e luleve të portokalleve, që përzihej me aromën e trëndafilave e me aromën e parë të lulemustakut apo të dorëzonjës, siç e quajnë elbasanasit. Në sallën e gjatë të hotel «Turizmit» hynin herë pas here çifte të reja, që pinin ujë gline dhe kafe, por kishte nga ata që pinin edhe konjak. Ishte koha e dashurive dhe koha e fejesave. Ishte edhe koha e turneve. Nga një autobus me targën «SHK» zbritën dhjetëra vajza e djem, ansambël artistik në turne. Vajzat, shumica me pantallona e bluza, djemtë me kostume të çelura, disa me çanta të fryra, disa me vegla muzikore të futura nëpër këllëfë. Ata hynë në sallë me zhurmë dhe bashkëbiseduesit heshtën për dy minuta. Me sa dukej i kishin tërhequr fytyrat e pamjohura, i kishte tërhequr freskia e djemve dhe e vajzave dhe në përgjithësi ai vrull që shoqëron rininë kudo, në punë e në jetë.

Kolë Boçari, që, po t'i kujtohet lexuesit, kishte filluar të thindej shumë shpejt, që në kohën e luftës, tashti ishte thinjur krejt, si të kishte në kokë jo flokë, por një top bore të pashkelur. I ishin zbardhur edhe vetullat, por fytyrën e kishte të shëndetshme, ngjyrë rozë dhe ky kontrast, që krijohej midis flokëve, fytyrës e vështrimit gjithmonë të ri, e kishte bërë Kolën të denjë për një portret, për një akua-

rel. Edhe ai që e dëgjonte e që shkruante herë pas here, e që në vitin 1945 i kishte pasur flokët shumë të zinj e të dendur tre gisht mbi vetulla, tashti ata i qenë rralluar, ballin e kishte të hapur dhe thinjat i merrnin valle mbi tëmtha.

— Ajo u kthye pas pak, — tha Kolë Boçari. — E di me çfarë u kthye? — pyeti ai. Tha: — Me diçka të mbledhur në një peshqir!

— Më duket sikur të quajnë, tha plaka...

— Kolë, i thashë unë.

— Plaka bëri një lëvizje të papërcaktuar, — tha ai, — sikur diçka donte të kujtonte akoma.

— Kolë Boçari, i thashë unë.

— Po... po... iu mbajt goja plakës. Pastaj ajo shpëstolli peshqirin me duart e dridhura dhe nxori prej andej pagurin tim, që e kisha vënë nën kokën e të birit tridhjetë e tre vjet më parë!

— Paguri kishte shpëtuar, sigurisht i dëmtuar, por kishte shpëtuar.

Tha Kola:

— Para se unë të hapja gojën për t'i thënë diçka, që as vetë s'e kisha menduar akoma çfarë t'i thosha, plaka futi dorën në gji dhe nxori prej andej një copë letër. Ajo e zgjati dorën drejt meje, dorën e rreshkur e të vyshkur, ku s'kishte mbetur tjetër veç lëkurës e damarëve blu të fryrë dhe ma lëshoi letrën në prehër.

E hapa letrën dhe lexova shkrimin tim: «*Këtu është varrosur partizani Bujar Tamili. Më poshtë lexova emrin tim, Kolë Boçari dhe emrin e fshatarit Hysen Hysa, pastaj datën 15.II.1944. Fjalës varrosur nuk i lexohej rrokja e parë, kurse emrit tim i qe fshirë rrokja e dytë. Fshatari kishte mbetur pa mbiemër. Të tjerat ishin në rregull, domethënë, diku të forta diku të zbehta, por lexoheshin.*

Tha Kola:

— Ti e merr me mend si më rrihte zemra në ato çaste, kur, po në ato çaste pashë të lëvizte trupi i plakës drejt meje dhe unë të dëgjoja zërin e saj të drobitur nga vitet:

— Kolë, më thuaj, tha plaka, duke shtrënguar pagurin në gji, i Bujarit ishte ky pagur?

— Unë e shikova plakën, — tha Kola, — dhe sytë e saj, që dukeshin vazhdimisht të veshur si me një perde, ishin rinuar dhe ishin ndezur. T'i thosha jo, t'i thosha se ishte paguri im? E pse duhej t'i prishja qejfin? I thashë, po, i Bujarit ishte!

— Kolë, më thuaj, tha plaka, a kishte ujë paguri?

— Kishte, i thashë unë.

— A kishte etje Bujari?

— Kishte, i thashë unë.

— A të kërkoi ujë?

— Po, i thashë unë.

— A i dhe?

— Po, i thashë unë.

Tha Kola:

— Atëherë u përqaftuam. Unë nuk e di, më përqaftoi ajo më parë, apo unë atë. Por di që u përqaftuam dhe di gjithashtu që, duke qenë të përqaftuar, filluam të përlo-teshim. Kush filloi të përlo-tesh i pari, prapë nuk e di. Por di që u përlo-tesh të dy. Sigurisht midis këtyre përlo-teshjeve kishte edhe ndonjë ofshamë, kishte edhe ndonjë dënesë. Në çastin tjetër plaka sikur qau, por jo tamam me zë. M'u duk sikur ajo përlo-tesh e qante jo vetëm nga hidhërimi i vjetër për të birin, por edhe nga një farë gëzimi lehtësues, që, më në fund, ishte siguruar se i biri s'kishte vdekur vetëm, ishte ndodhur dikush pranë tij, ai dikush kisha qenë unë, që isha përkujdesur dhe i kisha dhënë ujë para se ai të jepte frymën e fundit. Prandaj them, ajo s'ishte një e qarë apo një përlo-teshje e zakonshme. Ja pse, edhe dukej sikur qante, edhe dukej sikur i gëzohej diçkaje. Ishte një çast i tillë kur plaka më pyeti:

— Më thanë se, aty ku u gjend varri i Bujarit, po ngrihet një uzinë e madhe!

— Po, i thashë unë.

— Më thanë sikur aty rrotull varrit të Bujarit ecin trenana, bien sirena, rrahin çekanë dhe ndizen shkëndija!

— Po, i thashë unë.

Vazhdoi Kola:

— Një çast më vonë, vura re që sytë e saj të përlo-teshur e të zvogëluar nga pleqëria qeshën përbrenda. — Tha pra-

pë: — Sytë dhe vështrimin nëna e Bujarit i kishte më të rinj se pamjen, bile shumë më të rinj se moshën!

Ai më i riu, ish flokëziu i dikurshëm, tashti flokëthinjuri e flokërralluari, që kishte mbajtur shënime gjatë tërë kohës, tashti nuk mbante më asnjë shënim. Ai shikonte bashkëbiseduesin në sy, i sigurt se nuk do t'i harronte kurrë ato që kishte dëgjuar. Bile ai e kishte mbyllur stilografin dhe e kishte vendosur pranë bllokut të mbyllur gjithashtu. S'ishte koha për shënime të veçanta, ishte koha e meditimeve, e reflektimeve, e përgjithësimeve. Këtë shprehte fizionomia e tij.

Nga pamja e Kolë Boçarit ishte zhdukur ai kontrast piktoresk midis flokëve të bardhë dhe fytyrës ngjyrë rozë. Tashti fytyra e tij ishte zverdhur pak dhe ishte rruddhur, si të kishte rënë, goftë vetëm për disa çaste, nën pushtetin e plotë të pleqërisë. Thithte cigaren, jo me pauza, jo thellë e jo me fjolla, por e thithte shpesh e nga pak, pa e pasur mendjen te cigarja, as te shoku përballë, që e shikonte në sy, as te lokali që gumëzhinte nga zërat e të dashuruarve e nga zërat e të rinjve të turneut.

Tha Kola:

— Tashti unë jam bërë miku i shtëpisë së tyre. Ata më duan dhe unë i dua po aq shumë!

Porositën edhe nga një kafe dhe ndoshta, të frymëzuar nga të rinjtë, porositën edhe ujë gline. Pastaj pinë kafën në heshtje, duke shikuar përtej xhamave të sallës së gjatë të hotel «Turizmit». Te sheshi i qytetit ishin radhitur autobusët dhe nga të gjitha rrugët e rrugicat pamë të vërshonin drejt sheshit, drejt autobusëve qindra e qindra punëtorë e punëtores: në Kombinatin Metalurgjik fillonte turni i dytë. Me ta shkoi edhe Kolë Boçari oë, ndonëse i kishte kapërcyer të riashtëdhietat, kishte dhënë fjalën se nuk do të dilte në pension, pa u dorëzuar uzina N.12 e Kombinatis.

Ishte një ditë e ngrohtë, një ditë kur mund të thuash se e gjithë bota çlodhej ose e gjithë bota punonte dhe djersitej. Ishte fillimi i pranverës së vitit 1977.

TREGIMI I TRETË

Tha Kola:

— Aty nga shtatori i po këtij viti, në vizitën time të tretë në qytetin e Vlorës, nëna e Bujar Tamilit m'u lut që ta çoja në Elbasan, në Kombinat, atje ku ishte gjetur varri i të birit. Që t'i bie shkurt, atë mbrëmje arritëm në Elbasan, të nesërmen në mëngjes zbritëm nga autobusi dhe u futëm labirinteve të Metalurgjikut. Nuk do të flas për çudinë e nënës së Bujarit, që s'kishte parë ndonjëherë kantier ndërtimi, aq më tepër, që kantieri i Metalurgjikut, nga madhësia e nga shumëllojshmëria e ndërtimeve mbi tokë e nën tokë, ka çuditur edhe njerëz të regjur me kantierë, e jo plakën e Bujarit. Por e kam fjalën gjetkë. Sa mijëra ditë kam hyrë e kam dalë nga portat e tij, sa herë më është dashur t'i bie kryq e tërthor terrenit ku ngrihen këto dhjetëra uzina e këto qindra objekte, sa gjëra kam parë e sa të tjera kam dëgjuar, por atë ditë që ecja me plakën e Bujarit, çdo gjë, ose pothuajse shumica e gjërave më duke-shin sikur i zbuloja për herë të parë. Ç'të të them...

Dhjetë metra para tyre u duk një djalë rreth të njëzetave. Në njërën dorë ai mbante një valixhe të vogël e në tjetrën një çantë lëkure nga ato të lartat, që mbajnë sportistët. Ishte veshur pastër, por jo me rroba të reja...

— O shokë, — thirri ai nga larg, — më duhet N M I — dyshi.

— Ec drejt!

— Atje ku rrotullohet hunda e vinçit?

— Ty s'të duhet kantieri sot, — tha Kola.

— Jo, zyrat!

— Zyrat e sektorit janë tek ajo godina e gjatë si kazermë.

— Drejt!

— Drejt, — tha Kola. — Mbi shinat e trenit do ta kesh më lehtë.

Djali me valixhen e me çantën sportive u largua. Kola

ndezi një cigare, lëvizi për të dalë në diell, pastaj, kur u kujtua se tjetri kishte mbetur pak larg, e ftoi me dorë. Ai, flokëziu i vitit 1945, tashti flokëthinjuri, por edhe flokërralluari, u afrua pranë Kolës dhe u ul si Kola, pa shikuar se ku. Në Kombinatin Metalurgjik njerëzit s'para i vënë rëndësi e s'para shikojnë se ku ulen. Kaq e kishte kuptuar ai që ndiqte historinë e Bujarit e që, për shkakun e kësaj historie, si dhe për shumë shkaqe të tjera, e kishte bërë zakon apo rregull të shkonte shpesh në Metalurgjik dhe në pushimet e shkurtra apo në pushimet e drekës të bisedonte me Kolën apo me punëtorë të tjerë, pastaj të shkonte në njërin nga klubet apo në njërën nga mensat e shumta të Metalurgjikut për të pirë kafën e famshme të Kolës (me pak) apo edhe për të ngrënë diçka. Por atë ditë ata nuk kishin shkuar për të pirë kafën «me pak». Atë ditë ata ishin ulur në vendin më luksos të Metalurgjikut: mbi një kodër litarësh, që ishin grumbulluar në njërin skaj të Uzinës së Çelikut. Këta litarë prej zhuge a prej diçkaje të përafërt me zhugën u përkisnin ambalazheve të makinerive të ndryshme.

— Ja një shembull, — tha Kola, duke treguar me sy djalin që po largohej. — Shpesh do të ndodhë që nëpër Kombinatin të shikosh njerëz me valixhe në dorë. Disa vijnë me veshjen e përshtatshme për një kantier. Ti e kupton cilët janë këta. Të tjerë jo. Edhe këta i kupton prej nga vijnë. Këta të fundit ecin gur më gur, kërcejnë në majë të këmbëve kanalet ose grumbujt e dheut, largohen më tepër sesa duhet nga rrotat e kamionëve, ose, në qoftë se janë duke ecur mbi shina, hidhen përprjetë kur dëgjojnë fishkëllimën e trenit njëqind metra larg. Janë ata që nuk e dinë se më parë duhet shkuar në konvikt, duhet zënë krevati, duhet lënë valixhja apo çanta, pastaj... Sidoqoftë, të gjithë këta janë të porsaardhurit. Të porsaardhurit nuk kanë stinë. Ata vijnë vazhdimisht dhe në çdo kohë të muajit a të ditës. E, pothua, të gjithë ata që vijnë këtu janë të asaj moshe që ishte Bujar Tamil kur vdiq. Por, të të them të drejtën, këtë gjë as e kisha vënë re më parë. As moshë dhe asgjë. Mjafton që kisha parë njerëz që vinin e shkonin nga Metalurgjiku. Vetëm kaq. Ishte nëna e Bujarit ajo

që më zgjoi një mendim të tillë. Dikur më pyeti, të gjithë njëzetvjeçarë qenkan këtu? Kurse mua m'u duk sikur më pyeti, sa Bujari im? Njëzet vjeç. Të paktën aq do të ishin sot edhe nipërit e mbesat e saj, djemtë apo vajzat e Bujarit.

Tha Kola:

— Atë ditë që unë e nëna e Bujarit ecnim përmes Kombinatit, u ndeshëm me shumë nga këta njëzetvjeçarë, që na pyesnin për kantieret, disa bile ecën bashkë me ne, ndonjëri, që e mori vesh arsyen e vizitës së plakës, duke e ndier veten ngushtë, tha se themelet e Shqipërisë së re e të Metalurgjikut ishin çimentuar me gjakun e dëshmorëve e tjerë, e tjerë. Unë, të të them të drejtën, prita që nëna e Bujarit, të paktën të përlotej, por jo. Trimëreshë, thashë me vete. Para se ta çoja atje ku dëshironte, e ktheva në një klub për t'i dhënë një kafe. Por, me të shkelur brenda, u pendova. Më ka ndodhur të shikoj nëna të moshuara e më pak të moshuara, që presin në mes të punëtorëve në stacionin e autobusëve në qendër të qytetit. Ato shkojnë në Metalurgjik. Ato janë gra, janë nëna e si të tilla janë të urta, janë të buta me fëmijët e tyre apo me nipërit e tyre dhe sytë i kanë plot me përfytyrime. Ndoshta disa nga ato për herë të parë bëjnë një rrugë aq të gjatë. Prej nga vijnë këto nëna? Prej nga është mbledhur rinia e Metalurgjikut? Nga të gjitha anët e Shqipërisë!

Tha Kola:

— Pastaj këto nëna do t'i shikosh nëpër mensat e uzinave të shfrytëzimit apo të kantierëve të ndërtim-montimit, do t'i shikosh të qeshin, të tundin pirunin me gjallëri, se ku ta dish ç'fjalë të mira u ka thënë djali ose vajza. Vijnë edhe baballarë, por më rallë. Ta themi hapur: baballarët ruajnë akoma diçka nga kapadailëku. Trasta me dhurata, ta zëmë me lakror, për djalin a vajzën, dëshmon se i ka marrë malli, por nuk e shprehin, shikojnë ashpër, bile edhe në çastet e takimit bëjnë sikur nuk shikojnë djalin apo vajzën e tyre, por diku lart mbi supet, përmbi e përtej kokave të tyre, shikojnë tubacionet e oxhakët e Furrnaltës, bie fjala, sikur pikërisht ato tubacione të jenë gjëja më e domosdoshme e më e rëndësishme për t'u shikuar në

ato çaste. Por nënat jo. Nënat janë ndryshe. Vërtet e tundin pirunin me gjallëri e qeshin, por prapë ato janë nëna, befas vështrimi i tyre bëhet më i kujdesshëm, më i mallëngjyer e më hetues. Ja pse, kur e ktheva në bufe nënën e Bujarit, në çastin e parë u pendova, thashë, pse kot, ndërsa nënat e tjera vijnë për të parë bijtë e tyre të gjallë, nëna e Bujarit vinte aty për të parë varrin e të birit. Sikur nuk shkonte. Po kur u futëm brenda, urova të paktën të mos ndodheshin prindër, se jo gjithmonë, bile rrallë shikoje prindër në këto mensa e klube. Të paktën urova, në qoftë se do të kishte, të ishin burra. Por do ti, takuam jo një, por dy dhe që të dyja nëna, që silleshin tamam ashtu siç ta shpjegova më sipër, që qeshnin, që tundnin pirunin, që shikonin si me mikroskop fytyrën, njëra të djalit, tjetra të vajzës, bile sikur shikonin përtej fytyrës, shikonin edhe ato gjëra që mund të fshiheshin në mendimet e djalit e të vajzës së tyre. Bile njëra nga ato, pasi e shikoi djalin një copë herë në sy, i hoqi një qime nga kominoshet, që ishin tërë vajëra e tërë pluhur. Djali buzëqeshi për kujdesin e kotë të nënës. Kurse nëna e Bujarit rrinte me mua, me një burrë gjashtëdhjetë vjeç, për më tepër me kokën si dele, pinte kafe në heshtje, ashtu pija dhe unë dhe shikonte me kureshtje çdo gjë, sikur pikërisht atë ditë t'i kishin ardhur sytë, pas një verbimi tepër të gjatë. M'u duk sikur tha nja dy herë, bukur, shumë bukur, pastaj unë prita sërisht që ajo të përlostej, ose të paktën të ofshante si më parë, por jo, ajo ishte, ose bënte sikur ishte fare e qetë. Pastaj biseduam për gjëra të zakonshme, pastaj u ngritëm dhe dolëm jashtë për të shkuar te varri ose më saktë, te vendi ku kishte qenë varri i të birit. Tashti po, tashti, thashë unë me vete, ajo do të përloset po edhe mund të qajë. Kështu mendova dhe vendosa ta çoja pikërisht te furrat elektrike, se fundja, rrjeti inxhinierik, që përfaqëson një uzinë tjetër nën tokë, atyre furrave u shërben. U futëm përmes uzinës, ecëm pranë grumbujve me lingota, me konkile e me çeklik, me ganxha, me kova apo me bunkerë dhe pas pak u ngjitëm në sheshin e furrave elektrike.

— Ja nënë këtu ishte... Nuk e shqiptova dot fjalën va-

rri i Bujarit. Ajo shikoi flakët, dëgjoi zhurmën e furrës dhe mbeti gojëhapur.

Kolë Boçari ndezi një cigare të dytë. Një të dytë e ndezi edhe ai që vetëm dëgjonte e që kësaj radhe nuk shkruante. As kishte tentuar ta nxirrte bllokun e tij të shënimeve. Ishte fundosur mbi litarët me fytyrë nga dielli dhe pinte cigaren ose dëgjonte i menduar. Megjithëse nëntori kishte hyrë i ngrohtë, prapëseprapë gjymtyrët kërkonin rreze, kërkonin ngrohtësi. Atë përshtypje të linte edhe vetë Metalurgjiku, që dukej sikur lahej në diell, sikur edhe ai, pas ndonjë rrebeshi të tetorit, çmpinte e shkrinte gjymtyrët në diell. Një pjesë e mirë e Metalurgjikut, pas uzinës nënë (kështu punëtorët e kanë bërë zakon të quajnë uzinën më të vjetër, që është ajo e Petëzimit të Imtë) kishte vënë në funksionim organet e tij të para. Janë ndezur me kohë furra të ndryshme e kaldaja të ndryshme, nëpër damarët e tij janë futur me kohë mineralet që japin gizën e parë shqiptare apo çelikun e parë shqiptar, e që prej aty ky çelik ngarkohet nëpër vagonë e shkon në uzinën mekanike, nëpër fonderira, në Petëzimin e Mesëm, ku rrihet, ku përpunohet e ku kthehet në detaje të ndryshme, në pjesë e në material të gatshëm ndërtimi. Të gjitha këto procese e kjo jetë e re, shoqërohen me një zhurmë jo të zakonshme për ata që futen për herë të parë aty. Më shumë se zhurma ajo ngjan me një fishkëllimë të pandërprerë, por gjithmonë të valëzuar, që herë duket sikur zbrit nga qielli, herë sikur del nga toka. Ajo vjen si një vrull apo si rapëllimë aeroplanësh, me të vetmin ndryshim, se ajo nuk zhduket me largimin e aeroplanëve, por është gjithmonë aty, është e pranishme dhe e qëndrueshme, ajo përsëritet vazhdimisht dhe prapë kthehet tek akordi i saj i parë me vibracione që mbulojnë njëri-tjetrin valë-valë. Këto zhurma, që shkaktohen nga furrat e nga elektodat, nga dhjetëra e qindra valvola të fuqishme e të mëdha, nga tokmakët e uzinës mekanike e të fonderisë, nga çekanët e perçinuesve, nga puna e mijëra shfrytëzuesve, montatorëve e ndërtuesve dhe, atë ditë, mbi këto zhurma të zakonshme, shtohet edhe zhurma që ngrihet nga puna e një mijë vullnetarëve, të cilët punonin para syve të tyre gati në uni-

son e me ritëm kronometrik — këto zhurma, që dikur qenë dëgjuar si një shfaqje e re në jetën e Metalurgjikut tashti, ato s'ishin tjetër veçse gjuha e fjala e tij, s'ishin tjetër veçse kënga më e zakonshme e shkrirjes së gizës e të çelikut dhe e përpunimit të tyre. Ja, këto dëgjonin atë ditë nëntori Kolë Boçari dhe shoku i tij i vjetër i luftës dhe i pasluftës. Këto dëgjonin... Por ndoshta as i dëgjonin, sepse ato zhurma ishin integruar me kohë me qenien e tyre, ishin kthyer me kohë në një harmoni të përrjetshme, që u përkëdhelnin veshët pa u vënë re. E sigurtë ishte që ata rrinin ulur përballë njëri-tjetrit mbi kodrën e litarëve të ambalazhit, pinin duhan dhe flisnin për një plakë tetëdhjetëvjeçare, për nënën e dëshmorit Bujar Tamili. Kjo po, kjo ishte e sigurt.

Tha Kola:

— Ti e kupton ç'do të thotë furrë elektrike për një plakë, që tërë jetën e ka kaluar në shtëpi rreth një zjarri të vogël të një vatre të vogël. Ne hipëm atje kur njëra nga furrat ishte në fazën e fundit apo në fazën e tretë të shkrirjes, që në gjuhën e metalurgëve e quajnë periudha e reduktimit, sepse në këtë periudhë hiqen nga çeliku i shkrirë të gjitha papastërtitë, hiqen oksigjeni, ajri, gazrat, elementët jometalorë. Kishte kaluar periudha e parë. Siç e di edhe ti vetë, bunkeri e kishte futur skrapin në furrë, pulti i komandimit e kishte lëshuar tensionin, elektrodat e kishin krijuar harkun, zhurmën, nxehësinë, metalurgët i kishin bërë të gjitha të tjerat, kishin bërë edhe fryrjen me oksigjen, që ngrenë një zhurmë tepër të thatë, të ashpër e që ngjan me atë koristin apo orkestrantin kur shkel një apo njëqind nota fals. Kishte kaluar edhe ajo që quhet periudha e dytë apo periudha e oksidimit, kur merren disa herë kampione dhe çohen në laborator për të kontrolluar karbonin se mos është më i lartë nga kërkesat e markës e kur me capinj hiqen skoriet, që pengojnë procesin e mëtejshëm të shkrirjes. Të gjitha këto kishin kaluar. Ne shkuam kur furra ishte në periudhën e tretë, domethënë kur skrapin apo hekurishtet hedhurina ishin shkrirë plotësisht e kur nga deriçka dukej atje brenda çeliku që valonte si ujë i zjarrtë. Ti e merr me mend çudinë e plakës kur

pa valimin e atij uji të zjarrtë, që dukej sikur vjen rrotull për të gjetur ndonjë të çarë, për t'u derdhur jashtë e për të përcëlluar e djegur çdo gjë që gjen përpara. Plaka shikonte, po edhe dëgjonte, pa lëvizur një qime, pa përplasur një herë qepallat, pa thënë një fjalë. Metalurgët, që e dinin si qëndronte puna, diçka kisha arritur t'u pëshpërisja, morën një karrige nga pulti i komandimit, e ulën plakën dhe herë pas here i sillnin nga një shishe të ftohtë me ujë të gazuar. Sigurisht që ishim djersitur, jo vetëm nga furra, por edhe nga ajri i ngrohtë. Ishte fillimi i shtatorit, plot dy muaj më parë.

— Dërguan përsëri kampione në laborator dhe kjo punë, siç mund ta dish, vazhdon derisa skoria e re merr ngjyrën e bardhë. Kur metalurgët u bindën se nga çeliku ishin hequr mbeturinat e fundit të oksigjenit, atëherë u dha komanda e derdhjes. Vetëm këtu plaka bëri një lëvizje, por jo të ndërgjegjshme, më shumë instinktive, dhe nuk kuptohej pse e bëri, si për t'u mbrojtur, apo si për të shprehur kulmin e çudisë. Kjo lëvizje qe një zbrapsje e vogël, aq sa kurrizi i saj zuri vend në mbështetësen e karriges. Kjo ndodhi kur, pas komandës, dikush shkeli një buton në pultin e komandimit dhe atëherë tërë ajo furrë, që plaka mund ta krahasonte nga madhësia me shtëpinë e saj të vogël në Vlorë, lëvizi. Në fillim lëvizi kapaku, çatia e shtëpisë. Ai u ngrit lart. Furra — shtëpia pa çati — sikur eci përpara si mbi rrota. S'mjaftoi me kaq, pas pak ajo zuri të anohej e në të njëjtën çast një vinç-urë kishte lëvizur mbi kokën tonë nën tavanin e uzinës, duke hallavitur nëpër ganxhat e tij të trasha një bunker, që ishte më i madh se të gjithë kazanët që mund të kishte parë plaka të marrë së bashku. Këto shprehje m'i tha ajo vetë, por m'i tha më vonë në, kur ishim në shtëpi. Të gjitha këto ndodhnin në të njëjtën kohë e, kur bunkeri kishte zënë vend nën furrën e anuar, currili i ujit të ndezur filloi të rridhte në grykën e tij. Këtu plaka bëri një lëvizje të dytë, por qepallat e saj nuk ishin përpëlitur asnjëherë. Lëvizja e dytë kishte të bënte me shkëputjen e kurrizit të saj nga mbështetësja e karriges dhe me kërrusjen e bustit në drejtim të çelikut të shkrirë, që binte në bunker. M'u duk sikur tha:

— Litar i ndezur!

Tha Kola:

— Ndoshta s'kishte thënë kështu. Ndoshta më kishin bërë veshët, se vinçieri, për të parandaluar ndonjë aksident atje poshtë, i binte vazhdimisht borisë.

— Kurse unë, — tha Kola, — të të them të drejtën, megjithëse i kam shikuar shpesh këto procese, sa herë që ndodhem pranë furrës elektrike dhe shikoj metalurgët e rinj, them me vetë afërsisht se këta janë ata, gjyshërit e të cilëve deri dje, por edhe ndonjë nga etërit, shkonin nëpër kisha e xhami, sepse kishin frikë nga e nesërmja, sepse kishin frikë nga zoti dhe i besonin xhehenemit. Kurse bijtë e tyre, me atë që të vjetrit e përfytyronin për xhehenem — me furrën elektrike — shkrijnë çelik.

— Edhe një herë tjetër plaka m'u duk sikur tha prapë diçka. Kur nga bunkeri rrjedh çeliku i shkrirë, litari i ndezur, për të mbushur ato që quhen konkile, me një fjalë kur çeliku futet në kallëpë, ti e di, atë mizëri të madhe xixash që mbulon platformën, si të kenë shkrepur në një hasër vend njëqind rrufe bashkë. Ndodh që punëtorët të humbasin të rrethuar e të mbuluar nga këto xixa. Unë vetë u trondita kur e pashë për herë të parë atë grumbull zjarri të shkërmoqur, kurse plaka, hiç, as thirri, as lëvizti, as përplasi qepallat. Vetëm m'u duk sikur tha:

— E-e-e-e!

Tha Kola:

— Të them të drejtën, unë prita përsëri që plaka të përlofej, kisha pritur të përlofej kur zbritëm nga autobusi. Rrugës, kur shikonte të lëvizte gjithë atë rini, që ishte në moshën e Bujarit partizan apo në moshën e atyre që duhej të ishin djemtë apo vajzat e Bujarit, në moshën e nipave dhe të mbesave të saj. Prita të përlofej në bufe, ku dy nëna të tjera kishin ardhur të takonin bijtë e tyre. Por ajo nuk u përlot as aty. Prita që një gjë e tillë të paktën të ndodhte pranë furrës elektrike, ku ajo pandehte se pikërisht aty kishte qenë varri i të birit, por jo. Jo e jo. Nuk u përlot as kur u larguam nga Kombinat. Ku ta dish, edhe ne vetë nuk i njohim nganjëherë nënat tona, ose pak be-

sojmë që edhe ato kanë ndryshuar, janë bërë më të forta sesa kanë qenë.

— Vetëm kur shkuam në qytet, vetëm kur unë i dhashë kafen e dytë në shtëpinë time, atëherë nga rrudhat që e prisnin fytyrën e saj horizontalisht e vertikalisht u rrokullisën dy pika lot, por dy pika të mëdha. Ajo i fshiu lotët me mollëzat e gishtave dhe po atë çast m'u duk se nuk kisha parë kurrë një plakë tjetër që të ishte aq e ëmbël, aq e ndjeshme, aq e dhimbshur sa ç'ishte ajo, nëna e dëshmorit Bujar Tamili.

Befas dy pika të tjera lotësh i ngecën përsëri në mes të faqeve. Ndoshta, për t'i fshehur nga unë, ajo ktheu kokën pak mënjatë dhe shikoi në dritare. Tashti që lotët kishin thithur shkëlqimin e diellit, me ngjyrën e tyre të ndezur m'u dukën si dy pika çeliku të shkrirë që rrokulliseshin tatëpjetë zhubrave të flakës. Ajo i fshiu prapë ata e, kur u kthye nga unë, m'u bë sikur shikova jo atë, por të birin Bujar Tamilin, se edhe ai partizani e marangozi i dikurshëm, i tillë kishte qenë, i ëmbël, i dhimbshur dhe vjershat e tij për Shqipërinë e ardhshme ne i këndonim gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, i këndojmë edhe sot.

PASQYRA E LËNDËS

Një punëtor	3
Kandidati (novelë)	23
Takti	109
Ishte ngrohtë, ishte bukur	124
Mirazh (novelë)	137
Në det	195
Udhëtimi i mbretërve me trenin e parë Elbasan-Tiranë	224
1944-1977.	248

Tirazhi 10.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204 - 72

KOMBINATI POLIGRAFIK - Shtypshkronja e Re Tiranë, 1978